BIBLIOTEKA KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE E KOSOVËS
THE NATIONAL AND UNIVERSITY LIBRARY OF KOSOVA

KONFERENCA KOMBËTARE E BIBLIOTEKONOMISË

2

Prishtinë
2008

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës
Botime të Veçanta: ***KONFERENCA KOMBËTARE E BIBLIOTEKONOMISË, 2***
EDICIONI II, 20 - 22 NËNTOR 2007, PRISHTINË

Botues:
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

Kryeredaktor i botimeve:
Prof. Dr. Sali Bashota

Këshilli redaktues:
Fazli Gajraku
Besim Kokollari
Bukurije Haliti

Dizajni dhe realizimi kompjuterik:
Hekuran Rexhepi

BKUK Botime të Veçanta; 12: Konferenca Kombëtare e Bibliotekonomisë, 2

BIBLIOTEKA KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE E KOSOVËS
DHE
BIBLIOTEKA KOMBËTARE E SHQIPËRISË

KONFERENCA KOMBËTARE E BIBLIOTEKONOMISË
"BIBLIOTEKA DHE KUJTESA KOMBËTARE"

(EDICIONI II)
20 - 22 NËNTOR 2007

Materialet e punimeve të Konferencës Kombëtare të Bibliotekonomisë

PËRMBAJTJA

BIBLIOTEKA DHE KUJTESA KOMBËTARE 7
Prof. dr. Sali BASHOTA

KOSOVA NË SHEKULLIN XVII SIPAS RELATORËVE SHQIPTARË 13
MA. Gjon BERISHA

BIBLIOTEKAT DIGJITALE DHE KUJTESA KOMBËTARE KONFLIKT DHE/OSE HARMONI 25
Etleva DOMI

TRINOMI BIBLIOTEKË - ARKIV - MUZE DHE KULTURA KOMBËTARE 33
Farfuri XHAJA
Alda BIÇOKU

RUAJTJA DHE ZHVILLIMI I KOLEKSIONEVE TË VEÇANTA NË BIBLIOTEKËN KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE TË KOSOVËS 41
Muharrem HALILI

ARRITJE DHE MUNDËSI TË REJA PËR NDRIÇIMIN E VLERAVE TË RRALLA TË KUJTESËS KOMBËTARE 47
Mejli KOKONA

BIBLIOTEKAT E PARA NË PRIZREN DHE LIBRAT E VJETËR 55
Sahadete SADIKAJ

HARTAT E SHEK. XVI - XIX, PJESË E KUJTESËS KOMBËTARE 61
Afërdita SHARRXHI

MOSDOKUMENTIMI APO KËRKIMI I SË HUMBURËS 71
Fazli GAJRAKU

LIBRI I DEKADAVE TË PARA TË SHTETIT SHQIPTAR: DUKURI DHE PROBLEME BIBLIOTEKONOMIKE SIPAS BIBLIOGRAFISË RETROSPEKTIVE 79
Maksim GJINAJ

POEZIA SHQIPTARE NË KOSOVË 1953 - 1980 - (Vështrim historik) 85
Mr. Tahir FONIQI

DIGJITALIZIMI I KATALOGËVE ME SKEDA TË VLERAVE TË RRALLA TË BIBLIOTEKËS KOMBËTARE 91
Behije LUGA
Mirlona BUZO

BIBLIOTEKA DIGJITALE NË SHËRBIM TË KUJTESËS SË KOSOVËS 103
Besim J. KOKOLLARI
Ramush ZEKA

KRIJIMI I SISTEMIT TË PËRBASHKËT TË INFORMACIONIT PËR VLERAT KOMBËTARE, DUKE SHKUAR DREJT UNIFIKIMIT TË KATALOGIMIT 121
Marjeta DACI

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË KATALOGUT TË PËRBASHKËT TË BIBLIOTEKAVE NË KOSOVË 127
Bukurije HALITI

KONVERTIMI RETROSPEKTIV: SFIDA DHE ARRITJE 131
Mirela MERSINI
Teuta SULA

TRASHËGIMIA KOMBËTARE E SHKRUAR DHE PUBLIKU 147
Ramazan VOZGA

FOTOGRAFIA - DËSHMI E KUJTESËS KOMBËTARE 155
Mr. Jetish KADISHANI

ZHVILLIMI I KOLEKSIONEVE NË BIBLIOTEKËN PUBLIKE DHE MENAXHIMI I TYRE 163
Sylejman PIREVA

FONDET ALBANOLOGJIKE NË BIBLIOTEKAT E SHKODRËS 169
Gjovalin ÇUNI

TRASHËGIMIA KULTURORE E BOTUAR DHE EKZEMPLARI I DETYRUESHËM 181
Lavdije RRAHMANI

ANIMIMI I KRIJUESVE DHE PËRDORUESVE PËR BIBLIOTEKAT E MUZIKËS 189
Edona MUNISHI - KOKOLLARI

BIBLIOTEKA PRIVATE, PJESË E TRASHËGIMISË KULTURORE KOMBËTARE 199
Violeta VISO

REZOLUTË: KONFERENCA KOMBËTARE E BIBLIOTEKONOMISË "BIBLIOTEKA DHE KUJTESA KOMBËTARE" (EDICIONI II) 207

BIBLIOTEKA DHE KUJTESA KOMBËTARE

Prof. dr. Sali BASHOTA
Drejtor i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës

Rëfimi për një Bibliotekë nacionale mund të sajohet nga shumë fjalë të zgjedhura, të urta, mbase, jo rrallë, edhe të shenjta, të shndërruara në histori apo në gojëdhënë. Kujtesa *e saj* apo kujtesa *për të*, mund të shndërrohet, gjithashtu, në një simbol komunikimi me të tjerët dhe prapë do të mbetet si gjithnjë vetëm historia e Librit dhe e Bibliotekës.

Siç është e njohur, tekstet në formën e shkruar e sajojnë dhe i përgjigjen gjenealogjisë së një kombi dhe të një civilizimi, prandaj çdo popull identitetin e vet e fillon me shkrimin, pra me datëlindjen e shkrimeve të para në gjuhën e tij. Në këtë kontekst, Biblioteka, si vend i shkrimeve, i doreshkrimeve, i librave të moçëm e të rinj, i hartave, i fonodokumenteve, i fotodokumenteve dhe i koleksioneve të tjera , e prodhon vetë në kujtesën e shekujve historinë e njerëzimit në periudha të caktuara, madje edhe historinë e fjalës së shkruar.

Tani kujtesa, lidhet me shkrimet e vjetra që u nevojiten gjeneratave të reja.

Biblioteka dhe Kujtesa Kombëtare , që është caktuar temë kryesore për debat dhe ligjërim në edicionin e dytë të Konferencës Kombëtare të Bibliotekonomisë,

organizuar nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, me kontributet e ekspertëve të bibliotekave shqiptare, mund të ofrojë një prezantim mjaft të rëndësishëm dhe me interes shkencor e kulturor, pikërisht në inicimin, zhvillimin, realizimin e një projekti madhor, që do të mund të quhej *Kujtesa Shqiptare*.

Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë dhe Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, si iniciues të mundshëm të këtij projekti të përbashkët nacional me emrin *Kujtesa Shqiptare,* doemo*s,* do të kenë rolin kryesor në grumbullimin, seleksionimin, sistemimin dhe digjitalizimin e materialeve të veçanta, për t'iu ofruar lexuesit një qasje të lirë në botën e internetit, sidomos për të kaluarën dhe të ardhmen e shqiptarëve, nëpër periudha të ndryshme historike.

Po kështu, *Kujtesa Shqiptare*, si e tillë, do të mund të përmblidhte imagjinatën e shkrimtarëve, artistëve, teoricienëve, filozofëve, psikologëve, shkencëtarëve etj., pikërisht atë imagjinatë kreative të shndërruar në vepra të dijeve të ndryshme, që do ta përbënte një bibliotekë, doemos, me idetë dhe mendimet që, po ashtu, do të funksiononin përmes gjuhës së komunikimit, në shumë rrafshe receptimi.

Kudo në botë, bibliotekat nacionale të çdo shteti, i kanë format e veta të mbledhjes së materialeve të dokumentuara, qoftë të trashëgimisë së shkruar, qoftë të trashëgimisë gojore, për t'i dhënë prioritet historisë, gjuhës, kulturës etj., për të ndërtuar një *Depo Qiellore,* që e ka kuptimin e *Gjithësisë,* siç do të thoshte Umberto Eco.

Prandaj, në këtë *Depo Qiellore,* përparësi do të kenë materialet me vlerë të veçantë dhe unikate nacionale, që do ta dokumentonin lashtësinë, gjuhën, identitetin, qytetërimin, kulturën etj.

Historia e një kombi, nuk mund të njihet, të shkruhet a të rishkruhet, madje të vlerësohet pa thesarin a trashëgiminë e një biblioteke nacionale të atij vendi, duke iu rikthyer vazhdimisht kujtesës kombëtare në fazat e zhvillimit të asaj kulture a qytetërimi të lashtë të popullit që i takon.

Biblioteka e humbur, si ajo e Aleksandrisë apo Biblioteka e pushtuar, madje edhe me fondet e saja të asgjësuara në dhjetëvjetëshin e fundit të shekullit XX, siç është Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, si dhe shumë biblioteka të tjera në botë, e kanë krijuar ekzistencën dhe historinë e tyre, në variante të ndryshme të gjëllimit.

Mirëpo, përbrenda plotnisë së identitetit dhe kulturës kombëtare, rrugëtimi ynë historik, i veçantë dhe i përbashkët, kuptohet me kufi të ndarë, nuk ka qenë i njëjtë, pra ka qenë i ndryshëm, prandaj edhe kujtesa e lexuesit shqiptar, iu është nënshtruar, herë diktatit e ideologjisë, herë anatemimit e pushtimit.

Pra, kështu ka ndodhur edhe me kujtesën e lexuesit për një letërsi nacionale, siç është letërsia shqipe, kur ajo madje është ndarë në përparimtare e reaksionare. Pra, kështu ka ndodhur me personalitetet letrare: Fishta, Konica, Koliqi, Harapi, Pllumi, Pipa etj.

Ekziston kujtesa e lexuesit nëpër kohë dhe hapësirë të caktuar, e cila do të dëftonte se tekstet e shtypura, librat e moçëm, filmat, fotografitë etj., të grumbulluara, të ruajtura, të sistemua dhe së fundi të prezantuara para opinionit, kanë rëndësi të madhe në ndriçimin e asaj që quhet kujtesë nacionale në retrospektivë, por edhe në perspektivë.

Në këtë pikëshikim, historia dhe kultura shqiptare në Kosovë dhe Shqipëri, edhe pse e një shtrati gjenetik, është zhvilluar përbrenda kontekseve të ndryshme shoqërore e politike, jo rrallë, është fragmentarizuar e çintegruar deri në absurditet, duke mbetur, jo rrallë, vetëm si kujtesë shpirtërore nga distanca.

Kujtesa Shqiptare është sajuar me përplot absurde dhe paradokse, sidomos në gjysmën e dytë të shekullit XX , kur ka kaluar nëpër periudha fatkeqësie përbrenda kontekstit ideologjik (në Shqipëri) dhe pushtues (në Kosovë). Tani dokumentimi dhe prezantimi digjital i kësaj Kujtese kërkon një hulumtim shkencor, pikërisht në ndriçimin e kësaj periudhe tepër të dhembshme.

Në anën tjetër, Kosova nuk ka ndonjë traditë të lakmueshme, sa i përket grumbullimit dhe ruajtjes së dokumenteve më rëndësi nacionale, për arsye se fati dhe perspektiva e saj është varur nga të tjerët. Në periudhat e pushtimit të saj, sidomos në luftën e fundit, janë shkatërruar, djegur, zhdukur shumë thesare të çmueshme dhe me rëndësi të veçantë kombëtare, por edhe monumente historike e kulturore me vlerë të jashtëzakonshme, të cilat do të tregonin për identitetin shqiptar të saj.

Në dhjetëvjetëshin e fundit të shekullit XX, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, si dhe shumë biblioteka tjera publike dhe private në Kosovë, kanë përjetuar fate të tmerrshme. Derisa në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës brenda viteve 1991- 1999, janë asgjësuar mbi njëqind mijë ekzemplarë librash të ndryshëm dhe janë shndërruar në kartuç në një fabrikë letre në një qytet të vogël të Kosovës, shumë biblioteka publike dhe private janë rrënuar, shkatërruar dhe djegur. Prandaj, djegia e librave dhe e bibliotekave në Kosovë, është njëri ndër kapitujt më të dhembshëm, nga mund të rrëfehet për përmasat e luftës në Kosovë.

Në vitin 2006, Biblioteka dhe Universitare e Kosovës, e ka inicuar projektin *Kujtesa e Kosovës*, sipas modelit *American Memory* (*Kujtesa Amerikane*), i Bibliotekës së Kongresit, i cili synon të jetë njëri ndër projektet më kapitale që mund të determinojë rolin dhe misionin e historisë, kulturës, qytetërimit, identitetit, shëmbëlltyrave, personaliteteve, trashëgimisë gojore, trashëgimisë së shkruar në periudha të caktuara historike, me qëllim të prezantimit të kësaj kujtese përmes informacioneve digjitale.

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, duke e filluar këtë projekt, do të bëhej, gjithsesi, një pikë e veçantë referimi, bashkë me institucionet tjera (muzetë, arkivat, institutet etj.), për të krijuar një koleksion dokumentar, qoftë madje edhe për ngjarjet politike, shoqërore që nuk i përkasin vetëm burimeve të komunitetit kosovar, por edhe më gjerë, që ndërlidhen pikërisht me çështjen shqiptare në kohë dhe periudha të ndryshme.

Në strategjinë e realizimit të një projekti gjithëpërfshirës për themelimin e koleksioneve digjitale të *Kujtesë së Kosovës*, e cila faktikisht është njëra nga portat e *Kujtesës Shqiptare* , është më rëndësi krijimi i fondeve nga burime qeveritare dhe alternative, si dhe bashkëpunimi me institucione të shumta në botë, që i posedojnë dokumentet shqiptare dhe për shqiptarët.

Po kështu, prioritet do të mund të kenë: koleksionet për personalitetet nacionale me përmasa botërore, siç janë Skënderbeu dhe Nënë Tereza, pastaj koleksionet e librave të rrallë dhe të vjetër, koleksionet e hartave, fotodokumenteve, fonodokumenteve etj.

Në grumbullimin e materialeve me vlerë, në sistemin, përzgjedhjen dhe krijimin e koleksioneve digjitale, rol të rëndësishëm do të ketë informacioni për historinë gojore dhe historinë e shkruar. Në këtë drejtim, kontributi i arkivave, i muzeve, i institucioneve historike, akademike, albanologjike, etnografike në Kosovë, Shqipëri, në viset tjera shqiptare, pastaj në ish-kolonitë shqiptare në Turqi, Itali, Rumani, Bullgari, Egjipt, Amerikë etj., do të ishte me rëndësi të dorës së parë.

Cilat do të ishin burimet për krijimin një koleksion digjital kombëtar në të ardhmen?

Natyrisht, në këtë drejtim do të mund të kenë rol të rëndësishëm shumë pjesëmarrës: gjithsesi, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, pastaj Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, pastaj arkivat, muzetë, institutet, institucionet fetare në Shqipëri dhe Kosovë. Në ketë drejtim, themelimi dhe funksionimi i bibliotekave presidenciale, i bibliotekave të personaliteteve apo i bibliotekave private etj., do të kontribuonin në afirmimin dhe ndriçimin e vlerave nacionale nëpër periudha të ndryshme të historisë.

Njihen raste të ndryshme në botë ku shumë biblioteka janë shkatërruar dhe nuk janë ruajtur më, ku shumë biblioteka janë djegur dhe nuk janë ndërtuar më. Biblioteka përmes ndriçimit të kujtesës kombëtare, e funksionalizon të kaluarën me të tashmen, duke dhënë vizion për të ardhmen.

Sa i përket gjendjes në bibliotekat e Kosovës, ende në bibliotekat tona mungojnë shkrimet, zërat për figurat e shquara të kombit shqiptar, për personalitetet kulturore, politike, pastaj mungon historia e largët dhe e afërt e Kosovës. Pra, mungon përmbajtja, si dhe ndërtimi i *Kujtesës së Kosovës*.

Pra, mungojnë burimet historike, trashëgimia kulturore, dorëshkrimet e lashta, dorëshkrimet origjinale, mungon pjesa e historisë së Kosovës, e cila do të mund të gjendej në arkiva dhe biblioteka të Evropës.

Në këtë mënyrë, strategjia e zhvillimit të bibliotekave shqiptare ndër të tjera, e nënkupton edhe funksionalizimin e kujtesës nacionale përmes një diskursi të ri të shkencës së bibliotekarisë dhe të informacionit. Pra*, e reja* duke iu rikthyer *të vjetrës*, do t'i gjejë prioritetet e afirmimit të vlerave elitiste nacionale nga momentet historike në momente të aktualitetit.

Debati ynë këtu, me ekipe ekspertësh nga Tirana dhe Prishtina, në relacionin *Biblioteka dhe Kujtesa Kombëtare*, është një kërkim pasionant, dashurues e shumë domethënës, jo vetëm për dy bibliotekave tona qendrore, që e kanë fundja shenjën e përbashkët nacionale, por edhe për bibliotekat shqiptare në përgjithësi, për ato private, shkollore, universitare, shkencore, akademike etj.

Projekti për funksionalizimin dhe digjitalizimin e *Kujtesës Shqiptare*, tashti në rrjetin global të *Kujtesës Botërore*, do ta funksionalizonte një kujtesë të fuqishme nacionale, qytetëruese e kulturore, fjala vjen, po t'i kishte të gjitha librat a dokumentet e shkruara e të botuara për Skënderbeun dhe Nënë Terezën, si dhe për personalitete të tjera të njohura në përmasa botërore në periudha të ndryshme, për të dokumentuar ekzistimin e civilizimit shqiptar në mijëvjeçarë, duke iu referuar edhe koleksioneve të shumta albanologjike, të pranishme në jo pak biblioteka, arkiva, muze në botë.

Besoj dhe shpresoj se kjo Konferencë, do të iniciojë shumë ide të frytshme e të vlefshme, si dhe do të sjellë rezultate të caktuara në fushat e hulumtimit, përkitazi me temën bosht. Natyrisht, mbështetja e institucioneve qeveritare në Kosovë dhe Shqipëri, për projekte të këtilla me interes të veçantë nacional, do të ishte e ardhmja e kulturës, e librit dhe e bibliotekave shqiptare në përgjithësi.

Uroj punë të mbarë, pjesëmarrësve të Konferencës Kombëtare të Bibliotekonomisë në Prishtinë. Suksese në projektet tona të përbashkëta, siç do të jetë edhe kontributi ynë në inicimin, zhvillimin dhe realizimin e projektit: *Kujtesa Shqiptare*.

KOSOVA NË SHEKULLIN XVII SIPAS RELATORËVE SHQIPTARË

MA. Gjon BERISHA
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

Gjatë shekujve XVII-XIX, Kuria Papnore, në mbrojtje të besimtarëve vendës, dërgoi edhe në viset shqiptare një numër të madh misionarësh françeskanë e jezuitë, një pjesë e madhe e të cilëve ishin shqiptarë të shkolluar në Romë. Në një mbledhje të organizuar nga papa Gërguri XV të datës 6. XII. 1622, në të cilën themelohet *Kongregacioni i Propagandës Fide*, theksohej se për punën e suksesshme politike dhe fetare të misionarëve është e domosdoshme njohja e gjuhës shqipe.

Seria e rregullt e relacioneve (raporteve) të hollësishme të dërguara nga kleri vendas këtij institucioni, përmban burime jashtëzakonisht të pasura të informacionit për kushtet në Kosovë që nga shekulli XVII deri në shekullin XIX.

Këta misionarë katolikë të dërguar nga Roma në këto vise të Ballkanit janë të merituar për hapjen dhe zhvillimin e shkollave shqipe, për zhvillimin e gjuhës

dhe letërsisë shqipe dhe për ruajtjen e të dhënave të shumta nga terreni në formë të raporteve dhe relacioneve.

Prej vitit 1622, relacionet dhe korrespodencat ishin të organizuara dhe të dendura, sepse Kongregacioni kërkonte përpikëri në dhënien e informatave të cilësdo natyrë.

Përveç prelatëve që ishin në krye të dioqezave, përveç misionarëve, të cilët dërgonin në Romë çdo informatë me rëndësi, kohë pas kohe ishin nisur në viset shqiptare edhe vizitorë ose inspektues apostolikë, me detyrën e inspektimit të përgjithshëm.

Këto raporte që dilnin nga dora e këtyre misionarëve, janë të dhëna dokumentare të dorës së parë, nëpërmjet të cilave sot dëshmohet një pjesë e kujtesës sonë historike. Në këto relacione e korrespodenca, përveç çështjeve kishtare, mësojmë edhe për jetën e përditshme, kulturën materiale e shpirtërore, për arsimin, demografinë etj., të popullit shqiptar të këtyre viseve. Disa prej këtyre misionarëve, përveç raporteve dërguar Papatit, ata kanë shkruar edhe vepra në gjuhën shqipe, latine, italiane etj., dhe në disa raste ishin edhe në krye të kryengritjeve të armatosura kundër sundimit turk.

Tanimë, njihen prej të gjithëve vlerat që kanë për studimet historike relacionet dhe korrespodencat e klerit misionar që Roma kishte shpërndarë në të gjithë anët e botë. Kjo shihet edhe nga fakti se pothuajse nuk ka asnjë studim që të jetë marrë me këtë shekull (XVII) të historisë shqiptare që mos t'i këtë shfrytëzuar këto burime.

Pjesa më e madhe e këtyre relacioneve dhe korrespodencave të relatorëve shqiptarë janë ruajtur dhe ruhen në Arkivin i Propagandës Fide në Romë, pastaj në Arkivin e Kuvendit të Shën Mëhillit në Venedik, në Arkivin e Bibliotekës Kombëtare të Napolit etj, në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë, etj.

Për numrin e madh të këtyre materialeve në Arkivin e Propagandës Fide, të dhëna të çmueshme ka ofruar qysh në vitet tridhjeta të shekullit XX, studiuesi i njohur frëng- i dokumenteve të vjetra të gjuhës shqipe Mario Rok (Roques).[1] Rëndësia e këtyre materialeve burimore të kësaj natyre ka qenë vënë në dukje prej kohësh. Kjo ka bërë që disa relacione të veçanta të botohen nga disa studiues që në shekullin XIX.

Një ndër relacionet e para të botuara është ai i Marin Bicit, i cili përmban të dhëna të shumta për qytetet e Kosovës. Relacioni i Marin Bicit, për qëllimin për të cilin është shkruar, për përmasat e tij dhe për çështjet që shtrohen në të, është padyshim një nga monumentet më të çmueshme që kemi për këtë kohë. Ky relacion u botua më 1888 në Zagreb nga historiani dhe paleografi i njohur kroat Franjo Rački në numrin XX të revistës STARINE të Akademisë Jugosllave të Shkencave (*F. Rački, Izveštaj barskoga nadbiskupa Marina Bizza o svojem putovanju god. 1610, po Arbanaskoj i staroj Srbiji, në: Starine JAZU, XX, Zagreb 1888, 51-156*). Këto relacione më pas janë botuar pjesërisht në revistën "*Zani i Shna Ndout*", në Shkodër më 1917-1920 dhe vazhdoi pastaj edhe në revistën tjetër "*Hylli i Dritës*" më 1914.

Relacionet e vizitorit apostolik Pjetër Mazrekut, janë botuar në vitin 1938, po ashtu në Starine në numrin XXXIX, me titull: "Relacioni i vizitorit apostolik Pjetër Mazrekut gjatë viteve 1623-24*" (Izveštaj apostolskog vizitora Petra Massarechia iz godine 1623-24, në: Starine JAZU, knj. XXXIX, Zagreb 1938*).

Në formë fragmentare relacionet e misionarëve të shekullit XVII, janë botuar edhe nga Fulvio Cordignano, gjatë përgatitjes së një vepre mbi gjeografinë kishtare shqiptare (*F. Cordignano, Geografia ecclesiastica dell'Albania,dali gultimi decenni del secolo XVI alla meta del secolo XVII, në: Orientalia Christiana, nr. 99, Roma 1934*.)

Ndër studiuesit që kanë i kanë përdorur dhe botuar këto relacione të shekullit XVII, duhet përmendur edhe studimin e studiueses Fernanda Granata me titull: "*Shqipëria dhe misionet italiane në gjysmën e parë të shekullit XVII në bazë të dokumenteve të pabotuara*", të cilën e botoi në revistën Rivista d'Albania, (*F. Granata, L'Albania e le Missioni italiane nella prima meta del secolo XVII in base a dokumenti inediti, në: Rivista d'Albania, nr. III/IV, 1942, 226-248*).

Ai i cili ka arritur që t'i përdorë gjerësisht materialet e nxjerra nga Arkivi i Propagandës Fide, është Jovan Radoniqi, në veprën e tij: "Kuria romake dhe vendet jugosllave në shekujt XVI-XIX (*J. Radonić, Rimska kurija i južnoslovenske zemlje od XVI do XVII veka, Beograd 1950*), ndonëse, Radoniqi me këtë botim bën një trajtesë dhe jo një botim të plotë të dokumentacionit, megjithatë botimi i tij në formë të dokumenteve të përmbledhura, është i rëndësishëm sidomos për Kosovën. Kjo ndodh për faktin se autori kishte për qëllim t'i shtrojë çështjet që u përkasin vendeve sllave dhe prandaj citatet e nxjerra nga Radoniqi kanë të bëjnë edhe me Kosovën.

Disa relacione të Nikollë Mekajshit (vitit 1610), Budit (relacioni i vitit 1621) dhe P. Bogdanit (vitit 1685) u botuan nga A. Theineri, në përmbledhjen e dokumenteve me titull: "Dokumente të vjetra që hedhin dritë mbi historinë e sllavëve të Jugut, të mbledhura nga Arkivat e Vatikanit"(*Theiner, A., Vetera mon-*

[1] M. Roques. Gjurmime mbi tekstet e vjetra shqipe, në: Buletin shkencor i Instituti Pedagogjik dyvjeçar të Shkodrës. Shkodër, 1964, nr. i posaçëm; nr. 3, 1965.

umenta Slavorum Meridionalium Historiam Illustrantia, tomus II, 1524-1800), Zagrebiae 1875, nr.CXXXIV, 111, nr. CCXXXIII, 217-221).

Puna më e madhe në mbledhjen, botimin dhe përkthimin e këtyre dokumenteve në gjuhën shqipe, është bërë nën kujdesin e Injac Zamputit në dy vëllime me titull: "*Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore e të Mesme në shekullin XVII, vëllimi I-II, USHT, Tiranë 1963, 1965*). Ndër botimet e kohëve të fundit duhet veçuar botimin e letrave të Bogdanit, të studiueses Odette Marquet, me titull: "Pjetër Bogdani, letra dhe dokumente nga Arkivi i Kongregatës "de Propaganda Fide" si dhe nga Arkivat Sekrete të Vatikanit, Shkodër 1997". Relacionet e Pjeter Bogdanit, janë botuar edhe nga studiuesi E. Sedaj në një studim të botuar me titull: "Relacionet e Pjetër Bogdanit mbi gjendjen shpirtërore të Shqipërisë e të Serbisë (1666-1684)"në vitin 1985.[2]

Këta misionarë përmendin në relacionet e tyre se jo vetëm në fshatrat e shumta, por edhe qytetet me rëndësi, sikurse Prizreni, Gjakova, Peja, Shkupi etj., kanë një numër të konsiderueshëm për popullsisë shqiptare.[3]

Një ndër relatorët e parë, i cili konsiderohet edhe si pararendës i relatorëve të tjerë, i cili na ofron të dhëna për Kosovën, është Argjipeshkvi i Tivarit Marin Bici.

Për Prizrenit në fillim të shekullit XVII, më së miri na njofton Marin Bici (1610). Sipas tij, aso kohe kishte 8 600 shtëpi shumë të mëdha që pothuaj të gjitha i kishin oborret e veta si shtëpitë fshatare në Itali. Prizreni ishte i pasur gjithkund me kroje dhe ujëra të rrjedhshëm, që sillnin rrotat e mullinjve dhe bënin qytetin të pasur dhe plot kënaqësi. Në qytet tingëllonte një kambanë përmbi njërën nga minaret e shumta që ishin pranë xhamive të tyre, dhe rrihnin orët e një sahati që disa francezë ua kishin ndërtuar turqve (myslimanëve), punë e jashtëzakonshme e Perandorisë Osmane. Aty kishte rreth 30 shtëpi latinësh, me titullin Zojës së Ngritur në Qiell.[4]

Po ashtu, imzot Marin Bici, argjipeshkëv i Tivarit në relacionin e tij të vitit 1610, dërguar Selisë së Shenjtë (Vatikanit), ndër të tjera pohon se, gjatë vizitës së tij baritore në famullinë e Trepçës, thotë: "*se Trepça asht qytet me 500 zjarre me 40 ose pak gja ma shumë shtëpi latinësh (...) edhe në këtë vend ka sasi të madhe argjendi. Nuk ka kishë në qytet por përjashta* (në Stani Tërg Gj. B.)". Ky është raporti më i vjetër që njohim për këtë kishë. Shënimet e tij janë posaçërisht të rëndësishme, sepse përmbajnë të dhëna mbi vendin se ku ka qenë kisha, mbi materialin nga i cili ka qenë i ndërtuar dhe mbi freskat murale. M. Bici, si duket ka qenë i vetmi që e ka gjetur kishën në gjendje të plotë, meqë udhëpërshkruesit e tjerë të cilët e kanë vizituar, flasin se kjo kishë ka qenë në gërmadhë. Argjipeshkvi Bici në relacionin e tij shkruan: "*kjo kishë është shumë e bukur dhe e ndërtuar shumë mirë nga guri i përpunuar i travenitit (latuar), kurse në brendësi e tërë është e mbuluar me piktura, e pajisun me kelqe, me kryqa t'argjend dhe me veshje të mira* ".[5] Kurse, tridhjetë vjet më vonë argjipeshkvi tjetër i Tivarit, Bianki (Gjergj Bardhi), me rastin e vizitës në Trepçë gjatë vitit 1642 në raportin e tij thotë se: " *e gjen kishën e vjetër të Shën Pjetrit të lënë pas dore*"[6]

Ndër relatorët, i cili ofron të dhëna të shumta për Kosovën është edhe Pjetër Mazreku, shqiptar i lindur në Prizren. Në dhjetor të vitit 1622 u emëruar për ipeshkëv të Prizrenit, pastaj argjipeshkëv të Tivarit dhe administrator të Serbisë, e më vonë (1631) për administrator të Hungarisë, Bullgarisë, Sllavonisë dhe Bosnjës.[7]

Nga raportet e Mazrekut më të njohura janë: 1. *Përgjigjet e vizitorit Pjetër Mazrekut formularit me 56 pyetje të instruksioneve romake*, në të cilën, Mazreku, duke iu përgjigjur 56 pyetjeve, ofron shënime mbi madhësinë e këtyre viseve, numrin e banorëve dhe gjuhën e tyre. Ky vizitor e kreu këtë detyrë të besuar në vitet 1623-1624, për të cilën gjë shkroi raport të posaçëm; 2. *Raporti i Pjetër Mazrekut, vizitorit apostolik të Bullgarisë, Serbisë, Sllavonisë dhe Bosnjës mbi gjendjen e katolicizmit në vitet 1623-1624*; dhe *Relationi di Pietro Masareco... Congregato de Propaganda Fide, në vitin 1633*.

Vizitori apostolik Pjetër Mazreku, në një raport të tij të viteve 1623-1624, përveç tjerash, thekson se "*Prizreni ka 12.000 frymë turq (lexo: mysliman), pothuajse të gjithë shqiptarë, të shkathët prej natyre dhe të aftë për çdo ndërmarrje. Katolikët po prej këtij kombi, mund të jenë rreth 200 frymë; ata kanë një kishë të ndërtuar prej të parëve të tyre, e cila, megjithëse ishte e pajisur me veshje të pasura, tridhjetë vjet më parë (1592), pësoi nga një zjarr dhe humbi çdo gjë që të bukur e të mirë që kishte(...)*.[8] Në rrethin e varfër të Prizrenit, vazhdon ai : "*nevojiten 5*

[2] E. Sedaj. Relacionet e Pjetër Bogdanit mbi gjendjen shpirtërore të Shqipërisë e të Serbisë (1666-1684), në: Gjurmime Albanologjike-seria e shkencave historike, 14/1984. Prishtinë, 1985, 237-249.
[3] Historia e popullit shqiptar, I, 366.
[4] I. Zamputi. Relacione, I, 169-171.

[*] Gurë gëlqeror
[5] F. Rački. Izveštaj barskoga nadbiskupa Marina Bizza o svojem putovanju god. 1610, po Arbanaskoj i Staroj Srbiji, në: Starine JAZU, XX. Zagreb 1888, 124.
[6] J. Radonić. Rimska kurija i južnoslovenske zemlje od XVI do XVII veka, 107.
[7] Izveštaj apostolskog vizitora Petra Massarechia iz godine 1623-24, në: Starine JAZU, knj. XXXIX. Zagreb 1938, 2.
[8] I. Zamputi. Relacione, I, 337.; K. Draganovic, pun. i cit., 28.

priftër, por asish që dijnë gjuhën shqipe. Çdo komb, pra edhe shqiptarët, dëshirojnë të kenë priftërit në gjuhën e tyre."[9]

Relatori P. Mazreku, në një raport tjetër të tij të vitit 1633, dërguar Kongregacionit të Shenjtë, shënon për Prizrenin edhe këtë: "*Qyteti më fisnik i kësaj krahine duket se ka qenë Prizreni (...) Asht i pasun me ujna shumë të shëndoshë, me ajër të mirë e me venëna të shkëlqyeshme, por i mungojnë pasunitë; i vijnë në ndihmë veç një shumicë mullinjsh të vendosur mbi një lum që i kalon për mes. Thonë se ky asht atdheu i perandorit Justinian.*[10] (...)*Prizreni gjendet ndër kufij të shqiptarëve...Besimtarët katolik kanë një kishë, që asht famullitarja e Zojës së Ngjituan në Qiell. Më 1592 u dogj me dam të madh librash shumë të vjetër e të pajisjes së shenjtë (...)Këtu pranë është territori i quajtur Shullan, që po ta themi latinisht, don me thanë: vende të thata apo thatësina. Quhet Has e përfshinë shumë katunde. Asht i banuem prej shqiptarësh.*"[11] Në raportin tjetër po të këtij viti, Mazreku shkruan:"*Në mbretërinë e Serbisë...në qytetin e Prizrenit, në Trepçë, Janjevë, Letnicë, etj., këta njerëz janë me gjuhë shqipe e sllave, dhe argjipeshkvi, me që i din të dyja këto gjuhë, ka qenë shumë më vend.*"[12]

P. Mazreku, në raportin e vitit 1652, dërguar Propagandës Fide në Romë, bën me dije se shqiptarët gjithnjë kanë jetuar në këto vise të Ballkanit: "*fshatarët shqiptarë punonin gjatë disa muajve të vitit si punëtorë të thjeshtë në minierat e Serbisë (Kosovës).*"[13]

Sipas relatorit tjetër, argjipeshkvit të Tivarit Gjergj Bardhit (të viti 1637), "*Prizreni së bashku me fshatrat përreth, mund të jenë 540 frymë (katolikësh); Jakova (Gjakova) 550 frymë; Mali i Ri (Novobërda) 366; Trepça 350; Prishtina 150; Janjeva 680 (...) dhe këta flasin gjuhën epirote d.m.th. shqipe...*"[14].

Në vitin 1638, Gjergj Bardhi, ndër të tjera, raportonte: "*Në Karadakun e Shkupit, Novobërdë, Janjevë, Prizren, Gjakovë, Kratovë, etj., flitet shqip, prandaj është e arsyeshme pse shqiptarët kërkojnë që priftërinjtë t'i kenë shqiptarë* ("della propria lingua albanese")

Në relacionin e vitit 1641-42, Gjergj Bardhi, ndër të tjera për Prizrenin thotë: "*në këtë vend(Prizren) si jemi informue nga pleqtë, shtëpi të turqve (lexo: shqiptarëve myslimanë) ka rreth 3000, të katolikëve 40, të skizmatikëve rreth 80 shtëpi dhe Prizreni nuk është qytet por varosh* dhe përmes këtij vendi kalon një përrue i quejtun Bushtrica (...) dhe përmbi varoshin e thanun në maje të një kodrine ashtë një kështjell i fort (...) dhe rrethas, qytetit që ishte aty asht i rrenuem*".

Disa ditë më vonë (më 14 nëntor 1641) Bardhi arriti në Suharekë, që, sipas tij, "*Suho Reka në italisht don me thanë lum i thatë (...) kishte një popullsi të vorfun, me gjuhë shqipe*".[15]

Kjo na tregon se katolikët e sanxhaqeve të Prizrenit, Dukagjinit, Vuçitërnës dhe të Shkupit ishin shqipfolës, d.m.th. shqiptarë, se numri i katolikëve ish në rënie e sipër nga sa ishin duke u islamizuar dhe duke kaluar në fenë ortodokse, d.m.th. duke u serbizuar, dhe se kombi shqiptar megjithatë, në mënyrë absolute mbizotëronte në trevat në fjalë.

Njësoj si argjipeshkvit e tjerë edhe P. Bogdani i dërgoi raporte dhe letra Kongregatës.

Vizitat dhe shtegtimet që P. Bogdani bëri vite me radhë në territoret shqiptare, që përfshiheshin në juridiksionin fetar të mbuluar prej tij, i dhanë mundësinë të njohë për së afërmi qytetet, fshatrat, qytetarët e malësorët, artizanët dhe bujqit, gjendjen ekonomike, demografike, kulturore etj., të vendit. Ndaj në mjaft letra e relacione të tij të dhënat gjeografike zënë vend të konsiderueshëm.

Kështu, në një raport të vitit 1647 i drejtohet Kongregatës që t'i lejohet largimi nga kolegji për t'i studiuar etikën dhe medicinën, sepse atdheut të tij i mungonin mjekët. Ai parasheh që t'i çlirojë bashkatdhetarët e tij nga "*vesi i besëtytnive të futura nëpërmjet ciganëve*", të cilët me terapinë e tyre të dyshimtë "*kërdisin trupin dhe shpirtin*".[16] Kurse, në raportin e vitit 1662, i përshkruan kushtet sociale në Kosovë dhe në Shqipëri. Ai shpjegon se shqiptarët kryesisht jetojnë nëpër fshatra, sepse turqit nga frika nuk i lëshojnë në qytete. Në këtë raport është përshkruar edhe gjendja e vështirë e shkollave në këto vise. Sipas autorit, shkollat në Kosovë pothuajse janë lënë pas dore, pasi nuk ekziston asnjë ent për edukimin e vajzave.[17] Po në këtë raport të vitit 1662, përveç tjerash thekson se: "*meqë bërthamën e pjesëtarëve të besimit katolik në*

[9] K. Draganovic, pun. i cit., 13.
[10] I. Zamputi. Relacione, I, 431
[11] Po aty, 435.
[12] Po aty, 451.
[13] Historia e popullit shqiptar, I, 365.
[14] I. Zamputi. Relacione, II, 97.

* Qyteti mesjetar kuptohej vendbanimi i rrethuar me mure dhe brenda këtij vendbanimi ishte një qendër e fortifikuar, ose kështjellë; kurse varoshi u formua jashtë mureve rrethuese të qytetit dhe përbënte lagjet periferike të tij.
[15] I. Zamputi. Relacione, II, 255.
[16] O. Marquet. Pjetër Bogdani, letra dhe dokumente nga Arkivi i Kongregatës "de Propaganda Fide" si dhe nga Arkivat Sekrete të Vatikanit. Shkodër 1997, 11.
[17] J. Radonić. Rimska kurija i južnoslovenske zemlje od XVI do XVII veka. Beograd 1950, 276-277.

Serbi(Kosovë) e përbëjnë shqiptarët",[18] kërkon që të dërgohen edhe shumë fretër për ta në Kosovë.

P. Bogdani, dërgoi edhe disa raporte më 1675, 1681 dhe 1685. Në to flet plot entuziazëm për Prizrenin, Gjakovën, Pejën, Janjevën dhe vendet e tjera në Kosovë. Raporti i tij i fundit dhe padyshim më i rëndësishmi "*Essatissima Relatione del stato Spirtuale, e Temporale del Regno di Albania e Servia, data dell'Arcivescovo di Scopia, stato per forco d 30 Ani Vescovo in quelle parti"* (Relacioni shumë i saktë i gjendjes shpirtërore e shekullare të Mbretërisë së Arbërisë e të Serbisë (Servia) dhënë prej argjipeshkvit të Shkupit, për tridhjetë vjet ipeshkëv i atyre anëve), i 15 dhjetorit 1685 (?).[19] Me ketë rast duhet të theksohet se sipas profesor K. Frashëri, P. Bogdani nuk i jepte emërtimit gjeografik Serbi një përmbajtje etnike, por ai e dallonte Kosovën nga Serbia, sepse të parën e quante, sipas emërtimit historik Serbi, kurse të dytën, Serbinë e mirëfilltë, e quante, si dhe qarqet zyrtare perëndimore Rashë. Me emërtimin Serbi ai nënkuptonte Kosovën arbërore dhe jo sllave.[20] Në relacion shënohet: "Serbia, thjesht Servia, kështu e quajtur nga populli, të cilën Koncili i Kostancës i quan serbë, ishte Dardania e vjetër..."[21]. Kurse studiuesi E. Sedaj shton: Është fjala për ndarjen kishtare katolike, të cilën e ka bërë Papati pasi që në "Geubi" përfshiheshin trevat e Dioqezës së Shkupit d.m.th. vetëm ato vise të Kosovës dhe të Maqedonisë ku kishte katolikë".[22]

Përmes këtij relacioni njihemi me shtrirjen dhe kufijtë e qyteteve e lokaliteteve shqiptare, relievin gjeografik, etj. Në të përshkruhet Kosova, Serbia, Malin e Zi dhe Shqipëria. Në gjithsej 19 faqe, në të bëhet fjalë për Tivarin, Ulqinin, Shkupin, Prizrenin, Pejën, Prishtinën, Mitrovicën, Zveçanin, Kaçanikun, Trepçën, Novobërdën, Fushë Kosovën dhe vende të tjera, për të cilat hollësisht flitet për popullsinë dhe analizohen etnitë dhe gjuhët e tyre. [23]

Në saje të këtij raporti mund të konkludohet se P. Bogdani ka njohur shumë mirë problemet sociale të bashkëkombësve të tij dhe ka qenë i gatshëm t'i ndihmojë.

[18] Po aty, 275.
[19] Sh. Osmani. Pjetër Bogdani. Tiranë: "Idromeno", 1996, 133-134.
[20] K. Frashëri. Pjetër Bogdani dhe lëvizja çlirimtare shqiptare në shek.XVII, në: Pjetër Bogdani dhe vepra e tij. Tiranë ASH të RSH, IGJL, 1991, 67-68.
[21] Sh. Osmani, vep. e cit., 125.
[22] E. Sedaj, pun. i cit., 245.
[23] A. Theiner. Vetera monumenta Slavorum Meridionalium Historiam Illustrantia (Maximam partem nondum edita ex tabulariis Vaticanis), tomus secundus, 1524-1800). Zagrebiae 1875, nr.CCXXXIII, 217-221.

Kështu, për Prizrenin, Pjetër Bogdani (1685) thotë: "*Prinepoli i vjetër, tash i quajtur Prizren, në bulën e papës Urbanit të VIII, për ngritjen e Kolegjit Ilirik të Loretos, nderohet më titullin Justiniana e Dytë (Justiniana secunda).*[24]*(...) tregtia e Prizrenit zakonisht bëhet me verë e lëkura. Nga lumi i quajtur Bistrica, që i rrjedh përmes, ushqehet me trofta e lloje të tjera peshqish. Ka njerëz të armatosur meqë pikërisht aty punohen pushkët të çdo lloji, damaskine shumë të përsosuna...".*[25]

Në një fragment tjetër P. Bogdani, viset e Kosovës i përshkruan: "*Nga Prizreni, duke shkuar në anën e veriut, me një ditë udhë, arrihet në Fushën e Kosovës, të quajtur Merlino, shumë e sheshuar, e rrethuar me vende minierash floriri, argjendi dhe metalesh të tjera, e ruajtur nga qyteti i Novobërdës, që është i vendosur mbi malin e lartë të Argjentinës, i cili sa më i zhveshur dhe i varfër që është nga jashtë, aq më i pasur është me miniera. Kur bien shira të mëdha, zbulojnë përjashta, si shumë hujze të shndritshme, sasi të mëdha kristalesh të malit, të cilat meqë nuk janë të spastruara, nuk çmohen aspak prej banorëve...Shqiptarët e mi janë ofruar që vetëm me treqind (luftëtarë) ta shtien në dorë atë vend pa derdhur gjak...*"[26]

P. Bodanit iu deshtë të luftonte njëherazi në tri fronte kryesore: edhe kundër zgjedhës së huaj, që në mesin e shekullit XVII ishte rënduar shumë, edhe kundër kishës ortodokse dhe sidomos patrikanës serbo-ortodokse të Pejës, që i kishte shtuar përpjekjet e vjetra për mos ta lejuar shpërthimin e kryengritjeve antiosmane në dioqezat e saj, edhe kundër politikës që ndiqte vetë kisha katolike e Romës në Ballkan.

Sipas të dhënave që jep Cornelli në: "*Illyricum*" më 1688 dhe në "*Corso delli fiumi Drino e Boisana nella Dalmatia*", më 1689 në Prizren kishte 6 000 shtëpi. Pra, nëse llogaritet se një shtëpi kishte mesatarisht 10 frymë, siç llogaritnin relatorët e kohës, atëherë Prizreni kishte 60 000 frymë. Sidoqoftë, edhe nëse ka pasur jo më shumë se 40 000 banorë, ky ishte numër kolosal.[27]

Ndërsa argjipeshkvi i Shkupit Andrea Bogdani i shkruan Romës (15. XI. 1664) nga Janjeva, ku e kishte rezidencën e vet, duke i rekomanduar në letër Kongregatës që për mësues të shkollës katolike në vend ta emëronin shqiptarin Pjetër Mazrekun, kërkesë e cila edhe u realizua në vitin 1665. Përveç shkollës së përmendur në Janjevë ku "*gjatë kohës së Pjetër Mazrekut mësimi në këtë shkollë ka*

[24] Po aty, 220.
[25] Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë, Vëll. III (1506-1839). Tiranë 1962, 153.
[26] Po aty, 187.
[27] S. Rizaj. Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII, Prishtinë 1982, 255.

qenë në gjuhën shqipe..." ndër shkollat më të vjetra hynë edhe shkolla e Pejës (shek. XVII).[28] Kah gjysma e shek. XVII për zhvillimin shkollave shqipe në Prizren, Suharekë, Gllogjan, Landovicë, Papaz është i merituar famullitari don Gegë Mazreku, i cili e hartoi një raport (1650-1651), në të cilin gjenden shënime interesante mbi numrin e familjeve katolike në Prishtinë, Prizren, Suharekë dhe në shumë fshatra që i ka vizituar.[29] Ndonëse në këtë raport nuk bëhet fjalë për aktivitetin e tij arsimor në Prizren dhe rrethinë, në raportin e Shtjefën Gasprit (1671) ka shënime edhe mbi aktivitetin arsimor të këtij misionari. Në këtë raport, pos tjerash, theksohet se Gegë Mazreku në Prizren, Suharekë dhe në katër fshatra fqinjë ka tubuar "*rreth vedit djelmninë për me e mësue në dieje e n'udhë të marë*".[30]

Kurdo udhëtarët kanë regjistruar ngjarje të veçanta të jetës së përditshme të popullatës. Kështu, ata nuk lanë pa paraqitur aspektet e veçanta si: doket e zakonet, besëtytnitë, mjekësinë popullore etj. Natyrisht, për sa u përket të dhënave të kësaj natyre të shpërndara nëpër këto materiale dokumentare, ato bëhen më interesante sidomos për zonat malore, pikërisht sepse këto zona ishin në një gjendje të veçantë dhe në kushte më të mira për t'i ruajtur dhe për t'i zhvilluar. Këto shënime janë ruajtur deri në ditët e sotme dhe na shërbejnë sot si një kujtesë e historisë për të kaluarën tonë të largët.

Në lidhje me çështjen e shqiptarëve të Kosovës, këto të dhëna fragmentare të relatorëve shqiptarë, dëshmojnë në mënyrë të qartë dhe të pakundërshtueshme se shumica dërrmuese e banorëve të Prizrenit, Gjakovës etj., ka qenë shqiptare qysh në fillim të shekullit XVII. Nuk bëhet fjalë për ndonjë jehonë të ardhjes së shqiptarëve në këto krahina, as në kohë të afërta as të largëta. Të kishin ngjarë të tilla shpërngulje masive, relatorët tanë patjetër që duhen ta kishin shënuar.

Rrethet e Prizrenit, Gjakovës e më gjerë, që juridiksioni kishtar katolik i përfshinte në dioqezën e Serbisë së Poshtme (siç e quanin relatorët Kosovën), janë konsideruar nga relatorët tanë vende shqiptare. Më 1638 fra Kurbini, pasi na flet për gjendjen e rretheve të Gjakovës e të Prizrenit, thotë: "*Po të shkohet ma tutje dhe të kalohet një mal, gjendet Shkupi, ku nuk kemi shkue sepse asht jashta Shqipnisë*".[31] Me fjalë të tjera, krahina e mëparshme deri tek ai mal, konsiderohej dhe ishte Shqipëri. Po për këto rrethe të Gjakovës e Prizrenit, Gjergj Bardhi na thotë në një nga relacionet e veta: "*Të gjitha këto vende të sipërpërmendura janë shqiptare dhe flasin po atë gjuhë (...)*". Dëshmi të tilla ka vazhdimisht në të gjitha relacionet e kësaj kohe.

Këto të dhëna të përmendura më lart, na japin mundësi të arrijmë në përfundim që me dëshminë e këtyre materialeve, rrëzohen pikëpamjet e studiuesve serbë, të cilët elementin shqiptar të Kosovës e datojnë vetëm në fundin e shekullit të XVII, kurse këto të dhëna dëshmojnë të kundërtën. Po ashtu këto të dhëna dëshmojnë se as në fillim të këtij shekulli nuk kanë ndodhur të tilla shpërngulje, as edhe në kohët e mëparshme, sepse shumica dërrmuese shqiptare-myslimane është fshatarësia vendëse e islamizuar gjatë pushtimit turk. Kështu në Kosovë elementi shqiptar nuk do të kërkohet vetëm ndër katolikët, por sidomos ndër myslimanët e qyteteve dhe fshatrave.

Kur ne p.sh. P. Mazreku na informon se në Has të Prizrenit kanë mbetur vetëm pesë fshatra katolike shqiptare dhe 45 të tjera (po ish-katolike shqiptare) kanë qenë islamizuar, dhe po ky autor na thotë: "*Asht i banuem prej shqiptarësh*", dëshmon se katolikët dhe myslimanët e Kosovës janë shqiptarë, sepse islamizimi (me gjithë termin "*turk*" që përdorin relatorët) nuk ua ndryshon etnitetin atyre që ishin dhe mbetën shqiptarë.

Në qoftë se Kosova, në këto materiale dokumentare, përfshihet nën emërtimin e dioqezës së Serbisë, nuk do të thotë asgjë. Kisha katolike përfshinte asokohe nën emërtimin *Dioqezë e Serbisë* edhe gjithë Bullgarinë, me Sofjen etj.[32]

Qëndrimet identike që vërtetojnë prezencën e popullsisë vendëse shqiptare në këto treva gjatë gjithë shekujve në fjalë përmbajnë edhe studimet e shkencëtarëve të mirëfilltë që duke hulumtuar dokumentacionin arkivor dhe lëndën relevante si burimet osmane, raguzane, venedikase, austriake etj., arrijnë në përfundimet se popullsia shqiptare mbizotëronte në Kosovë, jo vetëm gjatë gjithë shekujve XV-XVII, por edhe më herët gjatë mesjetës.

[28] Starine, JAZU, knj.XXV, Zagreb 1898, 170.
[29] Po aty, 196.; Hylli i Dritës, nr. 7-8, Shkodër 1932, 413.
[30] Po aty, 413.
[31] I. Zamputi. Relacione II, 107.
[32] Po aty, 36.

BIBLIOTEKAT DIGJITALE DHE KUJTESA KOMBËTARE
KONFLIKT DHE/OSE HARMONI

Etleva DOMI
Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë

Ëndrra e bibliotekës virtuale - dalë në pah aktualisht jo se premton një të ardhme kureshtare e ngacmuese, por sepse premton një të ardhme që do të jetë jo vetëm si e shkuara, por shumë më e mirë dhe më e shpejtë.

James J. O'Donnerll, Avatars of the World

Dekadat e fundit shoqëria ka ndryshuar me shpejtësi marramendëse duke hyrë në një epoke të re - në atë digjitale, ku spikatin zhvillimet në teknologjinë e informacionit, referimet digjitale dhe komunikimi digjital. Është koha që bibliotekat të përmbushin rolin dhe funksionet e tyre të shek. XXI duke u përballur me sfidat e kësaj bote që është gjithnjë në lëvizje e ndryshim. Tani, rreth gjashtë shekuj larg nga shpikja e Gutenbergut, në epokën

e kibernetikës dhe internetit, të botës së virtualitetit, të modernitetit virtual, të lirisë së informimit-shprehjes-përzgjedhjes, të shfaqjes së librarive-katalogëve-bibliotekave digjitale, një nga temat më të debatuara në mjediset e editorisë elektronike, shkencore dhe mediatike, është ajo që ka të bëjë me të ardhmen e librit dhe të bibliotekave, me editoritë digjitale, me konceptimet e ndryshme të asaj që ç'është dhe/ose ç'do të jetë kujtesë kombëtare, debat që, përgjatë së paku 10 viteve të fundit, ka tër he qur një numër të madh njerëzish prej të gjithë kon tinenteve dhe të gjithë horizonteve kulturore.

Krijimi i "autostradës" informatike, i hipertekseteve digjitale, zhvillimi spektakolar i siteve web etj. janë tregues të zhvillimit dhe aplikimit të vrullshëm të teknologjive të reja. Por, kur reflektohet mbi marrëdhëniet ndërmjet teknologjive dhe librit si kujtesë e njerëzimit, vendin kryesor pa dyshim e zë libri-mjeti parësor i depozitimit dhe transmetimit të dijes. Libri është Trashëgimia jonë pasi ai është, para së gjithash, simbol i qytetërimit, i kulturës, i dijes. *Libri,*- siç thotë edhe shkrimtari i madh argjentinas Jorge Luis Borges, - *nuk është një entitet i veçuar, por një marrëdhënie, aksi i marrëdhënieve të panumërta*. Prandaj është e natyrshme të shqetësohemi kur dëgjojmë lajme tronditëse për "zhdukjen" e tij. Në shekullin XXI të gjithë duhet të jemi të vetëdijshëm se libri është çështje e gjithëkohshme dhe se ai mbetet një mjet i pazëvendësueshëm për zhvillimin e kulturës kombëtare të çdo populli.

Gjithnjë e më shumë sot po zbulohen dhe vlerësohen mjaft anë të botës së librit si vektor vlerash dhe dijesh, por edhe si depozitues trashëgimie jomateriale; libri si dritare e hapur mbi ndryshmërinë e kulturave dhe si mjet dialogu. Ndonëse sot media moderne ka marrë rolin e përhapjes së informacionit, librat janë akoma burimi i ideve që ndryshojnë mendësitë e njerëzve. Për këtë të fundit është e nevojshme të thuhet diçka më shumë. Nuk duhet harruar që shumica e lëvizjeve të mëdha në të gjithë botën kanë lindur për shkak të një libri të çfarëdo lloji dhe se ai është mjeti kryesor nëpërmjet të cilit transmetohen e përhapen idetë. Profetët e së keqes, të cilët paralajmërojnë zhdukjen e librit, në periudha të ngjashme ndryshimesh teknologjike kanë propaganduar të njëjtën gjë. Mjafton të kujtojmë periudhat e shpikjes së kinemasë, radios, televizionit etj. Edhe me shfaqjen e medias moderne, librat nuk rrezikojnë zhdukjen. Ndonëse numri i përdoruesve të Internetit është gjithnjë në rritje, të paktë janë ata që parapëlqejnë leximin nga "instrumente elektronike". Në epokën e përpjekjeve mbarëbotërore për krijimin e "bibliotekave virtuale", e-books-eve etj. nuk do të humbasë kurrë komoditeti i të mbajturit në dorë të librit, nuk do të zhduket asnjëherë emocioni i të prekurit të librit, i kontaktit të drejtpërdrejtë me origjinalin, aromës së tij…. Nuk mund të imagjinoj kurrë heqjen e librave nga raftet e bibliotekave tona, madje as edhe nga ato të fëmijëve tanë. Radhët e gjata të fëmijëve deri në orët e vona pas mesnate, që çdokush i ka ndjekur në ekranet televizive apo elektronike, për të blerë librin e tyre të preferuar *Harry Potter*, dëshmuan qartë që edhe fëmijët e lindur në "botën digjitale" nuk heqin dorë "bota librore". Dhe u ndjeva mirë kur nipi im 12 vjeçar, që është "i marrosur" pas çudirave të botës elektronike: videogame-ve, mp3player-ve, ai-pod-eve, rendi menjëherë për ta blerë, duke qëndruar madje vetë 5 orë në radhë. Është për të ardhur keq që pikërisht kjo gjë ende nuk po kuptohet nga editorët digjitalë. Edhe vetë Amerika që është vendlindja e kësaj bote digjitale, duke synuar mbajtjen e fëmijëve pranë librit, në kurrikulat shkollore ka përfshirë veprimtari në *media center;* në këto të fundit bibliotekarët nuk janë thjesht njerëzit që ofrojnë librin për lexuesit, por edukatorë që, nëpërmjet letërsisë për fëmijë, shpjegojnë kulturën dhe historinë e vendit të tyre. Mund të përmendim që duke filluar nga shkollat fillore deri në ato tetëvjeçare, çdo ditë për nxënësit zbatohet programi *D.E.A.R time (drop everything and read),* që në shqip do të thuhej *lë gjithçka dhe lexo,* që organizohet çdo ditë për 15 minuta dhe 3 herë në javë shkohet në bibliotekën e shkollës për të marrë libra.

Sot është bërë fakt që bibliotekat kombëtare, që tradicionalisht kanë grumbulluar, ruajtur dhe shërbyer shtypshkrime, aktualisht po përballen edhe me sfidën e mbledhjes së burimeve digjitale dhe/ose krijimin e tyre, ruajtjen dhe vënien në rrjetin digjital global. Në rrethana të tilla *Kujtesa Kombëtare* është një koncept mjaft i ndryshueshëm, është dëshmi e një epoke, por edhe i dijeve të grumbulluara, ku bazohen kërkimet e tashme dhe të ardhme. Kur pyeta një kolegun tim amerikan se si do ta përkufizonte nocionin *Kujtesë kombëtare* m'u përgjigj *"Anything you want",* në shqip *"Gjithçka që ti dëshiron".* Më erdhi ndërmend menjëherë André Malraux, i cili që vitin 1964 duke rimarrë një nga temat madhore të *Musée imaginaire*, arsyetonte po si kolegu amerikan duke thënë *që çdo periudhë "shikon" objekte që të tjerat "nuk i shohin".* Vërtet është kështu; edhe ajo që sot nuk është kujtesë nesër do të bëhet e tillë. Dhe nëse do të duam të ruajmë lirinë e mendimit dhe të të shprehurit të çdokujt, nuk ka sesi të jetë ndryshe. Askush nuk mund të dijë, të imagjinojë se në cilin objekt, fjalë, veprim, figurë do të përqendrohet vëmendja pas 500 vjetësh, e sidomos cili komunitet - që ka qenë ndofta i rrezikuar edhe për të ekzistuar - duke u gjykuar si vlerë nga pasardhësit tanë do të ketë privilegjin që të bëhet pjesë e kësaj kujtese.

Ndërkohë që *Digjitalizimi* është konvertimi i një objekti real në një objekt elektronik të digjitalizuar, në një kuptim më të gjerë ai është transformimi i informacioneve në një formë që mundëson ruajtjen, përcjelljen dhe trajtimin nëpërmjet teknologjive të reja të informacionit dhe komunikimit, ku Interneti është një ndër aspektet më të njohura, është mjet për të ruajtur dhe rritur vlerën e Kujtesës Kombëtare. *Biblioteka digjitale*, e quajtur ndryshe edhe *bibliotekë virtuale, elektronike* (fillimi i viteve '80) apo *bibliotekë pa mure*, siç përdoret sot, është hapësirë informacioni, që lejon zbulimin dhe navigimin në "objekte digjitale", ku përdoruesi vetudhëhiqet. Bibliotekat digjitale janë koleksione të organizuara të informacionit, në të cilat ky është vendosur në formate digjitale, të akcesueshme në mbarë rrjetin botëror. Bëhet fjalë për një site Interneti – një çadër të madhe do të më pëlqente ta quaja - në të cilin janë mbledhur tekste në format digjitale. Kjo bibliotekë nuk ka nevojë për hapësirë fizike. Këto koleksione, që në përgjithësi përmbajnë tekste të përjashtuara nga të drejtat e autorit - thënë ndryshe që janë në domen publik - pra, janë të tërheqshme falas nga Interneti, kanë për qëllim paraqitjen e materialeve (libra, periodikë, doreshkrime, harta etj.) në formë elektronike, rritjen e akcesit intelektual për komunitetin mbarëbotëror nëpërmjet Internetit dhe ruajtjen e ekzemplarëve origjinalë. Digjitalizimi dhe krijimi i burimeve digjitale botërore – lindur kryesisht në vende "të pasura" që në fillim të viteve '90, synonte perfeksionimin e cilësisë së akcesit në Kujtesën Kombëtare historike të shkruar. Dhe tanimë bota e teknologjive informatike këtë "thesar të paprekur e të fshehtë" e ka bërë "të rrokshëm".

Dëshmitë dhe provat për bibliotekat kombëtare i kemi në duar. *Kujtesa Amerikane* ("American Memory") - e para bibliotekë digjitale, krijuar që më 1995 me nismën e Bibliotekës së Kongresit - mundëson akces në pasuritë e papërshkrueshme të koleksioneve arkivore duke filluar që nga librat, pamfletet, hartat, revistat, gazetat etj. dhe vijuar te videot, filmat e regjistrimet zanore. Nismë e ngjashme e përmasave të tilla gjigande është edhe projekti i Bibliotekës Kombëtare të Francës *Gallica,* vijuar së fundmi me *Gallica 2,* që mund të quhet pa hezitim një model për të ardhmen i një biblioteke europiane digjitale. Në fillimet e viteve 2000, nisma të tilla "kanë shpërthyer" e "mbërthyer" mbarë botën si: TEL (The European Libraries), TEL-ME-MORE, EDL (European Digital Libraries), "EUROPEANA", "i2010: Bibliotekat Digjitale" etj. etj. të cilat synojnë që të mundësojë lehtësisht akcesin në trashëgiminë globale - në kultura e gjuhë të ndryshme - për publikun kulturor mbarëbotëror.

Digjitalizimi i kujtesës kombëtare është bërë domosdoshmëri pasi mundëson ruajtjen e vlerave të rralla nga koha dhe përdorimi dhe vënia e tyre në Internet mundëson arsimimin e popujve, promovon kulturën e identitetin e çdo kombi, mundëson akces të barabartë për të gjithë. Çdo person që ka një akces në Internet mund të ketë në pëllëmbën e dorës për një sekondë me një të klikuar të mouse-it kujtesën e të gjitha kohërave. Thelbi i krijimit të burimeve kombëtare digjitale është sigurimi i jetëgjatësisë dhe sigurisë. Sot, po të digjej një bibliotekë, do të konsiderohej si tragjedi lokale, por po qe se do të digjej një bibliotekë kombëtare me doreshkrime e botime të rralla, do të shikohej si një katastrofë kulturore prej së cilës nuk kishte shërim. Djegia e Bibliotekës Anna-Analia të Weimar-it na bëri të mendojmë që ashtu si edhe qytetërimet, bibliotekat janë "të vdekshme".

Bibliotekat Kombëtare kanë qenë pioniere të ngritjes së bibliotekave digjitale. Vërtetë tradita ngahera ka zënë një vend të rëndësishëm në to, por, ndërkohë që sot kur zhvillimi teknik e elektronik po përparon dita ditës, ato përpiqen të pozicionohen sa më mirë në këtë evolucionin të përshpejtuar të botës së informacionit, që prek si mënyrat e informacionit ashtu edhe të përdorimit të burimeve bibliotekare. Dhe pikërisht në këtë kontekst, bibliotekat e kanë kuptuar tanimë që e ardhmja duhet planifikuar mirë. Krahas domosdoshmërisë për t'iu përgjigjur nevojave imediate me strategji afatshkurtra, ato domosdoshmërisht duhet të punojnë edhe për një perspektivë afatgjatë - të sigurojnë që kujtesa kombëtare e shkruar të mblidhet pa paragjykime, të identifikohet, të ruhet edhe për brezat e ardhshëm. Në mbledhjen e materialeve duhet të kihen parasysh nevojat e studiuesve të nesërm dhe të atyre pas një shekulli. Pas 500 vjetëve, ashtu si edhe në fund të shek. XV, kjo mori botimesh - me/ose pa vlerë, shpikje apo idiotizëm - do të jenë inkunabulat e epokës së re të shtypshkrimeve. Si "ruajtëse" të pjesës më të vyer të kujtesës kombëtare, bibliotekat kombëtare krahas digjitalizimit të shtypshkrimeve, duhet të kontribuojnë në ruajtjen afatgjatë edhe të "objekteve digjitale"- thënë ndryshe të materialeve që janë krijuar që në origjinë në formë digjitale dhe nuk ekzistojnë në një formë tjetër fizike, - sfidë me të cilën ato po përballen sot.

Bibliotekat digjitale dhe kujtesa kombëtare po afrohen gjithnjë e më shumë. Tundimi më i madh qëndron në kundërvënien e thellë mes atyre që lëshojnë thirrjen e alarmit dhe atyre që entuziazmohen nga risitë. Një sjellje më e ekuilibruar do të ishte të llogaritnim potencialin që biblioteka digjitale i ofron kujtesës kombëtare. Në fazën e tanishme risi nuk do të thotë "humbje e traditës". Është paradoksale që teknologjia e informacionit, që i jep akces shër-

bimeve në biblioteka, t'i çojë disa në pyetjen nëse bibliotekat do të jenë të nevojshme. Si bibliotekarë ne bëjmë pyetjen retorike: *Bibliotekat digjitale a do t'i zëvendësojnë ato tradicionale?* Dhe ne mbrohemi duke u bazuar në konceptin tradicional të bibliotekave. Duhet mbajtur me kujdes një ekuilibër midis strategjisë së ruajtjes, që, në rastin më të keq, rrezikon t'i transformojë bibliotekat në muze të thjeshtë dhe strategjisë si zgjerim të konceptit digjital të bibliotekave. Parashikimet në dekadën e fundit pritnin një zëvendësim të formatit të shtypur me revistat elektronike, por deri tani askush nuk ka mundur të zhvillojë një model ekonomik për t'u përgatitur për një ndryshim kaq të madh. Siç dihet nga të gjithë ekziston vetëm një numër i vogël revistash të vlefshme komerciale elektronike. Pra, koncepti i revistës duket i pazbatueshëm në epokën elektronike. Ironia më e madhe është që kur sot shënohen arritje në kontrollin bibliografik të materialeve "tradicionale" bibliotekare, disa e shohin si "kërcënim" ndaj shërbimeve bibliotekare ekzistuese shfaqjen e burimeve digjitale.

Ndërsa gurët mund të shpresojmë të ekzistojnë mijëra vjet, letra qindra vjet, një disketë mundet vetëm 10 vjet, jetëgjatësia mesatare e faqeve të web-it rreth 70 ditë. "Biblioteka, - siç thotë Borgesi, - do të jetojë ngahera: e ndriçuar, e vetmuar, e pafund, krejt e palëvizshme, e armatosur me vëllime të çmuara, të padobishme, e paprishur, e fshehtë". Kam bindjen se, siç duket, as teknika e as mentaliteti nuk kanë qenë të gatshme për të lejuar suksesin që kjo botë po ofron. Duhet të pohojmë që nuk bëhet fjalë për dilemë. Për këtë kërkohet integrimi i një bote të re të dijeve e komunikimit në kulturën tradicionale librore. Autorja e njohur amerikane Gertrude Stein ka shkruar: "Historia kërkon kohë, historia krijon kujtesa". Dhe kjo është padyshim për çka ekziston një bibliotekë kombëtare. Një bibliotekë kombëtare do të vijojë të jetë një kujtesë e mbarë shoqërisë, njerëzimit, qytetërimit, kujtesë që nuk do të zbehet në kohë, kujtesë që do të udhëheqë dhe formëzojë historinë e vet dhe kulturën e gjeneratave të ardhshme". Dhe kjo kërkon një përkushtim të madh nga të gjithë.

Në një kohë si kjo që po jetojmë, kur përditë flitet e shpresohet për integrime në rrjedhat europiane, a nuk duhet që edhe bibliotekat tona kombëtare të shtyhen për t'u përfshirë në të tilla projekte e nisma europiane? Them se po. Ka ardhur koha që të përpilojmë strategjitë tona pasi jemi në mes të rrugës, në udhëkryq: ndërmjet së shkuarës dhe së ardhmes, materialit bibliotekar dhe hedhjes së hapave të parë për një bibliotekë digjitale. Dhe jemi pikërisht ne njerëzit e librit që duhet të përgatitemi për t'iu përgjigjur sfidave të kohës, "kujtesës kombëtare digjitale" që është sa e sofistikuar aq edhe "delikate".

Le të udhëhiqemi në hartimin e strategjive tona nga deklarata e Bashkimit Europian: "Digjitalizimi është një hap i parë thelbësor për krijimin e përmbajtjes digjitale që do të mbështesë një Europë gjithëdigjitale. Ai është një veprimtari e rëndësishme në ruajtjen e trashëgimisë kulturore kolektive të Europës, që siguron akces për qytetarët në këtë trashëgimi për të zgjeruar arsimin, turizmin dhe për të zhvilluar industritë me përmbajtje elektronike".

Kam bindjen se i gjithë komuniteti i bibliotekarëve si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë do të mbështesë hartimin e një platformë model për digjitalizimin e kujtesës kombëtare, bashkëveprimin midis bibliotekave kombëtare dhe bashkërendimin e nismave kombëtare në një nivel europian.

Më lejoni ta mbyll paraqitjen time me një frazë nga Raporti i Kombeve të Bashkuara ku thuhet: "Kërkohen përpjekje vendimtare për të çuar vendet në zhvillim - dhe njerëzit kudo që janë - drejt bashkëbisedimit "global".

TRINOMI BIBLIOTEKË - ARKIV - MUZE DHE KULTURA KOMBËTARE

Farfuri XHAJA
Alda BIÇOKU
Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë

Institucionet e trashëgimisë kulturore - bibliotekat, arkivat dhe muzetë - ndajnë synime të njëjta dhe në shumë raste, duke punuar së bashku përmirësojnë shërbimet, rrisin komunikimin dhe respektin reciprok.

Historikisht dallimet mes këtyre tre institucioneve të kujtesës nuk kanë qenë të prera dhe të qarta. Bibliotekat më të hershme që dimë nga historia kanë qenë njëkohësisht edhe arkiva. Ato që quheshin biblioteka tempujsh apo pallatesh ishin vende ku depozitoheshin koleksione shkrimesh që dokumentonin veprimtarinë e tyre. Më pas koleksione të një lloji tjetër tekstesh u quajtën muze. Biblioteka legjendare e Aleksandrisë, p.sh. u quajt Museon.

Në praktikë dallimet mes bibliotekës dhe muzeut kanë qenë fare të vogla deri në fillimet e periudhës moderne, kur me lindjen e shtypit pati rritje dramatike

të koleksioneve të shtypura të cilat ndryshonin nga koleksionet e objekteve, duke sjellë dhe dallimin mes bibliotekës dhe muzeut. Megjithatë ajo që i bashkon këto institucione është depozitimi, ruajtja dhe përdorimi i njësive të quajtura dokumente. Parë në këtë aspekt dallimi mes tyre është vetëm çështje marrëveshjeje që ka evoluar në vite, pasi ata depozitojnë njësi të ndryshme që në thelb quhen dokumente.

Por si përkufizohet termi "dokument"? Përkufizimet janë të shumta. Nocioni tradicional lidhet me shkrimin dhe letrën. Por po t'i referohemi mjedisit digjital, ne përdorim fjalën dokument edhe për skedarë në formë teksti, skedarë audio e video, për materiale multimediale deri dhe për faqe web-i. Paul Otlet, një nga themeluesit e shkollës së dokumentacionit (sot e quajtur shkenca e informacionit) në termin dokument përfshin krahas dokumentit si tekst, edhe objektet natyrore, artifaktet, modelet, veprat e artit, Pra sipas tij termi "dokument" përdoret për të treguar fakte "informative"[1].

Sipas Suzanne Briet, vijuese e teorisë së P. Otlet-it, figurë e rëndësishme në fushën e dokumentacionit dhe themeluese e sallës së shërbimit referues në Bibliotekën Kombëtare të Francës, quhet dokument "çdo dëshmi fizike ose simbolike, e ruajtur ose e regjistruar që ka qëllim të paraqesë, të rikrijojë apo të demonstrojë një fenomen fizik ose konceptor" (në librin What is documentation, 1951)[2]. Ajo thotë se edhe një antilopë mund të jetë një dokument. Për sa kohë që ajo jeton në botën e egër nuk është dokument. Kur kapet dhe vendoset në kopshtin zoologjik, apo skeleti i saj vendoset në muze, ajo bëhet dokument sepse tashmë është shfaqje e një fenomeni.

Pa u ndalur më gjatë në përkufizimet e shumta të termit dokument le t'i referohemi një përkufizimi të thjeshtë: Dokumentet janë mjete komunikimi. Janë copa të botës materiale – argjilë, gur, lëkurë kafshësh, fibra bimësh - që ne i përdorim për të shprehur mendim e ide. Parë në këtë këndvështrim, kufijtë mes bibliotekave, arkivave dhe muzeve janë të zbehtë dhe vijnë duke u zbehur edhe më në epokën digjitale.

Është pikërisht kjo aftësi dhe aspak rastësi krijimi i Bibliotekës së Muzeut Britanik brenda këtij muzeu dhe e hapur njëkohësisht me hapjen e vetë Muzeut Britanik në vitin 1753, apo bashkimi i koleksioneve, shërbimeve dhe personelit të Bibliotekës Kombëtare dhe Arkivit Kombëtar të Kanadasë për të krijuar një institucion të vetëm me emrin Biblioteka Kombëtare dhe Arkivi i Kanadasë. Por

[1] Sipas Robert S. Martin, Cooperation and change: archives, libraries and museums in the United States www.ifla.org/IV/ifla69/papers/066e-Martin.pdf
[2] Po aty.

le të mos shkojmë kaq larg. Edhe Biblioteka jonë Kombëtare historinë e krijimit të saj e ka së bashku me Muzeun Kombëtar.

Bibliotekave, arkivave dhe muzeve u është besuar përgjegjësia e mbledhjes, ruajtjes dhe vënies në përdorim të trashëgimisë kulturore të kombit. Koleksionet e bibliotekave përbëhen kryesisht nga materiale të botuara në formë të shtypur dhe elektronike si dhe dorëshkrime, harta etj. Arkivi Kombëtar ka përgjegjësi kryesore ruajtjen e regjistrimeve publike në letër ose në formë elektronike. Muzeu mbledh, ruan dhe ekspozon artefakte rreth kulturës tonë kombëtare. Por aktualisht nuk ka ndonjë ndarje të qartë për sa i përket llojit të materialeve. Libra gjejmë në bibliotekë, në arkiv dhe në muze, madje dhe njësi me vlera të rralla siç janë kodikët. Po të njëjtën gjë mund të themi për koleksione periodiku, për harta, regjistrime zanore, fotografi, letra personale etj. Edhe legjislacioni përkatës i pasurimit lë shteg për depozitim të materialeve të caktuara në të tre institucionet.

Bibliotekat hartojnë katalogë të koleksioneve me synimin për ta bërë të gjithë koleksionin të akcesueshëm dhe të disponueshëm për përdorim. Arkivat hartojnë lista apo, siç quhen në Arkivin Qendror të Shtetit (me tej AQSH), inventarë të koleksioneve me qëllim konsultimin në mënyrë selektive të këtyre koleksioneve, por jo për huazim. Muzeu i vë në dispozicion koleksionet e tij për t'u parë përmes ekspozimeve, por nuk i vë në përdorim dhe nuk ofron akces në regjistrimet e koleksioneve të tij.

Pavarësisht nga këto dallime bibliotekat, arkivat dhe muzetë ndajnë synime të njëjta: koleksionimin, ruajtjen dhe dhënien e informacionit për përdoruesit. Këtij të fundit nuk i intereson se ku gjendet fizikisht informacioni (në bibliotekë, muze apo arkiv) dhe në çfarë forme është (artikull, libër, fotografi, hartë, muzikë, objekt etj.), për sa kohë që burimi që ai kërkon është i integruar diku, i organizuar mirë dhe lehtësisht i akcesueshëm. Pikërisht ky është dhe çelësi i domosdoshmërisë së bashkëpunimit. Bashkëpunim apo e thënë ndryshe - të punojmë së bashku – është marrëdhënie me përfitim reciprok mes institucioneve, për të arritur synime të përbashkëta duke ndarë përgjegjësitë dhe kompetencat.

Pse duhet të bashkëpunojmë?

Bashkëpunimi për të siguruar akces të materialeve të të tre institucioneve është i nevojshëm sepse:

- praktikat dhe mënyrat e ndryshme të regjistrimit e vështirësojnë gjetjen e informacionit të duhur nga përdoruesi

- mungesa e standardeve nuk lejon koordinimin e komunikimit dhe kërkimin e njëkohshëm të informacionit në institucione të ndryshme
- duhen shfrytëzuar maksimalisht mundësitë e teknologjisë për ruajtjen dhe përdorimin e materialeve.

Përvoja e deritanishme e bashkëpunimit të Bibliotekës Kombëtare me Arkivin Qendror apo Muzeun Kombëtar ka qenë e përqendruar kryesisht në dy aspekte: në botimet bibliografike dhe restaurimin e materialeve. Mund të përmendet pasqyrimi në botimin bibliografik Albanica, vëllimi I, edhe të librave antikuarë që gjenden në Arkiv apo në Muze, duke i dhënë përdoruesit informacion të plotë për botimet e periudhës përkatëse. Por kjo praktikë nuk ka vijuar më tej me vëllimet e tjera të kësaj bibliografie. Po kështu mund të ishte vepruar edhe për botime të tjera bibliografike tematike, apo ato për personalitete të historisë dhe kulturës shqiptare, të cilat janë të vlerësuara nga studiuesit. Vlerësimi do të ishte edhe më i madh po qe se ata, krahas informacionit për libra dhe artikuj, do të gjenin informacion edhe për dokumente, veprimtari krijuese në dorëshkrim (që janë të shumta në AQSH), letra e korrespondenca, fotografi e video të jetës si dhe objekte të personave e ngjarjeve.

Ruajtja afatgjatë e materialeve është një sfidë për institucionet e kujtesës. Arkivi Qendror dallohet për më shumë përvojë në përdorimin e kopjeve (kryesisht mikrofilma) dhe restaurimin e dokumenteve origjinale. Krijimi i repartit të restaurimit në Bibliotekën Kombëtare u realizua edhe si pasojë e marrëdhënieve shumë të mira bashkëpunuese mes specialistëve të të dy institucioneve. Kjo praktikë vijon edhe sot duke kombinuar aftësitë dhe mjetet më të mira restauruese të punonjësve të arkivit me profesionalizmin e punonjëseve të Bibliotekës Kombëtare për proceset e lidhjes me lëkurë. Shembull i mirë bashkëpunimi është kalimi në Muzeun Historik Kombëtar i disa objekteve që fillimisht kanë qenë në dosjet e fondeve personale të Arkivit.

Sot jemi në një situatë krejt tjetër. Teknologjia e re ka krijuar mundësi pa precedent për institucionet e kujtesës. Bashkëpunimi bibliotekë - arkiv - muze është aktualisht një nga temat më interesante të diskutimeve në mjedisin bibliotekar ndërkombëtar. Me prodhimin e informacionit digjital dhe rritjen e vëllimit të materialeve të konvertuara në formë digjitale, bashkëpunimi po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm dhe më i ngutshëm. Bibliotekat, nga ana e tyre, kanë marrë nisma digjitalizimi për të ruajtur koleksionet dhe rritjen e akcesit. Pak më të vonuar janë në këtë proces dy institucionet e tjera. Në kushtet e teknologjisë së re nismat e përbashkëta mund të jenë më të shumta dhe më efektive. Së pari janë tendencat e përdoruesve që i motivojnë si:

- pretendimet e tyre për institucione publike më të hapura dhe të akcesueshme
- përgjegjësia më e madhe e institucioneve publike për shërbime publike cilësore
- publiku dhe studiuesit nuk duan të dinë se ku gjendet burimi i informacionit, mjafton të kenë akces intelektual në të. Ata pretendojnë akces në përmbajtje në sa më shumë burime ose institucione të mundshme.

Duke shfletuar burime të ndryshme lidhur me trajtimin e kësaj teme, në revistën *Library and Information update*, botim i profesionistëve të bibliotekonomisë dhe informacionit në Britaninë e Madhe, tërheq vëmendjen një ilustrim i një shkrimi ku paraqitet një inkunabul e hapur në ekranin e një kompjuteri. Shkrimi mban titullin: A keni ju ndonjë njësi që bota dëshiron ta shohë? (Have you got an item the world wants to see? në *L + I update*, vol. 6, nr. 5, 2007, f. 14) dhe në të bëhet fjalë për një konkurs për futjen online të trashëgimisë lokale, pavarësisht se kush e zotëron origjinalin.

Përfitimet e bashkëpunimit

Krijimi i një rrjeti të përbashkët të trashëgimisë kulturore sjell disa përfitime që motivojnë bashkëpunimin. Cilat janë disa nga këto?

- koleksione më të mëdha
- më shumë përdorues
- shkëmbim më të gjerë përvoje dhe zgjerim të traditës profesionale
- kosto më efektive si rezultat i përdorimit të përbashkët të infrastrukturës dhe pajisjeve hardware e software
- koordinim më i mirë i programeve të trajnimit
- më shumë mundësi për tërheqje fondesh.

Nisur nga këto, sektori i kërkimeve të OCLC (Online Computer Library Center) ka ngritur programe bashkëpunimi mes bibliotekave, arkivave dhe muzeve në përgjigje të sfidave të reja për krijimin, organizimin dhe ruajtjen e koleksioneve të mëdha digjitale. Komisioni Europian nga viti 1988 e në vijim ka mbështetur një seri projektesh bashkëpunimi në sektorin e trashëgimisë. Projekti CALIMERA p.sh. ka qenë i suksesshëm në punën e përbashkët të tre sektorëve për zhvillimin e koleksioneve të trashëgimisë lokale digjitale. Në Britaninë e Madhe në vitin 2000 u krijua Këshilli i bibliotekave-arkivave-muzeve si një organizëm strategjik që punon me dhe për bibliotekat, muzetë dhe arkivat, duke nxitur bashkëpunimin mes tyre. Ky organizëm zëvendësoi dy

këshilla të veçuara: këshillin e muzeve dhe galerive dhe atë të bibliotekave dhe informacionit duke përfshirë dhe arkivat në veprimtarinë e tij. Në Danimarkë janë realizuar projekte që japin mundësi kërkimi njëkohësisht në të tre institucionet, pasi regjistrimet janë hedhur në një bazë të dhënash që akcesohet në Internet. Në Gjermani në vitin 2002 filloi projekti për një portal të përbashkët në Internet për BAM. Nisma të ngjashme ka dhe jashtë Europës, në SHBA, Kanada etj.

Kërkesa për bashkëpunim të suksesshëm

Duke u nisur nga përvoja e projekteve të suksesshme të bashkëpunimit, trashëgimia kulturore në rrjet kërkon disa kushte si:

Gjuha e komunikimit. Ndonëse ne si profesionistë të bibliotekave, arkivave dhe muzeve kemi synime të përbashkëta, na duhet dhe një gjuhë e përbashkët. P. sh. termi *kontribues* për një bibliotekar që bën një regjistrim në *Dublin Core* quhet personi që ka luajtur rol në krijimin e veprës (ilustrator, përkthyes, fotograf etj.), ndërsa për një profesionist të muzeut kontribues është një donator.

Bashkëveprimi mes sistemeve të ndryshme të softeve dhe hardeve. Kjo është një çështje kritike në krijimin e bibliotekës digjitale. Ndonëse në bibliotekën tonë punohet prej vitesh me standardet e përshkrimit bibliografik dhe formatin MARC të shkëmbimit si dhe softe që bazohen në protokollin Z.39.50 për kërkim e gjetje të informacionit, nuk është e njëjta situatë në institucionet e tjera. P. sh. në përshkrimin e dokumenteve arkivore në AQSH nuk zbatohet ende standardi ISAD(G) (International Standard Archives Description - General) dhe standardet e tjera për metadatat. Ndërsa muzetë janë në përgjithësi më të ngadaltë në zhvillimin e standardeve. Standardet janë kërkesë e domosdoshme për pjesëmarrje në rrjete të përbashkëta të trashëgimisë kulturore.

Unifikimi i fjalorëve të termave të kontrolluar. Si Biblioteka Kombëtare ashtu dhe arkivi kanë listat e tyre të emërtimeve lëndore, të emrave personalë dhe të termave gjeografikë, por këto nuk mund të funksionojnë në një rrjet të përbashkët. (p.sh. për emrat personalë në bibliotekë përdoret forma mbiemër - emër, ndërsa në arkiv duhet të kërkosh me emër - mbiemër. Fjalorët e termave të kontrolluar duhet t'i përshtaten përmbajtjes së të tre institucioneve.

Respektimi i dallimeve mes institucioneve. Çdo institucion i trashëgimisë sjell në projektet e përbashkëta vlerat e tij përkatëse, ndaj kërkohet që çdo partner të angazhohet për bashkëpunim duke pasur parasysh dallimet. Kjo do të thotë vlerësim dhe respekt ndaj misionit, kulturës dhe strukturës së çdo institucioni. Koleksionet digjitale duhen bazuar në këto vlera të përbashkëta, duke garantuar se çdo pjesëmarrës do të ketë përfitim nga rezultati përfundimtar.

Puna në grup. Kërkohet gatishmëri dhe dëshirë nga ana e bibliotekarëve për të punuar së bashku me arkivistë, specialistë të TI dhe kuratorë të muzeut.

Krahas këtyre kushteve janë dhe disa faktorë, diskutimi i të cilave do të ndikonte ndjeshëm në bashkëpunimin mes këtyre tre institucioneve:

1. Rishikimi i legjislacionit dhe i kritereve për të saktësuar më mirë zhvillimin e koleksioneve në të tre kategoritë e institucioneve në të ardhmen. Kemi parasysh këtu kuptimin e termit dokument dhe gjendjen aktuale të koleksioneve. Gjen kodikë, libra, dorëshkrime, harta, regjistra famullish, regjistrime zanore etj. në të tre institucionet.
2. Të shihet mundësia e zgjerimit të Këshillit Kombëtar të Bibliotekave në një këshill për të tre institucionet dhe me vartësi nga një organizëm më i lartë se MTKRS.
3. Hartimi i një strategjie kombëtare për ruajtjen afatgjatë dhe akces në materialet digjitale, duke përcaktuar rolin dhe përgjegjësitë e çdo institucioni pjesëmarrës.

Shtrohet pyetja se kush do të jetë nismëtar i këtij bashkëpunimi. Ky rol i përket Bibliotekës Kombëtare sepse:

- Po të ndërtonim një grafik me të dhënat e çdo institucioni për numrin e përdoruesve dhe të materialeve të përdorura, pika më e lartë e grafikut i referohet Bibliotekës Kombëtare. Ajo ka numër më të madh përdoruesish dhe siguron më shumë akces për studim.
- Ka sasi të madhe dokumentesh me vlerë të trashëgimisë kulturore.
- Prej disa kohësh bazohet në standarde ISBD, MARC dhe Z.39.50 dhe është më e angazhuar në procesin e digjitalizimit.
- Ka sistem më të organizuar të përgatitjes profesionale.

Në rekomandimet e Komisionit Europian lidhur me Bibliotekën Digjitale Europiane theksohet mbledhja e informacionit për materialet digjitale dhe ato të planifikuara për digjitalizim (libra, revista, gazeta, fotografi, dokumente arkivore, objekte muzeore, materiale audiovizuale - të gjitha këto materiale kultur-

ore - për të shmangur dublimin dhe nxitjen e bashkëpunimit. Akcesi online do t'u mundësojë qytetarëve europianë përdorimin e këtyre materialeve për studim, punë dhe çlodhje. Kjo do t'i japë trashëgimisë së larmishme dhe shumëgjuhëshe europiane një profil të qartë në Internet. Jemi në kohë për të hedhur bazat e këtij bashkëpunimi në nivel kombëtar së pari, për të prezantuar më pas të plotë në Europë trashëgiminë tonë kombëtare.

RUAJTJA DHE ZHVILLIMI I KOLEKSIONEVE TË VEÇANTA NË BIBLIOTEKËN KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE TË KOSOVËS

Muharrem HALILI
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

Koleksionet Veçanta, në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, përbëjnë pjesën më të rëndësishme të koleksioneve, edhe pse deri në fund të viteve '90-të, kanë qenë koleksione multilinguale e multikulturore, të modifikuara mbi kritere ideologjike, politike, e religjioze, sipas të cilave dominonte koleksioni me burim sllav, përballë koleksionit që është shprehje e identitetit shqiptar, përfshirë këtu edhe koleksionet orientale - me burim kulturor shqiptar.

Në Sektorët e Departamentit të Koleksioneve të Veçanta të BKUK-së ruhen, përpunohen dhe jepen në përdorim vetëm një pjesë e këtyre koleksioneve. Dhe, në këtë përpjekje tonën, për të ofruar shërbim në të gjitha koleksionet e veçanta, jemi në proces të përpunimit të të gjitha koleksioneve, në mënyrë që të avancojmë nivelin e ofrimit të shërbimeve dhe informatave të sakta për përdoruesit.

Një pjesë e njësive të këtyre koleksioneve janë përpunuar në skeda dhe të njëjtat janë shtypur në katalog libër. Ndërsa, tashmë është filluar me procesin përpunimin automatik të koleksioneve në skeda dhe atyre të papërpunuara në programin Aleph 500; janë duke u bartur në katalogun elektronik të dhënat për koleksionet e librit të rrallë dhe të vjetër, muzikaleve, doktoratave, magjistraturave, koleksionet e bibliotekave legatë, koleksioni muzeal.

Mbështetur në koleksionet e përpunuara (të kataloguara) dhe atyre të regjistruara, nëpërmjet librave të inventarit, numri i përgjithshëm i Koleksioneve të Veçanta është 40.775 njësi bibliotekare.

Koleksionet dhe Bibliotekat e Veçanta

Departamenti i Koleksioneve të Veçanta të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, përmban:

- Koleksionin e dorëshkrimeve;
- Koleksionin e librit dhe të periodikut të rrallë e të vjetër;
- Koleksionin e muzikaleve;
- Koleksionin e hartave;
- Koleksionin e doktoranturave dhe magjistraturave;
- Koleksionin muzeal (arkivor);
- Koleksionim e foto-dokumenteve;
- Koleksionin e mikrofilmave dhe mikrofisheve;
- Koleksionin e materialit të imët.

Departamenti i Koleksioneve të Veçanta, gjithashtu, ka edhe biblioteka të veçanta legatë, të cilat janë dhuratë, të trashëguara ose të grumbulluara nga personalitete të njohura publike të kulturës e të shkencës:

- Biblioteka e Hasan Efendi Nahit;
- Biblioteka e Krist Malokit;
- Biblioteka e Fehmi Aganit.

Po ashtu, në kuadër të Departamentit të Koleksioneve të Veçanta, janë edhe bibliotekat me koleksione speciale, si:

- Biblioteka e Artit bashkëkohor;
- Biblioteka e NATO-s;
- Arkivi i Autorëve.

Në kuadër të Departamentit të Koleksioneve të Veçanta, është edhe biblioteka në krijim: Kujtesa e Kosovës.

Dorëshkrimet

Në Koleksionet e Veçanta të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës janë 779 dorëshkrime të vjetra kryesisht me alfabet arab, e më pak dorëshkrime me alfabet latin, grek, cilirik. Shumica e dorëshkrimeve orientale janë në gjuhën arabe, osmane dhe persiane, por në këtë koleksion përfshihen edhe dorëshkrime shqipe me alfabet arab.

Dorëshkrimi më i vjetër është ai i vitit 1347 - dhuratë nga biblioteka e Hasan Efendi Nahit. Pastaj është: "Pendnameja" e Feriduddin Muhamed b. Ibrahim Attari-it, kopjuar në vitin 1635, "Divani" i Sylejman Axhize Babës, 1717, "Vehbija" e Tahir Gjakovës, autograf, 1835, "Trajtesë nga fusha e logjikës", përpiluar nga Mahmud B. Abdyl - Halim (Gjakova), 1835 etj.

Katalogu i koleksionit të Dorëshkrimeve orientale-osmane në Kosovë në vijimësi është duke u pasuruar nëpërmjet dhuratës nga donatorë, të cilët i dhurojnë bibliotekës dorëshkrime me interes kulturor dhe historik.

Libri i rrallë dhe i vjetër

Në Koleksionin e librit të rrallë dhe të vjetër janë rreth 2 mijë njësi - libra. Librat e këtij koleksioni janë në gjuhë dhe alfabete të ndryshme. Tashmë koleksioni i librit të rrallë dhe të vjetër, me rëndësi për fushat e albanologjisë, është duke u pasuruar dhe duke e dominuar koleksion në gjuhë të huaja, kryesisht atë serbe, i cili më parë përfshinte shumicën dërrmuese të titujve. Shumica e këtyre titujve janë dhuruar nga individë dhe autorë të rëndësishëm të kulturës shqiptare, si: Shaqir Kastrati, Hasan Efendi Nahi, Krist Malokit, Fehmi Aganit etj. Një numër titujsh të çmuar në këtë koleksion janë dhuruar nga Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë. Edhe pas luftës, janë dhuruar libra dhe dorëshkrime të çmuara nga individë të fushave kulturore.

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, gjithashtu, ka blerë në vijimësi edhe libra dhe dorëshkrime nga bibliotekat antikuar, si dhe nga individë që mbledhin dhe ruajnë libra të vjetër.

Libri më i vjetër është "Historia për jetën dhe bëmat e Skenderbeut, princit të Epirotëve i Marin Barletit", 1533, i përkthyer nga gjuha latine në gjuhën gjermane në alfabetin gotik dhe i botuar në Augsburg, pastaj vepra e Ioan Petri Contareni me titull: "Veneti historiae de belo nvper Venetis a Selimo II, Tvrcarvm imperatore Nikolao philos et medito", 1573 (e botuar në Bazel). Në

këtë libër gjendet një hartë (fletë e palosur) e Ballkanit e vitit 1571, ku është shënuar emri ALBANIE, pastaj 2 nga 3 librat e kompletit të Renati Descartes: "Epistolae: Partim ab Auctore Latino fermone confcripte, parim ex Gallico tranflate", botuar në Amstelodami, 1683 etj.

Koleksioni i periodikut të rrallë dhe të vjetër

Në Koleksionet periodikut të rrallë dhe të vjetër janë mbi 300 tituj, me afro 5.000 njësi periodiku. Koleksioni i periodikut - revista dhe gazeta, përbëhet nga tituj me traditë të shkurtër, por dhe të gjatë të daljes - javore, mujore, vjetore etj.; shumë prej titujve janë ta pakompletuar dhe mungojnë numra muajsh dhe vitesh të ndryshme.

Titujt më të vjetër janë: Fiamuri Arbërit i De Radës. - Itali, 1883; Shqipëria.- Bukuresht, 1897; Yll' i Shkjiperise : Organe Des Aalbanais Nationalistes. - Bucarest, 1899; Albania. - Bruksel, 1897; Kalendari Kombiar. - Sofje, 1903; Laimtari i Scypnies. - Roma, 1905; La Nazione Albanese : Organo Unitario Nazionale. - (Catanzaro) - Roma, 1907; Dielli. - Boston, 1909; Zgjimi. - Korçë, 1914; Iliria. - Boston, 1916; Hylli i Dritës. - Shkodër, 1921; Normalisti : Del nji herë në muej.- Elbasan, 1928; Leka. - Shkodër, 1936; Përpjekja Shqiptare. - Tiranë, 1938 etj.; Djaleria : Organ i Djaleris Shqiptare n'Amerike. - Toronto ; Ont. Canada, 1950; L'Action Des Kossovars : Bulletin Du Comite des Aalbanais de Yougoslavie. - Paris, 1957.

Koleksioni i magjistraturave dhe doktoranturave

Për Koleksionin e doktoratave dhe magjistraturave, përkujdeset Qendra për Informata Shkencore dhe Veprimtari Referale, e cila funksionon në kuadër të Departamentit të Koleksioneve të Veçanta. Me implementimin e programit Aleph 500, Qendra ka filluar të krijojë bazën e të dhënave për magjistraturat dhe doktoratat, të cilat do të kenë rëndësi të veçantë për kompletim të informacionit në këtë koleksion, kur dihet se jo rrallë tezat e magjistraturës apo të doktoranturave të mos botohen asnjëherë. Në këtë kontekst, Qendra Referale ka botuar Bibliografinë e Disertacioneve të Doktoratave të doktorëve të shkencave të Kosovës për periudhën kohore 1947-1982, 1999-2004.

Koleksioni i muzikaleve, hartave, foto-dokumenteve

Në koleksionet e muzikaleve hyjnë doreshkrimet muzikore, partiturat, muzikalet e shtypura, pllakat e gramofonit, kasetat, CD etj.

Koleksioni i fono-dokumenteve përfshin të gjitha incizimet e të gjitha zhanreve të muzikës të autorëve dhe kompozitorëve vendas dhe të huaj, përfshirë tekste letrare artistike, si dhe publikime audio-vizuele me përmbajtje të ndryshme. Ky koleksion posedon skedarin, në të cilin është përfshirë shumica e titujve të koleksionit të muzikës.

Tashmë ka filluar aplikimi i katalogimit në publikim(CIP) dhe dhënia numrit të ISMN-së.

Koleksioni i hartave është i pasur nga përmbajtja, destinomi, si dhe shkalla e zvogëlimit. Koleksionet e hartave, përfshijnë harta për territorin e Kosovës, territoret shqiptare, Ballkanin, Evropën Juglindore, si dhe harta, po ashtu të shteteve të Evropës dhe botës.

Koleksioni i hartave i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës përmban mbi 1500 njësi.

Koleksioni i foto-dokumenteve është i pasur nga përmbajtja, lloji, formati dhe vjetërsia e prodhimit të tyre. Ky koleksion i fotografive është mjaft i pasur me figura të personaliteteve historike të kulturës dhe të historisë sonë.

Koleksioni i albumeve përbëhet prej foto-monografive të botuesve tonë dhe të huaj. Këto albume përmbajnë, gjithashtu tema të ndryshme.

Edhe koleksioni i panoramave është i pasur dhe paraqet fotografi të qyteteve, figura historike, personalitete nga arti dhe letërsia, si dhe ngjarje historike.

Përfundim

Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës tash është në proces të projektit për përpunimin e të gjitha koleksioneve dhe bibliotekave të veçanta - që janë pjesë e Departamentit të Koleksioneve të Veçanta. Gjithashtu, mbështetur në politikat e pasurimit të koleksioneve të rralla dhe të vjetra, janë duke u hartuar lista për blerjen e titujve të rëndësishëm; në këtë kontekst, gjithashtu, po hulumtohet për sigurimin e informacioneve për gjetjen e këtyre titujve nëpër biblioteka antikuar, si dhe individë, të cilët mbledhin dhe ruajnë libra të vjetër.

Blerja e këtyre titujve, duke u bërë pronë e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, do të vinte në mbrojtje pjesën më të rëndësishme të kulturës nacionale të shkrimit dhe të materialit dokumentar. Ky lloj kërkimi i informacionit do të zgjerohet edhe për të gjitha llojet dhe format e të tjera të materialeve.

Në këtë proces të konsolidimit dhe të zhvillimit të Departamentit të Koleksioneve të Veçanta, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, do të ofrojë shembullin më të mirë në Kosovë se si mund të merret nën kontroll informacioni, dhe në këtë kontekst si mund të grumbullohet, ruhet, përpunohet dhe digjitalizohet pjesa e trashëgimisë kulturore kombëtare.

Na duhet kohë, vullnet, dije dhe kreativitet, që t'ia dalim mbarë t'i përmbyllim këto projekte me rëndësi kombëtare.

Tashmë kemi nisur t'i hapim shtigjet e këtij kërkimi dhe rezultatet janë të prekshme - Departamenti i Koleksioneve të Veçanta është pasuruar me shumë tituj të rrallë e të veçantë koleksionesh, janë kataloguar shumë tituj në katalogun elektronik dhe, po ashtu, janë restauruar tituj me rëndësi të veçantë për kulturën shqiptare.

ARRITJE DHE MUNDËSI TË REJA PËR NDRIÇIMIN E VLERAVE TË RRALLA TË KUJTESËS KOMBËTARE

Mejli KOKONA
Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë

Bibliotekat në të gjitha kohërat janë konsideruar si kujtesa të njerëzimit. Si të tilla ato kanë luajtur një rol të madh në zhvillimin e dijes, mendimit dhe kulturës. Ashtu siç shprehet edhe Umberto Eco "Bibliotekat në shekuj janë bërë rruga më e rëndësishme e të mbajturit të mençurisë kolektive". Ato grumbullojnë e ruajnë vlera, mbështesin dhe përkrahin lirinë e informacionit dhe të qenit të informuar si një e drejtë themelore e qytetarëve.

Funksioni i Bibliotekës Kombëtare në mbarë botën është grumbullimi, pasurimi, ruajtja dhe vënia në shërbim të përdoruesve të koleksioneve të saj, duke dokumentuar kështu të kaluarën e njohur a të panjohur, të tashmen që së shpejti do të bëhet e kaluar.

Fondet e rralla të kujtesës kombëtare

Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë ruan në fondet e saj botime të rralla, që kanë vlerë jo vetëm për trashëgiminë e shkruar kombëtare, por më gjerë dhe atë europiane. Një vend të rëndësishëm në koleksionet e Bibliotekës Kombëtare zënë:

- Fondi i Antikuarit;
- Fondi i Dorëshkrimeve;
- Fondi i Arkivit Shqip;
- Fondi i Hartave;
- Fondi i Botimeve Albano- Balkanologjike.

Fondi i Antikuarit, përmban rreth 2000 vëllime, ku përfshihen botime të shekujve XV- XVIII me përmbajtje historike, gjuhësore, fetare etj. - shprehje e qytetërimeve të popujve të ndryshëm. Dallohen veprat e autorëve të vjetër greko - latinë si: Tuqiditi, Straboni, Aristoteli, Apiani etj., të cilët në veprat e tyre sjellin njoftime të vlefshme për ilirët dhe Ilirinë; ato të autorëve bizantinë si: Ana Komnena, Halkondili etj., studimet e të cilëve sjellin të dhëna për historinë e popullit tonë në lashtësi. Me rëndësi të pallogaritshme janë edhe veprat historike dhe letrare të autorëve francezë, italianë, gjermanë etj.,të cilët në qendër të botimeve të tyre kanë vendosur figurën e heroit tonë kombëtar Skënderbeut; numërohen gati 500 të tilla. Ndër 7 inkunabulat që ruhen në këto fonde, më e hershmja i takon vitit 1473 me titull "Letra për Kuvendin e Mantovës" e Papa Piut II, në të cilën jepen të dhëna për organizimin e një ekspedite ndërkombëtare kundër pushtuesve osmanë, ku përmenden edhe shqiptarët. Ky fond merr vlera të veçanta për faktin se në të ruhen edhe vepra në shqip të autorëve të vjetër si: Buzuku, Budi, Bogdani, Frang Bardhi, Dhimitër Frëngut etj., si dhe të humanistëve shqiptarë Marin Barleti e Marin Beçikemi. Botimet e Voskopojës, ndonëse me përmbajtje fetare, vlerësohen pasi ato tregojnë shkallët e zhvillimit të shtypshkrimit në Shqipëri.

Fondi i Dorëshkrimeve përfshin 1128 vepra, kryesisht në gjuhët orientale arabisht, osmanisht dhe persisht, shumica e të cilëve të kopjuara nga kaligrafë të specializuar nga Shkodra, Berati, Tirana etj. Për vlerat e tyre dallohen edhe dorëshkrimet shqipe me alfabet arab. Me vlerë të veçantë historike janë "munsheatët" ose krestomacitë dokumentare, në të cilat flitet për ngjarje, vende dhe figura të ndryshme të Shqipërisë si p.sh.: për veprimtarinë e Ali Pashë Tepelenës dhe Mustafa Pashë Bushatlliut, historinë e qyteteve të ndryshme të Shqipërisë etj. Në këtë fond gjenden edhe një pjesë e vogël dorëshkrimesh në gjuhët perëndimore si "Ditarët e punës" në gjermanisht (6 vëllime) të albanologut Franz Nopcsa. Në serinë e veprave letrare mbisundojnë "divanet". Në këtë fond ruhet vëllimi me poezi i Nezim Frakullës, poema "Erveheja" e Muhamet Çamit etj.

Fondi i Albano-Balkanologjisë numëron rreth 44.000 vëllime; përfshin botime në shqip dhe në gjuhë të huaja që flasin për Shqipërinë, studime mbi kulturën, historinë, folklorin, arkeologjinë, gjuhësinë, etnografinë etj. Këtu gjendet veprat e De Radës, Kamardës, Naim Frashërit, Jani Vretos, Dora D'Isrias etj. Një botim i rrallë është edhe "Evetari" i Naum Veqilharxhit me një alfabet të veçantë të krijuar nga autori, i pari abetar në gjuhën shqipe, "Alfavitar shqip" i Kostandin Kristoforidhit etj. etj. Vepra me peshë në këtë fond janë ato të albanologëve si: Jokli, Lamberci, Babingeri etj. Pasurimit të këtij fondi i kushtohet një kujdes i veçantë.

Fondi i Arkivit Shqip përfshin të gjitha shtypshkrimet në shqip të botuara brenda dhe jashtë vendit nga autorë shqiptarë dhe të huaj, si edhe ato në gjuhë të huaj që botohen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Ky fond pasurohet në radhë të parë nga ligji i ekzemplarit të detyruar, si dhe nga dhuratat ose shkëmbimet. Ky fond përfshin 71.400 tituj.

Botime me mjaft vlerë për kujtesën tonë kombëtare, që në fakt janë nënvlerësuar, dhe si rrjedhojë nuk janë "ndriçuar", janë edhe botimet me shënime apo autografë, skica a vizatime etj. të personaliteteve të ndryshme - të shkruara në frontespice, kopertina a faqe librash. Ky element i rëndësishëm nuk rezulton të jetë shënuar në çdo skedë. Në bibliotekë mungon një katalog i mirëfilltë për autografet. Ndofta ka ardhur koha që të mendohet për një botim të tillë.

Arritje

Duke pasur parasysh që termi "Kujtesë kombëtare" i referohet të gjithë testamenteve të kulturave të shkruara e kulturave të tashme, është treguar kujdes jo vetëm për ta grumbulluar këtë thesar, por dhe ruajtur e evidentuar. Do të rendisim shkurtazi disa arritje si:

I. Mikrofilmi i një pjese të fondit të vlerave të rralla;
II. Konvertimi retrospektiv i hyrjeve të reja Albano-Balkanologji (1988-1995);
III. Ekspozitat;
IV. Bibliografitë tematike;
V. Digjitalizimin e skedarëve të vlerave të rralla.

I. Mikrofilmimi

Ngaherë, madje edhe në epokën e sotme digjitale, mikrofilmimi është konsideruar si një mjet i rëndësishëm për të ruajtur kujtesën kombëtare. Shtypshkrimet, që rrezikojnë dëmtimin për shkak të vjetërsisë së letrës së shkrimit ose të shtypit, në bibliotekat e huaja, rezultojnë të mikrofilmuara dhe të ruajtura në kuti metalike - si një mjet sigurie edhe raste fatkeqësish natyrore ose aksidentale siç mund të jenë: përmbytjet, rënia e zjarrit etj. Kujtojmë dëmet që solli përmbytja në Bibliotekën e Republikës Çeke. Edhe Komisioni i Ruajtjes dhe Përdorimit – PAC (*Preservation and Conservation)* - një ndër programet kryesore të IFLA-s, për zgjidhjen e problemit të "librave me letër të brishtë" rekomandon përdorimin e mikrofilmimit.

Biblioteka Kombëtare ka mundur të mikrofilmojë vite më parë, kur funksiononte laboratori i mikrofilmimit, 6.300 njësi, nga të cilat 350 i përkasin Fondit të Antikuarit, 100 Fondit të Dorëshkrimeve, pjesa tjetër Fondit të Arkivit të Periodikut Shqip dhe pak Fondit të Albanolo - Balkanologjisë.

II. Konvertimi retrospektiv i hyrjeve të reja albano-balkanologji (1988-1995)

Informatizimi i proceseve dhe i shërbimeve bibliotekare në Bibliotekën Kombëtare shënoi një hap përpara në përshtatje me kërkesat gjithnjë e në rritje të përdoruesve në kushtet e reja të Shoqërisë së Informacionit. Me automatizimin e bibliotekës, në bazën elektronike të të dhënave filloi vetëm hedhja e hyrjeve të reja, ndërkohë që përdoruesi kërkonte më shumë informacion për kujtesën e shkruar. Në këto kushte, mbështetur edhe në përvojën e bibliotekave të përparuara, u ngrit një grup pune, me specialistët më me përvojë të Bibliotekës Kombëtare, të cilët hartuan projektin e "Konvertimit retrospektiv të hyrjeve të fondit Albano-Balkanologji (periudha 1988-1995)". Zbatimi i projektit filloi në vitin 2003 dhe përfundoi në maj të vitit 2006. Ndër mënyrat e ndryshme të konvertimit, u zgjodh ajo e hedhjes së të dhënave në kompjuter dhe jo skanimi i skedave. Në bazën e të dhënave u hodhën rreth 4500 skeda dhe u redaktuan 500 regjistrime të mbartura nga softi i mëparshëm bibliotekar ISIS, që ka përdorur Biblioteka Kombëtare. Projekti është sukses pasi:

- Rriti shkallën e përpunimit të informacionit;
- Nëpërmjet redaktimit të skedave, mundësoi standardizimin e informacionit;
- Unifikoi autorët;
- Informacionin bibliografik në katalogun elektronik e paraqiti me standardet e reja të klasifikimit;
- Duke zgjeruar bazën e të dhënave, ofroi mundësi më të mëdha të akcesit në burimet e informacionit.

Katalogu elektronik vijon të pasurohet me hyrjet e reja dhe me artikujt e vjelë nga revista, gazeta në shqip dhe në gjuhë të huaja me karakter albano-balkanologji. Deri më sot janë regjistruar 2300 artikuj; kohët e fundit ka filluar përpunimi i tyre edhe me fjalët kyçe. Regjistrimet në OPAC të botimeve me karakter Albano-Balkanologji janë : 8.000 libra, 440 dorëshkrime, 28 harta, 60 materiale në grup etj.

III. Ekspozitat

Biblioteka Kombëtare ka krijuar një traditë mjaft të mirë në organizimin e ekspozitave, kryesisht me vlerat e rralla që ajo ruan në fondet e saj, duke i kthyer ato në ngjarje të shënuara kulturore. Botimet në origjinal të sjella para publikut, libra, revista, harta, dorëshkrime etj. ngjallin interes si për studiuesit ashtu dhe njerëzit e thjeshtë, pasi thesaret "zbulohen" rrallë. Duke ndriçuar pjesë të kujtesës kombëtare krijohen lidhje të publikut me vlerat e bibliotekës.

Vlen të përmenden disa ekspozita tepër të suksesshme, të organizuara së fundmi në mjediset e Bibliotekës Kombëtare, si: "Skënderbeu - Botime antikuar", "Shenjtorët e Shqipërisë", "Autorët gjermanshkrues", "Kuteli në 100 vjetor" - të cilën e përuruam edhe këtu në Prishtinë.

Në ditët e sotme, në web-et e bibliotekave gjithnjë e më shumë, po navigojmë në ekspozita online ose të quajtura ndryshe ekspozita virtuale. Konferenca e Bibliotekave Kombëtare të Evropës (CENL), ku biblioteka jonë është anëtare, krijoi në vitin 1999 një ekspozitë virtuale të titulluar "Thesare të Bibliotekës Kombëtare Europiane", në të cilën pasqyrohen: dorëshkrime të ilustruara, botime antikuare, botime me lidhje dhe/ose ilustrime speciale etj. me vlerë nga

koleksionet e bibliotekave kombëtare të vendeve anëtare. Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë është përfaqësuar në këtë ekspozitë on - line me veprën e Marin Barletit "Historia de vita et gestis Scanderbegi Epirotarum, principis". - Romë, 1508 - 1510. - 159 f. [Historia e jetës dhe bëmave të Skënderbeut, princ i Epirit]. Kjo vepër është zgjedhur jo si botimi më i vjetër që ruhet në fondet me vlerë të Bibliotekës Kombëtare, por si një botim që bart vlerat historiko – dokumentare për historinë e vendit tonë. Veprat e Barletit - të përkthyera në disa gjuhë - shërbyen si burim kryesor, ku u mbështetën mjaft autorë të huaj në veprat e tyre për Skënderbeun. Krahas një përmbledhjeje të shkurtër të përmbajtjes së veprës, jepen dhe disa veçori të shtypit dhe rishtypjes së saj gjatë shekujve XVI- XVII.

IV. Bibliografitë

Për të orientuar lexuesin në morinë e vlerave që mbart çdo bibliotekë dhe në morinë e informacionit që është gjithnjë në rritje, është i nevojshëm hartimi i bibliografive retrospektive tematike. Ato u krijojnë atyre komoditetin e duhur për identifikimin e burimeve dhe të dhënave të panumërta, që gjenden në librat e shkruar vite a shekuj më parë. Prandaj hartimi i bibliografive të tilla është parë me përparësi edhe në bibliotekën tonë. Lexuesi ka tanimë nëpër duar mjaft botime bibliografike si: bibliografinë e adnotuar "Albanica 1", e cila përmban botime të shek.XV-XVII; "Albanica II", që përmban botime të gjysmës së parë të shekullit XIX; kolanën "Vepra të autorëve dhe studiuesve të huaj për Shqipërinë dhe shqiptarët" etj. Të shoqëruara me adnotime edhe në gjuhë të huaj, ato janë të përdorshme edhe për studiues të huaj. Një katalog i dorëshkrimeve në gjuhët arabisht dhe persisht nga koleksioni i bibliotekës Kombëtare është botuar në Londër më 1997.

Aktualisht po punohet për botimin e "Bibliografisë së librit shqip 1555 –1912", vepër madhore për kulturën shqiptare. Sektori i Albano-balkanologjisë boton rregullisht botimin "Hyrjet e reja Albano-balkanologji", ku përfshihen të gjitha hyrjet e reja - libra, artikuj, disertacione, harta etj. që lidhen me historinë, gjuhën, kulturën, etnografinë etj. E Shqipërisë dhe vendeve të Ballkanit.

Për projektin më të fundmë të digjitalizimit të skedarëve të vlerave të rralla nuk do të ndalemi pasi për të do të flasin kolegët e Sektorit të Teknologjive të Reja.

Mundësi të reja

Ritmet e shpejta të zhvillimit teknologjik, teknikat e reja të digjitalizimit dhe ruajtjes së vlerave të rralla, kërkojnë një vëmendje e angazhim më të madh nga ne komuniteti i bibliotekarëve - domosdoshmëri për të përballuar sfidat e shekullit 21. Prandaj, nëse të gjithë së bashku do të bashkëpunojmë në zgjerimin e bazës së të dhënave, rritjen e akcesit në vlerat e rralla nëpërmjet web-siteve të bibliotekave tona, digjitalizimit të "thesareve" të dy institucioneve kombëtare të librit në Prishtinë e Tiranë, ne do të kontribuojmë në ndriçimin e kujtesës kombëtare.

BIBLIOTEKAT E PARA NË PRIZREN DHE LIBRAT E VJETËR

Sahadete SADIKAJ
Biblioteka Ndërkomunale - Prizren

Hyrje

Shoqëritë që kanë arritur të ruajnë sa më të plota dhe t'i japin në përdorim vlerat e tyre të shkruara, njihen si shoqëri me tradita e trashëgimi të pasur kulturore e shpirtërore.

Që nga mijëvjeçarët e kaluar, bibliotekat kanë bartur fuqishëm kujtesën e shkruar të njerëzimit. Në fakt, biblioteka është institucion kulturor që vë bazat për ruajtjen e kulturës materiale-shpirtërore të popujve, duke vënë në lidhje të përhershme njerëzit me nevojën për interkomunikim mes vete për dijet dhe kulturat kombëtare.

Nëse nisemi nga termi kujtesë kombëtare, që nënkupton krijimin, regjistrimin dhe ruajtjen e vlerave më të larta të një kombi, atëherë mund t`i përmendim edhe bibliotekat, si arkiv i ruajtjes së këtyre vlerave nacionale. Në këtë kontekst, ne do të flasim për fillimet e para të ekzistencës së bibliotekave në Kosovë. Këto

biblioteka ekzistuan në forma dhe kushte të ndryshme, varësisht nga kushtet shoqërore-historike në të cilat kaloi edhe vetë Kosova.

Gjurmëve të bibliotekave të para

Të flasësh me saktësi për vjetërsinë e librave dhe dorëshkrimeve, si dhe të bibliotekave të para në Prizren, nuk është punë e lehtë, duke pasur parasysh mungesën e ekspertëve të fushave e gjuhëve që identifikojnë, lexojnë dhe interpretojnë shenjat kulturore të traditës së lashtë. Ndërsa, në këtë kontekst, kur është fjala për gjurmët e bibliotekave të para, u referohemi burimeve të ndryshme si sentencave historike, fondeve të trashëgimisë, burimeve arkeologjike, materialeve të shkruara (fetare edhe laike) e deri te ato të përpunuara nën përkujdesjen shkencor, pasi që siç thotë Paul Buck: „Biblioteka pa dyshim konsiderohet si një nga shenjat supreme më dalluese të pjekurisë civilizuese të një shoqërie".

Duke e pasur parasysh se ekzistenca e bibliotekave të para në Kosovë ka një histori të hershme, që mbështetur mbi disa fakte relevante, lidhet me qytetin e Prizrenit, ne po japim dëshmitë e shkrimit e të dokumentimit të ruajtura në biblioteka të veçanta në këtë qytet, ekzistenca e të cilave lidhet me religjionet që kanë bërë jetë në këto hapësira.

Biblioteka e Suzi Çelebiut

Prizreni njihet edhe si njëri nga qytetet më të vjetra ku u kultivuan vlerat e ndryshme të kulturës, dhe gurëthemel i shumë institucione me rëndësi kulturore e religjioze. Në këtë kontekst, Prizreni njihet në Kosovë edhe nëpërmjet bibliotekës së parë - bibliotekës së Suzi Çelebiut (1513).

Suzi Çelebiu u lind në Prizren në vitin 1465, dhe është i njohur me emrin Muhamed. Emrin Suzi e mori nga kuptimi i fjalës - i djegur. Ai ishte njëri ndër poetët më të vjetër jo vetëm në Kosovë.

Dorëshkrimi i Suzi Çelebiut "Vakifnamesi"

Suzi Çelebiu kishte shkruar 15 000 vargje, të cilat nuk u publikuan, si dhe ishte autorë i njohur i librave nga fusha të ndryshëme. Shpresohet se një numër të dorëshkrimeve të Suzit ekzistojnë ende të ruajtura, sepse një pjesë të tyre e kishin marrë francezet në pronësi, pjesën tjetër - konsulli rus me shërbim në Prizren, si dhe një pjesë kishte përfunduar në Zagreb (IMM në Prizren ka arritur ta ketë vetëm nga një kopje të tyre).

Vakufnamja e Suzit, e legalizuar para organeve legjislative të asaj kohe në muajin Rebiul Ahir të vitit 919 (muaji Reb Iul Ahir ka filluar më 6. 06.1513 dhe ka pasur 30 ditë - sqarim nga IMM). Në Vakufnamen e Suzit, legalizuar në muajin Rebuil Ahir të vitit 919 [1513], shkruan: "... unë vakufoj" (lë amanet / bëj testament).

Në bibliotekën e kësaj medreseje, janë edhe librat: "Tevsirubshejn" - dy vëllime, "Hidaje" - një vëllim, "Sheriatin islam" në dy vëllime, "Teskiretylenbija" - një vëllim, "Mesnevi" - katër vëllime, "Kimia Seaadeti" - dy vëllime etj., të cilat, pas vdekjes së tij, janë mbikëqyrur nga imami i xhamisë dhe u jepen në shfrytëzim përdoruesve.

Gjatë punës tonë kërkimore, kemi gjetur libra, duke filluar nga viti 1092 e tutje sipas llogaritjeve të Hixhrit, si p.sh. libri" "Kitab Elmelik Gl-vehab", i autorit Mustafa Bin Hamze, me përmbajtje gramatike nga gjuha arabe, gjuha e shkruar e arabe e viti 1092 (sipas Hixhrit)

Biblioteka e Suzi Çelebiut (1513)

Në Prizren, pos bibliotekave të cilat kanë ekzistuar pranë xhamive dhe mejtepeve, kemi edhe biblioteka të kishave - të besimit katolik dhe të besimit ortodoks, të cilat, po ashtu, përmbajnë dorëshkrime dhe libra të rëndësishëm.

Një rëndësi mjaft të madhe kanë edhe bibliotekat e krijuara pranë teqeve. Teqet kanë ekzistuar në shumë vendbanime të Kosovës, ndërsa ndër më të njohurat ishin në Prizren, të cilat përmbajnë një fond të rëndësishëm të librave dhe dorëshkrimeve.

Ne kemi vijuar me hulumtimin e këtyre objekteve të kultit, për të evidentuar pasurinë e tyre - të librave dhe dorëshkrimeve. Qëllimi ynë ishte që, krahas njohjes dhe hulumtimit të bibliotekave të para, të njihen edhe materialet e shkruara, të botuara të pabotuara; të njihemi më shumë me ekzistencën e tyre, përmbajtjen, gjuhën, autorët, vjetërsinë, si dhe gjendjen fizike të këtyre materialeve.

Gjendja e librave dhe dorëshkrimeve nuk është e njëjtë; gjendja e tyre është shenjë se sa janë ruajtur nga individë dhe institucione përkatëse. Nga ajo që kemi verifikuar, ka libra dhe dorëshkrime që kërkojnë restaurim urgjent, për shkak të dëmtimit të tyre.

Si rezultat i punës dhe hulumtimit tonë për gjetjen, evidentimin dhe ruajtjen e dorëshkrimeve dhe librave të vjetër, Biblioteka Ndërkomunale e Prizrenit ka botuar një përmbledhje me titull: "Libra të rrallë", që prezanton pjesën e trashëgimisë së bibliotekave të Prizrenit, në të cilën janë dhënë pamjet e shumë librave, të cilat biblioteka ka arritur t'i evidentojë, duke ofruar të dhëna për njësi, si: titulli, autori, viti i botimit, si dhe vendi ku gjendet libri apo dorëshkrimi. Këto libra janë kryesisht në gjuhën arabe, turke, persishte etj., si dhe kanë përmbajtje kryesisht fetare, por edhe shkencore, nga fusha e mjekësisë, gjeografisë, biologjisë, matematikës etj.

Duke e ditur se kjo është vetëm një nismë drejt këtij qëllimi, i cili do të ndihmonte njohjen e një tradite kulturore, ne jemi të sigurt se duhet të punohet më shumë në këtë drejtim, sepse, siç thotë Mithat Frasheri: "Biblioteka duhet te jet nje gje e gjalle, qe rron, qe do ushqyer, qe do shikuar; te jet ne kontakt me kendonjesin dhe t'i plotsoj kerkesat e tyre". Prandaj, në këtë kontekst, do të duhej që të gjitha bibliotekat, krahas hulumtimit të librit të ri, të hulumtojnë, të gjejnë e të ruajnë edhe libra e dorëshkrimet e vjetra. Të dëshmohet se sa ka traditë të shkrimit e të kulturës në Kosovë, si dhe sa ruhen e mbrohen vlera kulturore të trashëguara.

Biblioteka ndërkomunale e Prizrenit, do të vazhdojë edhe më tutje me hulumtimin dhe evidentimin e materialeve të ndryshme dhe librave, të cilat gjenden në vende të ndryshme.

Shpresojmë se ndjeshmëria dhe nevoja për t'u marrë më me përkushtim me këto aspekte të kulturës materiale e të shkrimit do të zhvillohet, meqë jemi ne që po aktualizojmë në vijimësi institucionet qeveritare e kulturore për t'u marrë më me përkushtim me këtë fushë të trashëgimisë.

Libri e shkrimi i ruajtur është trashëgimia jonë, matja e qytetërimit, e kulturës dhe e dijes tonë; dritare e hapur në evoluimin e kulturës dhe dialogim me kohët - të djeshmen, të sotmen, e të nesërmen. Drejt këtij qëllimi edhe ne po ecim. Pra, të mundohemi të ruajmë, të njohim dhe të vlerësojmë trashëgiminë tonë.

HARTAT E SHEK. XVI - XIX, PJESË E KUJTESËS KOMBËTARE

Afërdita SHARRXHI
Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë

Ligjërata trajton dy probleme që kanë të bëjnë *së pari* me evidentimin e vlerave dhe rëndësinë që ka koleksioni i hartave të rralla të Bibliotekës Kombëtare në paraqitjen e trojeve shqiptare, veçanërisht atyre të Kosovës, në periudha të ndryshme historike dhe *së dyti* me digjitalizimin e këtij koleksioni në të ardhmen, për të mundësuar jetëgjatësinë dhe shfrytëzimin online të tij nga përdoruesit.

Hartat e rralla si pjesë e trashëgimisë kulturore

Në fondet e Bibliotekës Kombëtare ndodhet një numër i konsiderueshëm hartash të shekujve XVI-XIX, që së bashku me librat e rrallë dhe dorëshkrimet janë pjesë e rëndësishme e trashëgimisë sonë kombëtare dhe si të tilla kanë vlera të jashtëzakonshme jo vetëm për moshën e tyre të vjetër, por mbi të gjitha se në to hartografohen trojet shqiptare. Përpiluesit e tyre janë hartografë të shquar të

kohës si: italianët Gastaldi, Cantelli, Coronelli, Zatta, Palma, De Gubernatis; holandezët Mercator, Ortellio, Wit; francezët Sanson, Bleau, Delisle, Robert, Iaillot, D'Anville, Du Val, Dufour, Hecquard; gjermanët Homann, Lotter, Hahn, Kiepert, Petermann, austriakët Konrad, Steinhauser, etj.

Këto harta, me vlera shkencore, janë dëshmi e historisë dhe ekzistencës së kombit e trojeve tona. Ashtu si dhe librat e rrallë ato janë burime të mirëfillta informacioni dhe si të tilla i shërbejnë historianit dhe gjeografit, etnografit dhe gjuhëtarit. Në to albanologët shqiptarë e të huaj do të gjejnë të dhëna të ndryshme për studimet dhe punën e tyre kërkimore-shkencore, njoftime për historinë, gjeografinë, kulturën, toponiminë e një vendi a krahine, rritjen dhe rënien e qyteteve, zhvillimin e bujqësisë, industrisë, komunikacionit etj.

Në këndvështrimin e një bibliografi po cek përmbajtjen e disa prej këtyre hartave, pa pretenduar detaje, çka i takon specialistëve të fushës.

Në shek. XVI dhe XVII hartografët e njohur italianë Giacomo Gastaldi, Giacomo Cantelli dhe Vincenzo Maria Coronelli përpilojnë harta të Europës Juglindore. Më 1560 Giacommo Gastaldi boton në Venedik hartën me titull *Përshkrim neoterik i mbarë Greqisë sipas vendosjes së sotme*[1]. Harta bën pjesë në atlasin e hartografit flaman Abraham Ortelio *Theatrum orbis terrarum [Atlasi i botës].* Biblioteka Kombëtare ka tre ekzemplarë të kësaj harte pa vend e vit botimi, 2 prej të cilave janë riprodhime të mëvonshme. Emri i autorit jepet në formën latine të ablatvit *Auctore Jacobo Castaldo Pedemontano.* Në këtë hartë përfshihen pothuaj të gjtha trojet shqiptare nga veriu në jug dhe paraqitet mirë vija e bregdetit shqiptar. Jepet toponimia e qendrave të banuara si: Dolcigno, Antivari, Drivasto, Scutari, S. Johanni della Medua, Dagna, Alessio, Croia, Durazzo, Lachi, Belgrado, Antigonea, Valona, Chimera, Clisura, Santiquaranta, Butintro, Struga, Bitola, Ocrida, Prilep etj. Në pjesën e sipërme majtas të hartës jepen të dhëna që kanë të bëjnë me toponiminë e Kosovës, ku dallojmë ndër të tjera vendbanimet Grachaniza, China (Klina), Pristrina, Vchiterno (Vuçiterni), Mitrouiza etj. Harta ka vlerë për paraqitjen hidrografike të Shqipërisë dhe hidroniminë e lumenjve të saj, ndër të cilë dallojmë qartë Drino flu (flumen).

Giacommo Rossi më 1683 boton në Romë hartën e Cantelli-t *Mbarë Greqia e vjetër e krahasuar me atë moderne*[2]. Harta është me ngjyra dhe paraqet trojet shqiptare nën emërtimin *Albania pars Illyridis* për trevat veriore dhe *Albania* e *Epiro* për trevat jugore. Botuesi Rossi e cilëson këtë hartë si ndër më të mirat e hartave të përpiluara nga hartografët më në zë të kohës. Më 1684 po në Romë nga ky botues publikohet harta tjetër me ngjyra e Cantelli-t *Maqedonia, Epiri, Livadia, Shqipëria dhe Iana*[3], ku territoret shqiptare paraqiten të ndara në katër krahina: Ducagini, Tamoritza, Canina, Chimera. Nga tri hartat e këtij hartografi, botuar në Romë, në vitin 1689 me interes për historianët, gjeografët e gjuhëtarët tanë është harta me ngjyra *Shqipëria e mirëfilltë ose e Epërme e quajtur edhe Maqedonia Perëndimore*[4], ku dallohen edhe trojet jugore shqiptare nën emërtimin *Epiro o Bassa Albania.* Për herë të parë në këtë hartë përmendet Tirana me toponimin *Terrana* si dhe të gjitha fshatrat e saj. Në pjesën e sipërme të kësaj harte ndodhet kushtimi i botuesit Giacomo Rossi për Françesk Albanin nga familja e njohur arbëreshe e Albanëve, vendosur në Urbino të Italisë pas pushtimit osman të Shqipërisë. Cantelli për përpilimin e hartave të tij, siç pohon vetë, ka shfrytëzuar hartat më të mira e të fundit të asaj kohe si dhe relacione udhëtarësh me njoftime e të dhëna të shumta.

Vincenzo Maria Coronelli, hartografi më i suksesshëm venecian, më 1688 publikon në Venecia *Rrjedha e lumenjve Drin dhe Bunë në Dalmaci*[5], hartë me vlera të veçanta, sidomos për hartografimin e territoreve të Kosovës. Viti i botimit është marrë në pjesën e sipërme djathtas të hartës ku shkruhet: *Për shtetin e Raguzës at Coronelli do të botojë një hartë të veçantë në muajin në vazhdim, mars 1688.* Përmbajtja e hartës paraqet interes për studiuesit e fushës së albanologjisë. Ajo sjell të dhëna të bollshme gjeografike, historike, toponomastike, hidronimike, etnografike, statistikore e demografike për krahinat, qytetet e fshatrat shqiptare. Vendbanimet në këtë hartë paraqiten me skica kështjellash a kishash. Jepet numri i popullsisë së shtëpive të qendrave të banuara si dhe përkatësia etnike e fetare e banorëve të tyre. Harta sjell të dhëna për ndërtesat fetare më të rëndësishme, paraqet rrugët dhe urat kryesore që lidhin qendrat e banuara. Për qytetet kryesore jep edhe toponiminë e vjetër të tyre. Njoftime të tilla gjejmë edhe për vendbanimet e trojeve veriore shqiptare si: Prizreni, Peja, Gjakova, Mitrovica, Prishtina, Deçani, Ulqini, Tivari etj.

[1] Gastaldus, Jacobus. Graeciae universae secundum hodiernum situm neoterica descriptio. S. l., S. a. 1 fl. hartë.
[2] Cantelli, Giacomo. La Grecia universale antica paragonata con la moderna. In Roma : Giacomo Rossi, 1684. 1 fl. hartë.
[3] Po ai. Macedonia Epiro Livadia Albania e Ianna…Roma : Giacomo Rossi, 1684. 1 fl. hartë.
[4] Po ai. Albania Propria ouero Superiore detto anche Macedonia Occidentale…In Roma : G. Rossi, 1689. 1 fl. hartë
[5] Coronelli, Vincenzo Maria. Corso delli fiumi Drino e Boiana…In Venezia, 1688. 1 fl. hartë

Me vlerë janë shpjegimet lidhur me historinë e disa prej qyteteve dhe vendbanimeve tona. Po kështu tërheqin vëmendje edhe indikacionet që kanë të bëjnë me lundrimin. Për sa më sipër rezulton se Coronelli në punimin e kësaj harte ka shfrytëzuar të dhëna të shumta dhe është mbështetur në burime të sigurta. Harta e Cornelli-t shquhet edhe për grafinë tepër të qartë dhe ornamentet e shumta. Më 1696 botohet në Venecia në dy pjesë vepra *Ishujt e atlasit venedikas* [6] e po këtij hartografi, ku përfshihen hartat e *Dalmacisë* ose e *Ilirikumit* dhe e *Greqisë*. Harta e parë paraqet interes të veçantë sidomos për territoret e Kosovës, të hartografuara nën emërtimin *Provinca e Podrimës* (*Podrima Prov*). Lidhur me trojet shqiptare duket se Coronelli me këtë hartë nuk sjell ndonjë të dhënë të re nga ajo e vitit 1688. Harta e dytë e përmbledhjes *Ishujt e atlasit venedikas* paraqet trojet jugore nën emërtimet *Albania* dhe *Epiro.* Të dyja hartat shquhen për elementët dekorativë.

Atlasi, nëse e quajmë kështu, veprën e Coronelli-t *Qytete, kështjella dhe vende të tjera kryesore të Shqipërisë, Epirit e Livadisë, veçanërisht ato nën zotërimin e Venedikut*[7], sipas Olschi-t, është botuar në Venecia, më 1689[8]. Në këtë përmbledhje hartash e skicash përfshihet edhe harta *Rrjedha e lumenjve Drin dhe Bunë,* të cilën e cekëm më lartë. Mjaft interesante dhe tërheqëse në këtë përmbledhje janë planimetritë e pamjet e kështjellave dhe e qyteteve shqiptare si : Durrësi, Vlora, Sazani, Kanina, Sopoti, Butrinti, Preveza, Ulqini, Tivari etj., pjesa më e madhe e të cilave është hartuar sipas Camocio-s e Bertelli-t, hartografë italianë të shek. XVI. Hartat dhe planimetritë e kështjellave e qyteteve janë pasuruar me njoftime historike.

Hartografët holandezë Gerard Mercator, Abraham Ortellius, Frederick de Wit dhe Nicolaus Visscher, që ushtruan aktivitetin e tyre në qytetet Amsterdam dhe Antverpen, sjellin kontributin e tyre në hartografimin e brendësisë së Gadishullit Ballkanik, për pasojë edhe të trojeve shqiptare. Nga koleksioni i Mercator-it veçojmë hartën *Vllahia, Serbia, Bullgaria, Rumania*[9], botuar nga hartografi francez Guljelm Blaeu. Ekzemplari i Bibliotekës Kombëtare rezulton pa vend e vit botimi; botim i parë i takon vitit 1589[10], në Duisburg. Është me interes për trojet veriore shqiptare, veçanërisht për territorin e Kosovës. Dallojmë toponimet që kanë të bëjnë me këtë territor si Ulpiana, Pistrina, Michrouica, Vohiterno etj. Në hartën tjetër të Mercator-it *Maqedonia, Epiri dhe Akaia*[11], e ilustruar me tekst, trojet shqiptare paraqiten nën emërtimet *Albania* dhe *Epirus.* Për sa i përket vendbanimeve të Kosovës dallojmë toponimin Grachaniza dhe Terranoua (fshati i tanishëm Tërrnavë[12]). Dy ekzemplarët e Bibliotekës Kombëtare janë pa vend e vit botimi.

Nga atlasi i botës *Theatrum orbis terrarum* të Abraham Ortelit[13], botuar më 1570[14] dhe ribotuar disa herë më vonë (ekzemplari i Bibliotekës Kombëtare është botim në italisht i Venecias i vitit 1667), do të veçonim hartat *Greqia* të Sophianit *dhe Përshkrim i Perandorisë Turke*, ku territoret shqiptare përshkruhen si pjesë e Perandorisë Osmane, me njoftime historike për to. Trojet shqiptare si pjesë e kësaj Perandorie hartografohen edhe nga italiani Antonio Zatta dhe bijtë e tij, të cilët më 1781e 1788 nxjerrin në Venecia dy harta me ngjyra, njëra për *Greqinë* dhe tjetra për një *pjesë të Perandorisë Osmane, përfshirë provincat e Bosnjës, Serbisë, Maqedonisë, Skiavonisë, Kroacisë dhe Dalmacisë*[15]*;* nga hartografët francezë të shek. XVII-XVIII përmendim Sanson, themelues i hartografisë franceze, djalin e tij Guillaume, Delisle, Du Val, Bleau, Iaillot, Janvier etj. në hartat e të cilëve pothuajse të gjitha trojet shqiptare përshkruhen si pjesë e Perandorisë Osmane nën emërtimet *Albanie, Haute Albanie, Basse Albanie* dhe *Épire*. D'Anville, gjeograf i mbretit të Francës, në hartën e tij *Greqia* …[16], botuar më 1740 në Paris, paraqet territoret shqiptare nën emërtimet *Illyrie* e *Dardanie* dhe jep toponimet e vjetra të vendbanimeve të tyre.

Nga hartografia gjermane e shek. XVI-XVII veçojmë *Hartën gjeografike të Greqisë së sotme Veriore ose të provincave të Maqedonisë, të Tesalisë dhe të Shqipërisë...*[17], botuar në Nyremberg më 1770, nga trashëgimtarët e Johann Baptist Homann, që ka zhvilluar aktivitetin e tij po në këtë qytet; hartën *Greqia e re dhe deti Egje…ku përfshihen Maqedonia, Shqipëria, Epiri, Thesalia etj* e Conrad Lotter-it botuar më 1775[18]. Në këtë hartë me ngjyra të spikatura, gravura e grafi të qartë nën emërtimin *Albania* paraqiten trojet veriore e verilindore

[6] Po ai. Isolario dell'Atlante Veneto. In Venetia. 1696. Part. 1, f. 152-153., 164-165.
[7] Po ai. Città, fortezze, ed altri luoghi principali dell'Albania, Epiro, e Livadia. S. l., S.a.79 fl.
[8] Çobo, Aldo; Prela, Zef. Albanica. Tiranë, 1965, f. 60.
[9] Mercator, Gerardus. Wlachia, Servia, Bvlgaria, Romania. S.l., S.a. 1 fl. hartë
[10] Cërabregu, Muharrem. Kosova në hartat e vjetra. Prishtinë, 1977, f. 63.
[11] Mercator, Gerardus. Macedonia Epirus et Achaia. S. l., S. a. 1fl. hartë
[12] Cërabregu, Muharrem. Po aty, f. 67.
[13] Ortelius, Abramus. Theatro del Momdo…Venetia : Scipion Banca, 1667, f. 184-186.
[14] Cërabregu, Muharrem. Po aty, f. 61.
[15] Zatta, Antonio. Parte dell'Impero Ottomano che confina cogli stati Austriaco e Veneto…Venezia, 1788. 1 fl. hartë
[16] D'Anville. La Grèce et les pays plus septentrionaux jusqu'au Danube…S.l. 1740. 1 fl. hartë
[17] Mappa geografica Graeciae Septentrionalis Hodiernae sive provinciarum Macedoniae, Thessaliae et Albaniae. Norimbergae. 1770, 1 fl. hartë.
[18] Cërabregu, Muharrem. Po aty, f. 116.

të Shqipërisë dhe nën emërtimin *Epirus* trojet jugore që shkojnë deri në Gjirin e Artës. Të dhënat për Kosovën i gjejmë në pjesën e sipërme majtas të kësaj harte.

Në shek. XIX, veçanërisht në gjysmën e dytë të tij nga hartografët e kohës bëhen përpjekje të shumta për hartografimin e territoreve të Ballkanit, në hartat e të cilëve trojet shqiptare, përfshirë dhe një pjesë të territoreve të Kosovës, paraqiten përgjithësisht si pjesë e Perandorisë Osmane, nën emërtimin *Albania, Albanie, Albanien*. Vlen të përmendim hartografët: Vaudoncour, Hecquard, Palma, De Gubernatis, Hahn, Kiepert, Peterman, Freytag etj., disa prej hartave të të cilëve ruhen në Bibliotekën Kombëtare. Ato janë të pasura me qendra banimi duke dhënë herë-herë emërtimet e vjetra të tyre. Bie në sy se në një pjesë të tyre jepen të dhëna statistikore për numrin e popullsisë së qyteteve kryesore të qendrave të banuara. Nga to do të veçonim hartat e gjeografit dhe hartografit më të suksesshëm gjerman Heinrich Kiepert-it, i cili më 1855 dhe 1867[19] boton në gjermanisht e frëngjisht *Hartën e përgjithshme të Perandorisë Osmane në Evropë dhe në Azi...*, ndërsa më 1880 në Berlin *Hartën për vendet e Danubit të Poshtëm dhe të Ballkanit, sipas skicimeve zyrtare të vitit 1879.*

Në shek. XIX botohen edhe një varg hartash etnografike. Përmendim hartën e Epirit të italianit De Gubernatis[20], sipas Legrand-it botuar më 1880[21], ku pasqyrohen trojet jugore shqiptare, përfshirë edhe Çamërinë, qytetet e rrethinat e saj, me të dhëna gjeografike, historike, statistikore e demografike për trevat e paraqitura. Në të jepen të dhëna për manastiret, hanet si dhe numri i shtëpive të fshatrave (me 300, 100 dhe nën 100 shtëpi). Dallohen qartë në të zonat me popullsi shqipfolëse, greqishtfolëse, shqip dhe greqishtfolëse njëkohësisht si dhe zonat me popullsi vllahe. Për përpilimin e saj autori, siç thotë vetë, është mbështetur në rezultatet e studimeve dhe udhëtimeve të tij në trevat shqiptare gjatë viteve 1869-1875.

Po në këtë shek. dalin në dritë një numër hartash të Ballkanit dhe të vilajeteve të Perandorisë Osmane në këtë trevë, të botuara nga Instituti Ushtarak i Vjenës dhe i Milanos, siç janë hartat për vilajetin e Manastirit, të Shkodrës, të Prishtinës etj.

Tërheq vëmendjen harta e Serbisë në osmanisht, përkthyer nga botimi në serbisht i Beogradit[22]. Kjo hartë është publikuar më 1873, disa vjet përpara Kongresit të Berlinit, i cili, siç dihet, shumë treva veriore shqiptare, përfshirë Kosovën, ia dha Serbisë dhe Malit të Zi. Në këtë hartë territoret e Kosovës rezultojnë jashtë kufijve serbë.

[19] Kiepert, Heinrich. General - Karte des Türkischen Reiches in Europa....Berlin, 1855; Générale carte....1867.
[20] De Gubernatis. Carta d'Epiro...Roma, {1880].
[21] Legrand, Emile. Bibliographie Albanaise...Paris; Athène. 1912, f. 132.
[22] Serbi haritasi 1873. 1 fl. hartë

2. Mundësia e digjitalizimit të hartave të rralla

Për përmbajtjen e tij dhe informacionin që sjell, ky koleksion hartash të rralla duhet ruajtur e restauruar. Në disa biblioteka të botës (p.sh. në bibliotekat e Italisë) dokumentet e rralla janë të pajisura me kartela personale, përmes të cilave bibliotekarët evidentojnë, regjistrojnë e ndjekin gjendjen fizike të tyre për sa i takon qëndrueshmërisë, lidhjes, elementëve të identifikimit, nevojës për restaurim etj. dhe mbi bazën e shënimeve të bëra në kartelë ata marrin masat e duhura. Është koha që edhe në bibliotekat tona të realizohet kjo gjë, në mënyrë që të ruajmë, parandalojmë dhe shmangim degradimin e dokumenteve të rralla. Faktor i rëndësishëm në ruajtjen e pasurive librare e hartografike, që duhet mbajtur parasysh, janë edhe përdoruesit e bibliotekave. Na takon ne, bibliotekarëve, t'i ndërgjegjësojmë dhe edukojmë ata për vlerat e rralla që mbajnë në duar.

Deri më sot në bibliotekën tonë përdoruesve përgjithësisht u janë shërbyer kopjet në origjinal, çka mundëson dëmtimin e tyre. Përdoruesit kanë të drejtën e tyre për informim, nga ana tjetër të gjithë ne e kemi për detyrë jo vetëm t'i ruajmë e mirëmbajmë koleksionet e rralla, por edhe t'i vëmë në dispozicion të përdoruesve. Teknologjia e sotme e informacionit na jep shumë mundësi për krijimin e kopjeve për përdorim. Mund të fotokopjohen apo mikrofilmohen hartat në origjinal dhe këto riprodhime t'u vihen në përdorim lexuesve, metodë tashmë e njohur dhe e zbatuar edhe në bibliotekën tonë. Kjo rrugë shmang dëmtimin e degradimin e ekzemplarëve në origjinal, por shfrytëzimi i tyre përsëri mbetet i kufizuar, brenda mureve të bibliotekës.

Me ecjen përpara të teknologjive të reja të informacionit shumë biblioteka sot në botë po i japin përparësi digjitalizimit të pasurive të rralla librare e kartografike. Ato po krijojnë imazhet kompjuterike të hartave, duke i vënë në Internet në dispozicion të përdoruesve. Ka shumë mënyra për digjitalizimin (hedhjen e hartave në Internet) e imazheve të hartave. Sigurisht prodhimi i imazheve të hartave, veçanërisht atyre me përmasa të mëdha, kërkon kohë dhe para. Siç tregon përvoja botërore është e mundur që kjo punë të fillohet me pak investim. Ajo që nevojitet fillimisht është të kesh akces në një server dhe në një kompjuter personal me një sasi të vogël softuerësh dhe harduerësh. Me këtë

rrugë që nuk kushton shumë mund të digjitalizohen në fillim hartat me përmasa të vogla, le të themi me madhësi 20X30 cm. Këto harta mund të skanohen dhe të vendosen në Internet për t'u shfrytëzuar nga të gjithë. Për këtë mjafton një skaner i zakonshëm. Digjitalizimi i hartave me format mesatar e të madh kërkon më shumë kohë dhe para, por nuk është e paarritshme. Është e mundur të realizohet nga bibliotekat kombëtare dhe ato universitare. Për digjitalizimi e këtyre hartave mund të përdoren disa mënyra si: **digjitalizimi nga filmi, përdorimi i skanerit, përdorimi i një kamere digjitale.**

Digjitalizimi i hartave nga filmi për bibliotekat që kanë një numër të vogël hartash, si bibliotekat tona, jo vetëm është metoda më e lehtë dhe më pak e kushtueshme, por njëkohësisht sjell edhe rezultate të kënaqshme, por e meta e saj është se nuk siguron atë rezolucion (qartësi) dhe pastërti në ngjyra që sigurojnë metodat e tjera.

Rezultate më të larta prodhon sigurisht **digjitalizimi i hartave me anë të skanerit**, por e meta e kësaj metode është se kufizohet nga madhësia e hartave. Për digjitalizimin e këtyre hartave mund të përdoren **kamerat digjitale.** Kjo metodë prodhon rezultate të larta në rezolucion, veçanërisht në ngjyrat. Për vendosjen e hartave në Internet duhen ndjekur këto procese:

1. Digjitalizimi i hartave (me një nga tri rrugët e përmendura më lart)
2. Ruajtja e file-ve të pangjeshura në CD
3. Editimi dhe ngjeshja e këtyre file-ve duke përdorur programin e caktuar
4. Vendosja e file-ve të ngjeshur në server
5. Krijimi i një baze të dhënash unike për të gjitha hartat e digjitalizuara

Krijimi i imazheve digjitale të hartave është procesi kryesor dhe më i rëndësishëm, por nuk mjafton vetëm kjo. Hartat e digjitalizuara duhet t'u vihen në dispozicion jo vetëm një numri përdoruesish që i lidh, i bashkon një zonë a vend i përbashkët gjeografik, por të gjithë atyre që navigojnë (kërkojnë) në Internet, pavarësisht nga vendi ku jetojnë. Për këtë ato duhet të shoqërohen patjetër me disa të dhëna bibliografike minimale si: autori, titulli, vendi, data e botimit të hartave, në mënyrë që përdoruesit të kenë disa mundësi kërkimi në Internet.

Mendoj që në të ardhmen me një bashkërendim të punës midis departamentit të Albano-Balkanologjisë dhe atij të Informatikës dhe Teknologjive të reja të informacionit mund të realizohet me pak shpenzime digjitalizimi i hartave të rralla, numri i të cilave në Bibliotekën Kombëtare është i vogël. Kjo do t'i hapë rrugë edhe digjitalizimit të botimeve të vjetra, duke filluar me ato të autorëve shqiptarë. Të mirat që sjell ky proces janë të pallogaritshme: akcesi në shfrytëzimin e hartave është pakufi; ruhen vlerat e rralla që ka biblioteka, duke shmangur kështu dëmtimin e tyre gjatë përdorimit të kopjeve në origjinal. Përvoja botërore na tregon se punë kaq të mëdha mund të arrihen me projekte të përbashkëta, të financuara nga burime të ndryshme shtetërore apo private. Këto projekte, që i shërbejnë ruajtjes së kujtesës së shkruar të kombit tonë, mund të realizohen në bashkëpunim me Arkivin e Shtetit, Muzeun Historik Kombëtar apo institucione të tjera të vendit, që kanë dokumente të rralla, pa lënë jashtë Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.

MOSDOKUMENTIMI APO KËRKIMI I SË HUMBURËS

Fazli GAJRAKU
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

Historia e kulturës njerëzore, duke u bazuar në atë çka shihet dhe çka dihet, nëpërmjet gjetjeve të mbetura ose fatmirësisht të ruajtura në plotninë e tyre, përfaqësohet në origjinë nga shenja materiali, trajte, madhësie, figure e alfabeti shumëformësh. Njëherë, një kohë, trashëgimia nga koha e antikitetit njihet kryesisht në trajtën e monumenteve të ndërtuara e të qëndrueshme, të përmasave e strukturave të ndryshme, të gdhendura e të latuara në materiale, si: piramida, varre, amfiteatro, kala e fortesa, apo të materialeve, sendeve e stolive më të imta - të ujdisura me simbole e shkrola.

Më pastaj, trashëgimia e kulturës njerëzore është rizgjeruar nëpërmjet shkrimit - shenjave të saj, si një reprezentim metafizik dhe fizik i botës, apo si një material bazik nëpërmjet të cilit lexohet historia dhe kultura. Pra, shkrimi ka shtuar rrjetin e narracionit për botën dhe njëkohësisht ka sfiduar gjuhën, pos të tjerash, edhe duke qenë si produkt, i cili ruhet, por edhe braktiset dhe zëvendësohet me shenja të reja (fjala është për lindjen dhe zhvillimin e gjuhëve).

Një tjetër element që duhet pasur parasysh është leximi dhe interpretimi i shkrimit. Pra, shkrimi në trajtën e vet origjinale, si vlerë e dokumentuar, u është nënshtruar leximeve dhe interpretimeve infinite dhe, në këtë mënyrë, ka provuar ta ndërtojë historinë e kuptimit (të domethënieve) qoftë edhe për një fakt apo koncept që ka bërë jetë në histori. Në këtë mënyrë shkrimi e ka shumëfishuar kapacitetin e memories së botës, si dhe mundësitë e njohjes së njeriut dhe të reflektimeve të tij.

Këto shenja monumentale të shkrimit (dhe të objekteve) nëpër kohë, të cilat kanë vlera të këmbyeshme dhe e plotësojnë njëra-tjetrën, janë pulsione që kanë gjallëruar, po ashtu, kujtimin për të kaluarën, duke u interpretuar dhe aktualizuar me njëfarë intencionaliteti estetik apo historik, varësisht nga natyra përmbajtjesore e shkrimit. Ky interpretim, (pra e kemi fjalën gjithnjë për shenjat e shkrimit të vjetër), i cili dëshmon se sa është kompleks ndërlidhnia e identitetit kulturoro-gjuhësor, herë është forcuar në rrafshin universal, në kërkim të shenjave të identiteteve kolektive: sociale, gjinore e religjioze, e herë të shenjave nacionale, etnike e raciale. Në këtë kontekst, fuqia dhe tendencat interpretuese, veçanërisht për shkrimet me përmbajtje historike e kulturore, më vonë kanë nisur të monitorohen nga shenjat e një lufte politike, ideologjike e kulturore; kur kuptimet e figurshme lexohet si shenja arbitrare, duke intencionalizuar interpretimin pa hesap. Pra, po flasim tashmë për shkrimet, dokumentet, që, përtej fshehtësisë dhe jehonës së tyre, reflektojnë ndjesinë e proveniencës nacionale. Mbi këto mbingarkesa, mospajtime a kundërthënie, pretendimet shkojnë deri në identifikim apo dhe 'përkthim' të shenjave të shkrimit me etninë, shtetin, ideologjinë, duke i dhënë edhe autorësisë apo anonimitetit të shkrimit/dorëshkrimit, po këto shenja identifikuese.

Po të shikojmë në mënyrë kronologjike, nëse në një kohë dhe hapësirë (territor a shtet) është ruajtur kultura dhe historia nëpërmjet dokumenteve të shkrimit, në një kohë tjetër - ndërmjet gërmadhave të shkatërrimit e të djegies, janë humbur këto shenja, duke e dëmtuar rrjetin e thurjes së fijeve të kulturës e të historisë - koherencën e tyre. Ky boshllëk mbushet me hamendësime, nga një perspektivë tjetër kohore, duke i përshtatur këto spekulime si prezenca historike për motive të ndryshme.

Ndjenja jonë historike, është ndërtuar mbi të kaluarën, e cila ruhet nëpërmjet dëshmive që ndodhin njëra pranë tjetrës dhe sipër tjetrës, duke qenë të vetëdijshëm se shkrimet e vjetra origjinale përplasen e përzihen (këtu po flasim për faktet dhe sajesat që janë ruajtur nëpërmjet shkrimit për të njëjtën dëshmi, por nga intenca të ndryshme). Ndërsa ne po nisemi të trajtojmë konsekuencat që dalin, në kontekstin kosovar, nga mosdokumentimi i vlerave kulturore - i pjesës trashëgimore të shkrimit.

Shprehje e prirjes sonë është rigjurmimi, meqë shqetësimi ynë në këtë kontekst është për të humburën, për boshllëkun që mbushet me hamendësime, pra, që të mos ndjehemi të habitur në pyetjen: cila është kultura jonë, në përthyerjen e saj me kulturat dhe identitetet, e ndoshta edhe me hegjemonitë kulturore, që nxjerrin në pah edhe të gjitha fenomenet kulturore diverse. Cilat janë referencat determinuese të kulturës sonë nacionale, për të parë në një gjerësi të dukshme ajo që është trashëgimi e këtij vendi dhe këtyre njerëzve të gjallë e të vdekur, që bën jetë këtu pranë nesh...

Para se të hyjë në jetën e evidencave dhe të fakteve (të dëshmisë së shkrimit të ruajtur në Kosovë), po i rimarr konceptet *dokument* dhe *dokumentim*, që ushqejnë gjendje të dyfishtë. Në këtë kontekst, kur nuk po citojmë së pari fjalën *dokument*, por *dokumentim*, nuk po merremi me *faktin* - dokumentin, por me *procesin* - dokumentimin, që është një njohje, një dije, një veprim, një metodë. Kjo logjikë, sipas të cilës po ndërtojmë qasjen tonë në këtë temë për kujtesën kombëtare, rrëshqet nëpër shtratin e mashtrimit në kuptimin: dokumentin e kemi diku (e, në fakt nuk është), por si ta dokumentojmë. Kjo, i jep shqetësimit tonë *elocution* për ta idealizuar formën e përsosur të kujtesës, të kujtesës që nuk e kemi të dokumentuar shumëherë hiç, por që e dëshmojmë nëpërmjet iluzionit të kërkimit - të kërkimit të së humburës, të asaj që themi së është diku po nuk po gjendet ose edhe deri të të qenit në kuptimin e shpresës apo të gjetjes së fatit me gjetjen e një dokumenti sipas të thënës: 'humbtë e u gjettë'.

Për aq sa kujtojnë të vjetrit, te ne këtu, nën një ankth e frikë pushtetesh, njerëzit, duke e përjashtuar veten nga pajtimi me frikën, kanë mbajtur në shtëpitë e tyre libra e dorëshkrime të vjetra, të pakuptueshmet - si mbrojtje nga e liga, ndërsa të lexueshmet - si një mburojë për t'u mësuar me gjërat e frikshme; një seriozitet burrërie për të jetuar me këtë sekret të madh.

Dhe, në këtë jetë të librave e dorëshkrimeve, që ruhen edhe nën dhé si varr, pa i dhënë kujt mundësi që të zbulohet sekreti, kur merr durimin e hyn me pa çfarë ka mbetur nga kultura e dokumentuar nacionale në Kosovë, të kujtohet ngushëllimi i të vjetërve: 'atë histori që na s'e kemi, ruhet në Shqipëri'.

Kërkimi ynë pas dokumentimit mund të jetë i hutueshëm dhe i pështjellshëm sa të thuash. Kultura materiale e shkrimit është shkatërruar shumë, djegur e hum-

bur, dhe, njëkohësisht, janë edhe magazinë dorëshkrimesh e librash që pritet të evidentohen. Mes këtyre fakteve, ndjehet pafuqia për ta artikuluar dhe argumentuar ngutjen tonë për kërkimin, grumbullimin dhe evidentimin e trashëgimisë kulturore të shkruar, para një politike kulturore, që këtë punë e kupton si një aktivitet mekanik të ftohtë. Ndërsa ndjehet pasioni i bibliotekarëve e arkivistëve, në një shoqëri të lirë që po de-ideologjizohet, të merren me semiotikën e shenjave të kërkimit në kuptimin hajdegerian - *poetikisht me banue* këtë regjistër faktesh, dorëshkrimesh e librash të vjetër e të ri, për të prekur hapësirat fizike e metafizike të kulturës shkrimore në Kosovë, edhe kur të tillat mund të jenë bërë hi e pluhur, na duhet të marrim përkrahjen për hartimin dhe realizimin e një programi, që do t'i japë pamje hartës së vlerave të mbledhura dhe të ruajtura.

Dhe tash në këtë rinisje, pas luftës në Kosovë, na duhet një program që do të përkrahej për të vënë rregulla përballë një rrëmuje masive faktesh, informacionesh, dokumentesh, librash, për t'u mos u sjellur shkel e shko; si të hartojmë kritere për ta kufizuar kërkimin në tharmin e kulturës, nëpër të cilën mund të bësh hapa shëtitjeje të vëmendshëm; si të veprojmë nga një ndikim përzgjedhës për kujtesën kombëtare - në kuptimin ideal, si dhe për përdoruesit (lexuesit) në kuptimin pragmatik e utilitar.

Shpesh në këtë invazion informacionesh e dokumentesh, duhet t'i kesh ngritur duart lartë për shkak të pafuqisë - si të vëmë kontroll bibliografik në këtë shumëllojshmëri informacionesh e koleksionesh që po ikin.

Konsekuencat e mosdokumentimit, pra të moskujdesit që të bëhet së paku një regjistër me njësi bibliografike i fondit të një biblioteke, kanë qenë të dhimbshme për kulturën në Kosovë. Duke iu referuar Raportit të IFLA/FAIFE Report / April 2000, Libraries in Kosova/Kosovo[1], bibliotekat e dorëshkrimeve dhe arkivat historike të Komunitetit islam të Kosovës, që mbanin materiale të shkruara për 600 vjetët e kulturës islame në rajon, u dogjën. Humbja më serioze sa i përket arkivave ishte djegia e Arkivit Qendror të Komunitetit të Bashkësive Islame në qendër të Prishtinës, që gjendej në një ndërtesë afër Xhamisë së Sulltan Muratit të ndërtuar në shekullin XV. Shumë nga këto burime të botuara e në dorëshkrim, të cilat janë shkatërruar, kanë marrë me vete edhe idiomën e shkrirjeve dhe konstruktimeve religjioze e morale të shqiptarëve në disa shekuj.

[1] http://www.ifla.org/faife/faife/kosova/kosorepo.htm

Në një raport të Andras Riedlmayer-it me titull: *Bibliotekat dhe arkivat në Kosovë: një raport i pasluftës*[2], përmenden shkatërrimet më të mëdha të bibliotekave dhe arkivave akademike e publike dhe të institucioneve religjioze, në këtë kontekst edhe të koleksioneve të pasura të komunitetit religjioz mysliman, për të cilat, në bazë të dëshmive, nuk është ruajtur as ndonjë regjistër bibliografik i fondit të këtyre bibliotekave, si:

Djegia e bibliotekës së Hadum Sylejman Agës, në Gjakovë, e cila mbante rreth 200 dorëshkrime dhe 1.300 libra të rrallë në turqishten otomane, arabishte dhe në shqipe me shkronja arabe, si dhe arkivat rajonale të Komunitetit të Bashkësive Islame KBI-së, me dokumente që datojnë qysh nga shekulli XVII;

Shkatërrimi i Teqesë së Bektashinjve të Axhize Babës, në Gjakovë, që kishte njërin prej koleksioneve më të vlefshme të manuskripteve në rajon. Flaka i mori 250 dorëshkrime dhe më shumë se 2.000 libra të rrallë; katalogu i kompjuterizuar, thuhet, u dogj së bashku me bibliotekën;

Biblioteka e Atik Medresesë, në Pejë, është djegur, ku është shkatërruar krejtësisht koleksioni prej 2.000 librave të shtypur dhe rreth 100 dorëshkrimeve.

Kur merr e interpreton shifrat e dorëshkrimeve të djegura, beson të mos jenë regjistruar e përpunuar fare pothuajse të gjitha fondet e këtyre bibliotekave dhe arkivave. Nuk do të dilnin këto shifra të plota për tituj apo ekzemplarë librash a dorëshkrimesh të djegura e të shkatërruara, si p.sh.: njëqind, dyqind, dyqind e pesëdhjetë, dy mijë etj. Faktit për pasaktësinë e materialeve shkrimore të djegura, (po flasim në kuptimin e numrit, lëre më në kuptimin e përmbajtjes dhe vjetërsisë së tyre) i vihen edhe të dhënat që nuk përputhen mes dy raporteve[3] për gjendjen e bibliotekave dhe arkivave në Kosovë pas luftës, të cilave ne po u referohemi, të dhëna këto që janë marrë nga burime vendëse në Kosovë.

Tash në këtë kohë gjendemi mes zgjerimit e prodhimit të madh të shkrimit e të informacionit dhe, po ashtu, të transformimit të këtij materiali kulturor në formate e materiale të ndryshme. Çdo ditë, çdo çast prodhohen materiale shkrimi, të cilat nuk marrin rrugë për në bibliotekë dhe humbin po ashtu gjasat që të hyjnë ndonjëherë. Sjellja jonë karshi këtij invazioni materialesh është krejt e hutuar, ashtu siç është e hutuar edhe e autorëve (fjala është për autorët që zënë momente reale e fiktive nëpërmjet shkrimit, fotografisë, incizimit etj.).

[2] http://www.ifla.org/faife/faife/kosova/kosorepo.htm
[3] Shih raportet nga dy burimet: http://www.ifla.org/faife/faife/kosova/kosorepo.htm dhe http://www.ifla.org/faife/faife/kosova/kosorepo.htm

Në konstruktimin e tashëm medial kulturor - të dokumentimit në çast, gazetari Adam Smith i thotë në telefon nobelistës së këtij viti - Doris Lessing, në çastin kur ajo merr lajmin se ka fituar çmimin Nobel: *"Jam nga uebfaqja e Fondacionit të Nobelit. E kemi traditë që të marrim intervista shumë të shkurtra telefonike me Laureatët e rinj për arkivin tonë, dhe kam shpresë se mund të flasim me ju për disa minuta?"*[4] Dhe, kaq. Mjafton për të nxënë shpejtë atë pjesë të mendimit emocional, që s'mund ta nxësh më ashtu, për ta arkivuar. Ky është moment që na ikën ta krijojmë dhe ta ruajmë në arkivin tonë. Pa primesa as hije analogjie: T'i themi Bamir Topit a je gëzuar që je bërë president i Shqipërisë, apo Hashim Thaçit - a je gëzuar, që i fitove zgjedhjet.

Në këtë situatë të perfiditetit dhe të ashpërsisë për të krijuar në mënyrë dinamike dhe të vijueshme hallkat e një kujtesë politike, historike e kulturore, na ndodh që në këto pjesë tematike të kujtesës, të mos kemi fakte, detaje e kohë, të lidhura me shkak, në kuptimin që njëra sekuencë e dokumentuar e reflekton apo e prodhon tjetrën. Një kujtesë e konsoliduar që lidh epokat dhe kohët dhe jo mbetje boshllëk kohësh, shekujsh, dekadash e vitesh. P.sh. Shqipëria ruan përmendoren e kulturës dhe qytetërimit të krishterë, *Kodikët*, që përfshijnë tërë një kulturë e civilizim prej shekullit të 6-të - deri në shekullin e 18-të, por nuk e ruan, siç dokumentohet tash këto ditë, dokumentin origjinal të Shpalljes së Pavarësisë të vitit 1912; apo Kosova mund të ketë ruajtur një dorëshkrim (vakufnamen) të trashëguar nga fondi i Suzi Çelebiu i muajit Rebiul Ahir të vitit 919 [1513], po nuk e ka në fondin e vet veprën e Pjetër Bogdanit "Cuneus Prophetarum" (1685), bile-bile as veprën e Martin Camajt "Një fyell ndër male", të vitit 1953. Gjithnjë po flasim për shenja të veçanta kulturore, p.sh. "Një fyell ndër male" është përmbledhja e parë me poezi e botuar pas Luftës së Dytë Botërore, atëherë kur shqiptarët në Kosovë po ringjalleshin nga hiri i vet.

Gjithashtu edhe institucionet tona të zhvillimit dhe të ruajtjes së trashëgimisë kulturore: Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, Arkivi i Kosovës, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Instituti i Historisë, Instituti Albanologjik, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës, nuk shkëmbejnë dhe as ndajnë informacione as materiale; pra që të marrin ose japin në kuptimin e qarkullimit të vlerave kulturore - secili hisen e vet të trashëgimisë, duke i reduktuar projektet e veta veç e veç. Kjo gjendje - e trashëguar qysh herët, e të qenit të izoluar dhe të hutuar si institucione, pasohet gjithashtu nga një boshllëk ligjesh, që nuk specifikojnë detyrat dhe përgjegjësitë që kanë institucionet ndaj njëra-tjetrës në raport me zhvillimin dhe ruajtjen e trashëgiminë kulturore. Nga viti 1877 deri në më tash, janë aprovuar mbi 70 dokumente në aspektin ndërkombëtar që rregullojnë shumë fusha të trashëgimisë kulturore, dhe detyrat dhe përgjegjësitë, veç e veç që kanë institucionet e ndryshme kulturore. Ndërsa në Kosovë nuk ka ligje që e përcaktojnë si duhet këtë relacion mes institucioneve kulturore e shkencore nacionale, nëpërmjet akteve e vendimeve nënligjore.

Edhe në këtë afishim të hallit si ta ruajmë kujtesën kombëtare, edhe në këtë përpjekje të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës për mbledhjen dhe ruajtjen e dorëshkrimeve dhe librave, një qartësi, çuditërisht - se çfarë iu ka ndodhur bibliotekave tona gjatë luftës së fundit në Kosovë, dhe një vizion se kah duhet bërë rrugë për të grumbulluar kujtesën kombëtare, e marrim nga dokumente të hartuara nga të huajtë. Kujtojmë këtu dokumentet, që i përmendëm më lartë për gjendjen e bibliotekave dhe arkivave pas luftës në Kosovë në njërën anë, dhe Plani Strategjik për Bibliotekën Kombëtare dhe për Bibliotekën Universitare, i hartuar nga Dr. Keneneth J. Oberembt. Ndërsa, i vetmi projekt, i bërë nga vendësit, që është realizuar me qëllim të ruajtjes së kujtesës, rezultatet e të cilit nuk e di të jenë bërë publike, ka qenë projekti nga komuniteti islamik në Kosovë për identifikimin dhe katalogimin e dorëshkrimeve në mbarë rajonin, që i takojnë Periudhës Osmane, që është mbështetur nga Zyra e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë.

Duke mos pritur më shumë, në një program të ardhshëm, i cili do të synonte ta ruajë dhe ta sigurojë trashëgiminë kulturore në Kosovë, në vija të qarta do të duhej t'i projektojmë konceptet bazë që garantojnë mbledhjen, përpunim dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore. Porse, para këtij synimi, në këtë realitet të ri politik e ideologjik, halli ynë është si të bindim me diskursin tonë, nëpërmjet një komunikimi efikas, politikën e qeverisjes së vendit dhe të kulturës, për vlerën e ruajtjes dhe të dokumentimit të trashëgimisë kulturore të botuar apo në dorëshkrim, dhe të na ndihmojë mirë.

4 http://nobelprize.org/nobel_prizes/literature/laureates/2007/lessing-telephone.html

LIBRI I DEKADAVE TË PARA TË SHTETIT SHQIPTAR: DUKURI DHE PROBLEME BIBLIOTEKONOMIKE SIPAS BIBLIOGRAFISË RETROSPEKTIVE

Maksim GJINAJ
Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë

Bibliotekonomia e përkufizon Bibliografinë Kombëtare si dëshmitaren e vetme të pjesës librore të kujtesës kombëtare, e cila synon të sjellë informacione relative për përmbajtjen e koleksioneve. **Në këtë bashkëlidhje, kujtesa kombëtare bazohet në dy momente të rëndësishme: ekzistencën e koleksionit të plotë kombëtar, çka nënkupton edhe tërë procesin për sigurimin dhe ruajtjen e tij dhe përshkrimin bibliografik metodik e profesional për përdorim publik sot dhe në të ardhmen.** Bibliografia kombëtare përgatit inventarin pa paragjykuar vlerat e dokumentit sepse ky proces do të shërbejë më pas për përcaktimin e asaj që do të hyjë/quhet trashëgimi e pasuri kombëtare. Bibliografia depoziton njëherazi burimet e domosdoshme për aktivitetin bibliotekar, por edhe burimet historike për dijet e ardhshme. Objektivat e bibli-

ografisë janë: **gjetje dhe grupim**. Bibliografia jo vetëm plotëson kujtesën kombëtare në fushën e botimeve, por edhe çel rrugën për njohjen dhe studimin shumëplanësh të kësaj trashëgimie në fushën e përmbajtjes së tyre, tematikës së botimeve, ndikimit dhe receptimit, gjeografisë së krijimeve dhe botimeve, pasojave social-politike, kulturore, studimeve statistikore e shumë e shumë të tjera, që sigurisht kanë efektin e duhur kur zbatohen saktë kriteret dhe standardet bibliotekonomike.

Argumentet do përpiqem t'i sjell nga Bibliografia Kombëtare e Librit Retrospektiv, periudha 1913 - 1944, pra mbasi filloi dhe vijoi ndërtimi i shtetit administrativ shqiptar.

Nëse do të ravijëzonim një tablo fare modeste të kësaj periudhe do na duhet të theksojmë se duke u shpallur pavarësia në kohë krize, struktura politike që iu dha shtetit nuk erdhi si pasojë as e një përgatitjeje dhe as e një zbatimi të kujdesshëm që mund t'i kishte dhënë atij mundësi më të mëdha. Ky ndërtim shtetëror i bërë në nxitim e sipër duket se ishte produkt i paqëndrueshmërisë politike, ekonomike e sociale. E gjithë periudha ndjekëse karakterizohet nga një përzierje e sistemeve, pikëpamjeve, kulturave paraardhëse vendase me ato të huajtura ose të pahuajtura nga jashtë, me përpjekjet për risi, stabilitet, dhe, jo rrallë, edhe për origjinalitet.

Edhe nëse vëren tematikën dhe natyrën e botimeve të rreth tri dekadave bie qartë në sy dilema. Shoqëria shqiptare kërkon pozicionin gjeografiko-kulturor, kërkon maturitetin e saj, kërkon të shkëputet nga Lindja pa u ndarë prej saj që të afrohet me Perëndimin pa iu bashkëngjitur atij. Te bota kulturore e mediatike e atyre dekadave bie në sy vendosmëria për të mos ua ndarë sytë zhvillimeve korente në botën joshqiptare, forca për të identifikuar problemet dhe nevojat, zotësia e aftësia për të dalluar përparësitë. Hedhja e bazave profesionale në shumë fusha të jetës dhe dijes përmes botimeve, këtë nënkupton. Tashmë ka një zgjerim tematik, së bashku me një brendi e përmbajtje më të avancuar. Në kushtet e ekzistencës së shtetit shqiptar, të një jete të pavarur shtetërore, të ndryshimeve të dallueshme kulturore, arsimore, ekonomike, juridike dallon një gamë më e larmishme botimesh në tematikë dhe në formë.

Koleksionet e kësaj periudhe nuk përbëjnë në vetvete një arkiv dhe kaq. Ato janë shprehje e zhvillimit të mëtejshëm të botimeve, ku bie në sy rritja progresive e tyre, zgjerimi i tematikës, përpjekja për të rrokur të gjitha fushat e jetës shoqërore e mendore, në kushtet e ekzistencës së shtetit shqiptar deri-diku edhe me tendencë për një politikë botimesh (veçanërisht aty ku mund të organizojë e ndikojë më dukshëm si jeta administrative, jurisprudenca, politika, arsimi, ushtria, etj.); censure, po se po.

Për ilustrim të tematikës që pasqyron bibliografia e periudhës 1913 – 1944 po jap fare pak statistika. Kapitulli mbi shtetin dhe të drejtën, që përfshin legjislacionin, organizimin e administratës qendrore dhe lokale, përmban rreth 550 tituj të botuar. Janë rreth 120 zëra bibliografikë mbi folklorin. 150 tituj mbi organizimin e arsimit dhe sistemit arsimor, rregullore shkollore, plane e programe mësimore, pa përmendur qindra tekste mësimore që për efekt bibliografik janë tematikisht të shpërndara në të gjithë vëllimin. Mbi 250 botime përmbledhin punimet mbi gjuhësinë dhe filologjinë; këtu përfshijmë edhe tekstet e abetareve, gramatikat etj. Matematika përfaqësohet me 50 zëra / botime. Rreth 1000 tituj përfshin letërsia shqipe dhe e huaj, si dhe studimet mbi to. Nuk po përmend këtu ato krijime e botime që mbeten e do të mbeten maja të letrave shqipe me përfaqësues Fishtën e Harapin, Nolin e Konicën, Frashërllinjtë e mëdhenj, Koliqin e Migjenin, Kutelin e pranishëm mes nesh; apo korpuse pasuri e paçmuar si Visaret e kombit.

Dukshëm bie në sy progresi sasior e cilësor i shtëpive dhe enteve botuese private, fetare, të institucioneve shoqërore. Edhe në botime vërehen dy synimet kryesore të shoqërisë dhe shtetit shqiptar: mbrojtja dhe forcimi i shtetit, administratës publike e shtetërore dhe organizmave të saj, njëkohësisht edhe përpjekjet për civilizim me një kahe drejt demokracisë, shpesh jo pa kontradikta të brendshme apo të ndërkallura nga situatat vendase e të jashtme.

Opinionin më tepër, madje shumë më tepër, e krijoi dhe gjallëroi shtypi, ndërsa libri social e alternativ u krijua me shumë ngadalësi, madje me shumë zbrazësi. Ndoshta kjo është edhe një prej arsyeve që sot po botohen jo pak vëllime përmbledhëse me krijimtarinë më përfaqësuese të publicistikës së kohës. Lexuesi i sotëm e ndjen instinktivisht se deri më sot i ka munguar njohja e organizuar e "opinionit publik" të asaj periudhe. Edhe kjo mbetet shprehje e ruajtjes dhe ndërlidhjes e kaluar – e tashme – madje edhe e ardhme, mes botimeve, bibliografisë që është përdorur dhe kujtesës kombëtare.

Në këtë panoramë të shkurtër që as nuk kërkon të jetë e plotë, shqyrtojmë rrëshqitas atë që mund ta quajmë "situatë të botimeve" përmes bibliografisë ku po mbështetem.

Siç përmenda më lart, raporti i drejtë bibliografi kombëtare – kujtesë kombëtare realizohet përmes gjetjes dhe sigurimit të koleksioneve dhe përshkrimit të

tyre me synim ruajtjen dhe përdorimin e tyre si pjesë e kësaj kujtese. Të mos harrojmë se që sot punojmë me synime e kritere të sakta për ruajtjen dhe disponimin e kujtesës kombëtare. E sotmja nesër do të jetë trashëgimi. Marrim nga brezat dhe u japim pasardhësve.

Me pak fjalë: kjo bibliografi është pjesë e korpusit "Bibliografi Kombëtare Retrospektive e Librit Shqip 1555 – 1958" që po përgatit Biblioteka Kombëtare. Ajo përfshin të gjithë librat, broshurat dhe hartat e botuara në gjuhën shqipe, brenda dhe jashtë kufijve të Shqipërisë, në trojet shqiptare, në diasporën shqiptare, si dhe botime të veçanta shqipe nëpër botë, botimet në gjuhë të huaj të realizuara në Shqipëri, në të njëjtën periudhë. Duke evidentuar tërë trashëgiminë botuese kjo bibliografi do të përbëjë një korpus tepër të rëndësishëm pune e referimi për çdo studiues shqiptar apo të huaj të trashëgimisë sonë kulturore.

Me një punë 85-vjeçare, kryer nga disa breza në Bibliotekën Kombëtare, ky kontingjent i rëndësishëm libri është siguruar dhe ruajtur, si edhe i është nënshtruar përpunimit bibliotekonomik, pra edhe bibliografik, regjistruar e vënë në përdorim për kërkime shkencore, arsimore etj. Por, ndërkaq, një pjesë, sigurisht e vogël, ka mbetur e panjohur rrëzave gjer më sot dhe pret që të mblidhet. Në një aspekt një pjesë e saj mund të jetë edhe në fondet tona, që për rrethana të caktuara, që fillojnë nga gabimet njerëzore dhe vijojnë të jenë në ndonjë rast pasojë e rrjetit relativisht të dendur të skedarëve, që ndonëse japin informacion të hollësishëm dhe çelin disa mënyra kërkimi, ndodh që fragmentarizojnë informacionin, i cili nuk i shpëton ndonjë pakujdesie me pasojë "humbjen e përkohshme" të ndonjë dokumenti të paevidentuar si pjesë "vendase" e kujtesës kombëtare. Kur janë konstatuar këto raste janë ndrequr, por dyshimi se mund të ketë raste të tjera nuk është pa bazë. Të sistemuar në disa fonde dokumentet janë të kataloguara dhe identifikohen e gjenden lehtësisht. Por po u bëj më tepër jehonë problemeve sepse mendoj se shtyhen më përpara korrigjimet e nevojshme dhe merr më përparësi e domethënie puna në shërbim të ruajtjes dhe shfrytëzimit pozitiv të trashëgimisë dhe kujtesës kombëtare.

Zbulime, e kam fjalën në sensin e pasurimit të bibliotekës, rrjedhimisht edhe të informacionit bibliografik, shpesh i detyrohen fatit, por janë edhe fryt kërkimesh sistematike që nuk duhen ndërprerë edhe mbas botimit të kësaj bibliografie. Madje vetë botimi i bibliografisë do të shërbejë si burim informacioni për pasurimin e mëtejshëm. Sigurisht marrim parasysh edhe avancimin teknologjik të hartimit të informacionit, shpërndarjes së tij dhe lehtësisë së kërkimit sipas shumë indikatorëve.

Shumë plotësime e përmirësime janë kryer duke u konsultuar me pjesën "jashtëlibrore", pra me burimet referuese si shtypi i kohës, studimet mbi periudhën dhe botimet e saj, gjurmimet në biblioteka të tjera, katalogë që nuk mungojnë (vetëm në këtë bibliografi ndodhen të skeduar mbi 15 katalogë e bibliografi të botuara në vitet '30-'40) etj. Drejtojmë vëmendjen veçanërisht te autorët dhe botimet serioze nga fusha e letërsisë, filologjisë, historisë etj., që kanë të dhëna për botimet e kohës. Referenca të shkëlqyera janë punimet bibliografike të Joklit, Skiroit, Kersopulos, Petrottës, Tagliavinit etj., - modele të informacionit dhe burime të rëndësishme mbi kronologjinë e botimeve, punime origjinale, me imagjinatë dhe të mbështetura në studimin e thelluar të librit shqip. Idetë dhe konstatimet e tyre janë të dokumentuara, të organizuara dhe me vlera të veçanta njohëse; mbulojnë shumë botime në mjaft disiplina. E gjithë kjo në funksion të zbatimit të parimit primar të kujtesës kombëtare, sigurimin maksimal të botimeve dhe realizimin e informacionit bibliografik në përputhje me atë situatë sasiore.

Duke iu dhënë përdoruesit të saj në mënyrë metodikisht të organizuar, me përmbajtje të klasifikuar hollësisht, me disa referime dhe me një aparat të gjerë ndihmës, të plotësuar me treguesit (indekset) e autorëve, përgatitësve, redaktorëve, botuesve, personave për të cilët është hartuar përmbajtja e librave, treguesit gjeografikë, ato të shtëpive botuese dhe të titujve të librave etj., jo vetëm lehtësohet së tepërmi përdorimi i bibliografive, por edhe prezantohet në unitet ajo plejadë krijuesish dhe botuesish, që dhanë një ndihmesë të çmuar dhe solide në kulturën e vjetër dhe të re.

Libri, duke qenë njëkohësisht mjet pune dhe shok i autorit apo lexuesit, madje edhe element i komunikimit kulturor, shpirtëror e fizik të përdoruesve, në vetvete bëhet edhe bartës i shumë intimiteteve, të cilat koha e gjatë i kthen në relikte, që si të tilla, veç asaj që na bëjnë të respektojmë brezat, janë elemente të rëndësishme të studimit apo njohjes së dukurive apo fateve të veçanta të personave dhe institucioneve. Nisur nga kjo, janë evidentuar të gjitha vulat, autografet që është bërë e mundur të deshifrohen.

Përshkrimi bibliografik është "paraqitje" e librit dhe jo vetë libri. Për pasojë, saktësia e përshkrimit, përputhja me standardet e njohura për identifikimin e botimeve dhe vlerën për çdo botim, krijojnë mundësinë e akcesit të gjerë të përdoruesve në informacion. Bashkëshoqërimi i përgatitjes së bibliografisë së librit me shfrytëzimin e bibliografisë së shtypit retrospektiv dhe vetë shtypin që jep informacion të vlefshëm me jehonën dhe pritjen e botimeve të kohës ka

ndikuar realisht në hartimin e kësaj bibliografie. Ndoshta mund të jetë i diskutueshëm mendimi im por na ka rezultuar pozitiv fakti që brenda një sektori, nga të njëjtët bibliografë (se edhe mundësitë janë të kufizuara) është punuar si për hartimin e bibliografive korente edhe për ato retrospektive të librit dhe shtypit shqip. Veprimtaria paralele - hartim i bibliografisë së librit - shqyrtim i shtypit të kohës (gazeta dhe libra) dhe, aty ku ndjehet e domosdoshme, botimet dhe studimet e sotme, ndihmon kujtesën historike përmes trajtimit të dy horizonteve receptive: atij bashkëkohor të krijuar në momentin botimit me horizontin e dytë, shqyrtimin retrospektiv përmes receptimit kritik. Për pasojë ndihmohet bibliografia me evidentime e saktësime, sugjerime e krahasime tematike për klasifikimin e të tjera. Kjo ka sjellë jo vetëm rritjen e vazhdueshme të informacionit, rrjedhimisht edhe të nivelit kulturor-profesional, gjithashtu ka mprehur e mbajtur të vijueshëm kujdesin për të plotësuar informacionet për botimet e kohës në fjalë, interpretimin dhe receptimin e botimeve në momentin e publikimit të tyre, por edhe shikimin retrospektiv prej studiuesve të sotëm, duke ndikuar në saktësinë e përshkrimit dhe klasifikimit bibliografik, në identifikimin e autorëve, përkthyesve, botuesve, vendeve dhe viteve të botimit etj. Megjithatë imponohet organizimi i një pune më sistematike me anën e së cilës dalin në dritë këta "gurë" që formojnë ngrehinën intelektuale të kohës dhe kujtesës kombëtare.

POEZIA SHQIPTARE NË KOSOVË 1953 - 1980
(Vështrim historik)

Mr. Tahir FONIQI
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

Viti historik 1953

Botimi i letërsisë shqiptare në Kosovë është bërë në frymën e lëvrimit të letrave shqipe, që nga Buzuku (shekulli XVI), Pjetër Bogdani (1625-1689), Gjon Nikollë Kazazi (1702-1752), përfshirë këtu edhe ndikimin e letërsisë gojore. Letërsia shqipe në Kosovë, e vjetër dhe e re, është pjesë e zhvillimit të kulturës e të letërsisë së shqiptarëve nga shekujt më të hershëm deri në ditët tona.

Është bërë e zakonshme që botimin e poezisë shqiptare në Kosovë, të formës libër, pas Luftës së Dytë Botërore, ta nisim me vitin 1953, ndonëse, më 1947, në Prishtinë është botuar vëllimi *Vjersha për shkolla fillore e paragjimnaze,* përkatësisht, më 1951, botohet vëllimi tjetër me titull *Vjersha të zgjedhuna për pionierë,* pa e parë këtu edhe librin Kangë popullore shqiptare të Kosovë-

Metohis I (është konfiskuar fill pas botimit më 1951). Këta tre tituj janë botuar në Prishtinë në 17500 kopje dhe rrokin 394 faqe shtypi. Titujt i kanë përgatitur Mehmet Gjevori, Stathi Kostari, Shefqet Veliu dhe Profesor Zekeria Rexha.

Vitin 1953 duhet marrë si nismë të botimit të veprave të para të letërsisë shqiptare, origjinale autoriale, në Kosovë.

Gjinia e poezisë prin në Kosovë, si sasi e cilësi, krahasuar me gjinitë e tjera gjatë periudhës sonë në shqyrtim.

Poezia për të rritur

Libri i parë i poezisë shqipe, për të rritur, në Kosovë është botuar më 30 maj 1953, titulluar: "*Nji fyell ndër male"* i poetit Martin Camaj. Sipas një dëshmie ky libër ka qenë i gatshëm për botim në gjysmën e parë 1952. Në fund të poezisë "Këcimi" ("Jeta e re", 1952, 4, 264-265) autori ka shënuar: nga përmbledhja *"Nji fyell ndër male".* Rrjedhimisht viti 1953 paraqet datë historike te ne për këtë gjini letrare.

Vëllimi poetik: *"Nji fyell ndër male*" ka 18 poezi: Fyellit, Katundi, Qarri, Mokna, Kroni, Luli, Fëmija i malit, Në dimën, Nana, Në pranverë, Mbramja, Zana, Gjarpni, Këcimi, Nata në mal, Në verime, Roja, Barit, Amaneti i dashnorit, Moj e mira, Nana e djali, Kush asht ma i forti, Kah vrrijet, Gjethi bjen, Dhimba e Zanës, Ditë vjeshte, Java e mbramë dhe Ikja.

Ky vëllim ka 132 vargje strofash tri, katër, pesë e gjashtë vargjëshe, rimash të ndryshme. Është botuar në 2000 kopje, në format 20 x 10 cm. Libri ka parathënien nga Prof. V. Dançetoviqi.

Më 1954 Martin Camaj boton edhe librin tjetër me poezi për të rritur: "*Kanga e vërrinit"*, që është vazhdimësi tematike e artistike e poetit Camaj për Dukagjinin e njerëzit e tij, ku hetohet po ai zë origjinal e frymëzues i poetit.

Këto dy përmbledhje poezish nuk kanë pasur ribotime gjatë periudhës sonë në shqyrtim, ndonëse ato kanë pasur ndikim të ndjeshëm në rrjedhat e poezisë sonë për të rritur në Kosovë e më gjerë.

Dhjetëvjetëshi i parë 1953 - 1963. - Gjatë këtij dhjetëvjetëshi janë botuar 17 tituj të dymbëdhjetë poetëve. Janë botuar: "*Nji fyell ndër male"* e *"Kanga e vërrinit"* të Martin Camajt, *"Për ty"* e Esad Mekulit, "*Tufa"* e Latif Berishës, "*Gjurmat e jetës"* e *"Bebzat e mallit"* të Enver Gjerqekut, "*Zani i malit"* e *"Buzëqeshjet e mesditës"* të Murat Isakut, "*Bulzat"* e Azem Shkrelit, *"Drita në zemër"* e Adem Gajtanit, "*Pështëritjet e mëngjezit*" të Fahredin Gungës, "*Në krahët e shkrepave"* e Din Mehmetit, "*Thirrje"* e *"Shamijat e përshëndetjeve"* të Ali Podrimjes, *"Me sy kange*" e Rrahman Dedajt dhe "*Vetëm jehona"* e Ali Musajt. Tetë poetë kanë botuar nga 1 titull: Esad Mekuli, Latif Berisha, Azem Shkreli, Adem Gajtani, Fahredin Gunga, Din Mehmeti, Rrahman Dedaj e Ali Musaj. Ndërsa katër poetë kanë botuar nga 2 tituj: Martin Camaj, Enver Gjerqeku, Murat Isaku e Ali Podrimja. Këto botime rrokin 1156 faqe në tirazh 51000 kopje.

Titujt kanë pasur këtë rrjedhë të botimit: më 1953, 1954, 1955 e 1962 është botuar nga 1 titull, më 1957-2, 1960-3 e më 1961 e 1963 botohen nga 4 tituj. Kurse, më 1956, 1958 e 1959 nuk është botuar asnjë titull. Titujt i kanë botuar Rilindja, revista letrare "Jeta e re" etj.

Dhjetëvjetëshi i dytë 1964 - 1974. - Në këtë dhjetëvjetësh botohen 118 tituj poezie të 63 poetëve: Azem Shkreli, Bedri Hysa, Besim Bokshi, Esad Mekuli, Fahredin Gunga, Josip Rela, Mark Krasniqi, Milaim Berisha, Mirko Gashi, Nexhat Pustina, Rexhep Elmazi, Teki Dervishi, Shime Deshpali, Sabri Hamiti Nebih Muriqi, Rifat Kukaj, Rrahman Dedaj, Musa Ramadani, Adem Gajtani, Enver Gjerqeku, Eqrem Basha, Qerim Ujkani, Jakup Ceraja, Abdylazis Islami, Din Mehmeti, Muhamed Kërveshi, Beqir Musliu, Ali Podrimja etj. Prej këtyre tridhjetë e gjashtë poetë kanë botuar nga 1 libër, njëmbëdhjetë nga 2, tetë nga 3, pesë nga 4 e tre nga 5: Ali Podrimja, Beqir Musliu e Muhamed Kërveshi. Gjatë këtij dhjetëvjetëshi botohen edhe përmbledhjet e para të katër poeteshave: "*Dallgë zemrash"* e Sadete Emërllahut, "*Sonte zemra ime feston"* e Edi Shukriut, "*Verma emrin tim"* e Flora Brovinës dhe *"Një mijë e një lule*" e Sheherzade Shkrelit. Titujt i kanë botuar Rilindja, "Jeta e re", Seksioni letrar "Jeronim De Rada" i Ferizajt, autorët, Klubi letrar "Trepça" i Mitrovicës, gazeta e studentëve "Bota e re" etj. Tirazhi i këtyre botimeve sillet rreth 230000 kopje.

Dhjetëvjetëshi i tretë, përkatësisht vitet 1975 - 1980. - Gjatë këtyre viteve janë botuar 72 titujt të 57 poetëve: Agim Mala, Ali Olloni, Agim Deva, Agim Vinca, Frrok Kristaj, Idriz Ulaj, Isak Ahmeti, Ismet Hebibi, Jusuf Gërvalla, Kadri Kadriu, Abdullah Konushevci, Merrushe Gjoshaj, Misret Halili, Murat Isaku, Nexhat Halimi, Osman R. Gashi, Ramadan Mehmeti, Rexhep Ferri, Rrustem Berisha, Skënder Sherifi, Shaip Beqiri, Qerim Ujkani, Mehmet Hoxha, Demë Topalli, Ymer Shkreli, Adem Gashi, Ibrahim Kadriu, Nehas Sopaj, Nexhmedin Soba etj. Prej këtyre, dyzet e pesë poetë kanë botuar nga

1 libër, nëntë nga 2 e tre nga 3: Bedri Hysa, Enver Gjerqeku e Muhamed Kërveshi. Librat i kanë botuar kryesisht "Rilindja", revista "Jeta e re" e klubet letrare. Tirazhi i këtyre botimeve sillet rreth 126000 kopje.

Gjatë kësaj periudhe botohen edhe titujt e parë me shkrimin në Braj, si: "*Vjersha*" të Esad Mekulit, titulli: "*Vepra*" e Migjenit, "*Thikë harrimi*" e Sabri Hamitit, "*Lumi i palodhur*" i Enver Gjerqekut, "*Jeta gabon*" e Rrahman Dedajt, "*Panorama e poezisë shqipe*" etj. Titujt me këtë shkrim janë shtypur në 15-150 kopje.

Me një fjalë, gjatë periudhës 1953 – 1980, janë botuar 207 tituj me poezi për të rritur, të krijuar prej 132 poetëve. Tirazhi i këtyre botimeve sillet rreth 407000 kopje.

Gjatë periudhës 1953 - 1980 poetët tanë, krahas vjershës e kanë krijuar edhe poemën: Martin Camaj, Esad Mekuli, Azem Shkreli, Besim Bokshi, Ali Podrimja, Fahredin Gunga, Din Mehmeti, përkatësisht kurorën sonetike: Enver Gjerqeku, Abdylazis Islami, Beqir Musliu, Hasan Hasani, Demir Behluli etj.

Për më kureshtarët sjellim këtu edhe këtë të dhënë: gjatë periudhës kohore l953-1980, për 27 vjet krijimtari letrare në këtë gjini, në titujt e përmendur, janë botuar rreth 393000 vargje për të rritur.

Poezia për fëmijë

Krahas poezisë për të rritur, paralel, është krijuar edhe poezia për fëmijë e cila, në formë të librit, botohet që nga 1953 duke filluar me dy titujt e parë: "*Gjethe të reja: (vjersha për fëmij)*" të Rexhep Hoxhës e "*Prrallat e gjyshit*" të Mark Krasniqit.

Vëllimi i parë është botuar në shtator 1953, ndërsa vëllimi i dytë në tetor 1953.

Libri "*Gjethe të reja*" i Rexhep Hoxhës ka 44 poezi: Fashizmi, Hylli partizan, Me pesë rremba xhixh shëndritë, Demostrata, Rrebeli vogël, Trakte shpërndaj, Te vorri i Ferid Grezdës, Ali Ngushtica, Shari, Brohorija, Migjeni dhe Kosta Obrasheviqi, Ndërtusit e vegjël, Traktori, Fluturës, Pranvra, Oh lum e lum, Vjollcat, Pioneri dhe bylbyli, Blini, Pendesa për shkollë, Shkolla e ime më thërret, Si i due prindët e mij, Duhani, Rrugaçi kokëfortë dhe shpendi, Kanga e vajzave të vogla të katundit, Dashuni dhe dëshira, Strinca dhe zogjt e saj, Ara ime plot me fat, Viçi im, Pushimet, Në bjeshkë, Nata, Erdhi vjeshta, Baba dimën, Ne babë dimni s'na frigon, Vallja rreth dardalecit, Fëmija dhe ujku, Gjuetar Bardheci, Picimuli, Kucani, Gjelocat ngatërrestarë, Zelli, Për sapun e për peshqir, Picimuli ka dëshirë.

Libri *Gjethe të reja* ka 67 faqe. E ka botuar shtëpia botuese "Mustafa Bakija" e Prishtinës në 3000 kopje.

Dhjetëvjetëshi i parë 1953 - 1963.- Gjatë këtij dhjetëvjetëshi janë botuar 10 tituj me poezi për fëmijë të pesë poetëve: Rexhep Hoxha, Mark Krasniqi, Anton Çetta, Vehbi Kikaj e Maksut Shehu. Tre poetë kanë botuar nga l libër: Anton Çetta, Maksut Shehu e Vehbi Kikaj, një 3: Mark Krasniqi e një poet boton 4 libra: Rexhep Hoxha. Librat i ka botuar Shtëpia botuese "Mustafa Bakija", përkatësisht "Rilindja" e Prishtinës dhe rrokin 667 faqe në 27200 kopje.

Dhjetëvjetëshi i dytë 1964 - 1974. - Në këtë dhjetëvjetësh botohen 65 tituj librash me poezi për fëmijë nga tridhjetë e tetë poetë: Qamil Batalli, Hivzi Sulejmani, Zihni Sako, Rrahman Dedaj, Odhise Grillo, Esad Mekuli, Ymer Shkreli, Ramadan Pasmaqiu, Naim Morina, Rushit Ramabaja, Bedri Rama, Anton Berisha, Nuhi Vinca, Ibrahim Kadriu, Mehmedali Hoxha, Abdylazis Islami, Zejnullah Halili, Avdi Shala, Ymer Elshani, Ali Huruglica, Rifat Kukaj, Muhamed Kërveshi, Agim Deva, Alqi Kristo, Qerim Ujkani, Nuhi Veselaj etj. Prej këtyre njëzet e katër poetë kanë botuar nga 1 libër, dhjetë nga 2, një 3, dy nga 4 e një poet boton 6 tituj: Agim Deva. Janë botuar edhe disa tituj grup autorësh, si: "*Letër pranverës*", Prishtinë, 1965, "*Këndo vlla*", Prishtinë, 1966 etj. Librat i ka botuar kryesisht Redaksia e botimeve "Rilindja". Botimet rrokin 4895 faqe në 186100 kopje.

Dhjetëvjetëshi i tretë 1975 - 1980. - Gjatë këtyre viteve botohen 37 tituj librash me poezi për fëmijë nga 24 poetë: Adelina Mamaqi, Gani Xhafolli, Shpresa Vinca, Hasan Hasani, Fejzi Bojku, Nol Berisha, Jakup Çitaku, Lutfi Lepaja, Faruk Tasholli, Mehmet Haziri, Xhevat Syla, Ibrahim Shala, Ramadan Zejneli, Qani Shabani, Aziz Ruhani etj. Gjashtëmbëdhjetë poetë kanë botuar nga 1 libër, pesë nga 2, një-3 e dy poetë botojnë nga 4 tituj: Rexhep Hoxha e Agim Deva. Librat i kanë botuar "Rilindja" e Prishtinës, Seksioni letrar "De Rada" i Ferizajt etj. Titujt rrokin 2465 faqe dhe janë botuar në 67500 kopje.

Me një fjalë gjatë periudhës 1953 - 1980, në Kosovë, janë botuar 112 libra me poezi për fëmijë: vjersha, poema, poema përrallë, tregime në vargje, përralla në vargje, pjesë teatrale në vargje etj. Këto botime rrokin 8027 faqe shtypi në rreth 280500 kopje.

DIGJITALIZIMI I KATALOGËVE ME SKEDA TË VLERAVE TË RRALLA TË BIBLIOTEKËS KOMBËTARE

Behije LUGA
Mirlona BUZO
Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë

Hyrje në procesin e digjitalizimit të katalogëve me skeda

Pasi bibliotekat pajisen me një sistem të integruar bibliotekar dhe katalogun e shërbimit publik në rrjet (OPAC), një nga sfidat më të mëdha është transferimi i skedave të vjetra në OPAC, të cilat janë përgatitur para automatizimit. Disa biblioteka e kanë arritur tashmë këtë qëllim, por shumë të tjera janë akoma larg përfundimit të këtij procesi.

Projektet e konvertimit retrospektiv ndërtohen duke kombinuar opsione dhe teknika të ndryshme. Është e rëndësishme të theksohet se konvertimi retrospektiv (ose "retrokonvert") nuk është e njëjtë me katalogimin retrospektiv (ose rikatalogimin). Digjitalizimi i skedave të katalogut është bërë praktikë e zakonshme në retrokonvert, pasi skanimi i tyre mund të bëhet shpejt dhe me kosto të arsyeshme si edhe është një kusht paraprak drejt identifikimit të karaktereve (OCR).

Pas procesit të skanimit shfaqet ideja për të kërkuar (përdorur) software të përshtatshëm për të shfletuar koleksionin e imazheve të skedave. Kjo do të bënte të mundur paraqitjen e një katalogu online ndihmës ose plotësues, ndoshta jo një OPAC "të vërtetë", por një alternativë me kosto shumë të arsyeshme. Shembulli i parë i OPAC-ut me imazhe të skedave u krijua në bibliotekën e Universitetit të Princeton në vitin 1994. Në mesin e viteve '90 katalogë të ngjashëm filluan të shfaqeshin në Europë me disa variante të elementëve shfletues, por gjithmonë duke shfaqur imazhet digjitale të skedave të katalogut si pamje e plotë e rekordit të gjetur. Projekti i Princetonit influencoi ndjeshëm në bibliotekat europiane dhe sot njihet edhe si fenomen europian. Disa nga këta katalogë ofroheshin në rrjet brenda mjediseve të bibliotekës, por shumë shpejt Rrjeti Mbarëbotëror u bë platforma më e përdorshme. Në mesin e viteve 2001, 38 katalogë janë identifikuar si faqe Web-i. Në fund të 2002 ky numër u rrit në 60 katalogë në 11 vende.

Deri tani nuk janë vendosur terminologji standarde për katalogët e këtij lloji. Shpesh i referohen si katalogë "elektronikë", "të skanuar" ose "të digjitalizuar", ose thjesht si "katalogë me imazhe". Si analogji e termit shumë të përdorur OPAC, përdoret akronimi CIPAC (card-image public access catalogues).

CIPAC janë katalogë online bazuar në baza të dhënash (database) të skedave të digjitalizuara të katalogut së bashku me mekanizmat pak ose më shumë të sofistikuar për shfletim ose kërkim dhe u shërben bibliotekave që nuk janë në gjendje të konvertojnë katalogët e vjetër aq shpejt sa ato dëshirojnë.

Lista ndërkombëtare e CIPAC
Adresa në Internet e katalogëve të digjitalizuar të bibliotekave të botës është:
URL: http://www.ub.tuwien.ac.at/cipacs/hrv.php

The International CIPAC List

CIPACs = Card-Image Public Access Catalogues (scanned / digitized card catalogues)

Croatia Zagreb National and University Library

Austria
Belgium
Czech Republic
Denmark
France
Germany
Italy
Japan
Lebanon
Lithuania
Norway
Poland
Russian Federation
Spain
Sweden
Switzerland
United Kingdom
United States

Përparësi të tjera të këtyre katalogëve ndaj atyre të ekzistues janë shpejtësia në kërkimin e informacionit, krijimi i burimeve të reja të informacionit, kursimi i kohës së përdoruesit, pavarësia nga orari i bibliotekës, mundësi kërkimi nëpërmjet indekseve alfabetike dhe sistematik, printimi dhe shkarkimi i regjistrimit, porositja online e burimeve dhe ruajtja e hapësirës në bibliotekë.

Megjithatë parë nga një vështrim kritik dikush mund të argumentojë që në shumicën e rasteve asnjë mjet për gjetjen e informacionit nuk ofrohet më mirë sesa nëpërmjet katalogëve tradicionalë. Teknologjia moderne e informacionit në këtë rast përdoret për të ringjallur dhe përjetësuar skedat e katalogut të cilat, në themel, janë relikte nga koha e kaluar. Ka qëndrime të ndryshme lidhur me këtë teknologji.

Motivet e krijimit të CIPAC

Digjitalizimi i katalogëve me skeda të koleksioneve të vlerave të rralla do të mundësojë akces online në këto koleksione të Bibliotekës Kombëtare, të cilat janë përshkruar vetëm në katalogun klasik me skeda. Gjithashtu ai do të promovojë koleksionet e rralla të BK të cilat mund të bëhen të akcesueshme edhe jashtë kufijve të Shqipërisë.

Përmbledhtazi:

- ✓ *kjo metodë është produktive dhe më pak e kushtueshme;*
- ✓ *është mënyra më e shpejtë për konvertimin e katalogut me skeda;*
- ✓ *ruan hapësirën;*
- ✓ *akcesi në katalogët me skeda realizohet përmes Internetit, çka çon në*
  - *përmirësim të kërkimit në katalog*
  - *përdoruesit mund të mbledhin informacione nga katalogë të ndryshëm tradicionalë tashmë nëpërmjet një katalogu të vetëm online*
  - *shpejtësi në kërkim*
  - *kursim të kohës së përdoruesit*
  - *pavarësi nga orari i bibliotekës*
- ✓ *është alternativë e vetme e paraqitjes së skedave me shkrim dore;*
- ✓ *printimi/shkarkimi i informacionit bëhet i mundur vetëm në një mjedis online;*

- ✓ *mundëson porositje online të burimeve;*
- ✓ *sigurohet ruajtja e katalogut (si masë për sigurimin e të dhënave);*
- ✓ *ndërkohë, katalogët me skeda kanë vlerë historike dhe janë trashëgimi kombëtare;*

Akcesi në katalogët me skeda përmes Internetit është sigurisht arsyeja më e rëndësishme pse bibliotekat kanë zgjedhur mënyrën CIPAC për konvertimin e katalogëve të tyre. Veçanërisht në rastet kur katalogët e vjetër ekzistojnë vetëm në një kopje, digjitalizimi i skedave konsiderohet si masë për sigurimin e të dhënave.

Kostoja: Pa dyshim krijimi i CIPAC është më pak i kushtueshëm se retrokonvertimi "real", por diferenca në kosto nuk është e lehtë të përcaktohet. Praktikisht të gjithë pohojnë që CIPAC janë shumë më pak të kushtueshëm, në disa raste ato përshkruhen si mënyra e vetme e "përballueshme" ose e vetmja mënyrë e "mundshme financiarisht" e konvertimit të katalogëve me skeda në format online.

Shpejtësia: Shumë biblioteka që kanë përdorur CIPAC kanë ndjerë nevojën për t'i patur të disponueshëm sa më shpejt të jetë e mundur të gjithë katalogët e tyre. Imazhet online të skedave të katalogut mund të krijohen dhe të bëhen të disponueshme në Rrjetin Mbarëbotëror në një kohë shumë të shkurtër, p.sh. disa biblioteka e kanë realizuar këtë brenda disa muajve (Biblioteka Kombëtare e Austrisë) ose brenda një viti (Princeton).

Akcesi: Publikimi i një katalogu në Internet, ose më saktë në Rrjetin Mbarëbotëror, nënkupton bërjen e katalogut të akcesueshëm nga të gjithë, d.m.th të pavarur nga vendi dhe orari i bibliotekës. Megjithatë jo të gjithë institucionet që krijojnë CIPAC kanë realizuar që në fillim akcesin përmes Web-it. Si fillim zgjidhjet kanë qenë realizuar vetëm në rrjetin lokal të bibliotekës p.sh. CIPAC i Princetonit në vitin 1995 përdorej vetëm në rrjetin e kampusit, por më vonë u zëvendësua me zgjidhje të bazuara në Web.

Hapësira: Në shumë raste aspekti i ruajtjes së hapësirës duke zhvendosur skedarët e vjetër është një arsye shumë e rëndësishme për zgjedhjen e një zgjidhje të tillë. Shumë biblioteka vuajnë vazhdimisht nga mungesa e hapësirës dhe ato biblioteka që aktualisht kanë zhvendosur skedarët e tyre pasi kanë realizuar procesin e CIPAC kanë përftuar të paktën një sallë, të cilën mund ta përdorin për qëllime të tjera (shpesh poste pune për OPAC). Çfarë ndodh me skedarët e vjetër? Në shumicën e rasteve ata janë zhvendosur nga sektori i referencave, por mbahen në vende të tjera.

Ruajtja: Në shumë raste, edhe kur bibliotekat donin të çliroheshin nga katalogët e vjetër, krijimi i CIPAC u pa si masë e ruajtjes së skedarit pasi vetë skedat janë produkt historik dhe si të tilla ato duhet të ruhen dhe të sigurohen. Pra krijimi i një kopjeje digjitale (CIPAC) të skedarit bën të mundur lëvizjen e një skedari të rrezikuar dhe ky proces çon në sigurimin e një kopjeje të këtij katalogu (në CD-ROM ose DVD).

Zgjedhja e llojit të CIPAC

Kur një bibliotekë planifikon të krijojë një katalog online me imazhe të skedave, lind pyetja se çfarë lloj CIPAC duhet të krijojë. Çfarë veçori do të ketë ky katalog? Çfarë lloj mekanizmash do të përdoren për shfletim, çfarë lloj paraqitjeje do të ketë imazhi i skedës? Do të jetë i mundur huazimi online? Çfarë software do të përdoren dhe ky do të jetë një zgjidhje komerciale apo i ndërtuar vetë? Të gjitha këto pyetje varen nga faktorë të tillë si buxheti, lloji i katalogut që do të konvertohet etj. Nisur edhe nga përvoja e bibliotekave të tjera ky software përmban këto veçori kryesore:

- shton, modifikon dhe fshin imazhet nëpërmjet mjeteve administrative të sistemit,
- shton indekset (nëse nevojitet zgjerimi i mëtejshëm i indekseve si alfabetik dhe sistematik),
- është i pajisur me mjete ndihmëse për përdorimin dhe shfletimin e katalogëve.

Zhvillimi i CIPAC në Bibliotekën Kombëtare

Pas një pune studimore mbi CIPAC vendosëm të krijojmë në Bibliotekën tonë Kombëtare katalogë online bazuar në baza të dhënash të skedave të digjitalizuara të katalogut së bashku me mekanizmat për shfletim ose kërkim. Në këtë katalog online janë përfshirë:

- ✓ *doreshkrime*
- ✓ *antikuarë*

✓ *harta të vjetra*
✓ *periodikë të vjetër*
✓ *vepra me karakter Al-Ba deri në vitin 1988*

Aspektet teknike të zhvillimit të CIPAC

Përgatitja e skedave të katalogut

Para skanimit të skedave u bë një punë paraprake me këta katalogë duke marrë në konsideratë disa aspekte të ndara në këto kategori:

• *përmirësimi/plotësimi i skedave kryesore ekzistuese*
• *kontrolli i renditjes alfabetike dhe sistematike*
• *zëvendësimi i skedave të dëmtuara*
• *heqja e skedave të dubluara, fotokopje, mikrofilma*

Skanimi dhe kontrolli i cilësisë

Skanimi mund të bëhet nga vetë stafi i bibliotekës, si në rastin tonë, ose nëpërmjet firmave komerciale (veçanërisht në bibliotekat e mëdha).

Për skanim duhet të përdoren skanera me cilësi dhe shpejtësi të lartë. Skanimi realizohet me rezolucion 300 dpi. Për shumicën e CIPAC skanohet vetëm pjesa e përparme e skedës edhe pse mund të ketë informacion edhe në pjesën e pasme. Përcaktohet madhësia e imazhit të skedës, e cila është 7.5x12.5 cm. Zgjidhet opsioni bardh e zi i imazhit të skedës dhe më pas këto imazhe ruhen në CD-ROM dhe DVD në formatin TIFF.

Në fakt kontrolli i cilësisë është një detyrë që kërkon kohë, por që është shumë e rëndësishme për funksionimin e CIPAC pavarësisht se çfarë software kërkimi përdoren. Dy aspekte duhet të kontrollohen, cilësia e imazhit dhe plotësimi i tij. *Cilësia e imazhit* ka të bëjë me lexueshmërinë, e cila duhet të jetë e njëjtë me skedën origjinale. Duke përdorur rezolucionin 300 dpi ky qëllim mund të arrihet pa vështirësi. *Plotësimi* nënkupton rendin e saktë të imazhit dhe ekzistencën e një imazhi për çdo skedë (duhet pasur kujdes në rastin kur skedat janë ngjitur me njëra-tjetrën).

Standardet e imazheve dhe shfletimi i tyre në Web

Skaneri automatikisht prodhon imazh digjital të skedës në format TIFF, i cili është standard i ruajtjes. Megjithatë formatet GIF dhe JPEG janë të domosdoshme për shfletimin e tyre në Web. Më pas bëhet përpunimi i imazhit (kontrast, ndriçim etj.)

Përgatitja manuale e indekseve

Për shfletimin virtual u krijuan indekset për kërkim. Ky proces është një nga fazat më të rëndësishme dhe në të u përfshinë bibliotekarë të kualifikuar. U ndërtuan indekse alfabetike autor/titull dhe indekse sistematike sipas skemës KDU.

Sistemi i shfletimit dhe kërkimit. Mjetet administrative

Në kontekstin e CIPAC mjet administrativ është një modul programi që u mundëson bibliotekave të bëjnë disa lloj ndryshimesh në imazhin e skedave të katalogut. Sistemi (software) menaxhon katalogët e digjitalizuar:

✓ shton, modifikon dhe fshin imazhet nëpërmjet mjeteve administrative të sistemit
✓ shton indekset (nëse nevojitet zgjerimi i mëtejshëm i indekseve si alfabetik dhe sistematik)
✓ është i pajisur me mjete ndihmëse për përdorimin dhe shfletimin e katalogëve

nëpërmjet indekseve realizohet shfletimi i skedave
(bllok ose një nga një)
bëhet i mundur zmadhimi dhe zvogëlimi i skedave
download-imi i skedës si imazh
printimi i skedave
marrja e ndihmës (udhëzuesi për përdorim)

Prezantimi i CIPAC në WEB-in e Bibliotekës Kombëtare

Emërtimi i CIPAC

Meqenëse nuk ka një terminologji të standardizuar për CIPAC, biblioteka të ndryshme kanë përdorur terma të ndryshme lidhur me këtë proces. Disa bib-

lioteka kanë përdorur akronimet e tyre për CIPAC, si *KatZoom* (Vienna), *DIKAT* (Luzerne), *DigiKat* (Heidelberg), *IPAC* (Berlin), ose *CardPAC* (Dortmund). Gjithashtu shumë biblioteka kanë përdorur për procesin e CIPAC thjesht *Katalogë të skanuar* ose *të digjitalizuar.* Biblioteka jonë Kombëtare e ka emërtuar CIPAC si *Katalogët e digjitalizuar*.

Integrimi i CIPAC në Web site-in e BK

URL :
http://www.bksh.al
http://www.bksh.al/kataloget_digjitale/home_2.aspx

Struktura e CIPAC

Renditja alfabetike e katalogut



Paraqitja e imazhit të skedës në renditjen alfabetike



Skema hierarkike sipas KDU

Paraqitja e imazhit të skedës sipas KDU

Opsioni i ndihmës



Përfundime

Zhvillimi i mëtejshëm i proceseve të automatizimit është e vetmja mënyrë për të arritur digjitalizimin dhe indeksimin e një numri shumë të madh të skedave të katalogut (me cilësi të lartë, me shpenzime të pakta dhe brenda një periudhe kohe jo shumë të gjatë).

Interneti, portalet dhe shërbimet në rrjet kanë ndryshuar shumë funksionet dhe fokusin e bibliotekave. Domosdoshmëria daljes së katalogëve online si shërbime elektronike përmes ndërfaqeve grafike dhe shërbimeve www nxit zhvillimin e bibliotekave.

Në biblioteka projektet e konvertimit retrospektiv janë fillime të vlefshme në kohën kur biblioteka është në pritje të një epoke të re të integrimit. Sot gjenden shumë mënyra moderne dhe fleksible të procesit të konvertimit. Këto projekte nxisin zhvillimin e shërbimeve bibliotekare dhe ndihmojnë në plotësimin e shfaqjeve të bazuara në Web.

Sfida

CIPAC do të jetë zgjidhje e përkohshme apo e përhershme?

Sfida për të ardhmen do të jetë gjetja e mënyrave dhe mjeteve efikase për përgatitjen dhe importimin e skedave të skanuara si edhe adaptimin e tyre në sistemin e integruar bibliotekar ADLiB. Etiketimi i fushave të skedës sipas formatit UNIMARC do të sillte një përfundim pozitiv të procesit të Konvertimit Retrospektiv.

BIBLIOTEKA DIGJITALE NË SHËRBIM TË KUJTESËS SË KOSOVËS

Besim J. KOKOLLARI
Ramush ZEKA
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

Abstrakt

Tema shqyrton aspekte të ndryshme të bibliotekave digjitale në vende të ndryshme. Pas një paraqitje të zhvillimit të bibliotekave digjitale në krahasim me ato tradicionale, autorët trajtojnë tri aspekte të këtyre tipave të bibliotekave: natyrën e dokumenteve digjitale, mjetet apo teknologjinë e zbatuar në bibliotekat digjitale, si dhe shembuj konkret të bibliotekave digjitale të zhvilluara nga biblioteka kombëtare të vendeve të ndryshme. Tema ka për qëllim të njohjes së bibliotekarëve të vendeve tona me zhvillimin e bibliotekave digjitale si mjete apo edhe si institucione të reja në ruajtjen e kujtesës së një kombi. Gjatë tërë temës, autorët sjellin shembuj të bibliotekave të ndryshme digjitale, herë herë të shoqëruara me komete lidhur me skemën e metadatave, teknologjisë kompjuterike të zbatuar në to, si dhe mënyrën e organizimit të koleksioneve dhe mundësive të kërkimit të tyre.

Hyrje

Përshëndetje zonja dhe zotërinj, të nderuar bibliotekarë - kolegë dhe të pranishëm të tjerë. Është me të vërtetë kënaqësi që për herë të dytë po mbahet *Konferenca e Bibliotekonomisë Shqipëri - Kosovë*. Kjo konferencë po jep mundësinë e shkëmbimit të informacionit, ideve, përvojës dhe të rejave në lëmin e bibliotekarisë në trevat tona –që nuk ka ekzistuar më parë në nivel të tillë në historinë e bibliotekave Shqipëri-Kosovë. Dhe kemi kënaqësinë që për herë të dytë para kolegëve tanë të Shqipërisë dhe të Kosovës të paraqitemi me një temë që kësaj radhe ka të bëjë me bibliotekat digjitale dhe rolin e tyre që luajnë në ruajtjen e kujtesës së Kosovës, pas së cilës është krijuar edhe tema bosht e kësaj konference. Ndonëse bibliotekat digjitale ende nuk kanë gjetur zbatim në trevat tona, për sa jemi në dijeni, mendojmë që kjo temë do të luaj rol në nxitjen e ideve dhe marrjen e hapave konkret për ndërtimin e një biblioteke të tillë. Për më tepër, tema shtjellon disa çështje që duhet pasur parasysh lidhur me natyrën e dokumenteve digjitale, pastaj teknologjinë e cila zbatohet në to për të parë mundësitë e zbatimit të një teknologjie të tillë në ndonjë iniciativë në bibliotekat tona, si dhe projekte në zhvillim të bibliotekave digjitale me qëllim të ofrimit të shembujve për audiencën tonë. Natyrisht se të gjitha këto janë vendosur në kontekstin e ruajtjes së kujtesës së një territori, në rastin tonë konkret të kujtesës së Kosovës, të ruajtjes së trashëgimisë intelektuale të shkruar, imazhesh, videosh, etj., të krijuara apo të konvertuara në burime digjitale.

Para se të shtjellojmë natyrën e dokumenteve, teknologjinë në zhvillimin e bibliotekave digjitale, dhe sjelljen e disa shembujve konkret në ndërtimin e bibliotekave digjitale, të cilat janë temat kryesore të këtij prezantimi, po ndalemi pak në arsyen e lindjes apo zhvillimit të këtyre llojeve të bibliotekave si dhe po sjellim disa definicione të tyre, të cilat provojnë të përcaktojnë kufijtë e bibliotekave digjitale.

Ashtu siç ishin shkrimet e para në alfabetin kunjor në Mesopotaminë e lashtë, për të cilat kemi njohuri deri më tani, si dhe ato shkrime apo forma të ndryshme të komunikimit në pllaka të argjilës në papirus në Egjiptin e vjetër që quan në lindjen e bibliotekave tradicionale, fillimisht nëpër tempuj e më vonë edhe në biblioteka qoftë edhe private (Wikipedia, 2007), në të njëjtën mënyrë po shkrimet dhe forma të tjera të komunikimit, në kohën tonë të teknologjisë moderne, bënë që të krijohen dhe zhvillohen bibliotekat digjitale. Bibliotekat digjitale nuk lindën rastësisht, ato u krijuan si nevojë e grumbullimit, organizimit, shërbimit dhe ruajtjes së materialeve, apo më mirë të themi informacionit, të krijuar apo konvertuar në formë digjitale. Nëse bibliotekat tradicionale, të cilat janë marrë dhe merren me materiale të njohura tashmë, si dorëshkrimet, librat, gazetat, revistat, fotografitë që të gjitha në formë letre e më vonë edhe deri diku të atyre elektronike, konsiderohen si arkiva të ruajtjes së kujtesës së një kombi për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm, atëherë të njëjtin rol e marrin edhe bibliotekat digjitale në ruajtjen e materialeve të këtij lloji dhe të tjerave, tani në formë digjitale, për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm.[1]

Në fillimin e tyre, bibliotekat digjitale u krijuan mbi premisën se kompjuteri jep mundësi të vënies në dispozicion të shumë përdoruesve në të njëjtën kohë po që se materiali është i ruajtur në një formë apo tjetër në kompjuter. Kështu filloi edhe projekti "Guttenberg" më 1971, që konsiderohet njëra prej bibliotekave më të vjetra digjitale (Hart, 1992), megjithëse vizioni për to ishte vënë disa dekada më herët me Vannevar Bush-in (Brown, 2005), e mbase edhe para tij, etj. Mbase në fillim ato kanë evoluar edhe si nevojë e përshkrimit, fotografimit apo skanimit të materialeve të vjetra dhe vendosjes së tyre në kompjuter, për t'i ruajtur nga prekja fizike nga përdoruesit, të cilët kanë pasur nevojë për atë material. Pra janë digjitalizuar, ashtu si krijimi dhe zhvillimi i mikroformat, për ta ruajtur kopjen origjinale të paprekshme, e natyrisht, edhe për ta vënë në dispozicion të një mase më të gjerë lexuesish. Më pas me zhvillimin e internetit, pasi bibliotekat e para digjitale u krijuan para ardhjes së internetit, ato materiale u bënë të mundshme të shfrytëzohen nga çdo kompjuterë që kishte lidhje interneti. Për më tepër nga arsyet e mëhershme dhe nevojat pse u krijuan bibliotekat e para digjitale, ato tani merren apo përpiqen të merren me çdo lloj materiale në formë digjitale qoftë të skanuar e konvertuar, qoftë të lindur në formë elektronike në kompjuter apo përmes ndonjë pajisje tjetër. Me zhvillimin e internetit, i cili transformoi edhe më tepër natyrën e dokumenteve të krijuara përmes kompjuterit apo pajisje tjera digjitale, edhe bibliotekat digjitale u zhvilluan, evoluuan e u njohën me emra të ndryshëm, si bibliotekat virutale, të cilat do të ekzistonin vetëm virtualisht në internet, pastaj biblioteka elektronike, të cilat do të merreshin me materiale në formë elektronike, koleksione të revistave elektronike, etj. (Harter, 1997). Këta terma vazhdojnë të ekzistojnë edhe më sot. Mirëpo, nocioni i bibliotekave digjitale, siç mund të kuptohet

[1] Natyrisht, shumë pyetje mund të bëhen në këtë rast sa i përket formave të ruajtjes së informacioneve në një ambient të tillë digjital, se sa teknologjia do të jetë stabile në bartjen e këtyre informacioneve qindra vjet më vonë, megjithatë ky aspekt i ruajtjes së formateve nuk do të shtjellohet në këtë punim, pasi punimi ynë nuk do të përqendrohet në format teknologjike të ruajtjes së informacionit, por në rolin e bibliotekave digjitale dhe mundësive që ofrojnë për ruajtjen e kujtesës së një vendi.

edhe nga definicionet e mëposhtme, është gjithëpërfshirës, dhe i mbulon nën gjirin e vet gjitha këto koncepte, për një gjë të tillë pajtohen edhe shumë ekspert në fushën e bibliotekarisë, megjithatë nuk ka një konsensus të plotë, madje shpeshherë këto koncepte përdoren në vend të njëra tjetrës.

Një nga definicionet për bibliotekat digjitale është ai i Federatës së Bibliotekave Digjitale (1998) që jep këtë përkufizim *"Bibliotekat digjitale janë organizata të cilat ofrojnë burime, kanë personel të specializuar për të për përzgjedhur, organizuar, ofruar qasje në burime intelektuale, interpretuar, shpërndarë, ruajtur integritetin, dhe sigurojnë jetëgjatësinë e koleksioneve digjitale kështu që ato të janë të gatshme për t'u përdor nga një bashkësi apo bashkësi të ndryshme".* Nga ky definicion dallohet qartë se bibliotekat digjitale kanë një përkufizim të gjerë sa i përket të të qenit organizatë apo institucion, pastaj përmbajtjes të cilën e kanë duke e përkufizuar fushëveprimin e tyre vetëm në botën e botimeve digjitale, e dhënë përmes konceptit të fjalës "burim", me të cilin nënkuptohen 'burimet digjitale'. Më tej definicioni jep edhe një aspekt të rëndësishëm të bibliotekave digjitale, të të pasurit personel me funksione të ndryshme për t'u kujdesur për burimet digjitale, si dhe aspektin se ato krijohen, mirëmbahen për t'i shërbyer një apo më shumë bashkësive, me fjalë të tjera përdoruesi është në vëmendje.

Një definicion tjetër nga Candela et al. (2007), ofron këtë përkufizim të bibliotekave digjitale: *"Një organizim virtual i mundshëm që mbledh në shkallë të gjerë, menaxhon dhe ruan në afat të gjatë përmbajtjen e pasur digjitale, dhe u ofron përdoruesve të saj funksione të veçanta për atë përmbajtje, të një cilësie të matshme sipas politikave të përcaktuara"*. Ajo që është me rëndësi këtu, përveç atyre që u thanë në definicionin e mëparshëm sa i përket personelit, përmbajtjes, e përdoruesve, është fjala apo termi "cilësi", e cila mund të nënkuptojë mbledhjen e dokumenteve digjitale sipas kritereve të caktuara apo edhe mund të nënkuptoj lënien anash të informacioneve jorelvante për atë bibliotekë digjitale.

Për t'i përmbledhur të dy definicionet del që biblioteka digjitale është e pajisur me të gjitha tiparet, vlerat dhe funksionet me të cilat i kemi identifikuar edhe vet bibliotekat tradicionale. Të njëjtat qëllime që bibliotekat tradicionale kanë synuar t'i arrinin përmes funksioneve dhe shërbimeve të tyre duke grumbulluar me kritere materiale tradicionale apo konvencionale, po ato qëllime synon t'i arrijë edhe biblioteka digjitale duke grumbulluar po me kritere dokumente jokonvencionale apo digjitale.

Natyra e dokumenteve digjitale

Natyra e dokumenteve digjitale është më komplekse. Tashmë kemi dhjeta e dhjeta formate e gjuhë programuese të ndryshme në të cilat prezantohen dokumentet digjitale. Sa për të përmendur disa, dokumente të tilla janë ato, si: Word, Excel, PDF, HTML, XML, XHTML, RDF, pastaj GIF, JPEG, TIFF, MPEG4, MP3, CD, DVD, e shumë të tjera. Nga kjo shihet se bibliotekat digjitale kanë të bëjnë tashmë me një natyrë dokumentesh krejtësisht të ndryshme nga natyra e dokumenteve konvencionale me të cilat jemi mësuar. Sa duken komplekse këto formate në të cilat ruhen informacionet, ato kanë një element universal të përbashkët – mënyrën se si kompjuteri e ruan dhe e kupton informacionin e këtyre dhe formateve të tjera (Harter, 1997). Çdo karakter në dokumentet digjitale, qoftë shkronjë, numër, fotografi, zë, etj., në teknologjinë e kompjuterit, ruhet si bit (Buckland, 1998). Për shembull, shkronja 'A' është e barabartë më 8 bit A= 01000001 (Savage, 1998-2006). Duke e marrë parasysh këtë veçori, kuptojmë se të gjitha dokumentet digjitale në format e tyre nga më të ndryshme kuptohen, trajtohen, e manipulohen me alogoritma të njëjta matematikore. Nga ky aspekt, dokumentet digjitale nuk paraqesin ndonjë problematikë për trajtimin e tyre. Mirëpo, ekzistojnë shumë çështje problematike lidhur me ofrimin e këtyre informacioneve për përdorues nga sisteme të ndryshme kompjuterike.

Një çështje e tillë ka të bëjë pikërisht me natyrën e dokumenteve digjitale. Sistemet kompjuterike, makinat kërkuese, programet e automatizuara bibliotekare kanë përparuar mjaft në mënyrën e nxjerrjes së informacionit nga dokumentet digjitale të shkruara në formë teksti. Ata i indeksojnë fjalët të veçuara, kuptojnë renditjen e fjalëve në fjali duke vënë rregulla alogoritmike, pastaj i kuptojnë edhe prapashtesat e parashtesat, siç është rasti me përdorimin e shenjës së yllit në fund të një fjale që gjeneron të gjitha variantet e asaj fjale. P.sh. fjala **Kosov*** po të shkruhet në katalogun e BKUK-së do të gjenerojë më shumë rezultate se sa fjala **Kosovë**. E njëjta gjë ndodh edhe po që se kjo strategji përdoret në ndonjë prej makinave kërkuese, si *Google* në faqen e saj në anglisht. Është çështje tjetër sa i përket relevancës. Se sa ato dokumente të cilat nxirren apo gjenden janë relevante me atë që dëshiron përdoruesi. Kjo çështje ka bërë që bibliotekat digjitale të krijojnë metadata për t' ndihmuar procesit të gjetjes së informacionit nga hapësira ruajtëse e kompjuterit. Metadatat, që në veprimtarinë bibliotekare si, MARC, RDF, Dublin Core, etj., së bashku me taksonomi e forma të ndryshme të fjalorëve të kontrolluar ofrojnë kërkim dhe nxjerrje më relevante të

informacioneve, pasi krijohen nga njeriu duke i dhënë sinjal kompjuterit se cilat informacione duhet të indeksohen patjetër. Megjithatë, kjo relevancë, në shumë raste, kërkon më shumë njohuri nga përdoruesi për sistemin të cilin e kërkon, e nganjëherë edhe durim. Në mënyrë vizuale, një dokument i ruajtur në bibliotekat digjitale, zakonisht është i ruajtur me tri komponentë si në figurën e më poshtme për të bërë sa më të lehtë dhe më relevante gjetjen e dokumentit.

Figura 1 Tri nivele të informacionit në një bibliotekë digjitale



Një problem të kësaj natyre, mirëpo më shumë kompleks, paraqesin edhe dokumentet digjitale në formë fotografie, e mos të flasim për video apo incizime zanore. Nëse si shembull marrin një automobil në fotografi, atëherë mund të krijojmë metadata, si emri i automobilit, zhanri apo lënda, krijuesin, teknikën e përdorur gjatë fotografimit, ngjyrat, etj., natyrisht duke përdorë një skemë standarde apo të pranuar të metadatave. Në këtë mënyrë mundësohet kërkimi dhe nxjerrja e fotografive të ruajtura në një sistem kompjuterik. Deri më tani nuk ka ndonjë program të besueshëm, të kënaqshëm a relativisht të mirë që i kupton fotografitë pa intervenimin e mendjes së njeriut në krijimin e metadatave. Megjithëse ka përpjekje në këtë drejtim siç është rasti me sistemin e kërkimit tre dimensional të objekteve (shih, 3D model retrieval system - http://3d.csie.ntu.edu.të/~dynamic/index.html), apo teknologjia QBIC e IBM, e cila mund t'i kuptojë pamjet në bazë të kombinimit të ngjyrave (Lesk, 2005). Modeli tre dimensional tenton që të arrijë nxjerrjen e pamjeve tre dimensionale nga përdoruesi vetëm duke e vizatuar objektin që ai e dëshiron në hapësirën e caktuar, në vend të fjalës për kërkim, dhe me shpresë sistemi do ta kuptojë dhe do t'i ofrojë pamjen e kërkuar. Përveç të tjerash, sistemi QBIC mundëson edhe kërkimin me anë të kombinimit të ngjyrave, dhe programi do të gjejë modelet e fotografive të cilat i përshtaten më së shumti atij kombinimi të ngjyrave. Për të parë një shembull të funksionimit të QBIC, vizito faqen e muzeut "The State Hermitage" në rusi: http://www.hermitagemuseum.org/fcgi-bin/db2www/qbicColor.mac/qbic?selLang=English). Natyrisht, që zhvillimi i sistemeve të tilla dhe përkryerja e tyre do të ndihmonte në shpejtësinë e organizmit dhe lehtësimit të gjetjes së dokumenteve digjitale me vlera dhe me interes për ruajtje.

Teknologjia e aplikuar në zhvillimin e bibliotekave digjitale

Në krijimin dhe zhvillimin e bibliotekave digjitale bën pjesë një numër i gjerë komponentesh teknologjike, prej harduerit e deri te softuerët e ndryshëm komercial e jokomercial. Megjithatë, për shkak të numrit të madh të këtyre komponentëve, si dhe për t'iu përshtatur rrethanave ekonomike në vendin tonë, në këtë punim jemi përqendruar në ofrimin e informacioneve të disa softuerëve të cilët janë falas por që kanë gjetur zbatim të gjerë në bibliotekat digjitale të vendeve të zhvilluara dhe të bibliotekave me renome botërore - shembuj të të cilave do t'i ofrojmë në seksionin tjetër të punimit. Programet kompjuterike falas (që në anglisht quhen O*pen Source Software*), janë në dispozicion për instalim të secilit individ apo institucion, i cili dëshiron të shfrytëzojë atë teknologji. Ato janë të hapura për ndryshime, modifikime, konfigurime të mëtutjeshme, si dhe në rastet më të shumta ekziston një bashkësi e cila e përdor, diskuton apo është e interesuar në një program të caktuar. Kështu që në rastin tonë, mund të vilen përvoja nga ato institucione dhe të përfitojmë nga përpjekjet e tyre gjatë instalimit, funksionimit si dhe nivelit të kënaqshmërisë së ndonjërin prej këtyre programeve në përdorim. UNESCO[2] (Organizata e

2 Faqja e UNESCO-s (United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization) për softuer të ndryshëm në fushën e bibliotekarisë. http://www.unesco.org/cgi-bin/webworld/portal_freesoftware/cgi/page.cgi?d=1&g=Software/Digital_Library/index.shtml. Vizituar më 14 nëntor 2007.

Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë) ofron një listë të gjerë të programeve të ndryshme falas në internet, duke përfshirë nga programet për biblioteka digjitale, programe vetëm për katalogim e deri të programe të plota për sisteme të automatizuara bibliotekare. Më poshtë kemi shkoqitur vetë disa prej programeve të cilat janë mjaft të popullarizuara dhe në përdorim të gjerë nga bashkësia e bibliotekave digjitale.

Greenstone - i zhvilluar në Zelandë të re nga Universiteti Waikato në bashkëpunim me UNESCO-në dhe organizatën joqeveritare Human Info NGO, ofron një mjetë të fuqishëm në organizimin, menaxhimin dhe gjetjen e informacioneve në biblioteka digjitale. Greenstone zë hapësirë të vogël instaluese në kompjuter, instalohet në të gjitha versionet e Windows, Unix/Linux, dhe Mac OS-X. Karakteristikë tjetër është se mbështet pamje shumë-gjuhësore të programit, pastaj mbështet të gjitha formatet e metadatave, si dhe ofron fleksibilitet të modifikimit e konfigurimit të mëtutjeshëm[3] (New Zealand Digital Library Project, 2007). Më poshtë po ofrojmë dy shembuj të bibliotekave digjitale të cilat e kanë në zbatim programin Greenstone.

Figura 2 Biblioteka Digjitale e Universitetit të Çikagos

[3] Për më tepër për programin Greenstone, shih: www.greenstone.org.

Figura 3 Biblioteka digjitale e Universitetit të Oxford-it

Nga këta dy shembuj mund të shihet qartë ndryshimet në faqet e tyre të internetit edhe pse përdorin produktin e njëjtë për rregullimin e tyre. Kjo tregon natyrën fleksibile të programit Greenstone për modifikim, si dhe mundësinë për të renditur koleksionet e digjitalizuara në mënyra të ndryshme - sipas nevojës, të cilat i parasheh biblioteka.

DSpace - i zhvilluar nga Bibliotekat MIT (Massachussets Institute of Technology) dhe Hewlet Packard Labs, është një program tjetër falas në internet dhe mjaft i përhapur nëpër institucione të ndryshme për ruajtjen e koleksioneve digjitale. Mund të instalohet në UNIX ose Linux. Një karakteristikë e Dspace është se bënë ruajtjen e koleksioneve digjitale në dy nivele - në nivelin me bit dhe në nivelin funksional. Ruajtja në nivelin bit mundëson që dokumenti të ruhet në formën origjinale të tij pa pësuar kurrfarë ndryshimi, ndërsa ruajtja në nivel funksional karakterizohet me ndryshimin e fajllit me evoluimin e formateve duke bërë të mundur përdorimin e dokumentit në kohë të ndryshme. DSpace mbështet metadatat në Dublin Core, ndërsa janë duke u bërë përpjekje edhe për aplikimin e skemave të tjera të metadatave[4] (DSpace). Shembulli i

[4] Për më tepër programin DSpace, shih: www.dspace.org/

mëposhtëm paraqet një kërkim në Bibliotekën Kombëtare të Finlandës e cila përdor DSpace projektin e saj të digjitalizimit të quajtur Doria (National Library of Finland, 2007).

Figura 4 Projekti i digjitalizimit Doria i Bibliotekës Kombëtare të Finlandës



Shembulli i mësipërm paraqet një dokument të kërkuar me fjalën 'Kosov*', e cila si rezultat ka gjetur një shkrim për traditën gojore të shqipe në Kosovë. Pasi Doria mbështetet nga DSpace, metadatat janë të krijuara në formatin Dublin Core, Faqja është mjaftë e qartë, e me organizim të thjeshtë por funksional, dhe ofron disa opsione kërkimi me kërkim të lirë, një koleksion të veçantë sipas titullit, datës, autorit dhe lëndës, por edhe kërkim të avancuar.

Fedora - një program tjetër falas, platforma e së cilës mbështetet në katër shërbime: shërbimit të depoziturës, shërbimit të ruajtjes, shërbimit semantik, dhe shërbimit evolues. Ajo ofron veçori nga më të ndryshmet si konvertimi i formateve, integrim me makinat kërkuese, pastaj kontroll në qasje, versione të ndryshme të gjeneruara nga përmbajtja, pamje dinamike të objekteve digjitale, etj., që të gjitha të përfshira në shërbimin e depoziturës së Fedora-s. Ajo ofron mundësi të ruajtjes së dokumenteve të ndryshme digjitale, e në të njëjtën kohë shfaq përmes ekranit një surrogat apo versione të ndryshme të atij dokumenti. Fedora, po ashtu, integron në vete teknologjinë e internetit semantik për të përshkruar e ndërlidhur dokumentet digjitale në botën e internetit. Ofron mundësi të ndryshme të konfigurimit, modifikimit dhe evoluimit për të qenë vazhdimisht program i kohës[5] (nga faqja e internetit e Fedora Commons). Shembulli i mëposhtëm i bibliotekës digjitale, e cila shfrytëzon teknologjinë e Fedora-s, tregon qartë për opsionet e shumta të kërkimit të koleksioneve të saj digjitale për përdoruesit e saj.

Figura 5 Biblioteka Digjitale e Institutit Kombëtar të Shkencës në ShBA



Duke i pasur parasysh edhe programet e tjera, të cilat zbatohen në krijimin dhe zhvillimin e bibliotekave digjitale, si programi *Eprints,* pastaj makina kërkuese të përshtatshme për bibliotekat digjitale, si *DL-Harvest*, *BRICKS Framework*, (Wikipedia, 2007), etj., por që nuk do t'i rishikojmë në këtë punim, ato janë një mundësi shumë e mirë për t'u shfrytëzuar në ndonjë pro-

[5] Për më tepër programin Fedora, shih: http://www.fedora-commons.org/index.php

jekt të mundshëm në vendet tona, e sidomos një rast i shkëlqyer për të filluar me hapa konkret të prezantimit të historisë dhe aspekteve të tjera kulturore, shoqërore e shkencore të Kosovës përmes *Kujtesës së Kosovës*, projekt që synon të realizohet nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës.

Shembuj të bibliotekave digjitale

Përveç shembujve të mësipërm, ku kemi përmendur disa biblioteka digjitale, por më shumë në kontekstin e teknologjisë së zbatuar në to, në vijim do të përqendrohemi kryesisht në disa projekte të mëdha të bibliotekave digjitale për të ofruar disa njohuri për to, si dhe natyrën e tyre.

Bibliotekat kombëtare të vendeve të ndryshme janë ato të cilat kanë marrë iniciativë të zhvillimit të bibliotekave digjitale me karakter kombëtar e botëror, e të cilat janë me interes për modele të mundshme për bibliotekat kombëtare të vendeve tona. Dy projekte të tilla janë të Bibliotekës së Kongresit. Njëri prej tyre është *Kujtesa Amerikane* (American Memory), të cilën e kemi trajtuar në një temë tonën në revistën *Biblioletra*, dhe nuk do të zgjerohemi këtu më tej, ndërsa projekti tjetër i lancuar kohëve të fundit po nga kjo Bibliotekë, është Biblioteka Digjitale e Botës (World Digital Library). Biblioteka Digjitale e Botës është ende në fazën e projektit, por që gëzon një mbështetje të madhe nga UNESCO. Kjo Bibliotekë synon të bëjë digjitalizimin e materialeve unike e të rralla të institucioneve bibliotekare dhe institucioneve të tjera kulturore nga e mbarë bota, dhe t'i ofrojë ato burime pa pagesë përmes internetit (UNESCO, 2007; World Digital Library, 2007).

Një bibliotekë tjetër digjitale, por e zhvilluar nga Biblioteka Kombëtare e Francës është *Gallica*, e cila ofron 90,000 vëllime të skanuara, 80,000 pamje (faqja e internetit e Gallica), 1,200 vëllime në tekst të plotë, si dhe 500 dokumente audio (Wikipedia, 2007). Faqja e fillimit e Gallica-s është e thjeshtë, koleksionet janë të organizuara në forma të ndryshme, kryesisht në koleksione tematike, dhe koleksionin ikonografike apo të pamjeve vizuale. Gjatë një kërkimi tonin, që është i paraqitur në figurën e mëposhtme, të një autori të interesuar për shqiptarët, mësojmë se Gallica ofron disa mundësi të kërkimit dhe të paraqitjes së dokumenteve digjitale në ekran. Megjithatë, rëndësia e saj qëndron më shumë në koleksionet e saja të pasura të kulturës e historisë franceze, por edhe të kulturave të tjera botërore.

Figura 6 Kërkim në bibliotekën digjitale të Bibliotekës Kombëtare të Francës, Gallica



Projekte të tilla të bibliotekave digjitale janë të zhvilluara edhe nga bibliotekat e tjera kombëtare, si projekti i Bibliotekës Kombëtare të Norvegjisë, së Finlandës, së Australisë, etj., si dhe shumë biblioteka të tilla nga institucione tjera kulturore, si arkivat e institute, të vendeve të ndryshme të botës. Pra, tashmë ekzistojnë shembuj të bollshëm të bibliotekave digjitale si dhe mjete e programe kompjuterike, të cilat e lehtësojnë një përpjekje të mundshëm të bibliotekave tona për të themeluar biblioteka digjitale për të ruajtur dhe prezantuar trashëgimin tonë historike, shoqërore e kulturore.

Përfundim

Bibliotekat digjitale u zhvilluan si rezultat i evoluimit të formateve në të cilat prezantohet tradita, kultura, historia, trashëgimia intelektuale, kreativiteti i njerëzimit. Ato, me një fjalë, vazhdojnë traditën e bibliotekave tradicionale të cilat merreshin me mbledhjen, organizimin, shërbimin dhe ruajtjen e materialeve të prekshme, por tash të një mediumi të ri. Nga vet përkufizimi i tyre, bib-

liotekat digjitale mund të thuhet që kanë po të njëjtin vizion, mision e aspirata që kishin e vazhdojnë të kenë bibliotekat tradicionale, përveç tjerash, ruajtjes së dokumenteve digjitale për brezat e ardhshëm – ruajtjen e kujtesës së një qytetërimi.

Më herët pamë se natyra e dokumenteve digjitale është mjaftë e ndryshme, kemi formate të ndryshme për prezantimin e tyre, formate për tekste, për fotografi, për zëra, etj., por se ato ruhen në kompjuter në bit dhe kuptohen nga kompjuteri duke kryer funksione matematikore. Kjo ka bërë edhe zhvillimin e hovshëm të programeve të ndryshme për të bërë të mundur gjetjen sa më të lehtë të informacioneve. Një zhvillim i suksesshëm është arritur në të kuptuarit dhe manipulimin e dokumenteve digjitale në formë teksti nga kompjuterit. Janë paraqitur tri nivele të bërjes së një dokumenti, si në Fig. 1 me veprën Gjenerali i Ushtrisë së Vdekur, pjesë të bibliotekës digjitale, 1) vetë informacioni, 2) metadatat për përshkrimin e tij, dhe 3) taksonomia apo fjalori i kontrolluar, të cilët ndihmojnë në standardizimin e terminologjisë apo përcaktueseve për përshkrimin e një informacion të të njëjtit zhanër. Megjithatë, mbetet shumë për t'u bërë sa i përket gjetjes së metodave për lehtësimin, dhe kërkimeve më efikase në gjetjen e dokumenteve digjitale në formate të tjera, si fotografitë, pamjet, incizimet zanore, video, etj. Shpesh kemi dëgjuar gjatë bisedave me profesorë e bibliotekarë se a nuk do të ishte mirë që në rast të kërkimit të ndonjë pjesë muzikore në audio, vetëm të luajmë në testuar një varg notash, dhe kompjuteri t'i kuptojë, interpretoj dhe gjejë për ne pjesën muzikore të dëshiruar apo të ngjashme me to?

Një aspekt tjetër që u shtjellua këtu është edhe teknologjia apo programet kompjuterike falas në internet, të cilat ofrojnë shërbime të menaxhimit, organizimit dhe ruajtjes së dokumenteve digjitale, si dhe mjeteve të tjera për kërkimin e atyre dokumenteve dhe prezantimin e tyre në ekranin e kompjuterit për përdoruesit e bibliotekës. Me qëllim u dhanë disa informacion për programet, si Greenstone, DSpace, Fedora, pasi janë programe të avancuara, shpesh të financuara nga qeveri të ndryshme, e po ashtu edhe nga organizata mbarëbotërore, siç është rasti me Greenstone, që u zhvillua dhe vazhdon të financohet nga UNESCO. Një arsye tjetër pse këto programe falas ishin pjesë e temës sonë, dhe jo ndonjë program komercial, është se mendojmë që ato paraqesin një mundësi të mirë të përvetësimit të tyre në ndonjë projekt të bibliotekave tona për krijimin e një biblioteke digjitale, duke marrë parasysh edhe aspektin ekonomik me të cilin ballafaqohen institucionet tona. Programet komerciale nga njëra anë, kushtojnë për t'u blerë në fillim, nuk mund të modifikohen deri në nivel ndoshta të kënaqshëm për rastin tonë, e po ashtu bartin edhe koston e mirëmbajtjes, të licencave, etj., e nga ana tjetër, ndihma e kompanisë e cila e ka zhvilluar atë program është gjithmonë e pranishme për funksionim të mirë dhe mirëmbajtje të programit, me një fjalë, ke kujt t'i drejtohesh në rast të nevojës për ndihmë. Kjo nuk do të thotë se në programet falas qëndrojnë më larg nga ky aspekt. Por në këtë rast, ekipi për mirëmbajtjen e programit duhet të krijohet në vet institucionin. Ka raste kur shumica e kompanive të cilat i kanë zhvilluar këto programe ofrojnë edhe shërbimin e mirëmbajtjes, natyrisht me kosto. Mirëpo beneficioni i vërtet i programeve falas është se nuk bartin ndonjë kosto të blerjes në fillim – pra mund të shkarkohen falas nga interneti, mund të modifikohen në tërësi për t'iu përshtatur nevojave të një biblioteke të veçantë, kryejnë funksionet e njëjta si programet komerciale, janë të testuara dhe të përdorura nga biblioteka me emër, siç pamë nga shembujt e mëhershëm, nuk ka kufizime sa i përket licencave, etj. Ato janë atje në pritje të shfrytëzimit nga bashkësia jonë për të bërë të mundur ruajtjen e qindra e mijëra informacioneve të krijuara në vendet tona përmes kompjuterit, si dhe qindra e mijëra informacioneve që presin intervenimin tonë për ruajtjen e tyre, si rasti me gazetat, e revistat të cilat kanë filluar të zbehen, shkrimi në to të venitet e pothuaj në disa raste edhe është bërë i palexueshëm, për shkak të cilësisë së ulët të letrës në të cilin janë shtypur e nganjëherë edhe për shkak të kushteve jo të mira për ruajtjen e tyre. Një prej formave të ruajtjes së tyre, por jo e vetme natyrisht, mund të jetë digjitalizimi i tyre dhe eventualisht vënia e tyre në një bibliotekë digjitale e cila do të ruaj me fanatizëm kujtesën shpeshherë të harruar të këtij kombi, si dhe me krenari do ta prezantojë atë të audienca mbarëbotërore e interesuar për të.

Në këtë aspekt, projektet si *Kujtesa Amerikane, Gallica*, e të tjera, me të vërtetë mund të shërbejnë si shembuj konkret për krijimin dhe zhvillimin e bibliotekave digjitale në vendet tona. Kjo formë e re, ky koncept i ri i paraqitjes së kulturës së një kombi dhe ruajtjes së saj paraqet evoluimin më të ri të bibliotekave pa e ndërprerë veprimtarinë tradicionale të bibliotekave por duke e shtyrë atë më përpara, duke e avancuar atë më shumë, dhe duke i vënë bibliotekat në vazhdimësi në ballë të mbledhjes, organizimit, ruajtje së *Kujtesës* së njerëzimit pa marrë parasysh formën të cilën e merr, e në rastin tonë ruajtjes së *Kujtesës shqiptare*.

Referenca

Brown, Mary E. (2005). History and definition of digital libraries. Vizituar më 13 nëntor 2007, në: http://www.southernct.edu/~brownm/dl_history.html.

Buckland, Michael. (1998). What is a "digjital dokument"? Vizituar në internet më 15 nëntor 2007, në: http://people.ischool.berkeley.edu/~buckland/digdoc.html.

Candela, Leonardo et al. (2007). Setting the foundations of digjital libraries: the DELOS manifesto. *D-Lib Magazine, 13* (3/4). Artikulli mund të gjendet në: http://www.dlib.org/dlib/march07/castelli/03castelli.html.

Digital Library Federation. (1998). A working definition of digital library [1998]. Digital Library Information. Vizituar në internet më 1 nëntor 2007, në: http://diglib.org/about/dldefinition.htm.

DSpace. (s.a.). FAQ. Vizituar në internet më 14 nëntor 2007, në: http://www.dspace.org/index.php?option=com_content&task=blogcategory&id=40&Itemid=88.

Fedora Commons. (s.a.). About Fedora Commons. Vizituar në internet më 14 nëntor 2007, në: http://www.fedora-commons.org/index.php.

Gallica, bibliothèque numérique de la Bibliothèque nationale de France. (s.a.). Gallica. Vizituar në internet më 17 nëntor 2007, në: http://gallica.bnf.fr/.

Hart, Michael. (1992). Gutenberg:The History and Philosophy of Project Gutenberg. Vizituar më 13 nëntor 2007, në: http://www.gutenberg.org/wiki/Gutenberg:The_History_and_Philosophy_of_Project_Gutenberg_by_Michael_Hart.

Harter, Stephen P. (1997). Scholarly communication and the digital library: problems and issues. *Journal of Digital Information, 1* (1). Artikulli mund të gjendet në: http://journals.tdl.org/jodi.

Lesk, Michael. (2005). Understanding digital libraries (2nd ed.). Amesterdam: Elsevier.

National Library of Finland. (2007). Doria. Vizituar në internet më 14 nëntor 2007, në: https://oa.doria.fi/.

New Zealand Digital Library Project. (2007). Greenstone digital library software: (Factsheet). Vizituar në internet më 16 nëntor 2007, në: http://www.greenstone.org/factsheet.

Oxford Digital Library. Vizituar në internet më 14 nëntor 2007, në: http://www2.odl.ox.ac.uk/gsdl/cgi-bin/library/.

Savage, Anne. (c1998-2006). The alphabet in binary code. Tekmom. Vizituar në internet më 1 nëntor 2007, në: http://www.tekmom.com/buzzwords/binaryalphabet.html.

The University of Chicago Library/Digital Activities & Collections. Vizituar në internet më 14 nëntor 2007, në: http://chopin.lib.uchicago.edu/.

UNESCO. (2007). News: the Director-General attends the presentation of a vision for a World Digital Library. Vizituar në internet më 17 nëntor 2007, në: http://portal.unesco.org/ci/en/ev.php-URL_ID=25547&URL_DO=DO_TOPIC&URL_SECTION=201.html.

Wikipedia. (2007). Digital library. Vizituar në internet më 14 nëntor 2007, në: http://en.wikipedia.org/wiki/Digital_library.

Wikipedia. (2007). Library. Vizituar në internet më 23 tetor 2007, në: http://en.wikipedia.org/wiki/Library.

World Digital Library. (2007). World Digital Library. Vizituar në internet më 14 nëntor 2007, në: www.worlddigitallibrary.org.

KONFERENCA KOMBËTARE E BIBLIOTEKONOMISË • 2 119 :·

KRIJIMI I SISTEMIT TË PËRBASHKËT TË INFORMACIONIT PËR VLERAT KOMBËTARE, DUKE SHKUAR DREJT UNIFIKIMIT TË KATALOGIMIT

Marjeta DACI
Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë

Ne shqiptarët do të integrohemi brenda vetes, duke krijuar sistemin e ri të përbashkët të vlerave, duke krijuar standardet unike gjuhësore, kulturore. Ky proces po zhvillohet dhe askush nuk mund ta ndalë, kjo është pjesë e etnohistorisë, etnografisë, etnopsikologjisë sonë, identitetit tonë, veçorive tona shqiptare. Ne bibliotekarët jemi të ndjeshëm ndaj ndryshimeve, kuptojmë ç'do të thonë ato për institucionet tona, pra nuk i shpëtojmë presionit për ndryshim. Rrethanat e reja politiko-shoqërore, zhvillimet pozitive drejt pavarësisë së Kosovës na çojnë ne, bibliotekarët shqiptarë, në vizionin frymëzues: krijimin e Katalogut të Përbashkët.

Gjithçka që do të shtjelloj më poshtë i shërben kësaj strategjie kombëtare. Ka një vit që përdoruesit i është ofruar shërbimi më i rëndësishëm, ai i kërkimit të

informacionit online. Në këtë mënyrë çdokush që ka një lidhje INTERNETI mund të kërkojë drejtpërdrejt nga kompjuteri i tij materialin e dëshiruar dhe të zgjedhë atë që kërkon.

Dalja e bazës sonë të të dhënave në INTERNET na vë ne kataloguesve para përgjegjësive profesionale; tani jemi të hapur para gjithë përdoruesve, kolegëve, të cilët na qortojnë për mënyrën se si i përdorim standardet apo na përgëzojnë. Baza e të dhënave që mirëmban sektori ynë (libër, teza, materiale audio-vizuale, harta, hyrje në BKSh nga viti 1995 e në vijim) ka 37.000 regjistrime bibliografike.

Sektori i katalogimit ka 4 vjet, që krahas punës së përditshme, identifikon, ndreq ndonjë parregullsi, duke ndjekur ecurinë e standardeve. Kjo është e suksesshme, kur bëhet nga profesionistët, nga bibliografët dhe klasifikatorët me nivel. Mund të themi, se kemi bërë më të mirën e mundshme. Arritëm të unifikojmë emrat e autorëve, t'i unifikojmë ata me "Person name" dhe me biografinë (929) në KDU. Për të pasur lehtësi përdoruesi me autorët e huaj, që sipas standardit regjistrohen në origjinal, përdoret dhe versioni ekuivalent, si shqiptohet, që na i mundëson dhe programi. Pjesë e kësaj pune korrigjuese ka qenë dhe unifikimi i termave gjeografikë, redaktimi në indeksin e kodeve të klasifikimit (Athority class number) për klasat: 1(filozofi), 2 (fe), 39 (etnologji), 7 (arte), 8 (filologji), 9 (gjeografi, histori). Kemi filluar të punojmë për njësimin e Shtëpive Botuese dhe si synim mbeten edhe Seritë e botimit. Pra, nga sa thamë, ka shumë punë për të arritur një regjistrim bibliografik sa më të saktë në skedarët e termave të njësuar për emra personash, emra gjeografikë, subjekte dhe numra klasifikimi.

Ç'do të thotë për institucionet tona: *Krijimi i një katalogu të përbashkët.* Do të thotë të *përdorim* bashkërisht katalogimet e koleksioneve dhe të *shkëmbejmë* të dhënat nga një sistem në një tjetër, pra ta krijojmë dhe ta mirëmbajmë bashkërisht këtë katalog. Nga kjo bazë të dhënash përdoruesi mund të kryejë kërkime për qëllime studimi, referimi dhe gjetje materialesh. Që të realizohet ky burim i përbashkët shqiptar, ky hambar shqiptar, është domosdoshmëri katalogimi sipas standardeve. Pa standardet ndërkombëtare si: AACR2 (Anglo-American Catalogue Rules 2); ISBD (International Standard Bibliographic Description); KDU (Universal Decimal Classification) nuk mund të kemi qasje dhe shkëmbim informacioni bibliotekar.

Të ngremë disa probleme konkrete, duke përqasur katalogun e Bibliotekës Kombëtare të Tiranës dhe atë të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës në linjën e klasifikimit sipas subjektit. Është rastësi shumë e mirë që të dy bibliotekat përdorin të njëjtin sistem klasifikimi, atë dhjetor universal. Skema e KDU-së është në zhvillim të vazhdueshëm, në çdo klasë ka shtime numrash si dhe riformulime të terminologjisë, për t'u përshtatur me zhvillimet aktuale në të gjitha fushat. Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë është kujdesur vazhdimisht për t'u njohur në kohë me këto zhvillime, pasi kjo mundëson komunikimin me bibliotekat e tjera. Kështu në vitin 2000 u pasqyruan ndryshimet e mëdha në përcaktuesit e gjuhës, në vitin 2003 u zbatuan ndryshimet në klasën 9 (arkeologji, studime sociale, gjeografi, histori), ku mori përparësi përdorimi i kllapave, kalimi i programeve të kompjuterit nga klasa 681.3 ne një numër të ri, 004 dhe së fundi, ndryshimet e tabelës të vitit 2006. Do të dalloja ndryshimet që bëhen në këtë të fundit në klasën 2 (feja), 396 (feminizmi), që është zëvendësuar me numrin 305 (studime gjinore), 37 (arsimi), 502/504 (shkenca e mjedisit), probleme të menaxhimit në numrin e ri 005 etj.

Po marrim një shembull: Historia e Shqipërisë para vitit 2000 pasqyrohej 949.65, tani po kjo përmbajtje pasqyrohet 94(496.5) (klasës 94 i shtohet në kllapa gjeografiku i Shqipërisë). Po kështu, studimet sociale nga 908.496.5 ka marrë formën 908(496.5). Po nuk ndoqëm këtë zhvillim të KDU-së, ne nuk mund të grupojmë dhe të shkëmbejmë informacionin në mënyrë të plotë; kemi të njëjtën përmbajtje të paraqitur në dy mënyra, gjë që çon në dublimin e regjistrimit dhe që duhet shmangur. Apo kemi raste kur përdorim metodikë të ndryshme të kombinimit të numrave kryesorë me përcaktuesit si për shembull: historia e gjuhës shqipe në formën 811.18-112 dhe 811.18 (091); letërsia arbëreshe në formën 821.18'282.4(450)-1 dhe 821.18'282.4-1(=18:450). Për të pasur unifikim në metodikën e renditjes duhet t'i referohemi udhëzimeve të tabelave të klasifikimit. Për këto probleme të përbashkëta është mundësia të kemi zgjidhje sa më të shpejta, përmes komunikimit të vazhdueshëm, trajnimeve cilësore, dhe rritjes së ndjenjës së përgjegjësisë në hartimin e regjistrimeve bibliografike.

Ka dhe hapësira *për marrëveshje,* si për shembull, kur pasqyrojmë problemet e ndryshme të shqiptarëve të Kosovës, në Jugosllavi ne, sipas standardeve, përdorim këtë metodikë : etnologjinë – 39(=18:497.115); çështjen nacionale –323.1(=18:497.115); arsimin –37(=18:497.115) e kështu me radhë. Tani që Kosova po shkon drejt pavarësisë dhe do të marrë përcaktuesin e saj gjeografik si Maqedonia (497.7), Bosnja (497.6) etj. ne mund të përdorim thjesht Lëndë me Gjeografik, pa etninë.

Për detajimin e historisë së Shqipërisë ne përdorim disa përcaktues të formuluar në bashkëpunim me specialistë të Institutit të Historisë për përcaktimin e periudhave historike, duke shmangur përdorimin e përcaktuesve të kohës. Po radhisim poshtë disa periudha historike si shprehen në KDU dhe në klasifikimin lëndor:

94(496.5).011.1Etnogjeneza
94(496.5).03Principatat feudale shqiptare
94(496.5).05Pushtimi osman
94(496.5).081/.084Rilindja shqiptare, 1844-1912
94(496.5).085.11Konferenca e Ambasadorëve, 1912-1913

Kjo mund të jetë një temë për diskutim, me synimin drejt një metodike unike në klasifikimin e historisë.

Kërkoj të ngacmoj dhe idenë, që klasifikimi dhjetor është gjuhë e rëndësishme komunikimi mes bibliotekave. Regjistrimet bibliografike në çdo vend bëhen në gjuhën përkatëse, e vetmja mundësi lidhjeje është klasifikimi dhjetor, që s'flet me gjuhë por me shifra. Sa rëndësi ka për një studiues që klasifikatori t'ia japë të detajuar tematikën e librit dhe jo në mënyrë të përgjithshme. Po të japim thjesht numrin 811.18 (gjuha shqipe) për një libër që trajton probleme të politikës gjuhësore ('272), apo të gjuhës standarde ('26), apo të etnolinguistikës (811.18:39) ne nuk kemi ndihmuar përdoruesin, studiuesin, i cili nuk njeh gjuhën tonë dhe nuk ka mundësi që të orientohet nga titulli, nga klasifikimi lëndor apo kërkimi në tekst. Klasifikimi i detajuar tregon profesionalizëm dhe në një bibliotekë kombëtare realizohet nga klasifikatorë me formim përkatës sipas shkencave: Filologji, Shkenca Shoqërore, Shkenca Natyrore dhe Teknologji.

Si përfundim, Katalogu i Përbashkët na vë ne para këtyre detyrave:

- Të kontribuojmë me informacion bibliografik, i cili prezanton njësi të kataloguara të koleksioneve tona.
- Të krijojmë regjistrime bibliografike të nivelit më të plotë të mundshëm sipas standardeve ndërkombëtare.
- Të shohim me sy kritik të gjitha elementet e të dhënave bibliografike.
- Të kontribuojmë me regjistrime bibliografike dhe të dhëna të tjera, për të rritur përdorimin e përbashkët të regjistrimeve dhe burimeve bibliografike.

Gjithçka që trajtuam kishte të bënte me standardet bibliografike, por që të realizohet katalogu i përbashkët kërkohet dhe Standardi Teknik. Institucionet tona kanë sektorët përkatës, që kanë nivelin e duhur për t'iu përgjigjur këtij synimi, por sigurisht këto kanë dhe koston financiare.

Integrimi ynë kombëtar kalon edhe përmes bibliotekave tona. Shtysa jonë kombëtare do të na çojë domosdoshmërisht drejt synimit: Të realizojmë Katalogun e Përbashkët.

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË KATALOGUT TË PËRBASHKËT TË BIBLIOTEKAVE NË KOSOVË

Bukurije HALITI
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, atëherë Biblioteka Popullore e Kosovës, ka bërë një provë të pasuksesshme, për herë të parë, për digjitalizimin e njësive bibliografike në vitet '80-ta - projekti COBISS, që do t'i paraprinte sistemit të ardhshëm të integrimit të informacionit bibliografik. E gjithë përpjekja e viteve '80-ta, të gjitha ato njësi të përpunuara, e gjithë ajo bazë e të dhënave, ka humbur.

Biblioteka, pastaj nga viti 1999 deri në vitin 2003, përpos përgatitjes dhe pasurimit të katalogut manual, nëpërmjet skedave, i ka futur të njëjtat të dhëna, nëpërmjet një shablloni të ndërtuar nga stafi, në Word.

Nga viti 2004 - Ex-Libris, një sistem i integruar bibliotekar, përkatësisht produkti i saj Aleph 500, u integrua edhe në BKUK. Ecja me një ritëm të kënaqshëm e futjes, përpunimit dhe menaxhimit të njësive bibliotekare nëpër-

mjet këtij programi, hapi ambicien për të bërë përpjekjen e parë - ndoshta modeste, por shumë ambicioze, për të shtrirë rrjetin e këtij programi edhe në bibliotekat kryesore publike - në 7 qendra të Kosovës: Prishtinë, Prizren, Gjakovë, Pejë, Mitrovicë, Gjilan, Ferizaj - një program i avancuar i bibliotekave që ka një shtrirje në mëse 50 shtete të botës, me modulet e veta për Pasurim, Katalogim, Qarkullim, Administrim, Huazim Ndërbibliotekar etj.

Pra, ky program po zgjerohet, pas 3 vitesh implementimi në BKUK dhe përafërsisht 30 000 njësive të përpunuara, me miratimin e dy ministrive: Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Kosovës. Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, për 7 bibliotekat publike ka dhënë falas nga një licencë të këtij Programi - duke qenë në fokus, për fillim, moduli i katalogimit.

Një këshill i zgjedhur nga BKUK-ja, për të marrë informacion dhe për të hartuar projektin e implementimit, ka vizituar 7 bibliotekat publike të Kosovës. Nga këshilli është hartuar një pyetësor që specifikon mënyrën për marrjen e një informacioni të rëndësishëm, për: përpunimin e materialeve, llojet e koleksioneve, pasurimin e fondeve, rrjetin e internetit dhe kushtet e tjera teknike, përgatitjen arsimore të stafit profesional etj., në bazë të të cilit do të nisë zbatimi i këtij projekti.

Mbështetur mbi kriteret profesionale, drejtuesit e bibliotekave publike kanë zgjedhur stafin, që performon më së miri në këtë program dhe që njeh, gjithashtu, mirë specifikat e katalogimit - përkatësisht standardet e përshkrimit bibliografik, i cili do të përcjellë, fillimisht, trajnimet në fushë të katalogimit, në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.

Faza e parë e trajnimit tashmë ka përfunduar, dhe rezultatet e njohurive për përvetësimin themelor të programit: njohuria e moduleve të Aleph-it, janë të kënaqshme. Po ashtu, njohuri të mira janë përfituar në modulin e katalogimit (në këtë dukje të faqes së katalogimit, që dallon nga njësia në skeda manuale): fushat e formatit MARC, roli dhe funksioni i tyre. Stafi ka përfituar njohuri edhe për tipet e koleksioneve, ndarja e njësive në nënbiblioteka, konvertimi i të dhënave bibliografike dhe modifikimi i njësisë sipas nevojave të secilës bibliotekë - performime këto që janë standarde të lëvizjes së një njësie në BKUK.

Kjo qasje jona për të hyrë fillimisht me modulin e katalogimit, ka pasur për synim që në secilën bibliotekë publike - pa degët e tyre, të nisë 'endja' e këtyre të dhënave bibliografike të njësive, duke kursyer kohë për të gjitha bibliotekat, meqë një njësi e përpunuar vetëm mund të konvertohet, pa pasur nevojë të përpunohet nga fillimi.

Përpunimi i koleksioneve do të përcillet sipas politikave që ka pasur BKUK, kur ka filluar t'i fusë njësitë bibliografike në programin Aleph, që të përpunohen koleksionet më aktuale për nga viti i botimit, duke zbritur poshtë nëpër vite - kemi parasysh këtu me prioritet koleksionin në gjuhën shqipe. Kjo do të krijojë lehtësi për bibliotekat publike që do të takojnë në katalogun tonë njësitë e përpunuara. Pra, njësia mjafton të përpunohet njëherë e pastaj nëpërmjet bazës së të dhënave të shpërndahet te të gjithë përdoruesit e programit. Kataloguesit do të mund të bëjnë konvertimin edhe në baza të tjera të të dhënave, siç është baza në Bibliotekën e Kongresit, WorldCat etj., si dhe në bibliotekat e tjera nëpër botë, dhe për këto tashmë kanë marrë informacionin.

Njësitë bibliografike nga baza e të dhënave të BKUK-së tash për tash shpërndahen vetëm brenda departamenteve të BKUK-së dhe në Qendrën e Bibliotekës Universitare (Qendra e Bibliotekës Universitare synon të jete Biblioteka Qendrore e Universitetit të Prishtinës me degët e saja në gjithë qendrat e tjera të Kosovës). Por, tash e tutje, posa të shpërndahet rrjeti dhe të fillojë implementimi i këtij projekti, njësitë bibliografike nga baza e të dhënave të BKUK, do të jenë të hapura për bibliotekat publike, në mënyrë që ato të kenë qasje në marrjen e njësisë bibliografike dhe konvertimin e saj sipas organizimit të koleksionit të bibliotekës publike përkatëse. Pra, njësitë e kataloguara nga BKUK do të 'kopjohen' nga bibliotekat publike dhe me ndonjë ndryshim të mundshëm rreth numrave të inventarit, lokacionit se ku gjenden njësitë e tyre, do të ruhe në bazat lokale të secilës bibliotekë, ndërsa do të përkujdeset personeli i BKUK-së. Kompetencat e intervenimeve do të bëhen drejtpërdrejt nga BKUK (do të krijohet një këshill i gjerë redaktues, i cili do të mbikëqyrë njësitë e kataloguara).

BKUK tash po përgatitë një projekt të specifikuar në detaje, i cili pritet t'u dorëzohet institucioneve qeveritare, për ta përkrahur shtrirjen e këtij rrjeti, me dhënien edhe të licencave të tjera të programit Aleph bibliotekave publike, si dhe dhënien e licencave për bibliotekat e tipave të tjera.

Projekti që tashmë është duke u hartuar, parasheh:
- zgjerimin e rrjetit në bibliotekat me frekuentim të madh të përdoruesve - kemi parasysh këtu - pos bibliotekave publike, edhe bibliotekat e fakulteteve të Universiteti të Prishtinës;
- lidhja e ngushtë e bazave lokale të të dhënave të të gjitha bibliotekave në një katalog të përbashkët;

- aftësimi i bibliotekarëve për një kulturë qasjeje në një katalog të përbashkët – për përpunim dhe kërkim;
- ndjekjen e cilësisë së përpunimit - kontrolli i redaktimit të njësive nga një këshill profesional i kataloguesve;
- shkëmbimi bibliografik i të dhënave i të gjitha bibliotekave që janë në rrjet, për harmonizim të politikave të pasurimit të koleksioneve;
- administrimi i bazës së përbashkët të të dhënave Aleph;
- shkëmbimi i koleksioneve, në bazë të porosisë së përdoruesve nga bibliotekat ku bëhet kërkimi, duke i ofruar në një kohë relativisht të shpejt njësinë e kërkuar nga përdoruesi.

Në krejt këtë projekt se si do të duket nesër - në të ardhmen, ky integrim informacionesh e koleksionesh, mbetet të inkorporohen shumë faktorë institucionalë, bibliotekarë e qeveritar, për të ndihmuar në finalizimin e këtij procesi shumë ambicioz në kushtet tona të infrastrukturës dhe të personelit. Mbesim me shpresë se projekti do të përkrahet nga institucionet qeveritare të Kosovës.

KONVERTIMI RETROSPEKTIV: SFIDA DHE ARRITJE

Mirela MERSINI
Teuta SULA
Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë

Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë ka në pronësi materiale shumë të vjetra të trashëgimisë shkruar; po ashtu shumë të vjetër janë edhe skedarët e saj. Si një ndër institucionet më të rëndësishme të kulturës së librit, ajo bart në koleksionet e veta dokumente bibliotekare nga më të pasurat dhe më me vlerë nga të gjitha fushat e asaj që nënkupton termi *kujtesë kombëtare*, ndaj procesi i konvertimit retrospektiv merr një rëndësi të dorës së parë për të bërë të shfrytëzueshme në mënyrë elektronike informacionin për gjithë këtë pasuri me vlera të shumta.

A. Shfaqja e problemit

Informatizimi i veprimtarisë së Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë (1997-2000), pra i shërbimeve dhe proceseve bibliotekare të saj, padyshim që shënoi një hap të madh e shumë të rëndësishëm për plotësimin si duhet të kërkesave

gjithnjë në rritje të përdoruesve në kushtet e reja të Shoqërisë së Informacionit në të cilën jetojmë.

Një nga frytet më të dukshme të investimeve në teknologjinë e informacionit në bibliotekën tonë ishte edhe sigurimi në vitin 1998 i informacionit bibliografik online që realizohet përmes sistemit të integruar bibliotekar ADLiB, çka mundësoi krijimin e bazës së të dhënave për botimet shqiptare e të huaja.

Por duke qenë se në këtë bazë të dhënash filluan të hidhen, sipas përvojës botërore, vetëm hyrjet e reja u krijua, të themi, një paradoks. Për materialet bibliotekare që hynin në Bibliotekën Kombëtare, tashmë të automatizuar, informacioni bibliografik mundësohej si në formatin elektronik ashtu edhe në atë tradicional manual. Ndërsa informacioni bibliografik për hyrjet e vjetra ekzistonte vetëm në formatin letër. Pra, në skedarin elektronik mungonte informacioni për gjithë atë trashëgimi të shkruar që, në të vërtetë, përbën themelet e kujtesës sonë kombëtare. Me fjalë të tjera, të dhënat bibliografike për pjesën retrospektive të skedarëve nuk ishin të arritshme në mënyrë elektronike nga përdoruesit. Kjo çoi në një pamje të çbalancuar të informacionit për koleksionet bibliotekare.

Sa më shumë regjistrime të lexueshme nga makina futeshin në ADLiB, aq më tepër vëmendja dhe shqetësimi natyrshëm ktheheshin te numri i madh i regjistrimeve të skedarëve që nuk gjendeshin aty. Nuk ishte normale që biblioteka të kishte një pjesë, mbase më të rëndësishmen, të skedarit të pahedhur në katalogun online.

B. Një zgjidhje e pjesshme

Në vitin 1994 ishte instaluar në bibliotekën tonë programi CDS/ISIS dhe kishte filluar katalogimi në të i hyrjeve të reja. Pra, në një farë mënyre, krijimi i skedarit elektronik në Bibliotekën Kombëtare pati nisur qysh me hedhjen e informacionit bibliografik të hyrjeve te reja në bazën e të dhënave të këtij programi. Meqenëse ishin programe kompatibël, pra që mund të merrnin dhe jepnin me njëri-tjetrin informacionet që bartnin, të dhënat e bazës ekzistuese të CDS/ISIS u transferuan në ADLiB. Kështu, gjithë ajo punë e bërë për disa vjet nuk vajti dëm. Por kjo nuk e zgjidhi dot problemin për të cilin po flasim.

Dalja nga kjo gjendje nuk kërkohej thjesht për luks, pra vetëm për të unifikuar infrastrukturën e informacionit bibliografik të koleksioneve. Mbi të gjitha, krijimi i një skedari elektronik tërësor të librit shqip do të krijonte lehtësi dhe komoditet për akces në informacion për përdoruesit, sidomos për ata në moshë të re, të cilët do të kishin mundësi të siguronin informacion bibliografik si manual ashtu edhe elektronik për të gjithë pasurinë librore në gjuhën shqipe të Bibliotekës Kombëtare që nga "Meshari" i Gjon Buzukut deri te hyrja më e fundit.

Nisur nga rëndësia e organizimit të akcesit efikas dhe produktiv të të gjitha burimeve kombëtare të regjistrimeve bibliografike, shqetësimi i drejtorisë dhe i specialistëve që kishin lidhje të drejtpërdrejtë me përpunimin dhe shërbimin e të dhënave bibliografike, çoi në ngritjen e një grupi pune që do të studionte situatën e krijuar dhe do të propozonte zgjidhjen e saj. Pas shumë debatesh, diskutimesh dhe rrahje mendimesh, duke pasur parasysh praktikat botërore, por edhe situatën konkrete në bibliotekën tonë, u arritën konkluzionet e duhura. U hartua një projekt, implementimi i të cilit solli krijimin e një sektori të ri në strukturën e institucionit, Sektori i katalogimit retrospektiv elektronik.

C. Zgjidhja: konvertimi retrospektiv

Konvertimi retrospektiv (ose retrokonvertimi) është procesi me anë të të cilit regjistrimet bibliografike ekzistuese në skedë apo libër konvertohen në regjistrime të kompjuterizuara dhe integrohen në bazën e të dhënave elektronike, e cila është zemra e shërbimeve të çdo biblioteke. Thënë ndryshe, retrokonvertimi është procesi i shndërrimit të informacionit bibliografik për dokumentet e vjetra bibliotekare, që kanë hyrë në koleksionet e një biblioteke para fillimit të katalogimit të kompjuterizuar, në format elektronik. Kjo nënkupton që skedari elektronik duhet mbushur me informacion, pra të kalohen të dhënat nga skedat prej letre në bazën elektronike, por me kusht që regjistrimet e konvertuara të plotësojnë standarde bibliografike të një niveli që të sigurojë akces dhe shkëmbim të dhënash midis siteve apo sistemeve të ndryshme, pra të realizohet paraqitja e skedës në Internet.

Në skedarin e kompjuterizuar informacioni për një njësi bibliotekare

të dhënë paraqitet sipas një formati standard të njohur me emrin MARC (MAchine Readable Cataloging), i cili nuk është gjë tjetër, pra, veçse pamje e standardizuar dhe mënyrë paraqitjeje e të dhënave që përbëjnë përshkrimin e plotë të një njësie në një sistem katalogimi.

Tashmë është provuar se bazat e të dhënave bibliografike ose skedarët e konvertuar në formë të lexueshme nga makina janë më të avancuar nga skedarët tradicionalë për shkak të fuqisë së teknologjive të informacionit që përdoret për krijimin dhe vijimësinë e punës së tyre për depozitimin dhe përpunimin e të dhënave bibliografike si dhe të mundësisë së komunikimit në rrjet.

Në procesin e konvertimit retrospektiv ka rëndësi:

I. mënyra e konvertimit që do të zgjidhet për t'u aplikuar,
II. gjendja fizike dhe infrastruktura e skedarëve, informacioni i të cilëve do të konvertohet,
III. metodologjia që do të ndiqet,
IV. stafi.

I. Mënyra e konvertimit që do të zgjidhet për t'u aplikuar

Ka disa mënyra retrokonvertimi:

1. *Me skanim*

a) I thjeshtë - Skedat ose faqet e bibliografive të shtypura skanohen dhe ruhen në formën e imazhit grafik. Në këtë lloj konvertimi informacioni kalon pa ndryshime nga skeda letër në atë në format elektronik, madje nuk është e mundur të korrigjohen as gabimet drejtshkrimore të saj. Ky retrokonvertim është më pak i kushtueshëm, por me mundësi minimale kërkimi. Kjo mënyrë do të përdoret për konvertimin e skedarëve alfabetik dhe sistematik të fondit antikuar të bibliotekës sonë.

b) I plotë - materiali i skanuar përpunohet (transkriptohet imazhi digjital në një format teksti) dhe futet në bazën e të dhënave (pra, formati tekst konvertohet në format MARC).

2. Me programe kompjuterike.

Kjo nënkupton përdorimin e informacionit të skedarit ekzistues për të krijuar regjistrime të lexueshme nga makina. Në këtë mënyrë përmirësohet akcesi në informacionin bibliografik dhe përdoruesve u krijohet mundësia që edhe pjesën e vjetër të koleksioneve ta kërkojnë në skedarin elektronik nëpërmjet disa pika akcesi si autor, titull, fjalë kyçe etj..

II. Gjendja fizike dhe infrastruktura e skedarëve që do të konvertohen

Skedarët janë çelësi i koleksioneve të çdo biblioteke, ndaj duhen vlerësuar dhe administruar me kujdes. Vlera e skedarëve manualë ka qenë dhe mbetet edhe sot e padiskutueshme, por duhet pranuar që ato kanë një sërë të metash:

- akcesohen vetëm brenda bibliotekës,
- numri i përdoruesve që mund të kenë akces në to njëherazi është i kufizuar,
- skedat konsumohen, dëmtohen dhe humbasin,
- etj.

Këto të meta shmangen në rastin e skedave elektronike, ndaj skedarët ekzistues manualë konvertohen, çka siguron kërkim në shumë fusha dhe nënfusha, më shumë mundësi kërkimi dhe në kohë më të shkurtër se në skedarët tradicionalë.

Ka programe që bëjnë konvertim automatik të skedave, çka nënkupton skeda me standarde përshkrimi dhe grafi uniforme, çka është gati e pamundur për biblioteka të vjetra dhe të pasura. Në kushtet e një skedari universal me skeda llojesh të ndryshme – të dorëshkruara, të shtypura me makinë shkrimi apo të radhitura dhe të printuara nga kompjuteri – në Bibliotekën Kombëtare po përdoret një metodë tjetër konvertimi: regjistrimi i skedave një për një në modulin e katalogimit të ADLiB-it.

III. Metodologjia që do të ndiqet (ose etapat):

a) përcaktimi i detyrës (formulohet qëllimi i retrokonvertimit - shndërrimi i informacionit bibliografik të skedave manuale të një pjese të caktuar të koleksionit në format elektronik).

b) detajimi dhe saktësimi i saj:

- Çfarë kemi në koleksionet tona (vlera dhe rëndësia e tyre, vjetërsia, gjuhët etj.)
- Analizë dhe vlerësim i tërësisë së skedarëve manualë (sasia dhe nomenklatura e skedave).
- Cila është gjendja e skedarëve që do të konvertohen:

< karakteristikat bibliografike: cilësia, rregullshmëria, vijueshmëria apo njëtrajtësia, plotësia si e të dhënave të përshkrimit ashtu edhe e pikave të akcesit;

< karakteristikat fizike, p. sh. lexueshmëria, prania e skedave të dorëshkruara, gjendja fizike e skedave dhe elemente të tjera që ndikojnë në procesin e konvertimit;

< forma alternative, p.sh. a ka regjistrime të disponueshme në formë të lexueshme nga makina ose të shtypura në bibliografinë kombëtare.

Ky studim ndihmon në saktësimin e përcaktimit të detyrës së retrokonvertimit dhe nga rezultatet e tij varet zgjedhja e mënyrës dhe teknologjisë që do të përdoret, po ashtu përcaktohet radha e përpunimit të skedarëve manualë.

c) përcaktimi i teknologjisë që do të përdoret

d) realizimi i konvertimit dhe futja e të dhënave në skedarin elektronik online. Integrimi i fletëve të modulit të katalogimit në të. Këtu u duhet dhënë përgjigje pyetjes: A do të zbatohet në skedarin e ardhshëm të konvertuar pak a shumë tërësia e kritereve të përdorura për skedarët ekzistues, veçanërisht ato që lidhen me pjesën e përshkrimit, pikat e akcesit etj. apo do të kemi kritere shtesë?

IV. Për të siguruar një konvertim cilësor lypset që stafi i ngarkuar:
- të ketë njohuri mbi standardet ndërkombëtare ISBD dhe AACR2;
- të kryejë transliterime;
- të dallojë, kuptojë dhe interpretojë të dhënat për çdo fushë të skedës;
- t'u kushtojë vëmendje të gjitha detajeve në skeda;
- të bëjë kontrollin përfundimtar të çdo të dhëne (redaktimin).

D. Projekti i konvertimit elektronik të skedarit të librit shqip

Biblioteka Kombëtare ka në qendër të vëmendjes ruajtjen dhe shërbimin e burimeve të informacionit bibliografik kombëtar të skedarëve të saj si vlerë e jashtëzakonshme për akces në materiale që flasin për historinë dhe kulturën e vendit si dhe sigurimin e mundësive për shfrytëzim të gjithanshëm të tyre përmes hyrjes operative në rrjet (vepruese, aktive).

Por duke qenë se konvertimi i të gjithë skedarëve të bibliotekës sonë kërkon kohë dhe mjete financiare, u pa e udhës të procedohet me faza duke i dhënë përparësi konvertimit të informacionit bibliografik hyrjeve të vjetra të pasqyruara në skedarin alfabetik të librit shqip, pjesa më vitale e trashëgimisë së shkruar dhe që është gjithashtu seksioni më i përdorshëm i skedarëve tanë.

Një përvojë të retrokonvertimit brenda bibliotekës e kishim në sprovën e sektorit të albanologjisë për konvertimin e skedarit të librit të huaj AL në të njëjtin modul katalogimi të sistemit ADLiB. Por me projektin që po implementon sektori ynë fillon konvertimi në shkallë të gjerë i skedarit të përgjithshëm të koleksionit universal të Bibliotekës Kombëtare. Ai është hartuar duke pasur parasysh tërësinë e skedarëve si "skema" më e plotë e koleksioneve të saj, po ashtu edhe historinë dhe gjendjen e çdo skedari (llojet e koleksioneve që pasqyrohen, standardet e përdorura në kohë të ndryshme etj.). Nisur nga sa thamë më sipër, pas analizash dhe shqyrtimesh të përgjegjshme, u konkludua të fillohej me punën për plotësimin e skedarit elektronik të librit shqip.

Objektivi i konvertimit të skedarit alfabetik manual të koleksioneve të librit shqip është hedhja e regjistrimeve të skedave të tij në bazën e strukturuar të të dhënave në formatin UNIMARC dhe bërja e tyre gjerësisht të disponueshme për përdoruesit. Automatizimi i Bibliotekës Kombëtare (sistemi i integruar bibliotekar dhe disponimi në faqen e saj të Internetit i skedarit elektronik) mundëson që informacioni bibliografik i koleksioneve të vlerave që ajo bart të shfrytëzohet edhe përtej mureve të saj brenda dhe jashtë vendit.

Procesi i konvertimit ka të bëjë me kalimin e të dhënave të skedës letër në fletën e punës së modulit të katalogimit, çka kërkon që të njihen mirë standardet e sotme të përshkrimit bibliografik dhe ato të klasifikimit, pra që punonjësit e ngarkuar me këtë detyrë të kenë nivelin profesional të bibliografit dhe klasifikatorit.

Çdo regjistrim bibliografik përmban dy lloje kryesore informacioni:
- së pari, të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e njësisë në tërësinë e skedarit,
- së dyti, të paktën një pikë akcesi (hyrjeje) si element kërkimi-emrat e autorëve, titujt e veprave, termat e subjektit etj.

Fleta e punës për plotësimin e të dhënave është formuluar sipas rregullave të standardeve ndërkombëtare të përshkrimit bibliografik (ISDB) dhe rregullave anglo-amerikane të katalogimit (AACR2), të cilat në vitin 1989 u vunë në zbatim edhe në Shqipëri.

Duke qenë se në kohë të ndryshme janë zbatuar rregulla të ndryshme të përshkrimit bibliografik hedhja e elementeve të përshkrimit në modulin e katalogimit kërkon vëmendje dhe aftësi interpretimi. Përmbledhurazi, mënyra apo metoda që përdoret për konvertimin e regjistrimeve në formatin UNIMARC është kjo:

• Regjistruesi apo bibliografi ka mbi tryezë skedën letër, ndërsa në ekran shfaqet fleta e të dhënave të modulit të katalogimit të sistemit ADLiB që duhet plotësuar.
• Numri i të dhënave që gjenden në skedat manuale nuk është i njëjtë me numrin e të dhënave të fletës së punës:

a) Në shumicën e skedave manuale mungojnë të dhëna që kërkohen nga fleta e punës, e cila u referohet rregullave të sotme të përshkrimit bibliografik. p. sh. dimensionet, ISBN dhe materiale shoqëruese.

b) Në raste të tjera ka ndryshime në elementet e të dhënave nga skeda në fletën e punës, p. sh. deri në vitin 1989 në skedë hidheshin gjer në 3 autorë, sot sipas rregullave të standardit të ISBD-së mund të hidhen edhe në skedën manuale edhe në atë elektronike gjer në 7 autorë.

• Interpretohen dhe përcaktohen elementet e skedës dhe hidhen ato në fletën e të dhënave në përputhje me rregullat e përshkrimit bibliografik.
• Të dhënat e çdo skede elektronike kontrollohen dhe redaktohen deri sa të vijnë në një formë korrekte. Në raste të paqarta (përmbajtja e skedës është e vështirë për t'u interpretuar, ka shkronja të palexueshme etj.) korrigjimi

bëhet duke konsultuar mendimin e kolegëve bibliografë dhe klasifikatorë me përvojë të sektorëve të tjerë.

Në procesin e konvertimit regjistruesi-bibliograf njeh dhe zbaton:

- formate të dhënash të njësuara (ISBD, AACR2) dhe konkretisht elemente që u përkasin grupeve të të dhënave të përshkrimit,
- tabelat e transliterimit të alfabeteve jolatine,
- rregullat e regjistrimit në mënyrë uniforme në formatin UNIMARC.

Në lidhje me detyrën e klasifikatorit, duhet thënë se po ashtu, për shkak të sistemeve të ndryshme të klasifikimit që janë zbatuar në vite të ndryshme apo të ndryshimeve në to, në një shumicë skedash hasen klasifikime të vjetruara (shpesh disa të tilla në një skedë). Kjo shmanget duke hedhur në zonën përkatëse të fletës së punës të modulit të katalogimit klasifikimin korrent (të saktë) sipas KDU-së.

Në 2 dy skedat e para klasifikimi është sipas sistemeve të vjetra (para aplikimit të KDU-së) ndaj për secilin libër bëhet riklasifikim. Skeda e 3-të vërtetë është klasifikuar sipas KDU, por ka një problem: në vitin 1981 gjuha ka qenë përfshirë në ndarjen 4 të tabelës, sot ka kaluar në atë 8. Edhe kjo saktësohet.







Në procesin e konvertimit klasifikatori:

- kontrollon të dhënat e hedhura nga regjistruesi ose bibliografi në fletën e punës së modulit të katalogimit dhe bën korrigjimet e nevojshme
- interpreton apo zbërthen sistemet e vjetra të klasifikimit
- pasi gjykon të dhënat e hedhura në fletën e punës plotëson, siç thamë pak më lart, zonën e klasifikimit dhjetor universal, tashmë të konvertuar
- plotëson në fletën e punës zonën e termave lëndorë sipas skedarit të termave të njësuar.

Rezultat i këtyre procedurave është krijimi i rekordeve të njësuara në ADLiB për hyrjet e vjetra të librit shqip, të cilat hidhen në bazën e të dhënave, pra u shtohen rekordeve të hyrjeve të reja, për të qenë të kërkueshme në OPAC-un e BKSh-së.

Në dy skedat e para kemi titullin në kllapa katrore. Në monografitë mbi abetaret gjejmë se me atë vit dhe vend botimi, me atë shtypshkronjë dhe numër faqesh ka një abetare edhe Kristoforidhi. Shkuam te shkronja K e skedarit dhe gjetëm dy skedat e tjera: e para, përshkrim i një fotorapidi me titull të patransliteruar, e dyta rezulton me informacionin më të saktë. Ka diçka interesante ky botim: fleta e titullit nuk është në krye të librit, ose, më mirë të themi, ai nuk ka fletë titulli. Elementete përshkrimit bibliografik janë të shpërndara: f. 3 (vendi dhe viti i bot. dhe shtypshkronja) dhe f. 4 (titulli dhe autori).











Fleta e punës e plotësuar



Informacioni bibliografik në OPAC



Siç shihet, konvertimi retrospektiv nuk është thjeshtë një punë mekanike përderisa të dhënat dhe simbolet e skedave të skedarëve të vjetër duhet të interpretohen sipas rregullave të katalogimit modern (përshkrim dhe klasifikim). Prandaj në teoritë e sotme të bibliotekonomisë nënvizohet se ky proces faktikisht nënkupton "konvertimin intelektual".

Nga ana tjetër, konvertimi retrospektiv si proces rikatalogimi (ripërshkrim dhe riklasifikim) është me mjaft rëndësi për një funksionim dinamik të skedarëve të bibliotekës, si komponent i procesit të rëndësishëm të redaktimit të tyre. Pra, nuk kemi të bëjmë me një hedhje e thjeshtë të dhënash, por me një interpretim të hollësishëm të tyre, i cili kalon në kufijtë e atij që quhet *redaktim skedari*, duke sinjalizuar edhe sektorët përkatës për probleme që lidhen me to.

Për të krijuar një pamje të punës që kryhet në sektorin tonë po japim shkurtazi disa nga problemet që dalin në procesin e konvertimit:

- mungesa e të dhënave të ndryshme në skeda, si p. sh. autor, vt, vd, ent botues, nr. faqesh etj.

Siç shihet, shembujt i kemi marrë kryesisht nga botime të abetareve. Kjo ka të bëjë me faktin që jemi në hapat e parë të punës, pra jemi ende te shkronja A e skedarit alfabetik, por edhe me faktin që abetaret janë pjesë e rëndësishme e trashëgimisë së shkrar kombëtare. Këtu kemi dy skeda bazë të të njëjtit botim, por që sigurisht kanë hyrë në bibliotekën tonë në kohë të ndryshme. Skeda 1 nuk ka vend dhe vit botimi, ndërsa skeda 2 ka vitin e botimit [1907] sipas bibliografit, po ashtu vendin e botimit Shkodër që edhe kjo duhej të ishte në [....]. Këtu regjistruesi u drejtohet për konsultim materialeve të ndryshme dhe fatmirësisht për abetaret ka të paktën dy monografi të dobishme për punën tonë (K. Bevapi dhe Sh. Osmani e Nj. Kazazi). Te të dyja këto botime konkludohet se kemi Shkodër dhe 1907, të cilët i hedhim në fl. p. në [...].





Tre skeda

Skeda 1 nuk ka autor. Kemi gjetur që janë A. Xhuvani dhe P. Pogoni nga ribotimi i kësaj abetareje më 1931.Në skedën 2 autori me iniciale SH. D. Në skedën 3 po ashtu, por shtohet e dhëna - Shtypshkronja Elbasan. Sipas të dy monografive autori është Shefqet Daiu.







- në mjaft raste për të njëjtin titull ka më tepër se një skedë bazë (çka shpjegohet me hyrjen e kopjeve të tij në bibliotekë në vite të ndryshme), por që kanë përshkrime dhe klasifikime të ndryshme, të cilat duhen unifikuar sipas standardeve të sotme të përshkrimit bibliografik dhe rregullave të klasifikimit. Pra në vend të disa skedave letër do të kemi një skedë elektronike dhe në vend të disa përshkrimeve apo klasifikimeve do të kemi vetëm një.
- në mjaft raste për të njëjtin titull ka më tepër se një skedë bazë, por që kanë përshkrime dhe klasifikime të ndryshme, të cilat duhen unifikuar sipas standardeve të sotme të përshkrimit bibliografik dhe rregullave të klasifikimit.
- në skedat deri në vitin 1989 emrat e autorëve janë të përshkruar me iniciale, për të mos thënë që na kanë dalë skeda ku edhe emri edhe mbiemri i autorit kanë qenë me iniciale.

Siç rezulton nga shqyrtimi i hollësishëm, këtu kemi 3 skeda bazë për të njëjtin botim, i cili edhe ky, ka hyrë në tre kohë të ndryshme në koleksionet e BK-së. Skeda 1 përshkruan një kopje të cunguar ndaj titulli është dhënë në [...], ndërkohë që viti dhe vendi i bot. mungojnë. Si e zgjidhëm problemin?Morëm të gjitha kopjet e këtij libri që ishin shënuar në të tri skedat (nuk neglizhuam as kopjen për të cilën në skedën 2 bibliografi kishte shkruar: e lidhur në një vëllim me vepra të tjera) dhe saktësuam: titullin, numrin e faqeve (jo 156, por 136 fq.), u gjet shtypshkronja (apo botuesi), që nuk ishte shënuar në asnjërën prej 3 skedave: Ndë shkronjështypjet të A. Zel?cit, mbi të gjitha në zonën e shënimeve shkruajtëm: "Autorë të kësaj vepre, që njihet me emrin Abetarja e Stambollit, janë Jani Vreto, Sami Frashëri, Koto Hoxhi dhe Pashko Vasa" sipas...





- të dhënat e skedës shpesh janë ndryshe nga ç'janë në libër, si p.sh. nëntitulli është vënë titull, botuesi në vend të autorit.

Në skedën bazë nuk ka autor, por në fl. tit. vemë re inicialet T. P., të cilat sipas K. Bevapit, janë të Taq (Dhimitraq) Paparistos, emrin e të cilit e hedhim te zona e autorit duke bërë shënimin përkatës në zonën e shënimeve. Këtu ka edhe një problem tjetër: në skedë mungon kjo e dhënë nga fl. tit.

Editor: LEF NOSI
ELBASAN

Nuk mund të neglizhohet një e dhënë e tillë që lidhet me emrin e një personaliteti të kulturës shqiptare si L. Nosi. Duke qenë se edhe në anën e pasme të fl. tit. ka një shënim ku ky nënshkruan si botonjës, emrin e tij e kemi vënë në zonën e botuesit, dhe Elbasanin në zonën e vendit të bot.



Çdo fletore qi nuk sieλ ndenekrimin e botojesit ndiqet pas nomit.

Lef Nosi

T. P.

ABETARE

PER

ΘΚΟΛΑ ΓΙΛΟΡΕ

Meskujs e Femnas.

Ne figerôje t' Elbasanit me pak ndryeime.

ΘΤΥΡΙ' Ε ΡΑΡΕ

ELBASAN

MANASTIR

„Tregetare Nrrkombetare"

1911

Njësitë që hidhen në bazën e të dhënave të ADLiB-it përmes konvertimit retrospektiv përmbajnë kryesisht të dhënat e skedave të skedarit manual, por çdo përshkrim bibliografik konsultohet me bibliografitë retrospektive të librit shqip 1555-1912 dhe 1913-1944 që po përgatiten nga sektorët e tjerë të bibliotekës si dhe me bibliografitë kombëtare të librit shqip të periudhës 1959-1994.

Por megjithatë shpesh duhet që librat të shihen një për një në fond dhe më pas të bëhet saktësimi dhe unifikimi i të dhënave. Po ashtu, është i domosdoshëm konsultimi me materiale referative, enciklopedi dhe botime të ndryshme, Internetin, skedarët e tjerë (sistematik, kronologjik dhe topografik), librat e inventarit në Sektorin e Zhvillimit të Koleksioneve. E gjitha kjo provon kompleksitetin e procesit të retrokonvertimit.

Në saje të kësaj pune, informacioni bibliografik i rreth 51.000 skedave, prej të cilave 42.700 i përkasin periudhës para vitit 1989 dhe 8.300 periudhës pas këtij viti deri më 1994 do të shtohet në skedarin online në formën e regjistrimeve të njësuara të disponueshme për t'u konsultuar dhe download-uar prej përdoruesve.

Plotësimi i skedarit elektronik, që pasqyron në mënyrë të plotë përmbajtjen e fondit të bibliotekës, do të mundësonte organizimin e punës së saj në nivel të ri cilësor, duke u siguruar përdoruesve kërkim operativ maksimal dhe të saktë të informacionit, çka rrit efektivitetin dhe komoditetin e kërkimit.

Pritet që konvertimi retrospektiv të përmirësojë cilësinë e shërbimeve të Bibliotekës Kombëtare në këto drejtime:

- përdoruesit mund të sigurojnë edhe në largësi informacion mbi atë pjesë të koleksioneve që do të përfshihet në skedarin online të akcesueshëm në web (rrjet);
- në të ardhmen regjistrimet e konvertuara mund të hidhen nga OPAC-u i Bibliotekës Kombëtare në një skedar përmbledhës në nivel kombëtar;
- akcesi në pjesën e konvertuar do të jetë më i lehtë, më i shpejtë dhe më efikas se në skedarin manual;
- do të rritet numri i pikave të akcesit.

Mbi të gjitha, në kushtet e funksionimit gjithnjë e më efikas në kuadër të një shoqërie të hapur dhe demokratike konvertimi retrospektiv do të sjellë në vitet e ardhshme një përmirësim thelbësor në "hapjen" e skedarëve dhe të koleksioneve të bibliotekës sonë, përfshirë këtu edhe të atyre që u përkasin trashëgimisë kombëtare të shkruar.

TRASHËGIMIA KOMBËTARE E SHKRUAR DHE PUBLIKU

Ramazan VOZGA
Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë

Bibliotekat kanë detyrë parësore shërbimin ndaj publikut, pra plotësimin e kërkesave të përdoruesve për burimet e informacionit që kanë në koleksione. Qëllimi i tyre është të nxitin shpërndarjen e njohurive, të nxitin kulturën dhe edukimin duke shërbyer të gjitha llojet e mediave tradicionale dhe digjitale. Ky qëllim arrihet kryesisht nëpërmjet një pasurimi që siguron cilësi, tërësi dhe llojshmëri të fondeve si dhe nëpërmjet sigurimit të një shërbimi sa më efektiv të koleksioneve të tyre.

Një komponent i rëndësishëm i punës së bibliotekave është përpjekja për t'i afruar dhe mbajtur pranë përdoruesit. Sigurimi i shërbimit për ta, tani dhe në të ardhmen, është detyrë kryesore e këtyre institucioneve të trashëgimisë kulturore, ndaj ato lypset të hartojnë dhe zbatojnë politika të qarta të menaxhimit të aseteve të informacionit që disponojnë.

Të drejtat dhe detyrat e përdoruesve janë nocione të njohura dhe të pranuara pa asnjë hezitim dhe prej askujt. E drejta e regjistrimit në bibliotekë, e drejta e

shfrytëzimit të materialeve dhe të informacionit, plotësimi i kërkesave të tyre, oraret e përshtatshme, - të gjitha këto sigurohen kundrejt pranimit të rregullave të përdorimit të shërbimeve bibliotekare, kundrejt një sjelljeje të përshtatshme, respektimit të interesave të përdoruesve të tjerë etj.

Përdoruesi nënshkruan, të themi, një pakt etik me bibliotekën. Është detyra jonë ta kështillojmë atë t'i kuptojë mirë detyrimet morale, por edhe ligjore, sepse, në momentin që anëtarësohet në bibliotekë, ai është i detyruar t'i respektojë këto detyrime. Të jesh anëtar i bibliotekës nuk do të thotë të jesh thjesht një përdorues i mjediseve, pajisjeve dhe shërbimeve të ofruara, por edhe një qytetar, që vendoset në një marrëdhënie të caktuar me bibliotekën. Kjo marrëdhënie, ashtu si të gjitha marrëdhëniet, duhet konsideruar reciproke dhe ka të bëjë me të drejtat, por edhe me detyrimet si për punonjësit e bibliotekës ashtu edhe për përdoruesit. Kësisoj, kemi të bëjmë me angazhime etike si detyrime të ndërsjella.

Ka një mendim të përgjithshëm se pa ndërgjegjësim të të dy palëve: bibliotekarë & përdorues - në një kompleks angazhimesh të përcaktuara qartë nuk mund të ndërtojmë shërbime bibliotekare në nivelin e sfidave me të cilat përballet shoqëria e sotme e informacionit dhe e dijeve. Nëpërmjet zbatimit të vetëdijshëm të kësaj tërësie angazhimesh të karakterit etik dhe ligjor synohet të ndërtohet një simbiozë në të cilën integrohen të dy palët: bibliotekarët që ofrojnë shërbimet dhe përdoruesit që i shfrytëzojnë ato.

Stafi që punon në biblioteka siguron lidhjen mes përdoruesve dhe informacionit që ata kërkojnë. Ai ka për detyrë të sigurojë këshilla dhe ndihmë për t'i mundësuar përdoruesit të qartësojë kërkesën e tij. Stafi duhet ta përmbushë detyrën e vet me objektivitet dhe të shmangë anësi të mundshme në orientimin e përdoruesve në informacion. Kjo kërkon që procesi i sigurimit të informacionit dhe standardet e procedurat që realizojnë këtë proces të bëhen të qarta dhe të hapura sa më shumë të jetë e mundur.

Stafi i bibliotekës duhet të demonstrojë përkushtim në përmirësimin e akcesit në informacion, por duke synuar gjithmonë balancimin midis nxitjes së akcesit publik në burimet e informacionit të trashëgimisë së shkruar dhe mbrojtjes së këtyre burimeve. Ndaj del detyrë e dorës së parë që ai të sqarohet dhe trajnohet për të qenë i ndërgjegjshëm për delikatesën e problemit, për rreziqet në këtë fushë si edhe për dëmin që mund t'i shkaktohet bibliotekës në qoftë se cenohen asetet e pronësisë intelektuale.

Vërtetë shërbimi bibliotekar është një detyrë ligjore, që buron nga e drejta e qytetarëve për akces në informacion, por kjo e drejtë e publikut shkon dora-dorës me detyrën e bibliotekave për mbrojtjen dhe ruajtjen e burimeve të informacionit që disponojnë, me detyrën për parandalimin e keqpërdorimit, të shfrytëzimit të tij për qëllime komerciale etj. Pra, përdorimi i materialeve bibliotekare duhet bërë brenda normave, kritereve dhe rregullave të caktuara, që burojnë kryesisht nga legjislacioni për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe ai për copyright-in. Duhen zbatuar me përpikëri nga ana e përdoruesve detyrime të tilla që kanë të bëjnë me rregullat për kthimin ose shtyrjen e afatit të kthimit të materialeve bibliotekare të huazuara, rregullat për fotokopjimin, printimin etj.

Përdoruesi është i detyruar, gjithashtu, të mirëpërdorë dhe të mos dëmtojë mjetet dhe burimet e informacionit, si: skedarë, botime referative dhe bibliografike si edhe pajisjet e teknologjisë së informacionit. Gjatë përdorimit të tyre ai është i vetmi përgjegjës për dëmtimet e mundshme dhe punonjësit e bibliotekës janë të autorizuar të verifikojnë në çdo moment nëse përdorimi i mjeteve, pajisjeve dhe shërbimeve të informacionit është në përputhje me parimet etike.

Përsa i përket shërbimit të vlerave të rralla, marrëdhëniet me publikun kanë specifikën e tyre dhe duhen parë në disa plane. Sidomos materialet e kësaj natyre janë pronë e kombit, pra hyjnë në korpusin e kujtesës kombëtare. Publiku ka të drejtë t'i shfrytëzojë ato, por brenda normave të caktuara që synojnë mbrojtjen e tyre nga dëmtimet fizike dhe abuzimet e formave të ndryshme të dënueshme nga ligji.

Shërbimet bibliotekare dhe informuese në biblioteka janë parashikuar të sigurohen mbi bazën e barazisë dhe përdorimit të lirë të tyre për të gjithë, pavarësisht racës, moshës, seksit, besimit fetar, kombësisë, gjuhës apo statusit social. Biblioteka, si institucion publik, garanton ofrimin e shërbimeve që synojnë informimin e qytetarëve me qëllim që ata të ushtrojnë të drejtat e tyre demokratike dhe të luajnë rol aktiv në shoqëri. Është për këtë arsye që parashikohet hyrje e lirë, e pakufizuar dhe e barabartë në dije, mendim, kulturë dhe informacion.

Por nga ana tjetër, shteti garanton mbrojtjen e trashëgimisë së shkruar në përputhje me legjislacionin vendas si dhe me konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat ai është palë. Kjo mbrojtje realizohet, në radhë të parë, nga institucionet e ruajtjes së kujtesës kombëtare, mes të cilave, ndër më të rëndësishmet, janë bibliotekat.

Koleksionet e bibliotekave, si pjesë thelbësore e trashëgimisë kulturore, historike etj. të shkruar, përbëhen nga materiale të shtypura dhe grafike, materiale audovizuale dhe elektronike, dorëshkrime etj. Vërtetë suksesi i një rrjeti bib-

liotekash shprehet në shfrytëzimin e gjithë kësaj pasurie prej publikut, por, nga ana tjetër, institucionet e trashëgimisë kulturore që financohen nga shoqëria për të siguruar shërbime publike, përfshirë këtu sidomos bibliotekat që kanë në koleksionet e tyre vlera të rralla, duhet të balancojnë marrjen në konsideratë të të drejtave të përdoruesve me sigurimin e përdorimit të ndershëm (fair use) dhe të mbrojtjes së aseteve të tyre të informacionit për qëllime jofitimprurëse.

Bibliotekat mund dhe duhet të preokupohen edhe më shumë në këtë fushë, e cila mbetet një çështje e pazgjidhur si duhet deri në fund. Në pamje të jashtme mund të duket se jemi subjektivë në shërbimin e këtyre vlerave, pra sikur disave ua shërbejmë këto materiale, disave jo. Ndaj është e nevojshme që të përcaktohen kritere të sakta shkencore dhe ligjore në dy plane:

a) për ruajtjen fizike të materialeve bibliotekare, sidomos atyre të rralla:
- përjashtimi nga huazimi jashtë mjediseve të bibliotekës,
- shërbimi i kopjeve të arkivit vetëm në rastet kur nuk ka kopje në fondin e përgjithshëm,
- konsultimi i tyre në mjedise të veçanta të mbikëqyrura,
- lejimi i konsultimit të tyre nga stafi i bibliotekës në mjediset e fondit,
- ndalimi i fotokopjimit të tyre,
- zbatimi i rregullave të veçanta të lëvizjes së tyre në raste ekspozitash brenda dhe jashtë mjediseve të bibliotekës, përfshirë ato jashtë vendit etj.

b) për parandalimin e përdorimit abuziv të këtyre vlerave nga individë të ndryshëm:
- mbase do të duhej të inkurajohej bashkëpunimi institucional, përpara bashkëpunimit me individë të veçantë,
- në materialet e fotokopjuara mund të vendosej një shenjë e caktuar, p.sh. *copy*, për të parandaluar riprodhimin e paautorizuar të tyre etj.

Por ka disa probleme që duhen njohur kur shërbejmë dhe përdorim sidomos këtë grup materialesh të koleksioneve bibliotekare. Kështu, një prej shërbimeve bibliotekare ku interferon më dukshëm problemi i copyright-it është ai i fotokopjimit. Shërbimi i shumëfishimit nëpërmjet fotokopjimit etj. duhet të marrë në konsideratë mbrojtjen e materialeve bibliotekare nga fotokopjimet pa kriter, zbatimin me korrektësi të legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar të copyright-it dhe mbrojtjen e pasurisë librore që e ka kaluar afatin ligjor të copyright-it, por që është pronë e inventarit të Bibliotekës Kombëtare si pjesë e koleksioneve të saj.

Biblioteka u vjen në ndihmë përdoruesve me një shërbim me pagesë për fotokopjime ose printime nga PC të dokumenteve që ata kërkojnë. Por gjithnjë duhen respektuar disa kushte dhe konkretisht:

a. kryerja e një numri të caktuar fotokopjimesh brenda një dite nëse dokumenti është në format letër dhe nuk lejohet të huazohet jashtë bibliotekës, gjithnjë duke respektuar të drejtën e autorit;

b) kryerja e një numri të caktuar printimesh nga PC brenda njëdite nëse dokumenti që kërkohet të shumëfishohet është në format elektronik me kusht që të respektohet e drejta e autorit.

Koleksionet në biblioteka, qoftë të shtypura, qoftë në formë digjitale (përfshirë baza të dhënash, intranete dhe website) janë të gjitha të mbrojtura nga ligji i copyright-it. Kopjimi dhe mikrofilmimi (me qëllim arkivimi ose ruajtjeje) i një vepre në koleksionin bibliotekar është i lejueshëm nga ligji. Po ashtu, është në interes të publikut, që bibliotekave u lejohet të kopjojnë materiale të tyre me qëllim që të ruhet origjinali dhe të kenë mundësi të japin për konsultim dhe për përdorime të tjera të ligjshme (si fotokopjimi) kopjen në vend të origjinalit.

Si institucione të akcesit publik, bibliotekat duhet të njohin përgjegjësitë e tyre, legjislacionin mbi copyright-in dhe të kërkojnë këshilla ligjore. Ato p. sh. mund të ndalojnë përdorime të caktuara të materialeve të caktuara të koleksioneve të tyre (p. sh. fotokopjim antikuarësh), përgjithësisht të lejojnë vetëm fotokopjime jokomerciale nga përdoruesit.

Le të ndalemi shkurt te fotokopjimi. Së pari, biblioteka e kryen shërbimin e fotokopjimit, mbështetur në rregullat për ruajtjen e koleksioneve bibliotekare. Për të mbrojtur koleksionet bibliotekare nga dëmtimi prej nxehtësisë dhe dritës që çlirohet gjatë procesit të fotokopjimit, nuk lejohet të fotokopjohen:
- materiale të fondeve të antikuarit, arkivit dhe doreshkrimeve
- disertacione të pabotuara
- materiale të brishta e të restauruara
- materiale të dëmtuara
- njësi me lidhje tepër speciale, e cila mund të dëmtohet gjatë fotokopjimit.

Së dyti, biblioteka e kryen shërbimin e fotokopjimit mbështetur në ligjin për të drejtën e autorit. Për këtë shërbim plotësohet një fletëkërkesë, në të cilën duhet të deklarohet që materiali i fotokopjuar do të përdoret për qëllime kërkimi, studimi, procesi juridik etj. dhe jo për ta shpërndarë për qëllim përfitimi.

Lidhur me copyright-in detyrat e bibliotekave kanë të bëjnë me:
- zbatimin korrekt të legjislacionit përkatës në shërbimin e fotokopjimit,
- kujdesin për mbrojtjen e produktit intelektual të vetë bibliotekës si bibliografi dhe botime të tjera të saj,
- kujdesin për përdorimin dhe mbrojtjen e bazës elektronike të të dhënave.

Bibliotekat mund të zbatojnë disa kufizime në shërbimin e fotokopjimit:
- Mund të fotokopjohet një përqindje e caktuar (10%) e njësisë ose:
• një kapitull i plotë i një libri (pavarësisht nga numri i faqeve)
• jo më shumë se një artikull në të njëjtin numër reviste ose gazete (pavarësisht nga numri i faqeve)
• një kumtesë nga një përmbledhje punimesh të një konference (pavarësisht nga numri i faqeve)
• deri në një përqindje të caktuar (10%) të një antologjie me tregime ose poezi ose të njërës prej tyre (jo më shumë se 10 faqe).
- Çdo përdorues shërbehet vetëm me një kopje. Kur ai kërkon më shumë se një kopje, riprodhimi nuk bëhet nga origjinali, por nga fotokopja.
- Për një përdorues mund të fotokopjohen jo më shumë se 30 faqe në ditë.
- Kur vërehet se i njëjti material kërkohet shpesh për fotokopjim, sektori i shërbimit bën kopje të plotë të origjinalit për ta përdorur për riprodhim.

Në zbatim të masave ligjore që rregullojnë mbrojtjen e copyright-it këto kufizime shtrihen edhe për çdo mënyrë tjetër të riprodhimit të materialeve bibliotekare si fotografim, radhitje me kompjuter ose laptop dhe çdo mjet tjetër shumëfishues.

Fluksi i përdorimit të teknologjive të reja të informacionit dhe komunikimit ka sjellë probleme të mprehta të kujdesit dhe respektimit të të drejtave të pronësisë intelektuale sidomos të vlerave të rralla që bartin koleksionet e bibliotekave. Me të drejtë institucionet e trashëgimisë kulturore, përfshirë edhe bibliotekat, i tremben abuzimit nga ana e përdoruesve në të drejtat e pronësisë intelektuale dhe në të drejtat që lidhen me asetet e tyre të informacionit në kushtet e shfrytëzimit të vlerave të tyre në mjedisin digjital. Ndaj, meqë asetet e tyre të shkruara bëhen të shfrytëzueshme përmes rrjeteve elektronike, po mendohet seriozisht që të kontrollohet përdorimi i paautorizuar i tyre. P. sh. ata që punojnë në sektorin e fitimit (botuesit etj.) mund të kenë nevojë të shfrytëzojnë rrjetin e bibliotekave disa herë përmes site-it në bibliotekë ose jashtë saj. Bibliotekat janë të detyruara ta sigurojnë këtë shërbim, por gjithnjë brenda normave ligjore. Por në raste të tilla nuk është e lehtë të bëhet dallimi mes përdorimeve komerciale dhe atyre jokomerciale.

Është e rëndësishme të shënohet që megjithëse biblioteka mund të jetë pronare ekskluzive e veprës fizikisht, ajo nuk mundet domosdoshmërisht t'i ketë kështu edhe të drejtat në pikëpamje të pronësisë intelektuale. P. sh. ligji nuk i lejon bibliotekat të digjitalizojnë një vepër të shtypur të koleksioneve të tyre për t'ua shërbyer atë përdoruesve në një rrjet të akcesit publik.

Për bibliotekat del detyrë të hartojnë një politikë të saktë copyright-i duke nënvizuar qëllimet dhe objektivat e shërbimeve të tyre në rrjet. Ka ardhur koha që ato t'u japin përgjigje pyetjeve të tilla si:
- kush do të ketë akces dhe për ç'qëllime,
- ç'masa duhen marrë për sigurimin e rrjetit,
- si do të kontrollohet kopjimi dhe përdorimi,
- a do të ketë një sistem teknik mbrojtjeje apo akcesi do të jetë i monitorueshëm përmes identifikimit, regjistrimit dhe fjalëkalimit,
- a do t'u ofrohet akces veprave të mbrojturaë

Kjo ishte vetëm një përpjekje në trajtë udhëzimesh apo sugjerimesh, që kurrsesi nuk përbën, as nuk pretendon të zëvendësojë këshillën e duhur ligjore, e cila duhet të kërkohet sa herë të jetë e nevojshme.

FOTOGRAFIA - DËSHMI E KUJTESËS KOMBËTARE

Mr. Jetish KADISHANI
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

Arti komunikon përpara se të kuptohet, thotë T. S. Eliot. Kështu edhe fotografia. Të shkruash një histori mbi fotografinë në përgjithësi e veçmas për atë shqiptare, është po aq e vështirë sa të tregosh historinë e letërsisë nëpërmjet fotografisë. Por një histori e fotografisë është njësoj e domosdoshme.

Materialet bibliotekare jolibër janë: fotografitë, hartat, muzikalet, dorëshkrimet, pullat postale etj.

Fotografia, si material muzeor

Fotografia, si material muzeor, bën pjesë në grupin e parë të materialeve muzeore që kanë të bëjnë me historinë e re dhe paraqet lloji të përshtatshëm të materialit muzeor. Krahas karakterit autentik dhe cilësisë së burimit historik

dokumentues, fotografia është material muzeor shumë i përshtatshëm për veprimtarinë prezantuese muzeore. Si e tillë, ajo është e pranuar mjaft mirë nga ana e vizitorit bashkëkohor në muze e bibliotekë.[1]

Fotografia zë vend të rëndësishëm në veprimtarinë muzeore, si në aspektin dokumentues, ashtu edhe në atë ilustrues. Është karakteristike se fotografia është prezente në të gjitha fazat e veprimtarisë muzeore, duke filluar që nga faza hulumtuese, faza e përpunimit profesional e shkencor, faza e mbrojtjes së objekteve muzeore, e deri tek faza e prezantimit dhe publikimit të rezultateve shkencore në kuadër të veprimtarisë muzeore,[2] fotografia ka edhe rolin dhe rëndësinë e mjetit për trajtim profesional e shkencor të temave të caktuara.

Fotografia në cilësinë e dokumentit inkorporohet midis eksponateve dhe materialeve të ndryshme muzeore shumë lehtë dhe në mënyrë të natyrshme. Si material muzeor, ajo është shumë e përshtatshme për pasqyrimin vizual të historisë, apo të një pjese të historisë në aspektin muzeor e bibliotekar.

Për t'u radhitur midis objekteve muzeore, fotografia duhet t'i plotësojë disa kritere të caktuara. Së pari, për shkak të voluminozitetit të fotografive si materiale muzeore, me rastin e hulumtimit, mbledhjes dhe përpunimit profesional të këtij lloji materiali muzeor, është më se i domosdoshëm seleksionimi i duhur dhe mjaft rigoroz i fotografisë-eksponat muzeor. Pastaj duhet bërë verifikimi i hollësishëm dhe kritik i të gjitha fakteve që kanë të bëjnë me fotografinë, në mënyrë që në koleksionin përkatës të inventarizohen vetëm ato foto-materiale që kanë vlerë të caktuar kulturo-historike.[3]

Në procesin e seleksionimit të fotografisë si material muzeor, krahas vlerësimit të përmbajtjes, duhet cilësuar edhe cilësinë burimore të fotografisë, autentitetin e saj, anën artistike etj.

Caktimi i kriteriumeve për seleksionimin e fotografive për koleksione muzeore, veç tjerash, varet shumë edhe nga sasia e fotografive që kanë të bëjnë me një datë, një ngjarje, një periudhë apo një personalitet kulturo-historik.[4] Mirëpo, kriteri kryesor për inventarizimin e fotografisë në koleksionin muzeor është që këtë lloj të materialit muzeor të shoqërojnë të dhëna konkrete të verifikuara lidhur me historikun që i përket. Vetëm atëherë fotografia mund të përdoret në cilësinë e eksponatit muzeor, në ekspozita apo në veprimtari të tjera muzeore.

[1] Edib Hasangic: Strucni i naucni rad u istorijskim muzejima-definicija i odnos, Zbornik radova Muzeja Revolucije BiH, br. 3-4, Sarajevo, 1977-78, f. 79.
[2] Slavko Sakota, punimi i cituar, Zbornik 3-4, Sarajevo, 1977-78, f. 65.
[3] Po arty, f. 68.
[4] Rudolf Polsak, punimi i cituar, Zbornik 3-4, Sarajevo, 1977-78, f. 111.

Kjo i obligon institucionet muzeore që mbledhjes së të dhëna përkatëse të fotografisë si material muzeor, t'i kushtojë kujdes të veçantë.[5]

Përshkrimi i fotografisë

Përshkrimi i përmbajtjes së fotografisë, që në gjuhën muzeore quhet diçiture, mund të jetë përshkrim i përgjithësuar dhe përshkrim i hollësishëm. Fotografitë me përshkrim të përmbajtjes në mënyrë të përgjithësuar, mund të përdorën kryesisht për ilustrimin e temave të përgjithshme, siç janë ekspeditat ndëshkimore ushtarake, shpërnguljet masive të popullsisë, masakrat, pastaj manifestimet e ndryshme, shënimi i ndonjë feste, etj. Prezantimi muzeor i fotografive me diçiture të përgjithësuara, me doemos duhen të ekspozohen bashkërisht me tekstet përcjellëse. Andaj, fotografia me diçiture të përgjithësuar mund të përdoret vetëm si mjet për ilustrimin e teksteve përcjellëse në veprimtarinë prezantuese muzeore, por jo edhe si material dokumentues muzeor.[6]

Përshkrimi i hollësishëm i fotografisë si material muzeor, bën që fotografia të ketë cilësinë e materialit muzeor për ngjarjen e caktuar, për kohën e caktuar, për vendin e caktuar, dhe për personalitetin e caktuar kulturo-historik. Me përshkrimin e hollësishëm të përmbajtjes së fotografisë në cilësinë e materialit muzeor, kuptojmë: përcaktimin e vendit dhe të datës ku dhe kur është krijuar fotografia; shkrimin e emrit, mbiemrit dhe pseudonimit të secilit luftëtar apo veprimtar që figuron në fotografi; shënimi i të dhënave lidhur me njësinë ushtarake në fotografi, e kështu me radhë. Është me rëndësi që në kuadër të përshkrimit të hollësishëm të fotografisë, të shënohet se fotografia është origjinale, apo kopje.

Fotografia ka cilësinë e materialit origjinal muzeor kur ajo është bërë në kohën e luftës, përkatësisht në kohën kur është zhvilluar ngjarja e cila pasqyrohet në fotografi. Për fotografitë origjinale, të cilat në veprimtarinë prezantuese muzeore e sigurojnë komponentin e besueshmërisë, në koleksionin përkatës duhet të sigurohet tretman i veçantë, gjë që nuk është e domosdoshme për fotografitë kopje. Kur kemi të bëjmë me fotografitë e reprodukuara, është më se e domosdoshme që me rastin e përshkrimit të përgjithshëm apo përshkrimin e hollësishëm, të shënohet se ku gjendet origjinali, përkatësisht negativi, dhe kush është autori i fotografisë. Në kompletimin e të dhënave të hollësishme për

[5] Po aty, f. 115.
[6] Po aty, f. 118.

fotografinë si material dokumentues muzeor, veç burimeve tjera, ka edhe lënda memoriale e mbledhur nga pjesëmarrësit apo nga bashkëkohanikët e datës, ngjarjes apo periudhës e cila pasqyrohet në fotografi. [7]

Pavarësisht nga fakti se fotografia mund të paraqet një pjesë të realitetit objektiv, nuk duhet harruar fakti se prapa aparatit qëndron njeriu, pra subjekti njeri, i cili ka qëndrim të caktuar ndaj motivit për fotografim, respektivisht ndaj datës, ngjarjes apo personalitetit që shihet në fotografi. Andaj, zbulimi i së vërtetës historike në bazë të fotodokumenteve nuk është gjithmonë i lehtë dhe i sigurt, madje një gjë e tillë kërkon punë, profesionalizëm dhe përgjegjësi nga hulumtuesi dhe punëtorët e tjerë muzeorë apo bibliotekarë.[8] Kjo obligon punëtorin muzeor apo bibliotekarin që me rastin e shkrimit të përmbajtjes së fotografisë, të konsultojë edhe burimet e tjera që flasin lidhur me datën, ngjarjen apo personalitetin që shihet në fotografi. Mbështetja më e mirë për hartimin e përshkrimit të fotografisë (diçiturës), është historiografia e deri diku edhe publicistika.

Për gjetjen e fotografive me vlerë muzeore, duhet hulumtuar në arkiva, në institucione shkencore, në biblioteka, dhe në institucione të tjera kulturo-shkencore. Mirëpo, për gjetjen e këtij lloj materiali muzeor, duhet hulumtuar edhe në arkivat private, në radhë të parë në familjet e organizatorëve apo të pjesëmarrësve të ngjarjeve të ndryshme kulturo-historike, të cilat janë objekt i trajtimit muzeor. Po ashtu duhet hulumtuar edhe në arkivat private të pasardhësve të veprimtarëve e personaliteteve nga periudhat historike që trajtohen në aspektin muzeor. Fotografi me vlerë të rrallë mund të gjendën edhe në arkivat private të bashkëkohanikëve të datave, ngjarjeve dhe periudhave që në i trajtojmë në fushën muzeore.

Kur kemi të bëjmë me fotografinë si material muzeor prezantues, duhet cekur se ana teknike e fotografisë nuk është gjithmonë e kënaqshme, sidomos jo në aspektin e prezantimit muzeor. Mirëpo është me rëndësi që fotografia si material muzeor, tek ajo të jetë prezent komponenti dokumentues, faktografik, konkretizues dhe ilustrues. Kur fotografia i ka këto cilësi, atëherë roli i saj si material muzeor në pasqyrimin e prezantimin e një date, një ngjarjeje apo të një personaliteti kulturo-historik, është tejet i madh, sepse krahas vlerës dokumentuese, ajo tërheq dhe e aktivizon kureshtjen e vizitorit në hapësirën prezantuese muzeore.[9]

[7] Po aty, f. 112.
[8] Slavo Sakota, punimi i cituar, f. 69.
[9] Rudolf Polsak, punimi i cituar, f. 112.

Trashëgimia kulturore Shqiptare në artin e fotografisë përbën një plejadë artistësh të talentuar që vazhdon deri në ditët tona. Më të shquarit në Shqipëri janë:

Kolë Idromeno (1860-1939), shkodran, mësoi te Marubi, u mor me fotografi dhe pikturë. Shquhej më tepër si portretist. Në vitin 1992 njihej si njeriu i parë në Shqipëri që u mor me kinematografinë.

Gjon Mili (1904-1984), u lind në Korçë. Kur kishte pesë vjeç bashkë me prindërit është larguar në Rumani, ku gjuhë e shtëpisë ishte shqipja. Ishte fotograf i njohur, më vonë kaloi në Amerikë, pikërisht në Uashington. Ai atje u bë fotograf i shquar shqiptaro-amerikan i shekullit të kaluar. Vdiq në Nju Jork në vitin 1984, duke lënë pas një thesar të madh fotografish dokumentare. Kur në vitin 1955, Redaksia e revistës së njohur amerikane "LIFE" (Jeta) në Nju Jork nxori në qarkullim botimin me karakter mësimor dhe zbulues të titulluar "Bota në të cilën jetojmë" ("The World we live in", në mesin e shumë fotografëve të njohur amerikanë zënë vend edhe Gjon Mili më 15 pikturat e tij, foto përgjithësisht me ngjyra. Aty vlen të theksohen fotografitë e tij me titull "Katër stinët e lisit", me ç'rast paraqet lisin gjatë katër stinëve të viti, gjë që zgjoi interesimin e madh të vizitorëve dhe të njerëzve kompetentë që merreshin në atë kohë me fotografinë.

Ymer Bali U lind në Tiranë. Më 1930 kreu studimet në Austri. Dallohet për portrete dhe fotografi kolektive. Ai nuk u martua dhe nuk la trashëgimtar pas. Pas vdekjes së tij, një mbesë e tij I dhuroi arkivin e tij tepër të pasur Arkivit Qendror të Shtetit në Tiranë.

Mandi Koçi. U lind në Voskopojë të Korçës më 17 janar 1912. Më 1936 hapë në Korçë të parën studio fotografike me korent. Kishte pseudonimin MAK. Më 1952 Maku mbaron një kurs për kinooperator dhe punoi në Kinostudion "Shqipëria e Re". Në moshë të shtyrë vdes në Tiranë.

Jani Ristani u lind në fshatin Zagori të Gjirokastrës më 1913. Në moshë të re shkoi në Stamboll në shkollën tekniko-inxhinierike. Merr mësimet e para nga mjeshtri tur I fotografisë Niko Huzuri dhe fillon një aktivitet të frytshëm fotografik në Turqi, ku fotografon edhe Qemal Aataturkun. Më 1935 kthehet në Tiranë dhe hap Sutdion Ristani. Më 1947 studio e tij shtetëzohet duke ia dorëzuar shtetit me dhjetëra mijëra negativësh. Vazhdon si nëpunës në fotografi pranë Ministrisë së Ndërtimit derisa del në pension. Ai fitoi shumë çmime kombëtare dhe ndërkombëtare për fotografi. Që nga viti 1954 në studion e tij zhvilloi për herë të parë fotografinë me ngjyra. Kjo studio vazhdon edhe sot punën me Petrit Ristanin.

Mihal Popi (1909-1979, u lind në Shkodër më vonë shpërngulet në Tiranë. Një kohë punoi si fotograf në Radio-Tirana. Më vonë hapi një studio fotografike në "Pazarin e Ri". I shërbeu luftës me fotoaparatin e tij. Me themelimin e Teatrit Popullor, Mihali ishte ndër të parët me sukseset e tij dhe mori titullin "Artist i Popullit".

Ali Bakiu (1911-1981). U lind në Tiranë. Në kohën e Zogut u mor me aktivitetin tregtar dhe gjatë asaj kohe nuk iu nda librave dhe pasionit për fotografi. Kishte korrespondencë me shumë firma e studiofotografike të botës duke mundësuar futjen e mjeteve moderne fotografike në Shqipëri. Vdiq në Tiranë në moshën 70-vjeçare.

Niko Stefani, rrjedhe nga një familje nga fshati Dardhë e Korçës, fshat i dëgjuar për fotografë të zotët. I ati dhe xhaxhai vijnë nga emigracioni nga Amerika ku kishin mësuar profesionin e fotografisë. Më vonë hapën studio në Tiranë.

Misto Cici, u lind më 10 tetor 1902 dhe u rrit në qytetin e Pogradecit. Bashkë me të vëllain i kushtohen fotografisë. Luajtën rol në udhëtimet e tyre në Greqi e Itali. Më 1925 caktohen nga Drejtoria e Shtypit dhe të Propagandës Turistike për bërjen e fotografive artistike të Pogradecit. Këto do të evidentohen si fotografitë e para artistike.

Petro Dhimitri (1861-1946), fotografi shqiptar që gjithë jetën punoi në Greqi.

Pas tyre përmendën edhe fotografët e tjerë: Kristaq Sotiri, që në vitin 1922 punon si fotograf dhe dallohet për portretin. Ai punon gjithë jetën e tij në Korçë.

Agim Verzivolli, fotograf i Kinostudios "Shqipëria e Re". Me iniciativën e tij hapet kursi për fotograf në Pallatin e Pionierit në Tiranë. Ajo është fidanishtja për të nxjerrë fotografë të rinj.

Emra të shquar fotografësh të kohës sonë janë: Besim Fusha, Petrit Kumi, Niko Xhufka etj.

Në vitin 1996 Besim Fusha nxjerrë revistën "Fotografia Art" në Tiranë.

Për herë të parë më 1998 u hap konkursi "Foto artistike" me emrin "Marubi".

Më 5 prill 2000, në Galerinë e Arteve në Tiranë hapet konkursi me emrin "Marubi 2000". Në këtë konkurs morën pjesë 54 fotografë shqiptarë dhe nga bota.

Në vitin 2005, Qerim Vrioni boton në Tiranë librin me titull "Fotografia - një grusht diell", që botohet me rastin e 150-vjetorit të historikut të fotografisë shqiptare.

Historiku i fotografisë në Shqipëri dhe në jugperëndim të Ballkanit filloi rreth kohës së Jozef Sekelit (1838-1901). Atë e caktoi Komisioni për Ballkanin i Akademisë së Shkencave të Austrisë e caktoi Sekelin që të merrte pjesë në një udhëtim në Shqipëri të albanologut Johan gerog fon Han (1811-1869), në vitin 1963. Gjatë kësaj ekspedite ai bëri 50 fotografi nëpër viset e Drinit dhe të Vardarit, që janë më të hershmet në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni.

Kontribut të çmuar për fotografinë shqiptare padyshim se ka dhënë edhe Dinastia Marubi e Shkodrës, që është ndër më të njohurat në fushën e fotografisë evropiane në gjysmën e dytë të shek. XIX dhe gjysmën e parë të shek. XX. Dinastia Marubi fillon me Pjetër Marubin, i lindur në Piacencia (Itali) më 1834 dhe arriti në Shkodër më 1856, në moshën 22-vjeçare, pas ndjekjeve të pushtuesve austro-hungarezë. Në Shkodër, Marubi nis aktivitetin e tij artistik njëherazi në disa fusha: si fotograf, arkitekt, piktor dhe skulptor. Me "Kutinë magjike" fotografike (më 1858) ai nisi të fotografojë jetën jashtë studios së tij, ndër të cilat edhe ngjarjet politike të kohës si: Kryengritjen e Mirditës (1876-77), Lidhjen Shqiptare të Prizrenit (1878-81) etj., që mbetën dëshmi në faqet e revistave dhe gazetave të huaja të kohës.

Studio "Marubi" shkëlqen me përmasat evropiane, me hapësirë ndriçimi dhe pajisjet më të fundit (1885-1900). Në atë kohë Pjetër Marubi zgjodhi për vijimësinë e punëve në studio djemtë e Rrok Kodhelit nga Kodheli i Kodrinës, së pari Mati-më jetëshkurtër (1862-1881) pastaj Mikeli, i quajtur edhe Kel Marubi, me mbiemrin e ri të mjeshtrit të madh. Fototeka Marubi, me më shumë se 150.000 fotografi, përfshin dhe dokumenton historinë e Shqipërisë së Veriut që prej Lidhjes së Prizrenit e më tej.[10]

Ndërkaq, në Kosovë, sipas hulumtimeve që kemi bërë deri më tash, fotografia zë fill që në fillim të shekullit XX me fotografët e Prizrenit e pastaj të Pejës, të Gjakovës, të Prishtinës, të Mitrovicës, të Janjevës etj.

Ndër fotografët më të hershëm dhe më të njohur në Kosovë mund të cekën emrat e vëllezërve: Faik, Eshref dhe Asaf Nurkollari (me fotostudion e tyre në Prizren Foto "Sharri", në të cilën kanë punuar që nga fillimi i shek. XX. Po në këtë fotostudio, mësimet e para për fotografinë dhe ka punuar për shumë vite edhe fotografi i njohur më vonë Neshat Dizdari, i cili sot në Prishtinë njihet me fotostudion e tij tepër kualitative Foto "Nesha".

Në Pejë njihet fotostudio"Gashi" (me pronar Kristë dhe Gjina Gashin), "Foto-Pepa", "Foto-Agroni" etj. Në Gjakovë njihen fotografët: "Foto-Roka",

[10] Sipas Foto-albumit të Dinastisë Marubi të Shkodrës.

"Foto-Dujaka", "Foto-Zherka" etj. Në Ferizaj njihet si fotografi më i vjetër Nazmi Hajrullahu (i cili prej shumë vitesh nuk punon dhe gjendet në Zvicër), Bedri Meta "Foto-Beti", pastaj "Foto-Gashi", "Foto-art" (me pronar, Habit Musliun), "Foto-Kushtrimi" (Kushtrim Topjani) etj. Këto ditë, sapo ka dalë nga shtypi në Prishtinë, nga Edicioni i gazetës "Lajm", Foto-albumi me titull "Dritëshkronja", me autor albanologun e njohur Robert Elsie, në të cilin janë botuar 248 fotografi të hershme nga Shqipëria dhe Ballkani Jugperëndimor, që datojnë pesëdhjetë prej tyre nga viti 1863 deri më 1917. Këto fotografi janë bërë gjatë ekspeditave të albanologëve të njohur në Shqipëri: Hahn, Nopça, Lamberc etj., si dhe nga fotografi Bajazid Elmaz Doda nga Dibra, i cili jetoi për shumë vite në Shkodër dhe udhëtoi shumë herë në Shqipërinë e Veriut etj.[11]

[11] Këto të dhëna janë vetëm dëshmi të pjesërishme lidhur me fotografinë dhe historikun e saj në Kosovë.

ZHVILLIMI I KOLEKSIONEVE NË BIBLIOTEKËN PUBLIKE DHE MENAXHIMI I TYRE

Sylejman PIREVA
Biblioteka Ndërkomunale "Hivzi Sulejmani" - Prishtinë

Vlerësimi i ekspertëve për kompleksitetin e bibliotekës publike është i drejtë dhe i saktë prandaj edhe i qëndrueshëm. Në vargun e faktorëve të shumtë të këtij kompleksiteti, përveç të tjerësh, bëjnë pjesë edhe zhvillimi i koleksioneve dhe menaxhimi i tyre. Madje këta dy togfjalësh janë aq të përputhshëm në mes veti, sa nuk bëjnë njëri pa tjetrin, pasi janë të ndërvarur në mes veti. Të ecurit është i njëkohshëm dhe aty ku nuk prin mirë i pari, doemos që do të ngecë mbrapa i dyti. Prandaj për bibliotekën publike, pa dashur nënvlerësuar edhe faktorët e tjerë, zhvillimi i koleksioneve dhe menaxhimi i tyre janë ndër më të rëndësishmit dhe zotërimi i tyre bën që biblioteka të funksionojë si duhet dhe të marrë kuptimin që i përket.

Duke marrë parasysh që Biblioteka publike për kah shtrirja, lloji i koleksioneve dhe i komunitetit që i shërben është i llojllojshëm, tema që unë shtjelloj i

përket më shumë tipit të bibliotekës publike qendrore, por nuk e përjashton interesin (përshtatjen) dhe përgjigjen edhe për tipat e tjerë të bibliotekës publike.

Katër kushte për zhvillimin e koleksioneve

Për të pasur sukses në zhvillimin e koleksioneve të bibliotekës publike dhe në menaxhimin e tyre, paraprakisht duhet plotësuar disa kushte, por unë i ndaj katër më kryesor: infrastruktura e bibliotekës, vendndodhja e saj, buxheti financiar dhe stafi profesional.

Infrastruktura e përshtatshme e bibliotekës krijon kushtet bazë: për zhvillim të pandalshëm të koleksioneve nëpër vite dhe ruajtjen për gjeneratat e ardhshme, për zbatim të standardeve në vendosje dhe renditje në rafte të koleksioneve të shumëllojshëm për nga përmbajtja dhe formati, si dhe për mbrojtjen e tyre, për formimin dhe strukturimin e sektorëve të nevojshëm, për shërbim efikas dhe cilësor të përdoruesve dhe për menaxhim efikas të koleksioneve.

Vendndodhja e bibliotekës luan rol kyç për zhvillimin e koleksioneve, prandaj që në fazën e krijimit duhet të kihen parasysh numri i banorëve, larmia e popullsisë, specifikat e mjedisit etj. Koleksionet në fillim do të përmbajnë "burime që të plotësojnë nevojat e përgjithshme", kurse në fazat e mëvonshme, gjatë konsolidimit, do të merren në konsideratë kërkesat dhe nevojat e veçanta të popullatës.

Sa për ilustrim, po jep një shembull praktik të një biblioteke-degë që e mbikëqyr Biblioteka publike qendrore e Prishtinës : për shkak që ajo ndodhet në një ambient më shumë malor se fushor, bibliotekari i kësaj dege me të drejtë, shpeshherë, bën presion në bibliotekën qendrore që të siguroje literaturë nga bletaria dhe pemëtaria, pasi për këtë lloj ka kërkesa nga banorët e asaj ane, sepse këto janë veprimtaritë e tyre dhe ata kanë nevojë për informim dhe konsultim të kësaj literature. Por për t'ia dalë kësaj me sukses, duhet të jesh i informuar edhe nga burime të reja nga të arriturat botërore dhe duhet provuar për t'i siguruar ato…

Për këtë arsye zhvillimi dhe menaxhimi i koleksioneve duhet të jetë punë permanente dhe e pandalshme. Dhe kjo fillon që në momentin e hapjes së bibliotekës së re, dhe në këtë rast duhet marrë parasysh dhe respektuar Udhëzimet e IFLA-s, se "një koleksion librash duhet të ketë 1.5 deri në 2.5 libra për banor" dhe "sasia minimale e fondit për një pikë shërbimi të vogël nuk duhet të jetë më pak se 2500 libra". (Udhëzime të IFLA/UNESCO-s…f. 60). Kjo nënkupton që pa marrë parasysh se në çfarë ndërtese dhe në çfarë mjedisi do të hapet një bibliotekë e re, nuk bën të shkohet nën këtë minimum. Por koherenca e zhvillimit të koleksioneve nuk mund të ruhet pa një buxhet të konsoliduar dhe konstant të bibliotekës publike. Rrugët e tjera për pasurim të koleksioneve, siç janë dhuratat, këmbimi ndërbibliotekar etj., janë të mirëseardhura, por nuk mjaftojnë për një balancë të qëndrueshëm.

Politika e zhvillimit dhe menaxhimit të koleksioneve pa censurë dhe në pajtim me diversitetin e popullatës

Vlen shumë formulimi i një politike të qartë që është e bazuar në kritere dhe parime që reflekton zhvillim dhe menaxhim të suksesshëm të koleksioneve të bibliotekës publike dhe fundja të çdo biblioteke tjetër. Të zotërosh këtë politikë, do të thotë të bësh një hulumtim sa më të saktë të interesave, nevojave dhe kërkesave të komunitetit lokal, duke ju mundësuar qasje të barabartë në shfrytëzim të koleksioneve libër dhe jolibër, pa marrë parasysh përkatësinë etnike, gjuhësore, fetare etj. Në këtë mënyrë bëhet i mundshëm respektimi i Nenit 9 i Deklaratës Universale i të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara, i misionit themelor kur kemi të bëjmë me diversitetin kulturor dhe gjuhësor të popullsisë lokale. Personelit të bibliotekës i takon që të hulumtojë dhe gjejë burime që i pasurojnë koleksionet me materiale që jo vetëm formalisht pasqyrojnë këtë diversitet, por edhe që "reflektojnë drejtimet aktuale dhe zhvillimin e shoqërisë, si dhe kujtesën njerëzore" (Manifesti I IFLA/UNESCO-S për Bibliotekat Publike, l994).

Njësoj mund të thuhet edhe për censurën. Ajo duhet të përjashtohet plotësisht me rastin e formimit dhe pasurimit të koleksioneve, duke mos na penguar përmbajtja ideologjike, gjuhësore, fetare e librave. Edhe në këtë rast, kur bëhet fjalë për koleksionet e Bibliotekës Publike, Manifesti I IFLA/UNESCO-s, tërheq vërejtjen që "Koleksionet dhe shërbimet nuk duhet të jenë subjekt i asnjë forme të censurës ideologjike, politike ose fetare dhe as të presioneve tregtare". (sa sinjifikative del kjo vërejtja në fund: pra as të presioneve tregtare!) Për këtë nevojitet që stafi i bibliotekës të jetë i ditur dhe i përgatitur profesionalisht në nivel të lakmueshëm.

Ndërlikueshmëria në bibliotekat publike në qytete më të mëdha

Në bibliotekat publike qendrore që veprojnë në qytete më të mëdha, politika e zhvillimit dhe menaxhimit të koleksioneve bibliotekare bëhet edhe më e ndërlikuar, për arsye se ato përveç që duhet të zhvillohen vetë, duhet të intere-

sohen edhe për zhvillimin e rrjetit të tyre që në Kosovë është mjaft i përhapur, deri në 17 degë, siç është rasti me Bibliotekën Ndërkomunale "Hivzi Sulejmani" të Prishtinës, që disponon 4 degë në qytet dhe 13 në fshatra. Në këtë rast barra dhe përgjegjësia bie kryesisht mbi stafin e bibliotekës publike qendrore, pasi ai në këtë mënyrë duhet të kujdeset për pasurim dhe seleksionim sa më të mirë të koleksioneve të këtyre bibliotekave, duke marrë parasysh edhe diversitetin kulturor dhe gjuhësor, por edhe specifikat e mjedisit të çdo njërës veç e veç. Kurse marrja parasysh e moshës së përdoruesve, për t'ua përshtatur përmbajtjen dhe larminë e koleksioneve, është politika e menaxhimit të veçantë. Kjo arrihet më së miri kur sektorët dhe degët e bibliotekës qendrore bashkëpunojnë si duhet me sektorin e zhvillimit dhe përparimit bibliotekar, por edhe anasjelltas.

Larmia e koleksioneve

Vrojtuesi i vëmendshëm gjatë leximit tim të derikëtushëm të këtij shkrimi mund të ketë vërejtur se u bë fjalë për zhvillimin dhe menaxhimin e koleksioneve kryesisht me libër, e fare pak të koleksioneve jolibër. Kjo nuk ndodh rastësisht, sepse bibliotekave publike në Kosovë, si edhe asaj në Prishtinë, thuaja se ju mungojnë koleksionet me materiale të tjera jolibër ose janë diku në fillim të formimit, përveç koleksionit të periodikut, për të cilin vlen të shkruhet në mënyrë të veçantë. Përndryshe, siç kemi pasur rastin t'i shohim bibliotekat e vendeve më të zhvilluara, dhe siç parashohin standardet e IFLA-s, koleksionet në bibliotekën publike mund të jenë të shumtë dhe të larmishëm.

Në to mund të përfshihen libra të formatit të ndryshëm, broshura, gazeta dhe revista (periodikë), CD-ROM, mikroforma, shirita, disqe CD, videokaseta, disqe, lazer, materiale braile, libra audio, libra elektronikë etj. (Udhëzime të IFLA/UNESCO-s për zhvillim ; f. 57).

Mosdisponimi i bibliotekave publike edhe me kësi lloji të koleksioneve nga materiale jolibër, tregon thjeshtësinë dhe varfërinë e tyre, tregon zhvillimin e koleksioneve vetëm në një drejtim, Kjo është politike e padenjë ose s'është farë politike e zhvillimit dhe e menaxhimit të koleksioneve. Tani kur teknologjia e informacionit ka shkuar shumë larg dhe kur dihet se shumë qytetarë dinë si ta përdorin atë, përgjegjësia e bibliotekave publike është edhe më e madhe, prandaj duhet nxituar pa vonesë në formimin e koleksioneve jolibër, që biblioteka publike të duket dhe të bëhet sa më e kompletuar.

Spastrimi i koleksioneve fakt i menaxhimit profesional

Në zhvillimin dhe menaxhimin e koleksioneve, aq sa ka rëndësi pasurimi dhe përtëritja e fondit bibliotekar, po aq rëndësi ka edhe çështja e spastrimit, dhe aq më e nevojshme kjo bëhet në bibliotekat publike qendrore. Ky veprim është i nevojshëm jo rrallëherë, por më i nevojshëm bëhet atëherë, kur ka mbingarkesë të koleksioneve dhe ngushtim të hapësirave. Qysh në shek. 4 p.k.r., Seneka kishte deklalruar: "E, ç'duhen gjithë ata libra të panumërt dhe biblioteka, kur i zoti i tyre gjatë gjithë jetës së vet mezi arrin t'u lexojë vetëm titujt?" (Bibliotheca 3, Tiranë, 2002, f. 92).

Lihet përshtypja se përkundër udhëzimeve që jepen nga specialistët për të kryer spastrimin e fondeve nga librat që nuk lexohen, në shumë biblioteka kjo bëhet pa ndonjë vullnet të madh. Mbase këto lëkundje dhe dilema, vijnë për shkak të mosdijes se çfarë duhet ruajtur dhe çfarë duhet hedhur. E pse u dashka të pritet me vjet e vjet, nëse dihet se akëcili libër nuk është kërkuar asnjëherë nga lexuesi? Në këtë rast, që të mos gabojë biblioteka, mjafton që ajo t'i ketë informuar qartë përdoruesit e vet për të gjitha njësitë e koleksioneve, në forma të ndryshme, qoftë përmes katalogut manual ose katalogut elektronik, apo në ndonjë formë tjetër. Sa për spastrimin e librave të vjetër, të amortizuar dhe të brejtur, as që duhet të bëhet fjalë, ata duhet t'u lirojnë sa më parë vendin librave të rinj. Por librat e rrallë nuk duhet ngatërruar me librat e vjetruar.

Kur veç po flasim për spastrimin e koleksioneve, për librat e tërhequr, qoftë për shkak se janë vjetruar apo të mosinteresimit të lexuesve për ta, kujtoj se në ato biblioteka që kanë hapësira të mjaftueshme, është mirë t'i ruajnë për një kohë në fondin rezervë, për arsye se mund të mos përsëritet tjetër herë botimi i tyre ose për t'ua falur më vonë bibliotekave të tjera, nëse për këtë tregojnë interesim .

Ndërsa për librat e rrallë dhe të çmueshëm që janë para rrezikut të asgjësimit nga vjetërsia dhe përdorimi i shpeshtë, i vetmi shpëtim është mikrofilmimi i tyre.

Përfundim

Duke e përfunduar këtë shkrim, le të shpresojmë se sadopak trajtimi i kësaj teme do të reflektojë në vetëdijesimin e dy subjekteve kryesorë: së pari në stafin e bibliotekës publike për të bërë më tepër në zhvillimin e koleksioneve sa më të larmishme dhe në menaxhimin e tyre nga një politikë efektive (nëse për këtë ka kushte) dhe e dyta, në financuesit, që kjo të kuptohet si interes fundamental i shoqërisë, prandaj të mos kursehet asnjëherë për të.

FONDET ALBANOLOGJIKE NË BIBLIOTEKAT E SHKODRËS

Gjovalin ÇUNI
Biblioteka "Marin Barleti", Shkoder

Tradita e bibliotekave në Shkodër

Historia e librit nuk mund të merret e shkëputur nga historia e qytetit, pa atë, vlera e Shkodrës do të ishte e mangët. Shenjat e para të pranisë së librit në Shkodër ndonëse të pakonfirmuara i nxjerrin nga A. Stipçeviç i cili nënvizonte: ".. nga fundi i Republikës (shek.I - shën. im) librat e shkrimtarëve të njohur romakë mund të bliheshin edhe në provincat më të largëta. Krahas qendrave të vjetra kulturore greke në të gjithë Mesdheun, ngrihen qendra të tjera në Gali, Iliri e gjetkë.[1]
Konstatimet e Stipçeviçit të krijojnë hapësirë që të pretendojmë për përhapjen e librit edhe në Shkodër, duke u nisur nga të qenit e saj, qendër e provincës romake të Preventalisë.

[1] A. Stipçeviç. Historia e librit, Prishtinë 1998, f. 95.

Edhe autorë të tjerë, me faktet që sjellin, të krijojnë idenë që në Shkodrën mesjetare mund të kenë ekzistuar, ndonëse jo virtualisht bibliotekat. Marin Barleti në veprën e tij "Rrethimi i Shkodrës" na njofton për ekzistencën e analeve të shkruara në gjuhën e popullit (invernacula lingua); I. Zamputi për: "... regjistra të noterëve, të administratës bashkiake, të gjykatave, kishave, kancelerive etj."[2]; Vinçenc Malaj O.F.M., na flet për 7 libra koralë të ruajtura në Bibliotekën e domenikanëve në Split, shkruar në pergamenë që datojnë të shekullit XV, si dhe disa inkunabula të sjella nga Durrësi. Duke përdorur induksionin në zhvillimin kulturor mes qyteteve, ai hedh idenë se një pjesë e vlerave të gjetura mund t'i takojnë edhe Shkodrës[3].

Edhe hapja e shkollave të para shqipe në zonën e Shkodrës në shekullin e XVII, si dhe afërsia e shkollave me kuvendet të lë të mendosh për ekzistencën e ndonjë libri apo edhe të ndonjë biblioteke tepër të vogël.

Të dhëna të mëvonshme për ekzistencën e librave dhe të bibliotekave në Shkodër i gjejmë në artikullin e një grupi autorësh titulluar: "Kontribut për historinë e bibliotekave në Shkodër"[4]. (Grupi i autorëve: Ll. Karafili (Bardhyli), Filip Fishta, T. Gjyli, K. Kamsi, W. Kamsi, Jup Kastrati, M. Kotrri, Sh. Osmani). Nga të dhënat e tyre mund të veçojmë:

Që në vitin 1563, flitet për ekzistencën e shtypshkronjës në Shkodër."… nji farë Shtjefni prej Shkodre pruni nga Venediku dhe ngrehi në Shkodër nji shtypshkronjë e në vjetë 1563 shtypi nje libër kishtar"[5] . Ekzistenca e kësaj shtypshkronje dhe e disa rrethanave të tjera nxiti debatin me pjesëmarrjen e albanologëve shqiptarë dhe të huaj mes të cilëve edhe Joklit për vendin e mundshëm të shtypjes së "Mesharit".·

Në bibliotekën Marin Barleti shënohet të ketë inkunabula.[6]

Mustafa Pashë Bushatliu thuhet të ketë hartuar Statutin e parë të bibliotekave në Shqipëri.[7]

Rreth viteve 1870-1871 sillet nga jezuitët e para shtypshkronjë në Shkodër: "Shtamperia e seminarit". Sipas H. Bushatit deri në vitin 1928 në këtë shtypshkronjë u shtypën u shtypën 411 tituj librash në gjuhët shqipe dhe latine. Sipas Gj. Fishtës O.F.M. në Shkodër nga 1908-1912 u ngritën 7 shtypshkronja.[8]

Bërthama e Bibliotekës Kombëtare dhe para bibliotekë Albanologjike u krijua në Shkodër në vitin 1916 (Biblioteka e Komisisë Letrare) me drejtues Hilë Mosin.[9]

Më 28 nëntor 1922 u krijua Biblioteka Kombëtare në Tiranë me një fond prej 6000 librash të ardhura nga Shkodra. Karl Gurakuqi ishte një ndër drejtorët e parë të kësaj biblioteke.

Më 1916 vendoset nga "Komisia Letrare" dorëzimi kopjes së detyruar.

Donat Kurti në vitin 1935 llogarit 460 vepra të 136 shkrimtarëve shkodranë.

Në Shkodër doli e para gazetë zyrtare," Ishkodra" në vitin 1897. Deri në vitin 1944 vetëm në Bibliotekën u Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" ruhen 296 tituj periodikësh nga të cilët 56 tituj të botuar në Shkodër.[10]

Familjet shkodrane krijuan biblioteka të pasura, të cilat krahas atyre të institucioneve fetare do të shërbenin si baza të bibliotekave albanologjike të krijuara jo vetëm në Shqipëri por edhe gjetkë, si në Itali, Kroaci, Gjermani etj.

Bibliotekat e traditës dhe pasuritë e tyre albanologjike

Akoma nuk dihet plotësisht numri i bibliotekave me karakter albanologjik që ekzistonin deri në vitin 1994. Në studimin e sipërpërmendur të bërë nga grupi i autorëve, në vitin 1961 rezultonin 28 të tilla, por në studimin e hulumtuesit të palodhur Willy Kamsi, numri tyre shkon në rritje. Ndërsa njihen mjaft mirë krijimi dhe pasurimi i bibliotekave të pasura të institucioneve fetare dhe publike nuk qëndron kështu problemi me bibliotekat personale, të cilat në përgjithësi iu ruajtën ekspozimit. Bardhyli në studimin e bibliotekave të Shkodrës theksonte: "Për bibliotekat private fatkeqësisht nuk na u dhanë shumë shpjegime nga frika se bibliotekave private u biem në qafë dhe u kërkojmë libra për studime"[11] , ndërsa Ragip Gjylbegu, sipas Kamsit,: "Koleksionist i dhanun ishte tejet xheloz i saj (bibliotekës-shën.im) dhe lejonte ta konsultojshin vetëm njerëz që me të vërtetë kryjshin studime dhe jo dëkëdo".[12] Në një renditje kronologjike bibliotekat rreshtohen si më poshtë:

[2] Shih I. Zamputi: Çështje të shkrimit dhe të fillimit të letërsisë në gjuhën shqipe. H. Dritës, 1995, nr. 1-2, f. 27-33.
[3] V. Malaj: Të dhëna albanologjike,vol. 2, Ulqin-Tuz, 1999, f. 280.
[4] Grup autorësh: Kontribut për historinë e Bibliotekave në Shkodër. Shkodra, 1961, f. 95-118.
[5] J. Rrota. Monumenti ma i vjetër i gjuhës shqipe. H.D., 1930, nr. f. 37
· Shih: N.Jokli. D. Dritës, 1930, nr. 3 f. 153. F. Fishta. Çashtja e dy shtypshkronjave të shekullit të XVI, H. Dritës, 1934, nr. 57, 80-84.
[6] W. Kamsi. Bibliotekat në traditën kulturore të Shkodrës. Artikull i cituar. f. 7.
[7] V. Osja. Libri dhe bibliotekat në Shkodër. Artikull i cituar. f. 1
[8] Gj. Fishta. Shqiptarët dhe të drejtat e tyre. Lezhë, 1998, f. 28.
[9] Lajmet e Komisis Letrare Shqipe. Shkodër, 1918. f. 26-28.
[10] W. Kamsi. Katalogu i shtypit shqiptar e për Shqipërinë që gjendet në Bibliotekën e ILP "Luigj Gurakuqi" (1879- 1994). Shkodër, 1989. f. 47-48.
[11] Bardhyli.Historia e Bibliotekave në Shqipëri. "Hylli i Dritës", Vj.XVIII 1942, nr. 5-10, f.314.
[12] Willy Kamsi. Bibliotekat në traditën kulturore të Shkodrës. Artikull i cituar. f. 2

• 1683. Biblioteka Bogdani.
• 1750. Biblioteka e Myftisë të Tabakëve apo Këllyçi.
• 1834. Biblioteka e Vakefit.
• 1858. Biblioteka e Etërve Jezuitë.
• 1875. Biblioteka e Etërve Françeskanë.
• 1880. Biblioteka e Shoqërisë "Bashkimi".
• 1901. Biblioteka e Shoqërisë "Agimi".
• 1911. Biblioteka e Klubit "Gjuha shqipe".
• 1916. Biblioteka e Shoqërisë "Bashkimi".
• 1917. Biblioteka e Komisisë Letrare.

Nëse i hedhim një sy vlerave albanologjike të këtyre bibliotekave, fatkeqësisht tanimë të zhdukura, do të shikojmë se këto biblioteka kanë qenë të specializuara. Ata kanë mbajtur jo vetëm libra, por edhe mjaft dorëshkrime duke krijuar një tip të veçantë bibliotekash, bibliotekat-arkiv. Këto biblioteka janë drejtuar nga njerëz të nderuar, albanologë të shquar si: Hilë Mosi, Zef Valentini S.J., Gjergj Fishta O.F.M., Hamdi Bushati, Tush Kakarriqi, Kolë Kamsi etj.

Ndonëse pasuritë albanologjike përqendroheshin në bibliotekat e komuniteteve fetare, nuk qëndronin më pas edhe bibliotekat personale, një pjesë e të cilave kanë arritur si të tilla deri në ditët tona.

Studiues të ndryshëm, duke qenë shumë të vëmendshëm ndaj çdo vlerë të krijuar, fatmirësisht na kanë lënë të dhëna të shumta rreth këtyre bibliotekave. Pa dashur të analizojmë bibliotekat një për një, po përpiqemi të japim disa të dhëna rreth vlerave dokumentare të tyre.

Studiuesi Willy Kamsi shkruan: "Për literaturën orientale ma e vjetra në Shkodër ka qënë Bibliotekat e Vakëfit, së pari e themelueme dhe pronë e Mehmet Pashë Plakut, e pasunueme prej mbasardhësve të tij e që ma në fundit i qe dhurue Vakëfit, më 1834, prej Mustafa Pashë Bushatit. Në të gjindeshin libra teologjie, jurisprodence, tekste fizike, shkencash natyrore, matematike, filozofie, astronomie e historie. Për Shqipërinë kishte rëndësi të posaçme në atë bibliotekë libri i shkruem shqip me alfabet arab i Tahir Ef. Gjakovës me titull "Vehbije".[13] Bibliotekë tjetër e rëndësishme ka qenë ajo e Myftisë së Tabakakëve apo dhe e Këllyçëve siç quhet. E formuar nga fundi i shekullit XVIII, ajo do ta pasuronte traditën. Për të njëjtën bibliotekë, studiuesja Vjollca Osja, shkruan: "...një nga më të vjetrat dhe nga më të rëndësishmet për vlerat e dokumenteve që përmbante, kjo bibliotekë e krijuar nga K. Këlliçi dhe e pasuruar nga J.Tabaku (Këlliçi) do të ruante deri në shkatërrimin përfundimtar një fond prej 2.000 vëllimesh (këtu përfshihen libra të shtypur dhe dorëshkrime, shumica e të cilave të kopjuara më dorë nga vetë J. Tabaku). Në bibliotekë gjendeshin, mes të tjerash, "Abc-ja shqipe" e botuar me 1900 në Stamboll dhe dy tabelat astronomike të H.Tahsinit.[14] Pasuri të kësaj biblioteke do të ishin edhe dy fjalorët shqip-turqisht dhe turqisht–shqip, me rreth 23.500 të Hafiz Ali Ulqinit, litografue më 1880 në Stamboll.

Kujdes të veçantë bën edhe jezuitët në ruajtjen e vlerave kombëtare. Në bibliotekën e Etërve Jezuitë të formuar në vitin 1858, u ruajtën libra të çmuar të letërsisë dhe historisë kombëtare, si veprat e Bogdanit, Farlatit, Roosit, të Francesco Maria da Lecce, studimet albanologjike të Meyer-it, Ascolit, Hanit, Joklit, Kamardës etj. Në revistën "Leka" në një shkrim kushtuar kësaj biblioteke lexojmë: "Në dy dhoma të ndara ndodheshin shkrimet për Shqipërinë dhe botimet e shtypshkronjes së tyre. Festimi i njëzet e pesë vjetorit të Pavarsisë dhe insiativa e vyer e Lumo Skëndos per formimin e Institutit Albanologjik bënë që Drejtori Kolegjës Saveriane shi për ketë kujtim të njizetepesevjetorit të Pavarsisë dau prei trupit të madh të bibliotekës së vet të përgjithshme gjith koleksionin albanologjik, edhe ngrehi si bibliotekë të veçantë è për shërbim jo vetëm të trupit mësimor të Institutit e të nxansavet, por edhe të Shoqatës "Leka" dhe degës së saj kulturore A.A.S. e të çdo studiuesi.[15] Koleksioni përmbante me tepër se 1000 libra në gjuhën shqipe, 1000 të tjerë që i takonin degëve të ndryshme të Albanologjisë, koleksionin e revistave të botuara gjatë 50 viteve, koleksionin e botimeve të trupës arsimore, koleksionin e 800 copë fotografive një pjesë e të cilave e pabotuar, fotokopje dokumentash historike të mbledhura në një periudhë kohore prej 60 vitesh prej profesorëve të Institutit, të gjitha mbi historinë e Shqipërisë. Në pjesën letrare u ruajtën dorëshkrime të pabotuara të Atë Jungut, Xanonit etj.

Një rol të madh zhvillimit të albanologjisë i ka dhënë edhe themelimi i revistës "Leka" (1929) dhe i Akademisë Saveriane. Në fletët e kësaj reviste nga Zef Valentini S. J. u përpilua "Nomenklatori", që ndonëse u la në fletët e para të tij (208), me të drejtë është quajtur: "e para enciklopedi albanologjike shqiptare". Po nga kjo revistë në shërbim të çështjes kombëtare u botua në vitin 1940, vëllimi me titull: "Të drejtat e Shqipnisë Etnike".

[13] Willy Kamsi. Bibliotekat në traditën kulturore të Shkodrës. Artikull i cituar. f. 3

[14] Vjollca Osja. Libri dhe bibliotekat në Shkodër. Art. i cituar. f. 1
[15] Leka. Numër përkujtimor ", 1937, Bleni II, f. 249.

Biblioteka françeskane në sajë të përkushtimit të etërve: Gjergj Fishta, Shtjefen Gjeçovi, Pal Doda etj. njohu lulëzimin e saj në vitin 1921. Në këtë bibliotekë krahas librave të vyer siç ishte një libër i vitit 1594 në të cilin shënohej: "... ku asht libri ma i vjetër i Provincës së hershme Franceskane", ruheshin edhe dorëshkrimet e kronikat D. P. Zarishtës, Sh. Gjeçovit, A. Marlaskaj dhe të Erasmo de Balneo-s konstruktorit të vërtetë të Pashallekut të Shkodrës dhe ideatorit të të parit bashkëpunim historik ndërmjet muslimanëve dhe kristianëve per me krijue nji shtet të pamvarun shqiptar.[16]

Pasuri të shumta albanologjike gjendeshin edhe në bibliotekat e shoqërive të shumta kulturore dhe artistike që u formuan në Shkodër që në vitet e para të shekullit XIX-të.

Mes bibliotekave të shumta përmendim atë të Komisisë Letrare (1917), rëndësia dhe vlera e së cilës mund të shikohet edhe nga anëtarët themelues të kësaj biblioteke, L. Gurakuqi, Nd. Mjeda, S. Peci, M. Logoreci, L. Naraçi etj.

Hilë Mosi, i zgjedhur si bibliotekar, kërkoi dërgimin e kopjeve të detyruara të botimeve të asaj kohe, duke hedhur kështu një hap të ri në organizimin dhe funksionimin e bibliotekave. Me mjaft rëndësi në grumbullimin e materialeve me karakter albanologjik në këto vite është edhe nisma e studentëve që studionin jashtë Shqipërisë, për grumbullimin dhe dërgimin e librave në Shqipëri në formë dhurate.

Pa dyshim, një vlerë të veçante patën edhe bibliotekat personale, që në qytetin tonë ishin të profilizuara. Kështu mund të përmendim bibliotekat e Pashko Vasës dhe Zef Ndokillisë- Jubani, atë të vëllezërve Ivanaj, që në vitin 1939 numëronte 1800 volume, duke qënë më e pasur se Biblioteka Kombëtare. Kjo bibliotekë ishte e specializuar në fushën juridike dhe të studimeve Ballkanologjike. Bibliotekat e Kolë e Gjon Kamsit ishin të specializuara rreth problemeve që kishin të bënin me arbëreshët, si dhe me problemet ekonomike-financiare e historike, që lidheshin me Shqipërinë. Dalloheshin edhe biblioteka të tjera si ato të Ragip Gjylbegut me koleksione të plota gazetash dhe revistash, Hamdi Bushatit me botime që kishin të bënin me historinë e Shqipërisë. Në këtë bibliotekë ndodheshin edhe mjaft trajtesa albanologjike të nxjerra nga dokumentat turke. Mes bibliotekave të Shkodrës u dallua edhe ajo e beratasit Lluka Karafilit, që shërbeu për shumë kohë në Shkodër, autor i disa punimeve dhe studimeve të pasqyruara në "Hyllin e Dritës", dhe revista të tjera. Biblioteka e tij me rreth 2500 libra në pjesën më të madhe kishte libra të karakterit albano-ballkanologjik.

Një tjetër bibliotekë e vyer për qytetin ishte edhe biblioteka e familjes Kastrati. Ajo dallohej për pasurinë e fondeve në fushën gjuhësore, e artistike.

Përcaktimi i numrit të bibliotekave private dhe pasurive të tyre kërkon një studim të hollësishëm. Të tërheq vëmendjen fakti që në fondet e dy bibliotekave kryesore të qytetit tonë, asaj publike dhe universitare gjendet një pjesë e mirë e pasurisë së këtyre bibliotekave. Nga këto burime kanë ardhur edhe libra mjaft të rrallë, kopje unike si vepra e Gjon Kazazit: "Përmbledhje e shkurtë e doktrinës kristiane", e vitit 1743 etj.

Në pasurimin e fondeve albanologjike të bibliotekave shkodrane, një rol të rëndësishëm kanë luajtur edhe zbulimi i dokumentave, dorëshkrimeve, relacioneve dhe librave në biblioteka të ndryshme të Europës, sidomos në ato të Italisë. Fryt i këtyre gjurmimeve ishte pasurimi i bibliotekave me vepra të rëndësishme fondamentale, si: "Illyricum Sacrum", "Kadastri venedikas i Shkodrës dhe i privilegjeve 1416-1417"; "Acta Albania Veneta" në 27 volume, si dhe sjellja në Shqipëri nga Justin Rrota O.F.M. e fotokopjes së "Mesharit" etj.

Një rol shumë të rëndësishëm luajtën edhe mecenët. Mecenët më të fuqishëm ngelën vetë themeluesit e këtyre bibliotekave. Sipas Hamdi Bushatit, Mustafa Pasha i fali vakëfit bibliotekën e tij, ndërtoi një ndërtesë të veçantë për bibliotekën, e pajisi me libra të zgjedhur dhe shumë të shtrenjtë, siguroi libra të rrallë që nuk i kishin bibliotekat e huaja.*

Dihet tanimë dëshira e Fishtës për të blerë libra të rrallë e të çmuar më qëllimin e vetëm pasurimin e fondeve të bibliotekës françeskane. Krahas blerjeve dhe dhuratës së bibliotekës së tij personale në vitin 1926, ai ishte edhe projektuesi i bibliotekës në vitin 1931. Ky projekt i realizuar një vit më vonë me ndihmën e zviceranes Marija Buhler, njihet si një ndër projektet më të bukura të tijat. Vetë vepra e Fishtës është dhurata më e bukur që ai i bëri bibliotekës françeskane. Në pasurimin e bibliotekës së jezuitëve një rëndësi të veçantë patën edhe dhuratat e dërguara kësaj biblioteke nga personalitete të kulturës brenda dhe jashtë vendit. Ilo Mitko Qafëzezi në vitin 1937, i dhuroi kësaj biblioteke një pjesë të punimeve të tija, të përmbledhura në dokumente linguistikë, historikë, fetaro-didaktikë, arti tipografik, fotografi, dokumente historike të Voskopojës etj. Po

[16] Zef Pllumi. Rrno për me tregue. Tiranë, 2001, vol. 1, f. 47.

* Shih: H. Bushati. Shkodra dhe motet. Shkodër, 1999. f. 98-100.

kështu edhe ballkanologu Tihomir Gjeorgjeviç, në vitin 1930-1931, i fali kësaj biblioteke një pjesë të punimeve të tija.*

Vlerat e vyera të bibliotekave shkodrane patën ngjallur interesin e mjaft studiuesve brenda e jashtë vendit. Mjafton të kujtojmë korrespondencat e Isuf Tabakut me njerëz të ditur nga Kosova, Tirana e Elbasani, që të lënë të mendosh për ekzistencën e mjaft librave dhe dokumentave që i përkisnin Shqipërisë dhe popullit shqiptar. Në të njëjtën linjë vlerësojmë edhe korrespondencat e Lumo Skëndos me Hamdi Bushatin e Atë Zef Valentinin, letërkëmbimin e N. Joklit me françeskanin A. Marlekaj të nxjerrë në dritë nga P. Kotrri etj.

Historia e dëmtimit të këtyre bibliotekave në vitet '20, dhe në vitet para të diktaturës komuniste, si dhe dëmtimet nga faktorët natyrorë, kërkojnë një analizë dhe verifikim të thellë, por një gjë duhet theksuar, dëshira e shkodranëve për të pasur biblioteka nuk u shua. Sot kemi një sërë bibliotekash publike dhe private që mbajnë fonde shumë të pasura albanologjike dhe ballkanologjike. Krahas bibliotekës publike "Marin Barleti", bibliotekës së universitetit "Luigj Gurakuqi", bibliotekës së Muzeut kemi edhe më të rejat, siç është Biblioteka "At Gjergj Fishta" e françeskanëve, ajo e Seminarit Ndërdioçezan Shkodrës, me fond albanologjik, me rreth 10 mijë vëllime, Biblioteka e Myftinisë etj.

Me mjaft interes janë edhe bibliotekat private. Studiuesja Vjollca Osja veçon nga këto biblioteka, bibliotekën e Jup Kastratit me rreth 10 mijë tituj, me drejtim gjuhësor e letrar; biblioteka W. Kamsi me një antikuariat të pasur albanologjik dhe me shumë libra të karakterit ekonomik; biblioteka Hasan Lekaj - me 12 mijë tituj me drejtim letrar; biblioteka T. Osmani me rreth 5 mijë tituj me drejtim albanologjik; bilioteka P. Kotrri me drejtim albanologjik, ku veçohet vepra e plotë e albanologut të shquar austriak, N. Jokli; biblioteka Ahmet Osja etj. Krahas këtyre bibliotekave, mjaft të pasura janë edhe bibliotekat e pedagogëve të universitetit "Luigj Gurakuqi" të Shkodrës, si ato dhe studiuesve të ndryshëm shkodranë.

* Shënim: Mecenët nuk kanë munguar as kohët e fundit mund të përmendim këtu fondin e Arshi Pipës, vendosur në bibliotekën e Muzeut, dhuratat e shumta të ErikaCamës, gruas të të ndjerit Martin Camaj, dhuratat e françeskanëve Daniel Gjeçaj, Paulin Margjokajt, Jak Marlekës mbi të cilat do të ngrihet biblioteka françeskane, fondi albanologjik i bibliotekës së R. Scwanke për bibliotekën e universitetit të Shkodrës, fondi i plotë i veprave të F. Kordinjanos vendosur në bibliotekën e Seminarit Ndërdioçezan, dhuratat e studiuesve dhe shkrimtarëve jashtë atdheut, veçanërisht nga Kosova etj.

Pasuritë albanologjike në bibliotekat e sotme shtetërore

Biblioteka "Marin Barleti"

Biblioteka "Marin Barleti" e qytetit të Shkodrës, një ndër bibliotekat e vyera shqiptare, ruan në fondet e saja vlera të rëndësishme albano-balkonologjike. Një rëndësi të veçantë në vite ka pasur krijimi i një fondit me libra të rrallë për Shkodrën. Ky fond që duhet ripërtërirë, mbante rreth 442 vepra të rralla autorësh kryesisht të huaj dhe shqiptarë, në gjuhët perëndimore dhe lindore. Të një rëndësie të veçantë janë edhe librat që lidhen me historinë e Skënderbeut, ku mund të veçohen librat e Barletit, Beçikemit, Merulës, një vepër pa autor - e vitit 1592, botuar në Amsterdam, dy poema mbi Skënderbeun në latinisht dhe italisht, dy vepra dramatike të shek. XIX në frëngjisht dhe kroatisht, një përmbledhje në greqisht, shtypur në Moskë në vitin 1812 etj. Mes veprave të rralla të letërsisë shqipe janë veprat e Budit, Bogdanit, Varibobës etj. Biblioteka ruan si kopje unikale librin e J. Varibobës: "Gjella e S. Mërris Virgjër" e vitit 1762.

Lista e librave të rrallë të kësaj biblioteke është mjaft e gjatë. Nga kjo listë po paraqesim disa si: "Illyricum Sacrum" (vetëm dy volume), "Acta et diplomata res Albaniae", "Vetera monumenta" të A. Theiner etj. Nuk mund të lëmë pa përmendur faktin se kjo bibliotekë ruan si pasuri të saj edhe 4 inkunabula.

Krahas librave në bibliotekë ndodhen edhe koleksione të pasura të shtypit periodik. Numri i titujve të periodikut nga revista e parë shqiptare (1883) deri në vitin 1944 është 344.

Së shpejti lexuesi do të ketë në dorë në një botim të veçantë, bibliografinë e skanerizuar (kopertina) të pasurive albano-balkonologjike të kësaj biblioteke.

Biblioteka e Universitetit "Luigj Gurakuqi" të Shkodrës

Biblioteka e Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" filloi veprimtarinë e vet me hapjen e Institutit Pedagogjik Dyvjeçar ne vitin 1957, me një fond prej 1000 vëllimesh kryesisht në shërbim të procesit mësimor. Pas vitit 1963 filloi një punë e kujdesshme për pasurimin e fondeve të kësaj biblioteke dhe krijimit të një fondi të veçantë albano-balkanologjik. Në formimin e këtij fondi, njëri nga më të pasurit e llojit të tij në Shqipëri padyshim që merita kryesore i takon Willy Kamsit, njërit nga bibliotekarët më me zë, i njohur në tërë Shqipërinë për punën dhe pasionin e tij për librat, pikë referimi për shumë studiues të shkencave filologjike.

Sipas të dhënave që jep W. Kamsi, fondi albanologjik i Bibliotekës së Universitetit është krijuar nga blerjet e librave më vlerë të familjeve shkodrane. Në këtë bibliotekë, sipas Kamsit: "... zanë vend një pjesë e librave të ish bibliotekës së pasur albano-balkanologjike të Lec Harapit, libra nga biblioteka e prof. Angjelin Saraçit që përfshinte në fondin e vet bibliotekën e konsullit të Austrisë në Shkodër, Theodor Ippen, të blemun në Austri. Nga biblioteka e studjuesit e bashkpuntorit të shquem të "Hyllit të Dritës", Lluka Karafilit (pseud. Bardhyli) me ma se 2.500 libra..".

Fondi albano-balkanologjik përbehet nga rreth 10 mije volume librash e shtyp periodik. Në të ka botime që fillojnë nga shekulli I XVI-të, si dhe mjaft tituj librash e revistash, "kopje unike e të rralla që nuk i ka as Biblioteka Kombëtare e Tiranës në fondet e veta."

Nga librat e rrallë të kësaj biblioteke mund të përmendim Historia de Vita et Gestis Georgii Castrioti Scanderbegi e Marin Barletit (1508- 1510), i cili mban një siglën e pronarit Abatit të Mirditës preng Doçit.; Cronicorum Turcicorum (1578); "Doktrina e Krishtene" e Gjon N.Kazazit (1743) (kopje e vetme në Shqipëri); koleksioni i plotë i revistave Albania e Faik Konicës (Bruxelles-Londër) , Hylli i Dritës (1913-1944), Leka (1929-1944).

Në fond gjenden studime të rëndësishme të albanologëve të huaj për Shqipërinë. Në një vështrim të bërë në fondin e albanologjisë deri në vitin 1944, gjenden 2 libra në gjuhën turke, 62 në gjuhën gjermane, 39 në gjuhën greke, 18 në anglisht, 41 në frëngjisht, 212 në italisht, 20 në gjuhët sllave, 21 në latinisht, 5 në rumanisht , 1 në rusisht, 13 libra të shkruar nga shqiptarë në gjuhë të huaj, 6 libra të autorëve të huaj në gjuhën shqipe. Në fondin e albanologjisë deri në vitin 1944 një vend të rëndësishëm zënë edhe punimet e autorëve shqiptarë. Libra me një autor ose bashkautorë janë rreth 961, pa autorë 671, përkthime 275. Fondin albanologjik e pasuron edhe periodiku shqip sidomos ai deri ne vitin 1944. Në këtë fond nga 297 titujt e regjistruar, 125 janë koleksione të plota dhe 43 thuajse të pa plota.

Krahas fondit albanologjik, një tjetër fond me shumë vlerë është ai i ballkanologjikut, i përbërë nga libra dhe periodike të ndryshëm. Në të ndodhet vepra të shkrimtarëve të dëgjuar të shekullit XIX dhe fillimeve të shekullit XX, që trajtojnë probleme të çështjeve ballkanike, të lidhura ose me krijimin e shteteve te pavarura nga fillimet e shek. XIX deri në vitet '30 të shekullit të kaluar. Shumë nga këto libra dhe periodikë nuk ndodhen në fondet e Bibliotekës Kombëtare.

Në ditët tona fondi albano-ballkanologjik që ndodhet në Bibliotekën e Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", vazhdon të jetë i pasur. Ndonëse blerja e librave të rrallë është bërë e vështirë edhe nga rivlerësimi që këto libra kanë pësuar në publik, fondi ka vazhduar të pasurohet nga dhuratat e albanologëve të shquar të kohës si, E. Hamp, A. Hetzer, R. Scëanke, F. Altimari etj.; nga puna e palodhur e studiuesve shqiptare jashtë atdheut, ku mund të veçojmë atë të studiuesve kosovarë, si dhe nga veprimtaria botuese e punonjësve shkencorë të Universitetit tonë. Një rol të madh në pasurimin e fondit albanologjik ka luajtur Sektori i Albanologjisë, i drejtuar nga Prof. dr. Tomor Osmani në bashkëpunim me të ndjerin Prof. dr . Simon Pepa. Botimet e shumta të këtij sektori ku mund të veçojmë: "Udha e Shkronjave" e T. Osmanit; "Leksiku Historik i Gjuhës shqipe" në 4 volume i Kolë Ashtës; "Tradita bujqësore nëpërmjet thesarit gjuhësor" në dy volume e S. Pepës si dhe kolana "Studime shqiptare" me 11 botime të tjera, bëjnë të mendosh se edhe në të ardhmen kjo bibliotekë do të vazhdojë të ngelet njëra nga bibliotekat më të mira në Shqipëri.

Biblioteka e Muzeut

Biblioteka e Muzeut apo Biblioteka "Arshi Pipa" siç njihet është e krijuar nga dhurata që ky i fundit i bëri vendlindjes së tij, Shkodrës. Biblioteka u vendos në mjediset e Muzeut Historik, nisur edhe konceptimi që Arshi Pipa kishte për bibliotekat, si mjete komunikimi dhe studimi që duhet të jenë pranë qendrave muzeale.

Biblioteka Pipa është një bibliotekë mjaft e pasur. Ajo mban në vete 25 000 vëllime, periodikë, doreshkrime, kaseta etj. Në këtë fond gjenden 363 tituj me trajtesa të mirëfillta albanologjike, 41 tituj me trajtesa ballkanologjike dhe 10 tituj me trajtesa të veçanta për Kosovën dhe problemet e saj.

Vendin kryesor në trajtesat albanologjike e zënë studimet shqiptare të autorëve të huaj dhe vendas, sidomos të viteve '20-44. Nga autorët shqiptarë gjen libra të Gj. Fishtës, Gj. Pekmezit, M. Frashërit, S. Skëndos, M. Logarecit, K. Kristoforidhit, T. Kolgjinajt, E. Vlorës, por edhe të autorëve të tjerë. Nga autorët e huaj veçojmë Mayer-Lubke, Leibnicin, Stadmuller, Cordignano, Valentini, M. Rok, Chomsky, A. Hetzer, S. E Mann etj.

Pipa ka bërë kujdes që në gjuhën shqipe të mos mungojnë edhe veprat e autorëve të letërsisë shqipe. Në këtë fond gjenden edhe një pjesë e mirë e veprave të Nolit, S. Frashërit, N. Mjedës, Migjenit, I. Kadaresë, por edhe të

shkrimtarëve bashkëkohorë të diasporës, si: M. Cama, E. Koliqi , T. Kolgjini, T. Zavalani, Gj. Sinishta etj.

Me mjaft interes janë edhe veprat e grumbulluara nga Pipa për problemet e Kosovës. Dihet tanimë nga të gjithë ndihmesa e tij në çështjen kosovare është e përmbledhur në librin e tij : "Studime mbi Kosovën". Në përpjekjet personale për të pasqyruar sa më saktë trajtesat delikate nacionale, në bibliotekë ndodhen trajtesa të autorëve shqiptarë, si: Rugova dhe Camaj, trajtesa të autorëve të huaj kryesisht atyre gjermanë, mes të cilëve edhe J. G. Hann, Th. Ipen, A. Hetzer, A. Scmaus, por edhe trajtesat sllave për Kosovën, si ato të autorëve: V. Djorxheviç, D. Tucoviç, A. Stipçeviç (kroat me origjinë shqiptare), M. Shuflay, H. Bariç etj.

Lashtësia e emrit, ruajtja e traditave, mundësia e komunikimit etj. e kanë shtyrë A. Pipën të grumbullojë në fondin e tij thuajse pjesën më të madhe të autorëve arbëreshë si : Scura, Guxeta, Sartori, G. Ferrari, Dorsa, Dara, Serembe, Masei, K. Tagliavini, Kamarda, De Grazia, Dushko Vetmo, E. Giordano, G. Petrotta, F. Krispi etj. Me mjaft vlerë për studiuesin janë veprat e De Radës, të cilët Pipa i trajtoi në njërin prej botimeve të veprës: "Trilogia Albanica".

U përpoqëm të trajtonim një pjesë të trashëgimisë së shkruar të popullit tonë që gjendet në bibliotekat shtetërore. Trajtesa do të ishte më e gjerë, nëse do të analizonim bibliotekat e reja të krijuara vitet e fundit.

TRASHËGIMIA KULTURORE E BOTUAR DHE EKZEMPLARI I DETYRUESHËM

Lavdije RRAHMANI
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

Ekzemplari i detyrueshëm - Ligj i njëjtë në shumë vende të botës

Vendi i parë që krijoi Ligjin e Ekzemplarit të detyrueshme ishte Franca. Më 1537 Mbreti Francois I (i pari) nxori një ligj i cili obligonte depozitimin e kopjeve të dokumenteve të shkruara në Francë, me qëllim të krijimit të një koleksioni nacional. Prej atëherë ky ligj është konsideruar nga shumë vende si mjet i rëndësishëm për ruajtjen dhe dokumentimin e traditës dhe kulturës së shkruar për një komb. Rreth 100 vende në gjithë botën zbatojnë ligjin për Ekzemplarin e Detyrueshëm. Gjatë 20 viteve të fundit, ky ligj në vende të ndryshme, varësisht nga zhvillimi i teknologjisë dhe mënyrave të përhapjes së informacionit është modifikuar ashtu që të përfshijnë edhe materiale jo të shtypura.

Numri i kopjeve që depozitohen ndryshon në vende të ndryshme; nga një në Australi deri në tetëmbëdhjetë kopje në Bullgari.

Një numër i madh vendesh sot hartojnë bibliografitë kombëtare duke u bazuar në Ekzemplarin e Detyruar.

Zbatimi i këtij ligji mundëson depozitimin e botimeve në Bibliotekën Kombëtare duke krijuar kështu arkivat kombëtare dhe bibliografitë kombëtare. Botimet e depozituara në këtë mënyrë bëhen pjesë e koleksionit kombëtar të botimeve në forma të ndryshme prej nga lexuesi mund të ketë qasje në çdo moment dhe njëkohësisht bëhen pjesë e trashëgimisë kulturore kombëtare. Kombinimi i Koleksionit të Ekzemplarit të Detyrueshëm ku grumbullohen të gjitha botimet e një vendi me Bibliografinë Kombëtare është shembull i përsosur se si mund të bëhet kontrolli bibliografik kombëtar i një vendi.

Ekzemplari i detyrueshëm në Kosovë

Kosova hyn në radhën e vendeve ku Ekzemplari i Detyrueshëm caktohet me ligj[1]. Në p*eriudhën e ish - Jugosllavisë*, tetë bibliotekat kryesore të vendit ndër to edhe ish Biblioteka Popullore e Kosovës tani Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës ishin qendra të mbledhjes së Ekzemplarit të Detyrueshëm në vend.

Periudha e viteve 90 ishte periudhë vakante sa i përket Ekzemplarit të Detyrueshëm për shkak të masave të dhunshme të ushtruara në biblioteka nga regjimi i atëhershëm serb.

Pas vitit 1999 - me krijimin e një realiteti të ri politik në Kosovë, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, u shkëput nga rrjeti i bibliotekave të ish - republikave të Jugosllavisë dhe në vitin 2003 me nxjerrjen e Ligjit për bibliotekat / Nr. 2003/6, miratuar nga Kuvendi i Kosovës, u bë qendër e depozitimit të Ekzemplarit të Detyrueshëm.

Ekzemplari i Detyrueshëm në BKUK

Për auditorin i cili nuk është i njoftuar se çfarë ndodh me Ekzemplarin e Detyrueshëm pasi hyn në BKUK po japim disa informacione themelore.

Pasi të pesë ekzemplarët arrijnë në BKUK, një prej tyre depozitohet në Koleksionin Muzeal të Kosovës i krijuar brenda BKUK-së, ndërsa varësisht nga vlera e botimit kopjet tjera hyjnë në koleksionet e përgjithshme të bibliotekës. Menjëherë krijohet rekordi bibliografik për secilën njësi dhe pastaj informacioni futet në bazën e të dhënave të katalogut elektronik në rrjet, prej nga lexuesi mund të ketë qasje të lirë. Kopjet të cilat eventualisht mbesin tepricë (botime që konsiderohen më pak të rëndësishme gjithmonë duke u nisur nga kritere të përcaktuara më parë nga BKUK) grumbullohen dhe në raste të caktuara u dhurohen bibliotekave të ndryshme në vend (zakonisht bibliotekave të reja).

Për zbatimin e ligjit të Ekzemplarit të Detyrueshëm BKUK ka bashkëpunim të mirë me botuesit. Megjithatë ka vend për shqetësime.

Problem shqetësues është sigurimi i Ekzemplarit të Detyrueshëm për botimet periodike. Në Kosovë botohen materiale të shumta periodike por për fat të keq një pjesë e madhe e botuesve të këtij lloj materiali të cilët janë institucione shtetërore, institucione private dhe shoqata të ndryshme, nuk i përgjigjen detyrimit ligjor. Ekzemplari i Detyrueshëm për materialet periodike funksionon vetëm për gazetat dhe për disa tituj revistash .

Sado që Ligji për Bibliotekat parasheh sanksione ndaj botuesve që nuk zbatojnë ligjin, këto sanksione deri më tani nuk janë përdorur në asnjë rast edhe pse BKUK ka statistika për botuesit që nuk zbatojnë ligjin. Por përkundër vërejtjeve tona ndaj disa botuesve, ekzistojnë shembuj të shumtë që tregojnë për botues mjaft korrektë.

Megjithatë nuk mjafton vetëm identifikimi i problemeve dhe ngecjeve në sistemin e Ekzemplarit të Detyrueshëm. Në përgjithësi ne, si shoqëri, si dhe institucionet kompetente në veçanti, duhet të bëjnë hapa konkretë që do të ndikonin drejtpërdrejt në mbarëvajtjen dhe rritjen e efikasitetit të sistemit të Ekzemplarit të Detyrueshëm. Funksionimi i dobët i Ekzemplarit të Detyrueshëm i kushton shtrenjtë dokumentimit të trashëgimisë kulturore kombëtare.

Për të pasur nja pasqyrë më të qartë rreth funksionimit të sistemit të Ekzemplarit të Detyrueshëm në vend si dhe dobësive të tij janë identifikuar disa nga çështjet më problematike dhe më të paqartësuara dhe janë dhënë në formë vërejtjesh të përgjithshme:

Ekzemplari i detyrueshëm ende nuk ka kaluar në prioritet për mekanizmat që e kanë krijuar dhe janë të detyruar ta mbajnë në funksion;

Sistemi funksionon dobët (edhe për shkak të mungesës së akteve nënligjore relevante që do të rregullonin çështjet si : definimi i rregullave për shpërndarjen Ekzemplari i Detyrueshëm, definimi i Ekzemplarit të Detyrueshëm si burim i Arkivit Kombëtar të materialeve të botuara dhe Bibliografisë Kombëtare, arkivimi i materialeve me vlerë kulturore dhe qasja në to);

[1] Ligji për Bibliotekat / Nr. 2003/6

BKUK nuk ka staf të mjaftueshëm të koncentruar në Ekzemplarin e Detyrueshëm;

Botuesit nuk i përgjigjen kënaqshëm detyrimit ligjor;

Botuesit nuk stimulohen mjaftueshëm në veprimtarinë e tyre botuese (është fjala për kushtet financiare dhe çështjet që kanë të bëjnë me tatimet që botuesi është i obliguar t'i paguaj shtetit) sidomos botuesit që nxjerrin botime të rëndësishme dhe të kushtueshme, ndaj dorëzimi i Ekzemplarëve u kushton atyre;

Botuesit shprehen të pakënaqur me numrin e Ekzemplarëve që përcakton ligji.

Nisur nga gjendja e nxjerrë më lart e Ekzemplarit të Detyrueshëm në Kosovë, lind pyetja: A mund të bëjmë më tepër si komunitet dhe si shoqëri? Mendojmë se po, dhe kjo do duhej të konsistonte në:

Ndryshimin e qëndrimit tonë karshi Ekzemplari i Detyrueshëm dhe rolit të tij në Kosovë;

Propozime konkrete dhe bashkëpunim më të mirë në të ardhmen mes faktorëve relevantë;

Krijimin e mekanizmave më funksionalë për implementimin e ligjit në tri nivele: Ministri – BKUK – Botues (p. sh. Krijimi i rrjetit online i komunikimit botues – bibliotekë, përmes web faqes, krijimi i një mekanizmi të posaçëm që do të merrej ekskluzivisht me veprimtarinë botuese në Kosovë dhe funksionimin e Ekzemplarit të Detyrueshëm etj.);

Nxjerrjen e akteve nënligjore që do të rregullonin çështjet e padefinuar me ligj (nxjerrja e një rregulloreje për Ekzemplarin e Detyrueshëm, etj.);

Zgjerimin e konceptit të Ekzemplarit të Detyrueshëm duke përfshirë edhe llojet e reja të botimeve siç janë burimet elektronike;

Legalizimi e mbledhjes së web dokumenteve;

Definimin e mekanizmave dhe metodave të shpërndarjes së Ekzemplarit të Detyrueshëm për burimet elektronike .

Ekzemplari i detyrueshëm - perspektiva

Principet e Ekzemplarit të Detyrueshëm mbështeten në rregullat dhe përgjegjësitë e vendosura me ligj me të cilat rregullohen çështje si mbledhja e të gjitha botimeve që dalin në vend, depozitimi dhe ruajtja e botimeve, depozitimi dhe mbrojtja në kushte dhe forma të veçanta i botimeve me përmbajtje dhe rëndësi kulturore e kombëtare etj.

Objektivi kryesor i sistemit të Ekzemplarit të Detyrueshme është të mbajë një arkiv të publikimeve për të ruajtur në mënyrë të dokumentuar trashëgiminë kulturore kombëtare. Në këtë mënyrë, e gjithë krijimtaria kulturore dhe intelektuale e botuar grumbullohet dhe ruhet në një vend prej nga gjenerata të tëra do të shërbehen me informacion të plotë dhe të saktë për aspektet historike, kulturore, artistike, ekonomike, shkencore etj, në vend dhe në botë.

Besojmë se funksionimi i Ligji për Ekzemplarin e Detyrueshëm në Kosovë gradualisht do të përmirësohet, natyrisht me krijimin kushteve më të favorshme për botuesit dhe plotësimin e zbrazëtirave ligjore.

Funksionimi i mirë i Ekzemplarit të Detyrueshëm do ta zgjidhte çështjen e mbledhjes së botimeve brenda Kosovës, por shtrohet pyetja: çka me botimet shqip që dalin çdo ditë në Shqipëri, Mal të Zi, Maqedoni etj. Një pjesë të këtyre botimeve BKUK i siguron përmes metodave tjera të pasurimit të koleksioneve siç janë *blerja, dhurata dhe shkëmbimi* por jo të gjitha. Meqenëse zhvillimi i politikave për pasurimin e koleksioneve në BKUK përveç tjerash synon sigurimin në mënyrë të vazhdueshme të botimeve që dalin edhe jashtë Kosovës, neve na mbetet të punojmë drejt gjetjes së mënyrave më të përshtatshme dhe më funksionale për sigurimin e këtyre botimeve.

Metoda e këmbimit e cila aktualisht në BKUK nuk funksionon mirë, ndoshta do ta zgjidhte deri diku këtë problem, e kjo do të ishte e mundur të realizohej me marrëveshje të ndërsjella mes BKUK-së dhe institucioneve kompetente siç është në Shqipëri Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë. Pastaj marrëveshje të tilla të ndërsjella është e mundur të realizohen mes institucioneve tona të rëndësishme shkencore, publike e jopublike që nxjerrin tituj të rëndësishëm librash e revistash, të cilat do të ishin me interes të ndërsjellë por njëkohësisht to t'i kontribuonin mbledhjes dhe ruajtjes së trashëgimisë sonë kulturore të botuar. Kjo është vetëm një nga metodat konkrete se si mund të lidhen relacione bashkëpunimi ndër institucional e kjo nuk kërkon mund të madh as shpenzime të mëdha, nevojitet vetëm vullnet i mirë.

Çështjen e mbledhjes së botimeve edhe jashtë kufijve shtetërorë do ta zgjidhte shumë mirë funksionimi i një legjislacioni të ndërsjellë në mes të Kosovës, Shqipërisë dhe vendeve tjera me popullsi shqiptare. Ekzistojnë shembuj në botë se si popuj që janë të ndarë në disa shtete e kanë të zgjidhur këtë çështje.

P.sh. Mbretëria e Bashkuar dhe Irlanda kanë krijuar një legjislacion me të cilin i autorizojnë gjashtë bibliotekat më të mëdha të këtyre dy vendeve si: The British Library, The National Library of Scotland (Edinburgh), The Bodleian Library (Oxford), Cambridge University Library , The Trinity College (Dublin)

dhe The National Library of Wales (Aberystwyth), të jenë qendra të depozitimit të ekzemplarit të detyrueshëm. Me siguri që këtyre shteteve një gjë e tillë u është bërë e mundur në saje të një rregullimi juridik të veçantë që kanë , por kjo nuk do të thotë që vende të ndryshme të mos kenë mundësi krijimi mekanizmash të tillë ligjorë, si shembulli i këtyre dy vendeve, për një bashkëpunim në këtë fushë dhe në fusha tjera të zhvillimit të kulturës së një populli që jeton i ndarë në disa shtete.

Selektimi dhe ruajta e materialeve me vlerë

Trashëgimia kulturore e njerëzve është kujtesa e jetës së tyre kulturore. Identiteti kombëtar kulturor varet kryesisht nga sigurimi i jetëgjatësisë së kulturës materiale. Institucionet si Biblioteka Kombëtare e një vendi duhet të jenë të autorizuara të sigurojnë jetëgjatësinë e trashëgimisë kulturore të botuar në të gjitha format. Sigurimi i jetëgjatësisë së trashëgimisë kulturore të botuar është i rrezikuar në vazhdimësi.

Shmangia e një rreziku të tillë do të bëhej më së miri me hartimin e një strategjie afatgjate për ruajtjen e trashëgimisë kulturore të botuar në Kosovë.

Biblioteka Kombëtare duhet të jetë përgjegjëse dhe e zonja të krijojë kushte të mira për mbledhjen dhe ruajtjen e botimeve në formë të shtypur si dhe për botimet në forma të tjera[2].

Sot, humbja e shumë materialeve të rëndësishme bibliotekare, të botuara në forma të ndryshme, cenon drejtpërsëdrejti trashëgiminë kulturore kombëtare të botuar, pikërisht për shkak të mosmbrojtjes ligjore. Sistemi i Ekzemplarit të Detyrueshëm për disa forma botimesh funksionon dobët e për disa tjera nuk funksionon fare. P. sh. në BKUK mungojnë koleksione si ai i materialeve radio-televizive.

Në Kosovë vitet e fundit ka pasur zhvillime të mëdha në fushën e mediave elektronike.

Materiale të shumta me vlerë kulturore e shkencore, emetohen çdo ditë në radiot dhe televizionet tona, pastaj krijimtaria në fushën e filmit kohët e fundit ka pasur zhvillime të dukshme.

Për mbledhjen dhe sigurimin e jetëgjatësisë së këtyre materialeve nuk mjafton vetëm mbështetja tek botuesit e këtyre lloj botimeve sepse ata shpesh mund ta hedhin informacionin po sa ta kryejnë veprimin, ose mendojnë se është joekonomike të ruajnë informacione për të cilat konsiderojnë sa tashmë e ka humbur rëndësinë ose vlerën komerciale.

Nuk është e mundur por as e dëshirueshme të ruhet gjithçka që botohet. Derisa botuesit kanë obligim të sjellin të gjitha botimet për t'i depozituar, institucionet publike si Biblioteka Kombëtare krijojnë kritere për të selektuar çfarë është e denjë për të qenë vlerë e qëndrueshme kulturore kombëtare[3]. Kjo nënkupton pranimin ose refuzimin e materialit për depozitim si dhe të drejtën për të mos selektuar materialet që gjykohen si materiale pa vlerë të qëndrueshme kulturore ose mund të jenë më të përshtatshme të sistemohen diku tjetër. Ky proces duhet të jetë i përshtatur ashtu që të jetë transparent, me rregullore të publikuar dhe të hapur për shqyrtim dhe diskutim.

Avancimet e teknologjisë kanë ridefinuar natyrën e ruajtjes dhe arkivimit të materialit bibliotekar si dhe mënyrat e qasjes në informata.

Institucioneve përgjegjëse si Biblioteka Kombëtare u nevojiten rregulla dhe kritere të qarta për të zgjedhur formën e përshtatshme për depozitim nëse materiali me të njëjtën përmbajte është ofruar në disa forma. Njëkohësisht BKUK duhet të ndërmarrë veprime që konsiderohen të rëndësishme për të siguruar qëndrueshmërinë e materialeve e kjo nënkupton kopjimin ose transformimin e informacionit në forma botimi që ofrojnë qëndrueshmëri më të madhe për përmbajtjen e materialeve të caktuara, përfshirë këtu edhe digjitalizimin e tyre.

[2] Ligji për biblioteka: neni 22; pika 22.3.6 thotë: Biblioteka Kombëtare është qendër e restaurimit dhe konservimit të librit

[3] Ligji për Trashëgiminë Kulturore: neni 9; pika 9.1 Trashëgimi e luajtshme sikur është caktuar në nenin 2. 5 përbëhet nga: dorëshkrimet, dokumentet fetare ose civile, librat, publikimet me rëndësi historike, shkencore ose artistike (ky nen përmban më tutje gjithë atë që konsiderohet trashëgimi e luajtshme)

ANIMIMI I KRIJUESVE DHE PËRDORUESVE PËR BIBLIOTEKAT E MUZIKËS

Edona MUNISHI - KOKOLLARI
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

Zhvillimet teknologjike informative ka kohë që janë bërë objekt diskutimesh, hulumtimesh e studimesh në shumë fusha e disiplina të dijës. Teknologjia moderne ka arritur të imponojë frikën dhe të krijojë skepsën rreth funksionit të deritashëm të institucionit Bibliotekë dhe pasurisë intelektuale që ruan dhe ofron ajo. Është e qartë se kjo gjendje dyshimi ka të bëjë me formën tradicionale të informimit, të arritjes së dijës që bëhej kryesisht (ose vetëm) përmes librit, përmes shkrimit. Tani me këtë avancim teknologjik ka ndryshuar mënyra e komunikimit, mënyra e pranimit të informacionit dhe mënyra e njohjes së botës. Mirëpo gjithnjë e më shumë po mbizotëron mendimi dhe konstatimi se libri, institucioni i bibliotekës mbesin të pazëvendësueshme dhe të përjetshme në shërbim të të interesuarve për to. Për kënaqësitë që sjell libri dhe për pazëvëndësueshmërinë e tij, shkrimtari i madh

Jorge Luis Borges shkruan: "Ndër instrumentet e shumtë të njeriut, më i mahnitshmi, pa dyshim është libri. Instrumentet e tjera janë zgjatim i trupit të tij. Mikroskopi dhe teleskopi janë zgjatim i pamjes; telefoni është zgjatim i zërit; kemi edhe parmendën dhe shpatën, kuptohet zgjatime të krahut. Por libri është diçka tjetër: libri është zgjatim i kujtesës dhe imagjinatës. Në librin "Cezari dhe Kleopatra", Bernard Shaw thotë për Bibliotekën e Aleksandrisë se ajo është kujtesa e njerëzimit. Por, libri ka diçka më tepër. Ai është edhe imagjinata e tij."[1] Thuhet se të dhurosh një libër, një vepër muzikore në Bibliotekë është barazi me kontributin që ka dhuruesi i gjakut. Shpëton një jetë me gjak, kurse u ofron një vlerë me mijëra njerëzve. Prandaj, sikur që nuk ka dhembje për dhuruesin e gjakut ashtu nuk ka kurrfarë dhembje edhe për dhuruesin e librit a veprës muzikore.

Nga të gjitha fushat e dijes dhe të artit, muzika sikur ka përjetuar dhe ka pësuar një goditje më të rëndë të shkaktuar pikërisht nga zhvillimet teknologjike të incizimit dhe të emetimit-transmetimit. Njohësve te teknikës dhe muzikëdashësve u është e njohur rruga e zhvillimit të mjeteve të fiksimit-incizimit dhe të pranimit të tingullit-muzikës gjatë kohës[2]. Dhe. Që nga koha e paraqitjes së gramafonit, më pas e magnetofonit, radio e televizionit, droja se muzika si art po humb përjetimin e gjallë, dhe se po bëhet material i teknikës, kurse bibliotekat e specializuara të zbrazëta nga mos interesimi i muzikëdashësve, nuk ka pushuar, por sa po kalon koha dhe po bëhet adaptimi i njeriut me këto rrjedha, ndjenja e frikës dhe e skepsës po minimizohet, kurse forma institucionale e pranisë së muzikës po tërheq vëmendjen e krijuesve, botuesve, prodhuesve muzikor dhe së fundi edhe të institucioneve të bibliotekarisë dhe të vetë përdoruesve. Prandaj, gjithnjë e më shumë, zhvillimi teknologjik modern po sjell edhe politikë bashkëkohore zhvillimore të Bibliotekës dhe qasje moderne të përpunimit dhe të ofrimit të pasurisë intelektuale të vendosur në Biblioteka. Duke e parë muzikën si një lëmë specifik pak më të dallueshëm për nga mënyra e komunikimit, mënyra e pranisë së saj institucionale në bibliotekë, vendosa që paraqitjen time në këtë konferencë ta përqendrojë në një temë me interes për t'i vënë relacionet dhe raportet mes bibliotekës së specializuar të muzikës dhe shfrytëzuesit të saj në erën bashkëkohore, pra për ta parë bashkekzistencën koherente të ofruesit dhe të përdoruesit.

[1] Jorge Luis Borges, Lumturia e librit, marrë nga gazeta "Shekulli",Tiranë. 15.08.2005
[2] Rreth zhvillimit teknologjik të mjeteve incizuese shih: Jacque Chailley, 40.000 vjetë muzikë, (përkthyer nga Sokol Shupo), ASMUS, Tiranë,1999, f. 205-212

Njoftime të shkurtra për Sektorin e muzikës në BKUK

Në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës veprojnë disa Departamente. Në Departamentin e Koleksioneve të Veçanta është edhe Sektori i muzikës që përfshin fondet, muzikalet e materiale të tjera muzikore. Sikur edhe i tërë institucioni i BKUK-ës që është në fazën e rimëkëmbjes dhe kyçjen në zhvillimet moderne të bibliotekarisë, edhe Sektori i muzikës po përjeton fazën e konsolidimit. Me angazhimin e punonjësve të bibliotekës dhe natyrisht pak më theksueshëm të të punësuarës në këtë sektor, është arritur që të bëhen disa punë në krijimin e një fizionomie përcaktuese të natyrës së këtij sektori. Në kryerjen e punëve, janë respektuar disa faza të domosdoshme të ecurisë së detyrave që ka parashtruar vetë karakteri bibliotekar i fondeve dhe i materialeve muzikore që kanë ekzistuar dhe që kemi arritur t'i sigurojmë.[3]

E ndihmuar nga punonjës të BKUK-ës u bë regjistrimi i materialeve që kishin ngelur nga lufta, vazhduam me koleksionimin e literaturës në kushte rrethana jo të favorshme, u kyçem në numrin standard të muzikës ISMN (u përkthye doracaku përdorues i ISMN-së dhe) , i regjistruam fondet muzikore që kishin mbetur dhe këto ishin disa nga rezultatet e punëve që ishin arritur të realizohen brenda këtyre viteve etj. Por, ambiciet dhe synimi im ishte që ta shtoj sasinë e koleksioneve muzikore, ta tërheq përdoruesin dhe krijuesin në Bibliotekë gjithnjë e më tepër. Për këto synime shtruam disa herë projekte, idealizuam plane, provuam të vëmë lidhjet dhe komunikimin me krijues, prodhues të muzikës.

Duke qene e njoftuar për të gjitha perfeksionimet e zhvillimeve të mjeteve incizuese e reprodukuese të muzikës, për mundësitë e shumta të njohjes së literaturës muzikore përmes internetit, pozicioni im prej bibliotekareje të kësaj fushe bëhej më i rëndë dhe me kërkesa për të hulumtuar po edhe sugjeruar rrugë që bibliotekën e specializuar të muzikës ta bëj tërheqëse për të gjithë të interesuarit. Në këtë kontekst, që në përcaktimin e temës zgjodha nocionin animim, të cilin analizuar më seriozisht do të dilte shumëkuptimor[4].

[3] Që nga viti i punësimit tim (shator 2003) në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës me shumë etnuziazëm e kisha kuptuar punën në këtë institucion e edhe më tepër më shtohej entuziasmi që punoja në Sektorin e muzikës. Si nismëtare e punës në këtë sektor, e ndieja veten përgjegjëse për t'u angazhuar në konsolidimin dhe krijimin e rrethanave të favorshme për funksionimin e këtij sektori.
[4] Fjalën animim e parapëlqyem ta përdorim edhe nga shpjegimi enciklopedik. Për këtë fjalë, Milan Vujaklia shkruan: "Animirati (me animue E.M.) (lat. Animare) me i dhanë shpirt ose frymë, me ngjallë, potencuar, përkrahur, ringjallur, etj…" Shih, M. Vujaklia, Leksikon Stranih reci i izraza, Prosveta, Beograd, 1980, f.50.

E vetëdijshme për rrezikun që i kanoset bashkëpunimit të bibliotekës muzikore[5] dhe shfrytëzuesve të saj nga teknologjia moderne, me kumtesën time do të përpiqem që synimet tona të kalojnë nëpër tri faza veprimesh të zhvilluara paralelisht për ta arritur qëllimin që duhet ta kishte ekzistimi i sektorit-departamentit të muzikës në kuadër të një Biblioteke Kombëtare: Krijimi i kushteve për funksionimin e sektorit, angazhimi për koleksionimin e materialeve-fondeve muzikore dhe, aktiviteti permanent në animimin e krijuesve-kompozitorëve për ta ofruar krijimtarinë e tyre në bibliotekë dhe përdoruesve-shfrytëzuesve të bibliotekës muzikore. Këto i konsiderojmë parakushte për të arritur rezultate të ekzistimit të Bibliotekës moderne të muzikës.

Krijimi i kushteve për mbarëvajtjen e Sektorit të muzikës

Shikuar nga një retrospektivë e BKUK-ës, duhet pranuar si veprim të dobishëm kur është planifikuar që në kuadër të Departamentit të Koleksioneve të Veçanta të përfshihen edhe fondet muzikore. Kjo bërthamë muzikore brenda këtij departamenti dita më ditë po bën orvatje për t'u konsoliduar dhe për t'u shndërruar në një minibibliotekë profesionale. Nëse qëllimi i bibliotekës është që të koleksionojë, ruajë dhe ofrojë shërbime, atëherë kompetentët dhe të punësuarit duhet t'i kenë parasysh këto tri kërkesa. Dhe, për t'i realizuar këto, duhet plotësuar kushte të caktuara të punës dhe të veprimtarisë funksionale.

Për dallim nga lëmit e tjera të dijës, muzika ka një specifikë të veçantë edhe si krijimtari, por mënyra e shfrytëzimit të saj në bibliotekë del më komplekse. Për t'u bërë sot një punë me standarde të kërkuara të kohës, duhet krijuar kushte jo vetëm teknike po edhe hapësinore. Tri veprimtaritë kryesore të muzikës: shkrimet për muzikën (libri), muzika e shkruar-kompozuar (muzikalet) dhe muzika e realizuar (incizimet)[6] të interesuarve duhet t'u ofrohen në veçanti. Këtij kompleksiteti në bibliotekë, për t'i dalë në ballë, i nevojitet një avancim organizativ brenda institucionit të BKUK-ës. E shohim të domosdoshëm ndarjen e këtij sektori nga Departamenti i Koleksioneve të Veçanta dhe krijimi i Departamentit të muzikës, të cilin duhet vendosur në hapësirat (lokalet) adekuate për tri veprimtaritë që përmendëm më lartë. Kështu është vepruar (dhe veprohet) në Bibliotekat e mëdha të karakterit kombëtar. Departamenti i muzikës është njësi e veçantë, të cilës i besohet detyra që në një vend të koleksionojë dhe me standarde të përpunojë, ruajë dhe ofrojë në shfrytëzim libra për muzikën, revista muzikore, muzikale dhe audio e video-materiale formatesh të ndryshme, si dhe lëndë tjetër (p.sh. programe koncertesh, pllakate e të ngjashme), që janë ngushtë të lidhura me artin muzikor"[7].

Hapësira muzikore në bibliotekë

Muzika e koleksionuar dhe e vendosur në bibliotekë, përveç që ka karakter konservimi-ruajtjes ka edhe karakterin e shfrytëzimit të materialit. Misioni i saj është që ajo të jetë sa më afër përdoruesit të interesuar. Shfrytëzimi i muzikës dhe i fondeve muzikore, bëhet për ta përjetuar, për të marrë informacione, po edhe për ta analizuar e studiuar. Funksionimi sa më racional dhe komod i Departamentit të muzikës (apo i bibliotekës së muzikës) shtron nevojën e posedimit të hapësirave adekuate për shërbimet e caktuara që ofron biblioteka e këtij karakteri. Vendosja e librave, revistave muzikore, fjalorëve, leksikoneve, etj. duhet ta kenë hapësirën e veçantë me vitrina. Po kështu, në raftet e vitrinave duhet vendosur muzikalet (partiturat), pastaj tavolina të veçanta për fotose, dorëshkrime, katalogë, programe të koncerteve etj. Fonoteka, gjithashtu, kërkon (materialet e incizuara-filmuara) ormare e rafte të caktuara për vendosje. Të gjitha këto klasifikohen, regjistrohen me kriteret standarde të bibliotekarisë muzikore. Në anën tjetër, të interesuarit për shfrytëzimin e pasurisë muzikore që gjendet në bibliotekë, duhet siguruar hapësirat e studimeve-hulumtimeve, analizave, hapësirën e dëgjimit të muzikës me të gjithë aparaturën përcjellëse, kompjuterë etj. Krijimi i këtyre kushteve do ta tërhiqte të interesuarin në shfrytëzimin e hapësirave të bibliotekës muzikore.

Pasurimi - koleksionimi i vazhdueshëm i fondeve - materiale muzikore

Brenda këtyre viteve për Sektorin e muzikës është arritur të sigurohet një sasi librash mbi muzikën fushash të ndryshme që kryesisht ishin dhuratë e autorëve shqiptarë, por fare pak është blerë literaturë muzikore qoftë kombëtare ose

[5] E shohim të arsyeshme që Sektorin e muzikës, po të ishte Departamenti i Veçantë i Muzikës, në kuadër të Bibliotekës, ta trajtojmë si një Bibliotekë specializuese. Pra, Biblioteka në Bibliotekë. Me këtë emërtim e hasim edhe në bibliotekat evropiane e botërore. Veçojmë shembullin e "Biblitheque National Français" ku është: "Departament de la musique", por që gjithnjë kur bëhet fjalë për të cilësohet si: "La Bibliotheque de la Musique (marrë nga interneti:http:www.darelkotob.org/FRENCH/HTML/LIBRARY/ musique.htm-21.07.2007) po edhe nëpër Bbilioteka të tjera qendrash të ndryshme.

[6] Më gjerësisht rreth kushteve të vendosjes së fondeve e materialeve muzikore shih: Vedrana Juriçiq dhe Anja Vukasoviq-Rogaç, Glazbene Zbirke u Narodnim Knjiznicama, Naklada Benja, Rijeka, 1998, f.29-39

[7] Glazbene zbirke …Op. cit. f. 17

ndërkombëtare e aspak muzikale (vepra muzikore në partitura) dhe incizime në CD e DVD materiale. Natyrisht kjo ka ndodhur për mungese të mjeteve materiale e jo për mungesë vullneti të kompetentëve të Bibliotekës. Muzika, me tërësinë e vet, qoftë kur shfaqet në formën artistike - me krijimtari, qoftë në atë shkencore studimore është një fushë e kushtueshme, me kërkesa relativisht të mëdha materiale. Të shtrenjta janë librat, revistat mbi muzikën, të shtrenjta janë materialet fonike (të zëshme) audio e video, po edhe më të shtrenjta janë muzikalet (krijimtaria muzikore në partitura). Dhe këtë fakt duhet ta kenë të ditur kompetentët që ndajnë mjete financiare për këto veprimtari. Por, po ata duhet ta kuptojnë se nuk ka politikë zhvillimore të kulturës pa investime në vetë kulturën dhe në rastin konkret edhe në bibliotekat e specializuara të muzikës.

Format tashmë të njohura të sigurimit të fondeve bibliotekare, siç janë: dhurimi, shkëmbimi dhe blerja në rastin e materialeve muzikore ecën diç më vështirë pikërisht nga specificiteti që ka muzika. Përkundër kësaj, duhet hulumtuar forma që të koleksionohen materialet që mund të sigurohen sa më lehtë. Meqë BKUK është institucion i karakterit gjithëkombëtarë, duhet vënë kontaktet , lidhjet me kompozitorë e krijues të tjerë shqiptarë që t'u përgjigjen ftesave të Bibliotekës dhe ta ofrojnë krijimtarinë e tyre këtu. Të vihen kontakte me institucione-biblioteka hapësirash shqiptare dhe të shkëmbehet krijimtari-materialet muzikore etj.

Më i vështirë është sigurimi i muzikaleve (partiturave) të literaturës botërore, e cila edhe është mëse e nevojshme për mjedisin tonë kulturor[8]. Këto vështirësi dalin nga çmimet e shtrenjta që i vënë botuesit e veprave të literaturës muzikore. Për këtë lloj fondesh muzikore bibliotekare, kërkohet ndarje mjetesh të veçanta të arsyetuara me projekte të shtruara me kritere profesionale.

Angazhimi në gjetjen e formave të animimit të krijuesve - kompozitorëve dhe përdoruesve të bibliotekës

Nëse paraprakisht institucioni që pretendon të ketë brenda organizmit të vet edhe lëndë muzikore duhet të mendojë mirë se ai departament ka karakter publik dhe i dedikohet të interesuarve për ta shfrytëzuar në varësi të kërkesave të

[8] Pretendimet tona që ta kemi Filharmoninë e Kosovës, Shtëinë e Operas e të Baletit, kore profesionale e amatore, të gjitha nivelet e shkollimit-arsimimit muzikor, të bëjmë studime muzikore dhe të mos ketë një bibliotekë prej së cilës do të sigurohej literaturë muzikore, del një absurditet kulturor i pafalshëm. Nuk jemi të vetëdijshëm se në çfarë pozicionesh gjendet dirigjenti, instrumentisti, studiuesi, të cilët me mundime të jashtëzakoshme arrijnë të sigurojnë literaturën e caktuar muzikore për t'i realizuar projektet e tyre në të mirë të këtij mjedisi kulturor.

përdoruesve. Me supozimin se janë krijuar kushte paraprake që u përmendën, për këto duhet të bëhet një publicitet (thënë kushtimisht) për praninë e bibliotekës muzikore Brenda një Institucioni më të madh[9]. Për ta kryer misionin që ka biblioteka në përgjithësi dhe ajo e muzikës në veçanti, kërkohet një angazhim i vazhdueshëm në tërheqjen e përdoruesve. Krijimi i kushteve të kohës moderne po ashtu kërkon edhe një qasje moderne në ofrimin e shërbimeve për të interesuarit.

Të punësuarit në sektorin e muzikës kanë nevojë për ndihma natyrash të ndryshme: nga ato materiale e deri te përkrahjet morale e organizative.

Që në titullin e temës e përdorëm nocionin animim dhe tani në pika të shkurta përpiqem ta sqaroj mendimin tim rreth kësaj forme të tërheqjes së krijuesve dhe përdoruesve të muzikës në bibliotekë.

Po qe se është plotësuar kushti i parë i krijimit të kushteve, tani veç është tërhequr vëmendja e atyre që duhet animuar, te ta tani është zgjuar kërshëria dhe siguria se aty mund të bëhet puna që i interesuari mund ta ketë.

Në institucionin e bibliotekës, ku ekziston Sektori ose Departamenti i muzikës, sugjerohet që të ketë aktivitete të ndryshme të karakterit muzikor: koncerte të veçanta (jo vetëm me rastin e promovimeve, Javës së Bibliotekës ose për ndonjë ngjarje tjetër), ekspozita të botimeve në fushë të muzikës (jo vetëm në gjuhën shqipe), ekspozimi i krijimtarisë muzikore të kompozitorëve shqiptarë dhe ndërkombëtar shoqëruar me ekzekutimin e veprave të tyre, organizimin e shpeshtë të bisedave, tribunave e konferencave që për tema ta kenë gjithnjë muzikën etj.

Përfundime

Në mjaft raste, në jetën tonë kulturore, muzika sikur neglizhohet (për të mos thënë pak më ashpër injorohet) dhe shpesh merret si diçka e dorës së dytë në krahasim me fusha të tjera të dijës. Kjo bëhet jo pse neglizhuesit ose injoruesit janë vërtet injorantë, po nga specificiteti që ka muzika si art në vete dhe të kuptuarit e saj në masën që duhet kuptuar. Prandaj, nuk duhet të krijohet ndjenjë

9 Para një kohe, për nevoja të BKUK-ës dhe për ta plotësuar punimin tim të diplomës në Fakultetin e Arteve Dega e Artit Muzikor, bëra një anketë me nxënës, studentë të muzikës dhe ndonjë profesor përmes së cilës kisha qëllimin të konstatoja sa janë ata të njohur se në Kosovë ka sektor, department ose bibliotekë të specializuar të muzikës. Dhe, nga ai anketim, mësova se një numër shumë simbolik i të anketuarve kanë njohuri se ekziston diku një hapësirër ku ka libra mbi muzikën, partitura veprash muzikore dhe materiale të incizuara. Ishte ky një fakt sa shqetësues aq edhe një vërejtje se duhet bërë më shumë në propagimin e këtij sektori të BKUK-ës.

e çfarëdo revolte, nëse bibliotekat e specializuara të muzikës nuk vizitohen nga përdorues në çfarëdo forme të të interesuarve të fushave të tjera. Por, ata që i takojnë lëmit të muzikës nga përgjegjësia profesionale do të duhej që biblioteka e këtij karakteri të jetë hapësirë reference për çfarëdolloj përdorimi.

Me një temë të shkurtër nuk pretenduam se do ta shterojmë problemin e specificitetit që ka biblioteka muzikore, por kishim vetëm një synim që të interesuarve për fushën e muzikës t'ua bëjmë me dije se Biblioteka duhet të bëjë tri veprime që të arrijë te ofruesi dhe përdoruesi i këtij institucioni: ta bindë se ka ku të shkojë, të besojë në institucion, dhe së fundi të hyjë në bibliotekë. Po të shkoqiten këto tri veprime, do të sillen disa përfundime:

- Në institucionin ku vepron Sektori, Departamenti ose ku ka Bibliotekë të pavarur të muzikës, duhet të krijohen kushte e rrethana të funksionimit bashkëkohor me të gjitha kriteret që ka bibliotekaria e kësaj kohe;

- Mjedisi kulturor që dëshiron të ketë institucione të këtij karakteri (biblioteka të muzikës), duhet ta kuptojë se dobitë e pranisë së tyre janë të shumanshme dhe se, veprimtaria e tyre, në forma të ndryshme ndihmon e ndikon në arsimimin, edukimin e të gjitha niveleve arsimimi muzikor, po edhe ndikon dukshëm në emancipimin e gjithmbarshëm të kulturës muzikore të hapësirës më të gjerë kulturore;

- Sikur edhe në qendra të tjera të rajonit, të Evropës dhe qendra botërore edhe këtu në Kosovë është domosdoshmëri e pashmangshme ringjallja e bibliotekave profesionale që dikur ishin në Shkolla të muzikës, në Fakultetin e Arteve dhe ato të ripërtërihen në kushte e rrethana të reja në hap me të arriturat bashkëkohore të bibliotekarisë botërore;

- Krijuesit-kompozitorët shqiptarë duhet të binden, ta kuptojnë drejt misionin e bibliotekës, t'i besojnë asaj dhe ta ofrojnë krijimtarinë e tyre në sasinë çfarë parashihet me ligjet e bibliotekarisë;

- Shfrytëzuesi-përdoruesi i fondeve, materialeve muzikore duhet të bindet në kushtet e mira që ofron institucioni i bibliotekës dhe se kërkesat e tij të çfarëdo natyre do të realizohen me shpejtësi dhe efikasitet të të punësuarve në bibliotekë;

- I interesuari për ngritjen e tij muzikore, për kënaqësitë që sjellë vetë atmosfera e ambientit bibliotekë, më në fund duhet të futet brenda mureve të kësaj shtëpie e cila gjatë tërë historisë së njerëzimit ka qenë një hapësirë e shenjtërisë intelektuale dhe ashtu do të jetë edhe në ardhmërinë e njerëzimit pavarësisht nga të gjitha zhvillimet teknologjike që po i afrohen njeriut;

- Po të ngrihej biblioteka e muzikës në nivelet standarde çfarë kërkohen me kritere të bibliotekave muzikore në qendrat e mjediset e tjera kulturore e që ne këtu në pika fare të shkurtra i veçuam, atëherë krijuesit dhe përdoruesit do të "ledhatoheshin" e intrigoheshin për ta vizituar më shpesh këtë bibliotekë dhe kështu plotësisht do të arsyetohej përdorimi i nocionit konotativ animimi që ne e vumë në titull të kumtesës tonë.

BIBLIOTEKA PRIVATE, PJESË E TRASHËGIMISË KULTURORE KOMBËTARE

Violeta VISO
Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë

Tradita e lashtë dhe e gjithanshme kulturore e vendit tonë, ka qenë dhe është e shtrirë edhe në fushën e librit. Janë të shumta dëshmitë që flasin për qenien e librave e shkrimeve të ndryshme të hershme. Si pasojë edhe ekzistenca e bibliotekave është shumë e hershme. Këto biblioteka vlerësoheshin jo vetëm nga numri i librave që kishin, por edhe nga përmbajtja e tyre, pra nga vlerat që ato mbanin.

Vlen të përmendim këtu bibliotekën e Ibrahim Pashë Vlorës, me mbi 2000 dorëshkrime në pergamenë në gjuhët orientale (arabisht, persisht, turqisht), por që fatkeqësisht u dogj në vitin 1914, bibliotekën e Bushatllinjve, bibliotekën e Myfit Bej Libohovës, bibliotekën e "Komisisë Letrare Shqipe", bibliotekën e Mit'hat Frashërit me rreth 40000 libra me vlera të rralla dhe albanobalkanologjike, nga të cilat 18000 libra ndodhen në fondet tona, bibliotekën e

Vakëfit me rreth 3000 vëllime me përmbajtje teologjike, juridike, fetare, historike, astronomike etj., bibliotekën e Mitropolisë së Beratit, bibliotekën e Tabakëve me rreth 2000 volume, e cila është djegur tre herë dhe shumë libra janë dëmtuar, bibliotekën françeskane me rreth 30000 volume, një pjesë e të cilave u dogjën dhe u dëmtuan në periudhën e reprezaljeve ndaj institucioneve në regjimin e Hoxhës, bibliotekën "Për djelmninë" apo siç njihet biblioteka "Karnarvon" e krijuar më 1929 me ndihmën financiare të konteshës Karnarvon etj.

Këto biblioteka, me thesare të rëndësishme të kulturës sonë kombëtare me përmbajtje historike, gjuhësore, letrare dhe fetare, u bënë burimi kryesor i pasurimit të fondeve të Bibliotekës Kombëtare, veçanërisht të fondeve të antikuarit, dorëshkrimeve, arkivit dhe të albano-balkanologjisë.

Si bërthamë për krijimin e Bibliotekës Kombëtare shërbeu fondi i bibliotekës së "Komisisë Letrare Shqipe", organizëm i përbashkët shqiptaro-austriak, i krijuar në Shkodër në vitin 1917. Fondet e rralla të Bibliotekës Kombëtare u rritën kryesisht si rezultat i konfiskimit të koleksioneve të disa librarive dhe bibliotekave private të personaliteteve të kulturës. Një nga bibliotekat që u bë burimi kryesor për pasurimin e fondeve të Bibliotekës Kombëtare ishte biblioteka dhe libraria e Mit'hat Frashërit, i cili njihet jo vetëm si politikan, publicist, studiues dhe albanolog, por edhe si bibliotekar dhe bibliograf. Si njohës i shumë gjuhëve të huaja, njeri me një kulturë mjaft të gjerë, bibliograf dhe bibliofil i apasionuar, ai kishte grumbulluar mjaft libra të rralla dhe me karakter tërësisht albanologjik që trajtojnë probleme të rëndësishme për Shqipërinë dhe shqiptarët, historinë, prejardhjen dhe gjuhën e tyre, marrëdhëniet shqiptaro - greke, çështjen e Epirit, politikën e Fuqive të Mëdha ndaj çështjes shqiptare, rolin e tyre në përcaktimin e kufijve të Shqipërisë etj. Këtu dua të përmend veprën e Papa Piu II Epistolae. De Conventu Montvano (Letra. Mbi kuvendin e Mantovës) botuar më 1473 në Milano, që siç e dokumenton në fund të librit e ka blerë me një shumë të madhe për kohën).

Mit'hat Frashëri e çmonte mjaft rolin e bibliotekave e të librarive në përhapjen e kulturës së njerëzimit dhe në përparimin e shoqërisë. *Një bibliotekë*, thoshte ai, *s'është një hambar ku grumbullohen volume, si të linjtat në një arkë. Biblioteka, duhet të jetë një gjë e gjallë, që rron, që do ushqyer, që do shikuar, të jetë në kontakt me këndonjësit dhe* të plotësojë nevojat e tyre. *Më mirë akoma të jetë e zonja, të zgjojë merakun e tyre, t'i udhëheq një, t'i shtyjë në studim. T'u jetë e dobishme dhe këshilltare.* Nga fondi i kësaj biblioteke ne kemi rreth 18 mijë vëllime. Këto mbajnë vulat *Librarja Lumo Skëndo Tiranë* (Librairie Lumo Skëndo Tirana Albanie) dhe *Biblioteka Lumo Skëndo 1897.* Interesant është fakti që krahas vulave në fund të çdo libri Mit'hat Frashëri shënonte me laps librarinë ku e ka blerë librin, vendin, datën dhe çmimin e librit. Herë shënon pseudonimin Lumo Skëndo, herë Mit'hat Frashëri. Po kështu librat e bibliotekës françeskane kanë vulën *Bibljoteka Françeskane Shkodër.*

Së bashku me librat e trashëguara nga bibliotekat e familjeve të mëdha shqiptare si biblioteka e familjes Vlora, e Bushatllinjve, e Myftiut të Tabakëve, e Bibliotekës Françeskane, Mitropolisë së Beratit etj. këto biblioteka përbëjnë bërthamën dhe fondin me vlera albanologjike të pakrahasueshme të Bibliotekës Kombëtare. Dokumentet librare të tyre kanë vlera si për përmbajtjen, vjetërsinë, lidhjen e tyre, po ashtu edhe për shenjat dalluese si vula, stema, autografe dhe shënime të vetë pronarëve të këtyre bibliotekave.

Duke vlerësuar rëndësinë e këtyre thesareve kombëtare të bibliotekave private, një nga detyrat më të rëndësishme e bibliotekës tonë ka qenë dhe është evidentimi i tyre si dhe i vlerave që ato kanë. Vazhdimisht nga Biblioteka Kombëtare janë organizuar hulumtime për evidentimin e këtyre bibliotekave dhe të vlerave që ato mbartnin, në qytete të ndryshme si: Tiranë, Shkodër, Korçë, Vlorë, Elbasan etj. Këtu mund të përmendim bibliotekën e Nikolla Lakos, Milto Gurrës, Nasuf Tahir Dizdarit, Dhimitër Paskos (Tiranë), Nestor Nepravishtës, Familjes Ferra, Llambi Durrollit, Sotir Koçit (Vlorë), Robert Kostaq Cipos, Ilo Mitkë Qafëzezit, Nikolla Strallit, Vasil Naum Treskës (Korçë), Jup Kastratit, Villy Kamsit, Tomor Osmanit, Ragip Gjylbegut (Shkodër), familjes Vokopola (Berat) etj.

Me informacionet e siguruara u ngrit kartoteka e adresave të familjeve dhe personave privatë që kishin libra me vlerë kombëtare dhe mbi këtë bazë u bënë dhe bëhen përpjekjet për sigurimin e tyre për fondet tona. Kështu, me dëshirën e vetë familjarëve, është mundur të sigurohet nëpërmjet dhurimit apo blerjes një numër jo i vogël librash sidomos për fondet e antikuarit, dorëshkrimeve, arkivit, albanologjisë dhe ballkanologjisë.

Me këtë rast dua të falënderoj të gjithë ata persona apo familjarë që, duke vlerësuar rolin e Bibliotekës Kombëtare jo vetëm si një institucion ku depozitohen, ruhen, përpunohen dokumentet librore, por edhe si një institucion kryesor i informimit, institucion që këto vlera i ve në dispozicion të për-

doruesve, na kanë dhuruar mjaft botime me vlerë si: familjen e Pashko Gecit, biblioteka personale e të cilit përmban libra me karakter albano-ballkanologjik, metoda për mësimin e gjuhëve të huaja, si dhe fjalorë të ndryshëm; familjen e Mahir Domit që dhuroi nga biblioteka personale rreth 30 libra për fondin e arkivit, krahas librave me karakter albanologjik dhe periodikëve të ndryshëm; familjen Alimani për dhurimin e librave për fondin albanologjik dhe atë të arkivit; Bibliotekën e Bashkisë Shkodër për dhurimin e 58 dorëshkrimeve të viteve 1500 -1800 me përmbajtje gjuhësore, letrare, juridike, fetare etj. ; studiuesin nga Kosova z. Ali Rexhën, i cili dhuroi bibliotekën e tij personale me rreth 2200 libra në gjuhën shqipe, nga të cilat një pjesë e konsiderueshme e tyre plotësuan fondin e arkivit; familjen e Aleks Budës, biblioteka e të cilit krahas librave në shqip, përmban dhe mjaft libra në gjermanisht, italisht, frëngjisht, anglisht e rusisht etj. dhe në mënyrë të veçantë Kryeministrin e Shqipërisë z. Sali Berisha, i cili i dhuroi Bibliotekës Kombëtare nga biblioteka e tij personale dy botime antikuar : *Historia e Gjergj Kastriotit, i quajtur Skënderbe, mbret i Shqipërisë*/Jacques de Lavardin - Franche-Ville, 1604 (vepër që Biblioteka Kombëtare e kishte në fotokopje); *Historia e të madhërishmit dhe trimit, zotit Gjergj Kastrioti, i quajtur Skënderbe, princ i denjë i shqiptarëve*/ Marinus Barletius – Venetia, 1568 si dhe *Historia e Skënderbeut ose turqve dhe të krishterëve në shek. XV-të*/ Camille Paganel, 1890 që ka mjaft vlera për fondin e albanologjisë

Koleksionet e Bibliotekës Kombëtare janë zhvilluar dhe pasuruar edhe me blerje nga familje apo persona private të evidentuara nga ne. Po rendisim disa prej tyre:

Nga familja e Nikolla Lakos në Tiranë u blenë rreth 117 botime nga të cilat vlen të përmenden antikuarët:

- *Georgius Bartholdus Pontanus Scanderbegvs hoc est vita et res strenve feliciterque; gestae Georgii Kastrioti, Epiri Regis*, 1609 (Skënderbeu: jeta, bëmat dhe ngjarjet e suksesshme të Gjergj Kastriotit, mbret i Epirit, botim i vitit 1609). Në këtë vepër përfshihen ligjëratat dhe letrat e Skënderbeut që jepen në veprat "Historia e Skënderbeut" dhe "Rrethimi i Shkodrës". Në kurriz të fletës së titullit ka një portret të Skënderbeut.
- *George Guillet de Saint – Georges Histoire du regne Mahomet II Empereur des Turcs* Vol. 1, 1681 (Historia e sundimit të Mehmetit II, perandor i turqve, botim i vitit 1681). Libri përmban të dhëna për jetën dhe luftërat e Skënderbeut kundër sulltan Muratit II dhe në mënyrë të veçantë kundër sulltan Mehmetit II)
- *Andrea Cambini Commentario de Andrea Cambini Fiorentino, delle origine de Tvrchi, el Imperio delle casa ottomana*, 1540 (Komentar i Andrea Kambinit për origjinën e turqve dhe për perandorinë e shtëpisë osmane, botim i vitit 1540) etj., si dhe libra për fondin e arkivit, dhe harta të ndryshme të botuara në fillim të viteve 1900.

Nga familja e Robert Kostaq Cipos, që kishte një bibliotekë mjaft të pasur, u siguruan 103 libra. Krahas librave me karakter albanologjik u blenë botime antikuarë si:

- *Françesc Maria de Lecce Osservazioni grammaticali nella lingua albanesse 1716* (Vrojtime gramatikore në gjuhën shqipe, 1716 nga At Françesk Maria de Lecce). Vepra konsiderohet si vepra e parë tërësore që njihet për gramatikën e gjuhës shqipe.
- *Pjetër Budi Dottrina Christiana* (Doktrina kristiane), 1664.
- *Luciani Samosatensis Opera* (Vepra e Luciano Samosantesis) në greqisht dhe latinisht Vol. 1-7.

Nga familja e Nezir Çekanit vlejnë të përmenden dorëshkrimet si:

- *Letra e Faik Konicës drejtuar At Shtjefën Gjeçovit*, datuar më 1907, letër në të cilën Konica ndër të tjera jep mendime sidomos lidhur me afrimin mes dialekteve të shqipes, gegërishtes dhe toskërishtes, për krijimin e një gjuhe letrare të njësuar të shqipes.
- *Letra e Nikolla Kaçorrit drejtuar Shjefën Gjeçovit e vitit 1906*, ku flitet për situatën politike në Kurbin si dhe për revoltat e banorëve të zonës së Kurbinit.
- Shtjefën Gjeçovi. *Trashëgime pellazgësh: besime dhe doke shqiptare mes të cilave dëshmohet vjetërsia e kombit shqiptar*, 1907.

Një koleksion prej 74 hartash historike gjeografike, administrative, etj. të Shqipërisë dhe Ballkanit të botuara gjatë viteve 1890-1918, si dhe libra të karakterit albano-ballkanologjik u blenë nga *Agron Gashi*

Nga familja e Eli Papës janë blerë:

- dorëshkrimi *Akolouthia tou ajiou asiomarturos Nikodhemou tou neou* (Shërbesë e të shenjtit martir oshënar Nikodhimit të ri). Voskopojë, 1742. Ky dorëshkrim sjell elemente të reja dhe origjinale për plotësimin e figurës

së Nikodhim Vithkuqarit që nderohet si shenjtor në Shqipërinë e Jugut e përtej saj (Nikollë Dede) dhe së bashku me 7 botimet e Voskopojës përbëjnë vlera shumë të rralla për Bibliotekën Kombëtare.

- antikuarët : *Akolouthia tou ajiou endoksou basileos, kai megalomartorus Ioannou tou Bladimerou kai thaumatougou* (Shërbesa e mbretit të lavdishëm dhe dëshmorit të madh Joan Vladimirit), botime të viteve 1690 dhe 1774. Në botimin e vitit 1690 në faqen e titullit thuhet që ky libër është botuar prej Jani Papës nga qyteti i Elbasanit, kurse në botimin e vitit 1774 krahas shënimit të mësipërm në faqen e titullit, në faqen e fundit është mbishkrimi i Kishës së Manastirit që sjell të dhëna mbi ndërtimin e saj.

Në familjen e Llambi Durrollit Vlorë janë blerë antikuarët në gjuhën greke:

- *Përmbledhje fjalimesh dhe vargjesh poetike të disa shkrimtarëve të dëgjuar kishëtarë të shekullit të IV - Gjirokastër*, 1779-1786 që japin të dhëna për historinë e kishës ortodokse, për Ali Pashë Tepelenën dhe poezi të ndryshme.
- *Përmbledhje fjalësh hyjnore të etërve oshnarë (martirë) të fesë.*

Në *familjen Evangjeli* (Korçë) janë blerë 86 libra kryesisht me karakter balkanologjik si dhe fjalorë të ndryshëm; *në familjen Peshtani* 22 dorëshkrime, që u përkasin viteve 1720-1820 në arabisht, persisht, mbi letërsinë, fenë, gramatikën; *në familjen Vokopola* (Berat) 7 dorëshkrime në arabisht si përmbledhje letrash, gjuhësi, poezi fetare etj.

Pavarësisht nga vështirësitë që dalin, evidentimi i bibliotekave private mbetet një nga detyrat tona kryesore. Punën tonë e kemi përqendruar në bashkëpunimin me specialistë të ndryshëm, me biblioteka si dhe në kontaktet me persona private. E rëndësishme është që të identifikohen bibliotekat private, vlerat e tyre, të shikohet gjendja e tyre fizike dhe të restaurohen ato që kanë nevojë, në mënyrë që të ruhet jetëgjatësia e tyre. Krahas kësaj nuk do të reshtin përpjekjet për pasurimin e fondeve tona.

Për evidentimin e trashëgimisë kulturore kombëtare është krijuar *Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore* që ka për qëllim të krijojë e të zhvillojë një sistem të automatizuar të informacionit për mbrojtjen, studimin dhe administrimin e trashëgimisë kulturore, pavarësisht nga pronësia mbi të. Pra, kjo qendër duhet të inventarizojë edhe dorëshkrimet dhe botimet me vlera të veçanta historike.

Por deri më sot, nga ana e kësaj qendre nuk është bërë asnjë regjistrim i thjeshtë i librave të rrallë, qoftë për vendndodhjen e tyre të saktë apo edhe një përshkrim fizik dhe përmbajtjesor të tyre. Si rrjedhim këto vlera janë të ekspozuara ndaj rrezikut të zhdukjes, dëmtimit apo shitjes së tyre pa lënë gjurmë në vende të ndryshme të botës.

REZOLUTË

KONFERENCA KOMBËTARE E BIBLIOTEKONOMISË
"BIBLIOTEKA DHE KUJTESA KOMBËTARE"
(EDICIONI II)

Nën kujdesin dhe mbështetjen e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Shqipërisë, Ministrisë së Arsimit, Shkencës & Teknologjisë e të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Kosovës, në shtator të vitit 2006 u themelua Konferenca Kombëtare e Bibliotekonomisë si institucion i ri kulturor-shkencor i përbashkët Shqipëri-Kosovë.

Në bazë të marrëveshjes themeluese, nënshkruar mes Drejtorit të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, z. Aurel Plasari, dhe Drejtorit të Bibliotekës Kombëtare e Universitare të Kosovës, z. Sali Bashota, Konferenca ka tanimë organizim të përvitshëm, përkatësisht: një vit në Tiranë, një në Prishtinë.

Konferenca edicionin e saj të dytë e zhvilloi nën temën *Biblioteka dhe Kujtesa Kombëtare*, nga data 20-22 nëntor 2007, në mjediset e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës në Prishtinë.

Konferenca u ndoq nga autoritete të drejtimit dhe menaxhimit të bibliotekave kombëtare, universitare, publike etj. nga Kosova dhe Shqipëria, si dhe specialistë të bibliotekonomisë dhe Teknologjisë së Informacionit (IT) nga të dyja vendet.

Ajo trajtoi problematika që lidhen me problemin e kujdesit që duhet treguar në epokën digjitale ndaj kujtesës kombëtare, duke mbledhur, ruajtur jo vetëm shtypshkrimet, materialet jo libra, por edhe "objektet digjitale", të cilat përcaktojnë identitetin kombëtar; u ndriçuan si arritjet ashtu edhe sfidat me të cilat përballen sot sistemi i bibliotekave në Shqipëri dhe Kosovë.

Bazuar në gjendjen konkrete të bibliotekave për mbledhjen, dokumentimin dhe ruajtjen e kulturës kombëtare, pjesëmarrësit miratojnë rezolutën e mëposhtme:

Bibliotekat shqiptare në Kosovë dhe Shqipëri i realizojnë detyrat e tyre funksionale në kushtet e shoqërive të reja demokratike përkatëse. Pavarësisht veçanësive të zhvillimit ekonomik dhe social të të dy vendeve, ato prej kohësh janë ballafaquar me dukuri dhe problematika të përbashkëta për ruajtjen dhe zhvillimin e kujtesës kombëtare.

Problemi i funksionimit të bibliotekave në kushtet e përkushtimit për krijimin dhe ruajtjen e kujtesës kombëtare, në kushte të reja të shoqërisë digjitale, është esencial për ecurinë e këtyre institucioneve të rëndësishme të kulturës së librit. Brenda rrjedhave të zhvillimeve bashkëkohore europiane dhe botërore, mendimi kombëtar shqiptar është përpjekur t'u japë interpretim dhe zgjidhje problematikave bibliotekare si për grumbullimin dhe identifikimin, ashtu edhe arkivimin e trashëgimisë kombëtare përkatëse.

Konferenca theksoi rëndësinë e rishikimit të kuadrit ligjor në fushën e bibliotekave dhe trashëgimisë kulturore, ripërcaktimit të rolit të bibliotekarëve në kushtet e shoqërisë së informacionit, përzgjedhjes dhe ruajtjes së dokumenteve dhe informacioneve burimore në çdo lloj forme, të cilat paraqesin identitetin kombëtar - e gjitha kjo për t'i ardhur në ndihmë zgjidhjes së problemeve teorike dhe praktike me të cilat ato ndeshen në veprimtarinë e tyre të përditshme të ruajtjes së kujtesës kombëtare. Ajo nënvizoi gjithashtu se qartësimi i problemeve dhe ndërgjegjësimi teorik për aspekte themelore që kanë të bëjnë me proceset dhe llojet e organizimit dhe të përpunimit të koleksioneve nacionale, janë kërkesë e domosdoshme për shkëmbimin e informacioneve Shqipëri-Kosovë. Në këtë aspekt bibliotekat e dy vendeve duhet të përfshihen më shumë se deri më sot në projekte të përbashkëta në mbështetje të ruajtjes së kulturës kombëtare.

Bibliotekat tona mbështesin plotësisht nismat e Këshillit të Europës për ndërtimin e Bibliotekës Digjitale Europiane, si të gjitha Manifestet e IFLA-s, UNESCO-s për ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

Përdorimi i teknologjisë së informacionit duhet të shihet si mjet për rritjen e efektivitetit dhe të nivelit të ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe të shërbimin ndaj përdoruesve. Zgjedhja, organizimi dhe funksionimi i sistemeve të integruara bibliotekare kërkon përshtatje me teknologjitë digjitale në zhvillim, për të siguruar bashkëpunim të frytshëm mes bibliotekave tona, por edhe mes tyre dhe bibliotekave të rajonit dhe më gjerë. Bashkëpunimi në veprimtarinë informuese bibliografike dhe në krijimin e bazave të të dhënave do të krijonte më shumë mundësi për shkëmbimin e informacionit dhe përdorim të përbashkët të burimeve. Synimi është që secili të përfitojë nga mundësitë që krijon teknologjia e informacionit dhe e komunikimit për rritjen e akcesit për përdoruesit (Deklarata e të Drejtave të Njeriut).

Epoka e informacionit kërkon forcimin e rolit të bibliotekarit si mediator dhe kujdestar i ruajtjes së materialeve dhe informacionit për përdoruesit. Edukimi i vijueshëm profesional i tyre është faktor kyç për vlerësimin e burimeve të informacionit, zgjedhjen në përshtatje me kërkesat dhe mbledhjen dhe ruajtjen e materialeve në shërbim të përdoruesve, si dhe transmetimin e tyre brezave të ardhshëm. Organizmi i veprimtarive të përbashkëta n ë këtë fushë si edhe përditësimi me teoritë dhe praktikat bashkëkohore të bibliotekonomisë, duhet të shihet si domosdoshmëri për t'u përshtatur me rrjedhat e kohës. Njëkohësisht bibliotekari i sotëm duhet të luajë edhe rolin e edukatorit për Aftësimin në Informacion të përdoruesve, shpallur së fundmi edhe nga UNESCO. Për të arritur sfidat e parashtruara duhet të punojmë të gjithë së bashku për:

1) forcimin e rolit të bibliotekave si mbështetëse të trashëgimisë, demokracisë dhe të lirive intelektuale e të akcesit në informacion;
2) grumbullimin e kujtesës kombëtare;
2) zhvillimin e kulturës së leximit si mjet i pazëvendësueshëm në edukim, kulturë e shkencë;
3) krijimin e mjediseve të përshtatshme digjitale për të gjitha kategoritë e përdoruesve;
4) zgjerimin e përdorimit të teknologjisë së informacionit me synim rritjen e akcesit në shërbimet dhe burimet bibliotekare;
5) rritjen e besimit dhe sigurisë në përdorimin e teknologjisë nga përdoruesit;
6) respektimin e normave të etikës kulturore, profesionale dhe të komunikimit.

Pjesëmarrësit në konferencë janë të ndërgjegjshëm se zhvillimi i mëtejshëm i bibliotekave shqiptare në një botë të digjitalizimit të kujtesës kombëtare, kërkon angazhimin serioz të drejtuesve dhe stafeve të tyre, por edhe të institucioneve të tjera të kujtesës, muzeumeve dhe arkivave. Vetëm kështu ato do të ishin në gjendje të përmbushnin misionin e tyre si institucione të rëndësishme sociale, informuese dhe kulturore.

Prishtinë, më 22 nëntor 2007

KONFERENCA KOMBËTARE E BIBLIOTEKONOMISË
"BIBLIOTEKA DHE KUJTESA KOMBËTARE"

(EDICIONI II)
20 - 22 NËNTOR 2007

Botues:
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës
Prishtinë
2008

Shtypi
"Prograf"
Prishtinë

Katalogimi në botim - **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

02:061.3(496.51)"2007"

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë. Edicioni II. 2007. Prishtinë.
Konferenca Kombëtare e Bibliotekonomisë "Biblioteka dhe Kujtesa Kombëtare" : materialet e punimeve të Konferencës Kombëtare të Bibliotekonomisë : (Edicioni i II) : Prishtinë 20-22 nëntor 2007 / [Kryeredaktor i botimeve Sali Bashota]. - Prishtinë : BKUK, 2008. - 209 f. : ilustr. ; 23 cm. - (BKUK Botime të Veçanta ; 12 : Konferenca Kombëtare e Bibliotekonomisë ; 2)

1. Bashota , Sali

ISBN 978-9951-13-034-9